



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

“Mbi Auditimin e Përputhshmërisë në DPT”

Tiranë, shtator 2024

NR.	PËRMBAJTJA	FAQE
I	PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	3
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	10
II	HYRJA	13
1.	Objektivat dhe qëllimi	13
2.	Identifikimi i çështjes	13
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	14
4.	Përgjegjësitë e audituesve	14
5.	Kriteret e vlerësimit	14
6.	Standardet e auditimit	14
7.	Metodat e auditimit	16
8.	Dokumentimi i auditimit	16
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	16
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin.	16
2.	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.	18
2.1	Mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm.	18
2.2	Mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për planifikimin dhe realizimin e të ardhurave tatimore gjithsej dhe sipas strukturës dhe llojit të tyre.	36
2.3	Mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për arkëtimin e detyrimeve tatimore.	54
2.4	Mbi deklarimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, arkëtimi dhe rakordimi me ISSH dhe FSDKSH	76
2.5	Mbi trajtimin, miratimin dhe kryerjen e procedurës së rimbursimit të TVSH-së.	85
2.6	Mbi organizimin, funksionimin dhe vlerësimin e përputhshmërisë me kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullative të veprimtarisë së drejtorive në hartimin dhe mbështetjen e programeve, si dhe në funksionet operacionale.	91
2.7	Auditimi i planifikimit dhe zbatimit të buxhetit si dhe mbi hartimin e pasqyrave financiare.	145
2.8	Mbi strukturën organizative, administrimin e marrëdhënieve të punës dhe shpenzimet për pagat në institucion.	169
2.9	Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave në punë, mallrave dhe shërbimeve.	184
2.10	Mbi auditimin e menaxhimit financiar dhe kontrollin, si dhe vlerësimi i veprimtarisë së auditimit të brendshëm.	201
IV	REKOMANDIME	215

II. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është autoriteti shtetëror i specializuar, në varësi të Ministrisë së Financave për krijimin, sigurimin dhe mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë. Institucioni është i organizuar në nivel qendror me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, përgjegjëse për hartimin, monitorimin dhe zbatimin e strategjive dhe politikave operacionale efikase në realizimin e misionit të institucionit. Administrata Tatimore Qendrore administron mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe kontributeve shoqërore, duke nxitur përmbushjen vullnetare dhe duke kërkuar nga të gjithë kuptimin dhe respektimin e detyrimeve ligjore.

Financimi i institucionit kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) sipas programit buxhetor programit 01140-“Menaxhimi i të Ardhurave Tatimore”, pjesë e programeve buxhetore të administruara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe bazuar në Programin e Auditimit 473/1, prot datë 15.04.2024, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, u ushtrua auditim në këtë drejtori lidhur me veprimtarinë për planifikimin dhe realizimin e të ardhurave tatimore; për arkëtimin e detyrimeve tatimor; mbi deklarimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore; arkëtimin dhe rakordimin me ISSH dhe FSDKSH; mbi trajtimin, miratimin dhe kryerjen e procedurës së rimbursimit të TVSH-së; mbi organizimin, funksionimin dhe vlerësimin e përputhshmërisë me kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullative të veprimtarisë së drejtorive në hartimin dhe mbështetjen e programeve, si dhe në funksionet operacionale; mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit si dhe mbi hartimin e pasqyrave financiare; mbi strukturën organizative, administrimin e marrëdhënieve të punës dhe shpenzimet për pagat në institucion; mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave në punë, mallrave dhe shërbimeve; mbi auditim e menaxhimit financiar dhe kontrollin, si dhe vlerësimi i veprimtarisë së auditimit të brendshëm, për periudhën 01.01.2023-31.12.2023.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është një njësi e krijuar në mbështetje të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe ligjit nr. 90/2012, datë 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”.

Realizimi i këtij auditimi është kryer në mbështetje të planit vjetor të vitit 2023, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit. Auditimi i këtij institucioni nga Kontrolli i Lartë të Shtetit, lidhur me transparencën e veprimtarisë së institucionin në drejtim të realizimit të të ardhurave tatimore kundrejt planit, deklarimin, arkëtimin dhe rakordimin me ISSH dhe FSDKSH të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, procedurat e rimbursimit të TVSH-së, realizimin e buxhetit të akorduar, si dhe funksionimit të strukturave përbërëse të saj, përbëjnë një rëndësi me një rëndësi të veçantë për hartimin e raportit vjetor të zbatimit të buxhetit.

c. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2023, nëpërmjet evidentimit të devijimeve nga standardet e pranuar, të shkeljeve të parimeve e të ligjshmërisë, të menaxhimit financiar, me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga ana e subjektit të audituar.

Nëpërmjet kryerjes së këtij auditimi KLSH synon të promovojë:

- Transparencën, duke ofruar raport të besueshëm për fondet nëse janë mbledhur dhe administruar sipas një procesi të rregullt dhe është respektuar kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi;
- Përgjegjshmërinë ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor e rregullator, në mënyrë që të mund të merren veprime korigjuese dhe personat përkatës të përgjigjen për veprimet e tyre;
- Qeverisjen e mirë, duke identifikuar dobësitë dhe duke vlerësuar rregullshmërinë aty ku kuadri ligjor rregullator rezulton i pamjaftueshëm dhe/ose i papërshtatshëm, si dhe duke marrë parasysh riskun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë.

Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësimin me synim marrjen e masave dhe veprimeve korigjuese nga subjekti i audituar.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm.
- Mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për planifikimin dhe realizimin e të ardhurave tatimore gjithsej dhe sipas strukturës dhe llojit të tyre.
- Mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për arkëtimin e detyrimeve tatimore.
- Mbi deklarimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, arkëtimi dhe rakordimi me ISSH dhe FSDKSH.
- Mbi trajtimin, miratimin dhe kryerjen e procedurës së rimbursimit të TVSH-së.
- Mbi organizimin, funksionimin dhe vlerësimin e përputhshmërisë me kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullative të veprimtarisë së drejtorive në hartimin dhe mbështetjen e programeve, si dhe në funksionet operacionale.
- Auditimi i planifikimit dhe zbatimit të buxhetit si dhe mbi hartimin e pasqyrave financiare
- Mbi strukturën organizative, administrimin e marrëdhënieve të punës dhe shpenzimet për pagat në institucion.
- Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave në punë, mallrave dhe shërbimeve.
- Mbi auditim e menaxhimit financiar dhe kontrollin, si dhe vlerësimi i veprimtarisë së auditimit të brendshëm.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Metodatat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit, në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testeve të kryera, me qëllim arritjen e objektivave të auditimit në bazë të vlerësimit të riskut.

Në këtë auditim janë përzgjedhur metoda, metodologji apo teknika auditimi dhe shtrirje të procedurave të auditimit, për të dhënë siguri të arsyeshme për arritjen e konkluzioneve të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodatat dhe teknikat e mëposhtme:

- Intervistimi- duke komunikuar dhe marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;
- Raporte dhe informacione - shfrytëzimi i raporteve, informacioneve relevante dhe që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht me drejtimit e auditimit;
- Verifikimi në sistemet DPT (C@TS)- me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;

- Teknikat me ndihmën e kompjuterit - për procedura të programuara, për të bërë testimet ose për nxjerrjen të dhënave për testim të mëtejshëm;
- Verifikime transaksionesh – me përzgjedhje i çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;
- Të kombinuara, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve.

Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën objekt auditimi paraqet problematika dhe mangësi në disa drejtime të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 35 gjetje dhe rekomandime, nga të cilat 34 masa organizative dhe 1 masë për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore.

-Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, konstatohet se nga 32 rekomandime të lëna, subjekti ka pranuar 27 rekomandime, ose 84% e tyre dhe nuk ka pranuar 5 rekomandime. Janë zbatuar plotësisht 7 rekomandime, janë zbatuar pjesërisht 6 rekomandime dhe nuk janë zbatuar 14 rekomandime ose 51.9 % e tyre.

- DPT nuk dokumenton një kontribut përgjatë përgatitjes së planit të të ardhurave, nëpërmjet analizave lidhur me parashikimin e arkëtive, projekt plane, apo raporteve të tilla të ngjashme, duke konsistuar kështu në kryerjen e një roli vetëm zbatues të planit të të ardhurave.

- Nga ana e DPT raportohen si të ardhura edhe parapagimet e tatim fitimit, duke vepruar jo në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, pasi nuk plotësohen kushtet për klasifikimin si të ardhur duke qenë se nuk lidhen me një pagesë pa kthim. Konstatohet se në realizimin e të ardhurave tatimore, raportohen edhe të ardhurat që arkëtohen si gjopa të sistemit tatimor, të cilat për vitin 2023 përlllogariten në vlerën rreth 876 milion lekë, problematikë kjo e konstatuar edhe në auditimin e mëparshëm. DPT përfshin si të ardhur nga kontributet edhe të ardhurat nga gjobat për deklarim të vonuar të kontributeve dhe TAP, gjopa për mos deklarim punonjësish dhe depozitime të përkohshme për listëpagesën e kontributeve dhe TAP, në vlerën totale për 391,853 mijë lekë.

- Gjendja e detyrimeve tatimore të papaguara në fillim të vitit 2023 paraqitet në vlerën rreth 146,767 milion lekë, që i përket një numri prej 182,490 subjektsh debitore, dhe në fund të vitit 2023 këto detyrime rezultojnë në vlerën rreth 155,165 milion lekë që i përket një numri prej rreth 181,023 subjektsh debitore. Detyrimet e shtuara gjatë vitit 2023 janë 40 miliard lekë ose afërsisht 3 miliard lekë më shumë krahasuar me vitin 2022, ku detyrimet e shtuara ishin 37 miliard lekë. Arkëtimet paraqiten në vlerën 31 miliard lekë, krahasuar më vitin paraardhës ku arkëtimin ishin 24 miliard lekë, këtë vit janë mbledhur afërsisht 7 miliard lekë më shumë. Nga auditimi konstatohet se Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka një vlerë detyrimi tatimor të papaguar jashtë sistemit C@TS në vlerën 2,351,817,199 lekë.

- Nga auditimi u konstatua se DRT Fier dhe DRT Vlorë, nuk kanë përfshirë në planin akumulativ të kontributeve, ndryshimet e dërguara nga Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës sipas Aktit Normativ nr. 5, datë 18.10.2023, veprim që ka sjellë raportim të pasaktë nga këto Drejtori Rajonale, të planifikimit dhe realizimin e të ardhurave për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për vitin 2023.

- Për vitin 2023 rimbursimi për TVSH-në është programuar në shumën për 18,000,000 mijë lekë, i cili nuk ka ndryshuar gjatë vitit dhe është realizuar në shumën 22,614,132 mijë lekë

duke rezultuar me tejkalim në shumën 4,614,132 mijë lekë, ose 25.63% më shumë kundrejt planit të rimbursimit.

-Nga auditimi u konstatua se në mbyllje të periudhës ushtrimore 2023, rezultojnë 9 kërkesa për rimbursimin e TVSH-së të pranuar por të pa miratuara në vlerën totale për 100,569,976 lekë, të cilat megjithëse kanë kaluar afati maksimal prej 60 ditëve nga data e paraqitjes së tyre nuk janë rimbursuar.

- Nga auditimi konstatohet se për vitin 2023 nga vetëdeklarimet e Drejtorive Rajonale Tatimore nuk janë filluar 109 kontrole nga 2,982 kontrole të planifikuara ose rreth 4% e totalit, duke krijuar një stok të subjekteve të planifikuara për kontroll dhe të pa kontrolluara, si pasojë edhe e mos koordinimit midis Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut dhe Drejtorive Rajonale.

- Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Menaxhimit të Riskut pranë DPT në 5 vitet e fundit nuk ka kryer për asnjë rast propozim kontrolli për subjektet e regjistruara si "OJF", pavarësisht qarkullimit të lartë që këto subjekte realizojnë, ku nga databaza e aktivitetit për 5 vitet e fundit, ekzistojnë OJF me qarkullim deri në 728,808,724 lekë, por gjithashtu edhe për risqet e tjera që këto biznese mbartin të tilla si diferenca mes të ardhurave/shpenzimeve të deklaruara në pasqyrat financiare të dorëzuara në C@ts, krahasuar me situatën që është raportuar në FDP, pagave të ulëta të deklaruara në listëpagesa, tatimit në burim, pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit etj.

-Nga auditimi u konstatua se nuk ka një rakordim midis Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut dhe Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, lidhur me problematikat, kontrollet e ushtruara dhe rezultatet e Planeve Operacionale sipas listave të gjeneruara për verifikim në bazë të kriterëve të riskut të thyera

- Nga auditimi i akt konstatimeve të mbajtur nga inspektorët e DVKT, në sistemin informatik tatimor C@ts në lidhje me verifikimet në terren, ka rezultuar se ato janë jashtë tematikës së përcaktuar për verifikim nga analiza e riskut të DMR, sipas kriterëve të riskut të thyera.

-Nga auditimi është konstatuar se gjatë vitit 2023 grupet e verifikimit në terren nuk kanë qenë të pajisur me sistemin elektronik të monitorimit "E-Inspektor", i cili shërben për regjistrimin e veprimeve të punës, monitorimin e inspektorëve gjatë kryerjes së kontrollit në terren, identifikimin dhe regjistrimin e subjekteve të tatuashme, rritjen e transparencës dhe përmirësimin e monitorimit në procesin e kryerjes së inspektimeve nga administrata tatimore, automatizimin e proceseve të punës si dhe arritjen e objektivave në luftën kundër informalitetit.

- Nga auditimi i planit dhe realizimit të kontroleve për vitin 2023, konstatohet se ka një mosrealizim të kontroleve në 2 DRT më të rëndësishme konkretisht DRT Tiranë me 12.34% të kontroleve dhe DTM me 0.85% të kontroleve. Nga analiza e të dhënave mbi evidencat e fazave në të cilat ndodhen kontrollet në proces, rezulton se stoku i kontroleve të papërfunduara nga Drejtoritë Rajonale Tatimore, vijon të jetë i konsiderueshëm.

-Nga auditimi për zbatimin e përputhshmërisë ligjore të afateve proceduriale, i të dhënave të vendosura në dispozicion nga Sektori i Hetimit Tatimor, në lidhje me rastet e ndjekur të cilat janë në proces deri në datë 31.12.2023, rezultojnë tejkalime të afateve administrative të hetimit dhe trajtimit mbi 6 muaj.

-Nga auditimi konstatohet se nga krahasimi i listës së investimeve të programuara përgjatë procesit të planifikimit dhe realizimit të buxhetit të vitit 2023, konstatohet se projekti i investimit me kod 18AV815 "Blerje pajisje kompj.", nuk është pjesë e fazës së parë të PBA 2023-2025, por është shtuar në fazën e dytë në vlerën 5,000 mijë lekë. Projekti me kod 22AD801 "Përmirësimi i sistemit E- taxation" nuk është planifikuar në PBA 2023-2025, faza e II, edhe pse sipas shkresës së AKSH dhe DPT ky investim ka prioritet të lartë pasi rrezikon që të çojë deri në mosfunksionim të sistemit e-Tax dhe bllokim të punës së administratës tatimore. Investimi i përcjellë nga AKSHI nuk përputhet me investimin e miratuar në buxhet, si në aspektin e fondit të tejkalkuar rreth 300 milion lekë si dhe elementeve dhe zërave të tjerë të shtuar për këtë investim në proceset e: rishikimit të termave të referencës, testimit të tregut,

përlllogaritjen e fondit limit si dhe hartimit të kriterëve të veçanta. Risk shumë i lartë mbetet edhe kontrata e mirëmbajtjes nr. 46, datë 06.01.2021 e cila ka përfunduar më 06.01.2023, dhe nuk është përsëritur përgjatë vitit 2023 dhe sistemi ka operuar pa mirëmbajtje.

- Nga auditimi me përzgjedhje i veprimeve me bankën u konstatuan 10 urdhër-shpenzime nga ana e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës, për të cilat janë kryer likuidimet në tejkalim të afatit 30 ditor nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik.

- Nga auditimi konstatohet se DPT për vitin 2023 efekti në krijim e detyrimeve të prapambetura vlerësohet të jetë 311 milion leke nga të cilat vendimet gjyqësore (subjekte) në vlerën 239,153 mijë lekë, 137,268 mijë lekë ish punonjës dhe Detyrime te prapambetura shtypshkrimesh në vlerën 12,873 mijë lekë. Në pasqyrat financiare të DPT nuk janë llogaritur provizione për shpenzimet.

-Nga auditimi konstatohet se DPT përsa i përket procesit të vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi për vitin 2022, në administratën e DPT, për aktivet për procedurë ankandi nuk është ndjekur procedura e shitjes në ankand.

- Në muajin Dhjetor 2023 DPT paraqitet me një shtim të numrit të vakancave krahasuar me fillim vitin, ku konkretisht nga 1450 pozicione pune që ka struktura në total janë të punësuar në total 1212 ku 913 prej tyre janë me status të nëpunësit civil dhe 299 me kod pune, pra 238 pozicione pune janë vakante, ku 207 prej tyre janë pozicione me status të nëpunësit civil dhe 31 pozicione me kod pune.

- Nga totali i 109 ish punonjësve gjyqfitues, rezultojnë se 77 prej tyre janë ish nëpunës me status të nëpunësit civil dhe 32 ish punonjës me kod pune. Nga totali ish nëpunësve civil, rezulton se 12 janë ish-punonjës të rikthyer, 1 ish-punonjës ka ndërruar jetë, 8 ish-punonjës në pension dhe 56 ish-punonjës janë të pa sistemuar. Kryetari i Komisionit të Posaçëm në DPT përgjatë vitit 2023 nuk e ka thirrur asnjëherë komisionin, pavarësisht 56 gjyqfituesve të pa sistemuar që rezultojnë në databazën e DPT për të cilët vijoje të kryhen pagesa për pagat e tyre të cilat shoqërohen m detyrime shtesë vit pas viti për buxhetin e shtetit, duke argumentuar sërish se shkak për këtë ka qenë procesi i ristrukturimit i pa finalizuar.

- M urdhër nr. 69, datë 26.05.2023 të Kryeministrit, është miratuar struktura organizative e administratës tatimore qendrore me numër total të personelit të administratës tatimore qendrore prej 1450 veta. Me urdhër nr. 189, datë 08.08.2023 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, është miratuar organigrama, pra konstatohet se në vijim të urdhrin nr. 69, prot datë 26.05.2023 të Kryeministrit, nga ana e Ministrisë së Financave është miratuar organigrama mbi 2 muaj më vonë. Nga verifikimi i afateve të të gjithë procesit të ristrukturimit, rezulton se nga momenti i miratimit të strukturës së re, e deri në daljen e vendimit për transferimin e përhershëm të nëpunësve civil brenda administratës tatimore, procesi i ka tejkaluar afatet. Procesi i ristrukturimit ka qenë në proces deri në fund të periudhës objekt auditimi, dhe ka vijuar përgjatë vitit 2024.

- Në dy raste nga auditimi i dokumentacionit të procedurës së prokurimit “Rikonstruksion i godinës të DRT Elbasan” dhe “Rikonstruksion i godinës të DRT Vlorë”, për vitin 2023, janë konstatuar mangësi në zhvillimin e procedurës për hartimin e DST-ve në lidhje me kriteret e vendosura, janë konstatuar kritere jo në përputhje me natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë paargumentuar, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

-Nga auditimi u konstatua se pas ndryshimit të emërtimit të një sektori të DAB, nuk është përditësuar Karta e Auditit, si dhe nuk është përcjellë për miratim tek titullari i institucionit. Komiteti i Auditimit të Brendshëm nuk ka dërguar në DPT, vendimin me mendimin dhe rekomandimin pozitiv ose jo, për planin vjetor 2023 dhe planin strategjik 2023-2025, për shkak të përfundimit të mandatit të anëtarëve të tij.

- Nga auditimi konstatohet se në fillim të vitit 2023 rezultojnë detyrime të prapambetura për ish punonjës gjyqfitues në vlerën 137,268 mijë lekë. Përgjatë vitit 2023, për ish punonjësit janë

likuiduar detyrime në vlerën 216,523 mijë lekë, e cila konsiderohet efekt financiar negativ në buxhetin e shtetit. Vlera e detyrimeve të lindura përgjatë vitit 2023 është 138,422 mijë lekë, dhe deri në fund të vitit 2023, rezultojnë detyrime të prapambetura për ish punonjës gjyqfitues në vlerën 59,167 mijë lekë. Nga totali i pagesave të kryera nga buxheti i shtetit për ish punonjësit gjyqfitues konstatohen se janë kryer likuidime të tarifave përmbartimore, duke e rënduar kështu buxhetin e shtetit për shkak të mos ekzekutimit në kohë të këtyre pagesave me 5,964 mijë lekë.

h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore

Me qëllim zgjidhjen e problematikave dhe përmirësimin e situatës, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

-Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për strukturat e ngarkuara në planin e masave, të cilët nuk kanë realizuar zbatimin e rekomandimeve, si dhe ri kërkojmë të merren masa nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e rekomandimeve që janë në proces zbatimi, pjesërisht të zbatuara si dhe të pa zbatuara.

- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të marrin masat për ngritjen e një grupi pune me përfaqësues nga këto dy institucione për analizimin e procedurave aktuale të ndjekura për përcaktimin e planit vjetor të ardhurave nga tatim fitimi, konkretisht lidhur me parapagesat e kësteve të tatim fitimit; gjobave; penaliteteve; kamatëvonesave, etj, me qëllim raportimin e realizimit të të ardhurave për këtë zë në koherencë me planin.

- Drejtori i Drejtorisë së Mbledhjes të Detyrimit Tatimor të Papaguara, në DPT, të ndërmarrë masat shtrënguese duke përdorur instrumentet e duhura për mbledhjen me forcë të detyrimit tatimor.

- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në bashkëpunim me DRT-të përkatëse, të marrin masat e duhura për të kryer procesin e hedhjes së detyrimeve në sistem në total për 775 subjekte në vlerën 150,192,552 lekë dhe 6 individë në vlerën 5,176,509 lekë, për të cilët ekziston mundësia e hedhjes në sistemin C@TS.

- Titullari i institucionit të marrë masat e nevojshme që Drejtoritë Rajonale Tatimore të përfshijnë në Planin akumulativ të gjitha ndryshimet sipas AN, që dërgohen nga Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës në DPT, të kryejnë analiza të performancës mbi mos realizimin e planit të të ardhurave të kontributeve, si dhe raportim të saktë të planifikimit dhe realizimit vjetor.

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë në kuadër të përcaktimit të planit vjetor të rimbursimit të TVSH-së, të marrë masat për të bashkëpunuar me DPT për një planifikim sa më real të vlerës së rimbursimeve, me qëllim parandalimin e kryerjes së pagesave përtej planit të miratuar.

-Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve të marrë masat për të intensifikuar procedurat monitoruese të subjekteve objekt rimbursimi i TVSH-së përgjatë aktivitetit të tyre, me qëllim garantimin e një projektimi sa më efektiv të kufijve të rimbursimit nga ana e tyre, dhe respektimin e afateve ligjore në kryerjen e procesit të rimbursimit të TVSH-së, në kuadër të miradministrimit të fondeve buxhetore.

- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të marrë masa që në aktivitetet e planifikimit për kontroll të reflektohet stoku i kontrolleve të mbartura nga viti i kaluar dhe në bashkëpunim me DRT të shkëmbejë në kohë informacion për problematikën e kontrolleve tatimore.

-Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut, të kryejë një analizë të detajuar të treguesve financiarë të deklaruar të OJF-ve për 5 vitet e fundit, sipas kriterëve të riskut, me qëllim përfshirjen për kontroll të thelluar në vend të subjekteve që paraqesin risk të lartë sipas kriterëve të thyera.

- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut, të kryejë një analizë të detajuar për çdo plan operacional të nxjerrë nga DMR për të patur një nivel matës të rezultateve të dala nga listat e gjeneruara nga kjo drejtori.
- Komiteti i Riskut në Drejtorin e Përgjithshme të Tatimeve, brenda tagrit dhe kompetencave ligjore të analizojë shkaqet e problematikave në performancën e DVKT përgjatë sezonit turistik për të verifikuar listën e tatimpaguesve me kritere të thyera riskut të gjeneruara nga DMR, dhe të merren masat me qëllim përmirësimin e situatës.
- Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të implementohen procedura rakordimi me DRT me qëllim planifikimin e saktë të burimeve kohore dhe njerëzore në dispozicion për kryerjen e kontroleve sipas aktivitetit vjetor.
- Nga Drejtori i Përgjithshme e Tatimeve të ngrihet grup pune për të analizuar shkaqet e tejkalimit të afateve ligjore procedurale në hetimin e subjekteve nga Sektori i Hetimit Tatimor dhe të merren masa me qëllim përmirësimin e situatës së rasteve hetimore në proces.
- Planifikimi buxhetor afatmesëm nga DPT, të kryhet sa më afër nevojave të institucionit si dhe të zhvillohen takime dhe bashkëbisedime me përfaqësues të AKSH-it për të rritur bashkëpunimin midis tyre mbi projekte të cilat në zhvillimin dhe përmirësimin e punës së kryer në DPT, po ashtu që të mos ketë mospërputhje me investimin e miratuar në buxhet.
- Drejtoria e Financës të marrë masa për likuidimin e faturave në kohë dhe sipas datave të faturimit për të shmangur rritjen e detyrimit si dhe të penaliteteve që mund të vijnë si pasojë e vonesave të likuidimit.
- Nga e DPT-së për aktivet për procedurë ankandi të ndiqet procedura e shitjes në ankand si dhe të realizohet procedura e kalimit të aseteve nga DPT tek AKSHI.
- Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve në bashkëpunim me DAP, të marrë masa për plotësimin e vendeve vakante në zbatim të urdhrin nr. 69, datë 26.05.2023, të Kryeministrit, nëpërmjet procedurave të rekrutimit apo sistemit të gjyqftuesve, me qëllim shmangien e vakancave që cënojnë kryerjen e detyrave funksionale sipas strukturave përkatëse.
- AK në hartimin e DST, të marrë masa në vijimësi të shmangë aplikimin e kritereve që nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargometuara dhe jo në përputhje me procedurën e zhvilluar.
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK, të marrë masat që:
- Struktura e re organizative e DPT dhe Raportet e monitorimit të buxhetit 4, 8 dhe 12 mujore, të publikohen në faqen zyrtare të internetit të institucionit, në kuadër të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoritetit publik.
- Drejtoria e Burimeve Njerëzore në DPT të kryejë një analizë mbi numrin e saktë të vakancave në institucion, me qëllim plotësimin e tyre. Të planifikojë programe trajnimit për punonjësit, në njohje të ligjit “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe të bëjë të mundur njohjen e nëpunësit me përshkrimin e punës së tij, si dhe duke e nënshkruar atë.
- Titullari i institucionit të urdhërojë krijimin e grupin e menaxhimit të riskut (GMR), si dhe të organizojë takime me stafin menaxherial me qëllim diskutimin e çështjeve të menaxhimit të riskut në institucion. Të miratojë: Gjurmën e Auditimit për procedurat e proceset që lidhen me veprimtarinë kryesore të DPT, “Hartën e proceseve të punës” dhe “Manualin e proceseve të punës”, i cili ndihmon institucionin të jetë i sigurt se nuk ka asnjë aktivitet pa person përgjegjës dhe që të gjithë punonjësit kanë përgjegjësitë përkatëse dhe të drejtën për të nënshkruar dokumente.
- Titullari i institucionit të marrë masa për plotësimin e pozicioneve vakante në këtë Drejtori, sipas strukturës së miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 69 datë 26.05.2023 “Për miratimin e strukturës organizative të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”.
- Drejtoria e Auditit të Brendshëm të përcjellë për miratim te Drejtori i Përgjithshëm, Kartën e Auditit, të përditësuar.

- Ministria e Financave si organi epror i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të urdhërojë emërimin e anëtarëve të Komitetit të Auditimit të Brendshëm, roli i të cilit përmes mendimeve për Planin strategjik e vjetor, monitorimin e raporteve të DAB, këshillimit e rekomandimeve objektive, i jep titullarit të DPT mbështetje në përmbushjen e përgjegjësive të saj.

- Drejtori i Përgjithshëm i DPT të marrë masat për analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësive për të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore të depozituara në DPT, duke intensifikuar procedurat aktuale të ndjekura në drejtim të përfaqësimit të institucionit për çështjet gjyqësore në proces, shoqëruar me efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit.

-Drejtori i Përgjithshëm i DPT të garantojë një rol më aktiv në drejtim të veprimtarisë së komisionit për sistemimin e gjyqfutesve, me qëllim arritjen e vendimmarrjeve efektive për sistemimin e gjyqfutesve, për të mos vijuar me likuidimin e tyre për periudha disa vjeçare, duke sjellë kështu duplikim të pagesave për çdo pozicion pune, pasi për të njëjtin pozicion pune, paguhen edhe ish-punonjësi që ka fituar gjyqin për largim të padrejtë nga puna dhe punonjësi i emëruar rishtaz në administratën tatimore.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit

OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion i auditimit të përputhshmërisë.

Ne kemi audituar zbatueshmërinë e akteve ligjore nën ligjore dhe rregullative (burimi i kriterëve të paracaktuara të vlerësimit), për veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve në lidhje me realizimin e të ardhurave tatimore, arkëtimin e detyrimeve tatimore, deklarimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, rimbursimin e TVSH-së, veprimtarisë së drejtorive në hartimin dhe mbështetjen e programeve, si dhe në funksionet operacionale, planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, strukturën organizative, planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik dhe zbatimin e kontratave, auditimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe vlerësimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm.

Opinion i modifikuar/kualifikuar¹

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjeve të cilësuar në paragrafin e “Baza për opinionin e modifikuar/kualifikuar” subjekti i audituar, DPT ka vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit (Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligji nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar, Ligji nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore dhe rregullatore mbi të cilët ushtron veprimtarinë DPT), gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj.

Baza për opinionin e modifikuar/kualifikuar:

Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për përputhshmërinë.

¹ *Opinionin i modifikuar, i cilësuar/kualifikuar: Audituesi duhet të shprehë një opinion të cilësuar, kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura*

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për dhënien e këtij opinionii.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, subjekti i audituar DPT, në disa raste nuk ka vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit. Shkeljet e evidentuara në disa çështje të audituara, janë materiale por jo të përhapura, referuar popullatave, nën popullatave të kampionuara dhe kampioneve të testuara, sipas përshkrimit të mëposhtëm:

Përshkrimi i çështjeve kryesore:

- DPT nuk dokumenton një kontribut përgjatë përgatitjes së planit të të ardhurave, nëpërmjet analizave lidhur me parashikimin e arkëtive, projekt plane, apo raporteve të tilla të ngjashme, duke konsistuar kështu në kryerjen e një roli vetëm zbatues të planit të të ardhurave. Nga ana e DPT raportohen si të ardhura edhe parapagimet e tatim fitimit, gjopa të sistemit tatimor, dhe penalitete, pavarësisht se nga MFE në planin e miratuar nuk përfshihen këto të ardhura.

- Gjendja e detyrimeve tatimore të papaguara në fillim të vitit 2023 paraqitet në vlerën rreth 146,767 milion lekë, që i përket një numri prej 182,490 subjektsh debitorë, dhe në fund të vitit 2023 këto detyrime rezultojnë në vlerën rreth 155,165 milion lekë që i përket një numri prej rreth 181,023 subjektsh debitorë. Detyrimet e shtuara gjatë vitit 2023 janë 40 miliard lekë ose afërsisht 3 miliard lekë më shumë krahasuar me vitin 2022, ku detyrimet e shtuara ishin 37 miliard lekë. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka një vlerë detyrimi tatimor të papaguar jashtë sistemit C@TS në vlerën 2,351,817,199 lekë.

-Rimbursimi për TVSH-në bazuar në ligjin vjetor të buxhetit është programuar në shumën për 18,000,000 mijë lekë dhe është realizuar në shumën 22,614,132 mijë lekë duke rezultuar me tejkalim në shumën 4,614,132 mijë lekë, ose 25.63% më shumë kundrejt planit të rimbursimit. Në mbyllje të periudhës ushtrimore 2023, rezultojnë 9 kërkesa për rimbursimin e TVSH-së të pranuar por të pa miratuara në vlerën totale për 100,569,976 lekë, të cilat megjithëse kanë kaluar afati maksimal prej 60 ditëve nga data e paraqitjes së tyre nuk janë rimbursuar.

- Nga vetëdeklarimet e Drejtorive Rajonale Tatimore nuk janë filluar 109 kontrolle nga 2,982 kontrolle të planifikuara ose rreth 4% e totalit, duke krijuar një stok të subjekteve të planifikuara për kontroll dhe të pa kontrolluara, si pasojë edhe e mos koordinimit midis Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut dhe Drejtorive Rajonale. Nuk ka një rakordim midis Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut dhe Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, lidhur me problematikat, kontrollet e ushtruara dhe rezultatet e Planeve Operacionale sipas listave të gjeneruara për verifikim në bazë të kriterëve të riskut të thyera. Drejtoria e Menaxhimit të Riskut pranë DPT në 5 vitet e fundit nuk ka kryer për asnjë rast propozim kontrolli për subjektet e regjistruara si “OJF”, pavarësisht qarkullimit të lartë që këto subjekte realizojnë, ku nga databaza e aktivitetit për 5 vitet e fundit, ekzistojnë OJF me qarkullim deri në 728,808,724 lekë, por gjithashtu edhe për risqet e tjera që këto biznese mbartin. Nga auditimi i akt konstatimeve të mbajtur nga inspektorët e DVKT, në sistemin informatik tatimor C@ts në lidhje me verifikimet në terren, ka rezultuar se ato janë jashtë tematikës së përcaktuar për verifikim nga analiza e riskut të DMR, sipas kriterëve të riskut të thyera.

-Gjatë vitit 2023 grupet e verifikimit në terren nuk kanë qenë të pajisur me sistemin elektronik të monitorimit “E-Inspektor”, i cili shërben për regjistrimin e veprimeve të punës, monitorimin e inspektorëve gjatë kryerjes së kontrollit në terren, identifikimin dhe regjistrimin e subjekteve të tatueshme, rritjen e transparencës dhe përmirësimin e monitorimit në procesin e kryerjes së inspektimeve nga administrata tatimore, automatizimin e proceseve të punës si dhe arritjen e objektivave në luftën kundër informalitetit.

- Konstatohet mosrealizim i kontrolleve në 2 DRT më të rëndësishme konkretisht DRT Tiranë me 12.34% të kontrolleve dhe DTM me 0.85% të kontrolleve. Nga analiza e të dhënave mbi evidencat e fazave në të cilat ndodhen kontrollet në proces, rezulton se stoku i kontrolleve të papërfunduara nga Drejtoritë Rajonale Tatimore, vijon të jetë i konsiderueshëm.

-Nga auditimi për zbatimin e përputhshmërisë ligjore të afateve procedurale, i të dhënave të vendosura në dispozicion nga Sektori i Hetimit Tatimor, në lidhje me rastet e ndjekur të cilat janë në proces deri në datë 31.12.2023, rezultojnë tejkalime të afateve administrative të hetimit dhe trajtimit mbi 6 muaj.

-Për vitin 2023 efekti në krijim e detyrimeve të prapambetura vlerësohet të jetë 311 milion leke.

- Në muajin Dhjetor 2023 DPT paraqitet me një shtim të numrit të vakancave krahasuar me fillim vitin, ku konkretisht 238 pozicione pune janë vakante, nga të cilat 207 prej tyre janë pozicione me status të nëpunësit civil dhe 31 pozicione me kod pune.

- Nga totali i 109 ish punonjësve gjyqfitues, rezultojnë se 77 prej tyre janë ish nëpunës me status të nëpunësit civil dhe 32 ish punonjës me kod pune. Nga totali ish nëpunësve civil, rezulton se 12 janë ish-punonjës të rikthyer, 1 ish-punonjës ka ndërruar jetë, 8 ish-punonjës në pension dhe 56 ish-punonjës janë të pa sistemuar.

- M urdhër nr. 69, datë 26.05.2023 të Kryeministrit është miratuar struktura organizative e administratës tatimore qendrore dhe me urdhër nr. 189, datë 08.08.202 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, është miratuar organigrama, pra mbi 2 muaj më vonë. Nga verifikimi i afateve të të gjithë procesit të ristrukturimit, rezulton se nga momenti i miratimit të strukturës së re, e deri në daljen e vendimit për transferimin e përhershëm të nëpunësve civil brenda administratës tatimore, procesi i ka tejkaluar afatet. Procesi i ristrukturimit ka qenë në proces deri në fund të periudhës objekt auditimi, dhe ka vijuar përgjatë vitit 2024.

- Janë konstatuar mangësi në zhvillimin e procedurës për hartimin e DST-ve në lidhje me kriteret e vendosura, janë konstatuar kriteret jo në përputhje me natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë të paargumetuar, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

-Pas ndryshimit të emërimit të një sektori të DAB, nuk është përditësuar Karta e Auditit, si dhe nuk është përcjellë për miratim tek titullari i institucionit. Komiteti i Auditimit të Brendshëm nuk ka dërguar në DPT, Vendimi për Planin vjetor 2023 dhe Planin strategjik 2023-2025.

- Në fillim të vitit 2023 rezultojnë detyrime të prapambetura për ish punonjës gjyqfitues në vlerën 137,268 mijë lekë. Përgjatë vitit 2023, për ish punonjësit janë likuiduar detyrime në vlerën 216,523 mijë lekë, e cila konsiderohet efekt financiar negativ në buxhetin e shtetit. Vlera e detyrimeve të lindura përgjatë vitit 2023 është 138,422 mijë lekë, dhe deri në fund të vitit 2023, rezultojnë detyrime të prapambetura për ish punonjës gjyqfitues në vlerën 59,167 mijë lekë, nga të cilat likuidime të tarifave përmbartimore në vlerën 5,964 mijë lekë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 473/1, prot datë 15.04.2024, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 15.04.2024 deri në datë 26.07.2024, në subjektin Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT), për periudhën e veprimtarisë së subjektit nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2023, u krye auditimi “Mbi përputhshmërinë”, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. J. T., Përgjegjës Grupi,
2. A. B., Anëtar,
3. R. Xh., Anëtar,
4. E. B., Anëtar.

5. E. M., Anëtar.

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit

Objektivi dhe qëllimi i auditimit është dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nëpërmjet një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen në të gjitha aspektet materiale me kriteret e aplikuar si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj.

Qëllimi i auditimit është raportimi mbi gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e auditimit dhe vlerësimi i pavarur i funksionimit të sistemeve të ngritura, procedurave të ndjekura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, gjatë procesit të realizimit të objektivave në përputhje me legjislacionin në fuqi, vlerësimi objektiv, profesional e i pavarur i përputhjes së veprimeve procedurale, administrative, ekonomike e financiare, me kriteret dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi; vlerësimi dhe evidentimi i shkeljeve të parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, shfrytëzimit me efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike si dhe dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes.

2. Identifikimi i çështjes

Fushëveprimi i këtij auditimi është vlerësimi me siguri të arsyeshme i veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2023 deri më 31.12.2023, në përputhje me aktet ligjore të cilat rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni. Përputhshmëria dhe rregullshmëria në procedurat e ndjekura nga ana e drejtorive përbërëse në DPT të cilat monitorojnë ecurinë e realizimit të të ardhurave tatimore, masat e marra për mbledhjen e detyrimeve tatimore, deklarimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, rimbursimin e TVSH-së, veprimtarisë së drejtorive në hartimin dhe mbështetjen e programeve, si dhe në funksionet operationale, planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, strukturën organizative, planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik dhe zbatimin e kontratave, auditimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe vlerësimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm. Referuar analizës së riskut, në fazën e planifikimit dhe auditimit në terren, u identifikuan fushat me risk më të lartë. Gjithashtu, sigurojmë që vlerësimi fillestar i riskut në fazën e planifikimit si dhe ai i aplikuar gjatë fazës së auditimit në terren, vijon të mbetet i vlefshëm. Sa më sipër, fushat me risk më të lartë u përcaktuan si drejtimet e auditimit të miratuara me Programin e Auditimit dhe të trajtuara në këtë Projekt Raport Auditimi.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese të DPT, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare, materiale

dhe njerëzore në përputhje me politikat, ligjet, vendimet, udhëzimet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit). Stafi drejtues dhe personeli i DPT ka përgjegjësi menaxheriale për planifikimin, zbatimin, kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin e tij. Drejtuesit e të gjitha niveleve janë përgjegjës për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësi të caktuara, duke menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet, si dhe për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Drejtimi i DPT është përgjegjës ndër të tjera për aktivitetet e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave, mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara, rimbursimin në kohë të TVSH-së, ushtrimin e kontroleve nga drejtoritë përkatëse në DPT për zbatimin e procedurave tatimore nga tatimpaguesit me qëllim maksimizimin e të ardhurave tatimore.

4. Përgjegjësitë e audituesve

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, ne kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese. Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë. Audituesit në të gjithë llojet e auditimit, kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 "Parimet themelore të auditimit të sektorit publik", paragrafi 44-51. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Këto standarde kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojë e kryejë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar nëpërmjet auditimit të realizuar.

5. Kriteret e vlerësimit

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar;
- Ligji Nr. 8438, Datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar;
- Ligji me Nr. 92.2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH" i ndryshuar ;
- Ligji Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar;
- Ligji Nr.9136, datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë" dhe udhëzimeve në zbatim të tij;
- Ligji Nr.8977, datë 12.12.2002 "Për sistemin e taksave kombëtare";
- Ligji Nr.25/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe PF", i ndryshuar;
- VKM Nr.953, datë 29.12.2014 "Për dispozitat zbatuese të Ligjit Nr.92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në R.SH", i ndryshuar;

- Udhëzimit Nr.19, datë 3.11.2014 “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar”.
- Rregullore e brendshme me nr. 19, datë 22.02.2017 “Për miratimin e rregullores së brendshme për funksionimin e administratës tatimore”;
- Rregullore nr. 2 “Mbi procedurat e përzgjedhjes për kontroll të tatimpaguesve”;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 26, datë 27.12.2007 “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 14, datë 28.12.2006”;
- Udhëzimi Nr.24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar;
- Udhëzimi Nr.6 , datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në R.SH”, i ndryshuar;
- Udhëzimi Nr.5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar;
- Manuali i Kontrollit nga Zyra dhe Kontrollit në vend,;
- Të tjera akte ligjore, nënligjore dhe rregullative.

6. Standardet e auditimit

Auditimi është kryer, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), përkatësisht në: Nivelin e parë “Parimet INTOSAI-t” ku përfshihet: ISSAI-P-1 “Deklarata e Limës”, ISSAI-P-10 “Deklarata e Meksikos”; Nivelin e dytë “Standardet e INTOSAI-t” ku përfshihen: ISSAI 100 - Parimet bazë në auditimin e sektorit publik, ISSAI 400-499 “Parimet bazë të auditimit të përputhshmërisë”, ISSAI 4000 "Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë"; ISSAI 4200; ISSAI-140 “Sigurimin e cilësisë”, ISSAI 130 “Kodin Etik”, ISSAI 2315 “Risku”, ISSAI 2320-2450 “Materialiteti” , ISSAI 2500 “Dokumentimi”; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t; INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë"; Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë"; etj.

7. Metodat e auditimit

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit, në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testeve të kryera, me qëllim arritjen e objektivave të auditimit në bazë të vlerësimit të riskut. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

- a. Intervistimi - duke komunikuar dhe marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;
- b. Raporte dhe informacione - shfrytëzimi i raporteve, informacioneve relevante dhe që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht me drejtimit e auditimit;
- c. Verifikimi në sistemet e DPT- me përzgjedhje i çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;
- d. Të kombinuara, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë procesit të vlerësimit të rrezikut, audituesit vlerësojnë nivelin e kontrollit të brendshëm relevant në entitetin DPT, në mënyrë që të programoheshin procedurat e auditimit, që janë të përshtatshme për kushtet e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin

e kontrollit të brendshëm të entitetit. Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale. Grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon:(a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm kryhet nëpërmjet testeve të kontrolleve. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit ka konsistuar në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm u administrua dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar vlerësimit përmes skepticizmit profesional nga ana e audituesve.

8. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i auditimit është mbështetur në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë dhe në Rregulloren e Procedurave të Auditimit në KLSH, me ndryshime.

Gjithashtu, është mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “Dokumentimi i Auditimit”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionin dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, Akteve të Konstatimeve të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit ky Projekt Raport i Auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është autoriteti shtetëror i specializuar, në varësi të Ministrisë së Financave për krijimin, sigurimin dhe mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë. Institucioni është i organizuar në nivel qendror me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, përgjegjëse për hartimin, monitorimin dhe zbatimin e strategjive dhe politikave operacionale efikase në realizimin e misionit të institucionit. Në nivel rajonal, institucioni ka 14 Drejtori Rajonale Tatimore dhe në total në organikën e administratës tatimore shqiptare numërohen 1261 punonjës (fakt 2023) duke e renditur administratën tatimore si një nga institucionet ligj zbatues më të rëndësishme në vend.

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2023 disa nga objektivat kryesor të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve kanë qenë:

- Rritja e pajtueshmërisë vullnetare,
- Rritja e performancës së mbledhjes të ardhurave tatimore mbi parashikimet aktuale,

- Përmirësimi dhe sigurimi i shërbimeve më të mira për tatimpaguesit,
- Reforma kundër informalitetit dhe fokusi në mirë-administrim,
- Trajnimi i vazhdueshëm për nëpunësit e të gjitha niveleve.

DPT drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili ka në varësi të tij tre Zëvendësdirjtorë të Përgjithshëm, të cilët sigurojnë mbështetjen në kryerjen e detyrës duke bashkërenduar punën. DPT ka funksionuar me rregulloren e miratuar me urdhrin nr. 193, datë 12.08.2020 të Ministrisë të MFE, “Rregullorja e Funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore”, në të cilën trajtohen objekti dhe funksionet e punës për të gjithë strukturën përbërëse të DPT-së, organizimi i strukturave, emërtimi, përbërja dhe detyrat e tyre, etj. Funksionet kryesore të punës të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve janë si më poshtë:

1. Administron detyrimet tatimore në Republikën e Shqipërisë në nivel qendror për llojet e tatimeve dhe taksave të përcaktuara në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore të përcaktuara me ligjin nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për Mbledhjen e Kontributeve të Detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. Përgatit dhe miraton planin strategjik të objektivave dhe synimeve kryesore të administratës tatimore qendrore për një periudhë afat-shkurtër, afat-mesme dhe afat-gjatë si edhe monitoron zbatimin e tij.
3. Evidenton nevojat për ndryshime dhe paraqet propozimet përkatëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, lidhur me ndryshimet në ligjet tatimore, në aktet nën-ligjore të nxjerra në zbatim të tyre.
4. Përgatit dhe miraton procedura standarde pune operative, ku sigurohet se këto procedura promovojnë transparencën e duhur në marrëdhëniet e administratës tatimore me tatimpaguesit, krijojnë sisteme të kontrollit të brendshëm të cilat minimizojnë rrezikun e korrupsionit, sigurojnë trajtim të paanshëm për të gjithë tatimpaguesit dhe reduktojnë subjektivitetin e punonjësve tatimorë.
5. Ofron asistencë për të siguruar zbatimin korrekt të legjislacionit tatimor, akteve nën-ligjore në zbatim të tij dhe manualeve operacionale në Drejtorinë Rajonale Tatimore.
6. Përcakton, në përputhje me dispozitat e legjislacionit të shërbimit civil, masa uniforme për matjen e performancës së punonjësve të administratës tatimore dhe krijon raporte standarde për të kontrolluar vlerësimin e performancës në nivel kombëtar, si dhe për çdo Drejtori Rajonale Tatimore. Ndjek zbatimin e kërkesave të Kodit të Etikës për Administratën Tatimore Qendrore.
7. Siguron shpërndarje të drejtë të burimeve njerëzore në çdo Drejtori Rajonale Tatimore.
8. Bashkëpunon me të gjitha Drejtorinë Rajonale Tatimore, për të përgatitur plane vjetore pune, bazuar në numrin e personelit që është përcaktuar për çdo drejtori dhe në objektivat funksionale të performancës për çdo Drejtori Rajonale Tatimore.
9. Harton dhe zbaton një program vjetor të vizitave të punës në çdo Drejtori Rajonale Tatimore, për të ofruar asistencë dhe për të kryer vlerësime.
10. Miraton planin vjetor të punës dhe planin e të ardhurave tatimore për çdo Drejtori Rajonale Tatimore.
11. Përgatit, miraton dhe kontrollon zbatimin e Kodit të Etikës për punonjësit e administratës tatimore, në përputhje me rregullat e etikës së administratës publike.
12. Përgatit, miraton dhe kontrollon zbatimin e Rregullores së Brendshme të Administratës Tatimore Qendrore për parandalimin e konfliktit të interesit të nëpunësit të Administratës Tatimore qendrore.

Referuar raportit vjetor të DPT, numri i tatimpaguesve aktiv (me përgjegjësi tatimore) në Regjistrin Kombëtar në fund të vitit 2023, rezultoi 127,698, pra 4,358 tatimpagues aktiv me

shumë se viti 2022. Sipas kategorizimit të tatimpaguesve, bazuar në nivelin e qarkullimit të realizuar dhe vetëdeklaruar, në fund të vitit 2023 rezultojnë 93,709 tatimpagues të regjistruar në Biznes të Vogël, 31,222 tatimpagues Biznes i Madh, dhe 2,767 të tjerë. Përgjatë vitit 2023 rezultojnë të regjistruar 34,767 tatimpagues me përgjegjësinë tatimore të TVSH-së, nga të cilët 9,450 janë biznes i vogël. Tatimpaguesit e rinj konsistojnë në 18,777, pra 605 më shumë se viti 2023.

Në fund të vitit 2023, numri i individëve në regjistrin për deklarimin e DIVA paraqitet në 106,208 persona.

Referuar të dhënave të DPT, në fund të vitit 2023 rezultojnë 152,179 tatimpagues pasiv, nga të cilët vetëm për vitin 2023 kanë kaluar në këtë status 12,341 tatimpagues. Gjithashtu, përgjatë vitit 2023 janë çregjistruar 3,100 tatimpagues, duke e çuar numrin e tatimpaguesve të çregjistruar në 69,600, në fund të vitit 2023.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit

2.1 Mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm.

Në zbatim të pikës I të Programit të Auditimit Nr.473/1 Prot., datë 15.04.2024 “Mbi përputhshmërinë e veprimtarisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”, i ndryshuar, u kërkuar dokumentacioni administrativ dhe ligjor nga përfaqësuesit e subjektit objekt auditimi, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në lidhje me rekomandimet e lëna për zbatim, sipas shkresës nr. 284/12 prot datë 09.10.2023, të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit me lëndë “Dërgim i Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe Rekomandimet”. Nga verifikimi rezulton konkretisht se:

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me shkresën nr.5749/35 prot., datë 30.10.2023, “Plani i masave për zbatimin e rekomandimeve sipas raportit të KLSH për auditimin në DPT njoftuar me shkresën nr.284/12 prot., datë 09.10.2023, protokolluar në DPT me nr.5749/33 Prot., datë 11.10.2023”, drejtuar KLSH është nisur plani i masave në vijim të zbatimit të rekomandimeve, **brenda afatit ligjor, prej 20 ditësh të vendosur nga KLSH**, veprim ky, në përputhje me kërkesat e nenit 15, shkronja “j”, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”, ku përcaktohet se: “Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas rastit, në fillim, përgjatë dhe/ose në përfundim të veprimtarisë, duhet: të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës”.

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me shkresën nr.5749/46 prot., datë 04.09.2024, “Raportim lidhur me zbatimin e rekomandimeve sipas raportit të KLSH për auditimin në DPT njoftuar me shkresën nr.284/12 prot., datë 09.10.2023, protokolluar në DPT me nr.5749/33 prot., datë 11.10.2023”, drejtuar KLSH është nisur raportimi lidhur me ecurinë mbi zbatimin e rekomandimeve, **brenda 6-muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna**, veprim ky në përputhje me kërkesat e nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”, ku përcaktohet se: “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”.

Në lidhje me masat e rekomanduara, gjëndja në mënyrë të përmbledhur paraqitet si më poshtë:

a. Masa Organizative.

Janë rekomanduar 29 masa organizative, nga të cilat janë pranuar 24 masa, konkretisht nga të cilat 7 janë zbatuar plotësisht, 6 masa janë zbatuar pjesërisht, 11 masa janë pa zbatuar dhe 5 masa janë pa pranuar.

b. Masa për Eliminimin e Paligjshmërive në Administrimin e Fondeve Publike dhe Menaxhimin me Ekonomicitet, Eficencë dhe Efektivitet të Fondeve Publike.

Është rekomanduar 1 masë për eliminimin e paligjshmërive në administrimin e fondeve publike dhe menaxhimin me ekonomikitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike, ku nga verifikimi rezulton se është pranuar masa por nuk është zbatuar.

d. Masa Disiplinore.

Janë rekomanduar 2 masa disiplinore për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil dhe për punonjësit marrëdhëniet e punës së të cilëve rregullohen me Kodin e Punës, Titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve vlerësimi i problematikave dhe shkeljeve të përshkruara në mënyrë të detajuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe të nisin procedurat për dhënien e masave disiplinore nga “Vërejtje” deri “Largim nga shërbimi civil” dhe “Largim nga puna”, për të gjithë punonjësit e konstatuar me përgjegjësi sipas çështjeve të trajtuara, të cilat nuk janë zbatuar.

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së në mënyrë më të detajuar rezulton si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.1 Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për moszbatimin e afatit ligjor në informacionin mbi ecurinë e zbatimit të masave të rekomanduara, si dhe për strukturat e ngarkuara në planin e masave, të cilët nuk kanë realizuar zbatimin e rekomandimeve, si dhe rikërkojmë të merren masa nga DPT për zbatimin e rekomandimeve që janë në proces zbatimi, pjesërisht të zbatuara si dhe të pa zbatuara të dërguara me shkresën nr.20/17 prot., të Kryetarit të KLSH datë 19.09.2022, konkretisht për masat organizative, rekomandimet nr. 1, 2, 3, 4, 5, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 14, 16, 18, 19, 20, 23, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34 dhe për masën për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike, rekomandimin nr.1.

Menjëherë e në vijimësi

Qëndrimi i Subjektit: Rekomandimet e lëna nga audimi i mëparshëm janë në proces ndjekje nga strukturat përgjegjëse sipas planit të masave të hartuar për këtë qëllim.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se rekomandimi 1.1 është vendosur në planin e masave nr.5749/35 prot., datë 30.10.2023 por në raportimin lidhur me zbatimin e rekomandimeve sipas shkresës nr.5749/49 prot., datë 09.04.2024 rezulton se nuk është marrë asnjë masë për të zbatuar rekomandimin e KLSH.

Statusi: I pa zbatuar.

2.1 Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të bashkëpunojë me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për planifikim real të vlerës së rimbursimeve të TVSH-së, si dhe të marrë masat e nevojshme për monitorimin e këtij procesi, me qëllim parandalimin e pagesave përtej kufirit të lejuar të shpenzimeve.

Menjëherë e në vijimësi

Qëndrimi i Subjektit: Plani i rimbursimeve vjen i miratuar nga MFE pavarësisht nga propozimet që mund të ketë bërë Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së. Kërkesat për rimbursim nga subjektet bëhen në mënyrë të vazhdueshme dhe Drejtoria e Rimbursimit ka për detyrë që t'i shqyrtoj të gjitha këto kërkesat pavarësisht planit të rimbursimit. DRTVSH shqyrton gjatë gjithë kohës mundësinë e mostejkalimit të planit të rimbursimeve.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga auditimi i veprimtarisë së DRTVSH për periudhën 2023, ka rezultuar se kemi një tejkalim të planit të rimbursimeve, fakt ky që vërteton se nuk është zbatuar rekomandimi i lëna nga ana e KLSH-së.

Statusi: I pa zbatuar.

3.1 Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të marrë masat e nevojshme për respektimin e afateve ligjore në kryerjen e procesit të rimbursimit të TVSH-së, nga ana e DRT-ve dhe DRTVSH-së me qëllim miradministrimin e fondeve buxhetore, dhe raportimin e saktë në MFE lidhur me këtë çështje.

Në vijimësi

Qëndrimi i Subjektit: Drejtorja e Rimbursimit të TVSH-së ka marrë të gjitha masat që të respektohen të gjitha afatet ligjore për çdo procedurë rimbursimi. DRTVSH raporton çdo muaj për ecurinë e rimbursimeve.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga auditimi i veprimtarisë së DRTVSH për periudhën 2023, kanë rezultuar kërkesa për rimbursimin e TVSH-së, të pranuar, por të pa miratuara të cilat megjithëse ka kaluar afati maksimal prej 60 ditëve nga data e paraqitjes së tyre nuk janë rimbursuar dhe që përbëjnë stokun e rimbursimeve në datën 31.12.2023, fakt ky që vërteton se nuk është zbatuar rekomandimi i lëna nga ana e KLSH-së.

Statusi: I pa zbatuar.

4.1 Rekomandim: Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të miratohet rregullore/udhëzues në lidhje me afatet dhe procedurat për detajimin e planit të dërguar nga MFE drejt Drejtorive Rajonale Tatimore në mënyrë që të ndërmerren veprimet operationale në kohë për mbledhjen e tyre, duke rritur kështu performancën institucionale dhe evidentimin e përgjegjësi të zyrtarëve publikë.

Menjëherë e në vijimësi

Qëndrimi i Subjektit: Ky rekomandim nuk qëndron dhe nuk është pranuar. Detajimi i planit të të ardhurave në nivel DRT-je bëhen nga Grupi i punës i ngritur me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm.

Për vitin 2022 grupi i punës në DPT ka shpërndarë plan mujor dhe progresiv për çdo DRT, çdo muaj. Për këtë pikë të Grupit të Audituesve të KLSH-së i janë vënë në dispozicion të gjitha shkresat me protokoll që evidentojnë këtë fakt. Theksojmë se, grupi i punës fillon punën dhe miraton planin e të ardhurave në nivel DRT-je vetëm pasi nga MFE kanë ardhur zyrtarisht vlerat e planit me bazë mujore dhe progresive të detajuara për: TVSH neto, Rimbursim TVSH-je, Tatim mbi ftimin, Tatim mbi te ardhurat, Taksat nacionale dhe te tjejar sipas zërave, Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore. DPT nuk mund të vendosë afate kohore për MFE lidhur me dërgimin e shkresave zyrtare ku përcaktohet detajimi i planit të të ardhurave për DPT me baza mujore dhe progresive sipas strukturës më lart.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Rekomandimi nuk është pranuar dhe nuk është zbatuar.

Statusi: I pa pranuar.

5.1 Rekomandim: Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të kryhet riklasifikimi përkundrejt planit i të ardhurave dytësore në raportin e performancës, me qëllim ruajtjen e trendit historik të raportimeve, si dhe nëpërmjet Drejtorive Rajonale Tatimore të drejtojë burimet e kontrollit në sektorët që janë objekt i taksave kombëtare të konstatuara me mosrealizim për shkak të rënies së konsiderueshme të të dhënave për sasi të indeksuara me taksat kombëtare.

Menjëherë e në vijimësi

Qëndrimi i Subjektit: Ky rekomandim nuk qëndron dhe nuk është pranuar. Drejtoria Kontabilitet Statistikë thekson se, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nuk planifikohet në ligjin e buxhetit dhe nuk arkëton të ardhura dytësore. Lidhur me drejtimin e burimeve të kontrollit në drejtim të taksave kombëtare nuk është Drejtoria Kontabilitet Statistikë që propozon tatimpagues për kontroll. Janë Drejtoritë Rajonale Tatimore që propozojnë subjekte për kontroll. Në këtë kuptim kjo pjesë e këtij rekomandimi në gjykimin e kësaj Drejtorie duhet ti kalojë për zbatim Drejtorive Rajonale Tatimore që kanë autoritetin e propozimit për kontroll të një tatimpaguesi.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Rekomandimi nuk është pranuar dhe nuk është zbatuar.

Statusi: I pa pranuar.

6.1 Rekomandim: Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të kryhet ripublikimi i treguesve të të ardhurave në raportin e performancës, duke hequr komponentin e gjobave nga realizimi dhe në të njëjtën kohë të bëhet në raportim ndarja e të ardhurave nga detyrimi kryesor dhe gjoba shoqërues e detyrimet për rivlerësimet tatimore të deklaratave në përfundim të kontrollit tatimor.

Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të kryhen veprimet rregulluese në lidhje me depozitimet e përkohshme për deklaratën e tatim fitimit në momentin e dorëzimit të deklaratës së tatim fitimit nga ana e tatimpaguesve me qëllim shmangien e akumulimit të tepricës së pa stornuar të kësaj llogarie.

Menjëherë e në vijimësi

Qëndrimi i Subjektit: Ky rekomandim nuk qëndron dhe nuk është pranuar. Drejtoria Kontabilitet Statistikë lidhur me raportimin e të ardhurave nga DPT në Raportin vjetor të performancës, i referohet Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 6, pika 3, i cili përcakton se: “Detyrimi tatimor përfshin tatimin, kamatëvonesat, si dhe gjobat, për rastet e parashikuara nga ky ligj”. Në vijim lidhur me veprimet rregulluese pas dorëzimit të deklaratës vjetore për tatim fitimit, Drejtoria Kontabilitet Statistikë sqaron se: Kontabilizimi gjatë vitit dhe mbartja e saj në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë është konform rregullave të ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Udhëzimit nr.8, datë 09.03.20018 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të njërive qendrore të qeverisjes së përgjithshme.” Udhëzimi nr. 8 përcakton për kontabilizimin të ardhurave për tatim fitimi skemën: Kredi llogaria 4665503 Mjete në ruajtje për Tatim fitimi, Debi llogaria 520 Disponibilitete në thesar. Pra, kontabilizimi është konform kërkesave të Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018. Ky udhëzim nuk parashikon veprime rregulluese në kontabilizim në vitin pasardhës buxhetor.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Rekomandimi nuk është pranuar dhe nuk është zbatuar.

Statusi: I pa pranuar.

7.1 Rekomandimi: Nga titullari i DPT të analizohet situata e kësaj Drejtorie duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse, si dhe të merren masa për plotësimin e vendeve vakantë të drejtorisë DMDTP sipas strukturës së miratuar Urdhrin e Kryeministrit Nr.33 datë 12.02.2020 “Për miratimin e strukturës organizative të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”, së bashku me hartimin e miratimin e programeve të inspektimit në mënyrë që DMDTP të realizojë inspektime në të gjithë rajonet.

Menjëherë e në vijimësi

Qëndrimi i Subjektit: Nga Administrata Tatimore është zbatuar Urdhëri nr.69, datë 26.05.2023 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës organizative dhe numrit të

përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”, i ndryshuar dhe Urdhëri nr. 189, datë 08.08.2023 “Për miratimin e Organigramës së Administratës Tatimore Qendrore” të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, lidhur me plotësimin e vendeve vakante, është mundësuar plotësimi i vendeve vakante. Lidhur me kryerjen e inspektimeve në DMDTP në Rajone në vijim gjatë vitit ushtrimor do të mundësohet kryerja e tyre. Në lidhje me nxjerrjen e përgjegjësive për këtë strukturë, në vitin 2023 nga Auditi i Brendshëm është kryer një inspektim për vitin 2022 dhe janë evidentuar shkeljet në mospërmbushjen detyrave funksionale dhe ka filluar procedimi disiplinor për të gjithë nëpunësit e kësaj strukture për të cilët janë marrë masa disiplinore të cilat administrohen në dosjet e personelit.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Auditi i Brendshëm, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në vitin 2023 ka kryer një inspektim për vitin 2022, i cili ka evidentuar shkeljet në mospërmbushjen e detyrave funksionale dhe ka marrë masa disiplinore të cilat administrohen në dosjet e personelit. Në Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara vazhdon të ketë vende vakante të cilat çenojnë mbarëvajtjen e punës.

Statusi: I pa pranuar.

8.1 Rekomandimi: DPT të marrë masa për trajtimin e rasteve sipas problemeve të identifikuar nga grupi i punës në mënyrë që këto detyrimet tatimore të papaguara të trajtohen me procedurën e mbledhjes së borxhit tatimorë që të rritet mundësia e vjeljes së detyrimit jashtë sistemit C@TS.

Menjëherë e në vijimësi

Qëndrimi i Subjektit: Në zbatim të Planit të Masave të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve “Për zbatimin e Rekomandimeve të KLSH-së” është ngritur grupi i punës me Urdhërin Nr.209 prot., datë 06.12.2023, “Për Marrjen e masave në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale Tatimore si dhe Drejtorinë e Kontrollit Tatimor pranë DRT-ve për hedhjen në sistem të detyrimeve tatimore për të cilat ka module përkatëse, si dhe propozimin e zgjidhjeve për rastet e tjera”. Pas mbledhjes së informacionit nga DRT-të, grupi i punës ka kryer analizën përfundimtare lidhur me numrin e subjekteve dhe vlerat korresponduese që janë të mundshme për tu hedhur në sistemin tatimor si dhe numrin e subjekteve dhe vlerat korresponduese për të cilat është e pamundur hedhja në sistem dhe do të vijohet me ndjekjen e mëtejshme të këtij rekomandimi.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Në zbatim të Urdhrit Nr.209, datë 06.12.2023 “Për trajtimin e problemeve të identifikuar nga grupi i punës në DPT lidhur me detyrimeve tatimore të papaguara jashtë sistemit c@ts” nga titullari i institucionit, pranë DPT është ngritur grupi i punës, i cili ka trajtuar problematikën në bashkëpunim me DRT. Pas verifikimit të situatës dhe informacionit analitikë të marrë nga DRT, me anë të Memos nr.5445/45 prot., datë 09.04.2024 është dërguar relacioni përmbledhës mbi veprimtarinë e grupit të punës tek Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve. Grupi i punës ka përshkruar arsyet për të cilat ekziston dhe nuk ekziston mundësia e hedhjes në sistem. Për detyrimet tatimore të papaguara jashtë sistemit c@ts për të cilat grupi i punës konstaton se ekziston mundësia e hedhjes nuk është kryer hedhja e tyre në sistem, janë në proces.

Statusi: I pa zbatuar.

9.1 Rekomandimi: DPT në bashkëpunim me strukturat e mbledhjes me forcë të borxhit pranë DRT-ve, të marrin masa të menjëhershme për uljen e borxhit tatimor si dhe të luajnë një rol më aktiv në monitorimin e veprimtarisë së mbledhjes së borxhit. Të marrin masa konkrete duke përdorur të gjithë instrumentet ligjore të parashikuar për uljen e borxhit tatimor si edhe duke zbatuar mënyrat e vlerësimit të riskut, për të përcaktuar dhe zbatuar, në çdo rast, masën më të

përshtatshme të mbledhjes me forcë, në mënyrë që të maksimizohet mbledhja e detyrimeve tatimore të papaguara.

Menjëherë e në vijimësi

Qëndrimi i Subjektit: Në zbatim të këtij rekomandimi, Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në DPT në funksion të maksimalizimit të mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara me qëllim arkëtimin e tyre, në funksion të uljes së stokut të borxhit në zbatim të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Planit Operacional është vijuar dhe do të vijohet me monitorimin e zbatimit të masave shtrënguese për tatimpaguesit me detyrime të shtuara, tatimpaguesit me vlerën më të lartë të detyrimit (për 100 tatimpaguesit më të mëdhenj kartelizimi dhe dokumentimi), tatimpaguestit me detyrime të reja (me moshë borxhi deri në dy vjet) me qëllim parandalimin e krijimit të borxhit të ri dhe gjetja e zgjidhjeve të përshtatshme për borxhet e vjetra, tatimpaguesit me detyrime në kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Në funksion të lehtësimit të procedurave të mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore të papaguara, është duke u punuar në kryejën e procesit të digjitalizimit të masave shtrënguese lidhur me gjenerimin e njoftimit dhe kërkesës për pagesë për tatimpaguesin në mënyrë automatike me firmë dhe vulë digjitale si dhe me ngritjen e një sistemi komunikimi elektronik me bankat e nivelit të dytë. Për rritjen e efikasitetit të zbatimit të masave shtrënguese, në funksion të qëllimit të Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara për maksimizimin e mbledhjes së detyrimit tatimor të papaguar, për të mundësuar ndjekjen e detyrimit të papaguar në kohë, u centralizua pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve komunikimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për vijimin e masës shtrënguese “Pezullim të aktivitetit në doganë”.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Mbi zbatimin e masave shtrënguese, Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara më së shumti ka marr këto masa mbi subjektet: Njoftim dhe kërkesë për të paguar dhe Urdhër bllokim të llogarive bankare. Kërkesa për pezullim të aktivitetit në Doganë në vitin 2023 janë vendosur nga DPT për 2926 subjekte. Nga sa më sipër rezulton se nuk janë përdorur të gjithë masat shtrënguese në rajone për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara sipas legjislacionit tatimor dhe se këto masa të marra se kanë përmbushur mjaftueshëm misionin e tyre.

Statusi: Pjesërisht i zbatuar.

10.1 Rekomandimi: Nënpunësi Autorizues i DPT në cilësinë e koordinatorit të GMS të marrë masa për koordinimin, realizimin dhe monitorimin e procesit të përgatitjes së kërkesave buxhetore në kuadër të programit buxhetor afatmesëm, me qëllim që të sigurojë që shpërndarjet e fondeve buxhetore të reflektojnë qëllimet dhe objektivat e politikës së programit.

Menjëherë e në vijimësi

Qëndrimi i Subjektit: Nënpunësi Autorizues së bashku me Nënpunësin Zbatues kanë zbatuar me rigorozitet rekomanimin e dhënë mbi GMS-në. Përkatësisht:

1. Takimi i parë më 19.04.2023 mbi “Prioritete buxhetore si dhe kërkesat shtesë”,
2. Takimi i dytë më 09.08.2023 mbi “Kërkesat buxhetore PBA 2024-2026 sipas prioriteteve”,
3. Takimi i tretë më 23.08.2023 mbi “Kërkesat buxhetore dhe kërkesat shtesë të argumentuara”,
4. Takimi i katërt më 07.12.2023 mbi “Drejtoritë e reja Rajonale dhe kërkesat buxhetore”. Gjithashtu është realizuar edhe EMP në datat: 06.07.2023 mbi “situatën konkrete të investimit dhe kërkesa për rialokim”, 10 Gusht 2023 mbi “PBA 2024-2026”.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: DPT dhe GMS në vitin 2023 ka zhvilluar takime mbi planifikimin buxhetor afatmesëm 2024-2026, me shkresat të datave 19.04.2023, 09.08.2023, 23.08.2023 dhe 07.12.2023.

Statusi: I zbauar.

11.1 Rekomandimi: Nga DPT të merren masa për përcaktimin e përgjegjësive për mungesën e reflektimit në kohë të kërkesave për kompensim në mënyrë që të gjithë pretendimet e subjekteve të referohen në kohë në drejtim të kërkesave buxhetore të rishikuara, duke marrë miratimin nga autoritetet përkatëse.

Menjëherë e në vijimësi

Qëndrimi i Subjektit: Në lidhje me titullin e gjetjes “Kryerja e shpenzimeve mbi fondin e kontigjencës të akorduar për kompensimin e shoqërive të transportit”, sqarojmë se Grupi i Punës i ngritur me urdhrat e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve me nr.47, datë 27.04.2022 dhe nr.118, datë 25.08.2022 “Për ngritjen e Grupit të Punës për zbatimin me korrektësi të “VKM-së nr.225, datë 13.04.2022 dhe VKM-së nr.569, datë 25.08.2022 – Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së kompensimit për shoqëritë e linjave të transportit qytetase, rrethqytetase dhe ndërqytetase, pjesë e paketës Anti-krizë, faza I-rë dhe faza II-të”, ka vepruar në zbatim dhe në përputhje të plotë me dy Vendimet e Këshillit të Ministrave dhe urdhrat e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve të sipërcituara. Grupi i Punës në DPT, në çdo rast brenda 5 ditëve pune nga marrja e dokumentacionit të përcjellë nga DRT-të përkatëse, ka verifikuar saktësinë e dokumentacionit për përfitim financiar të subjekteve përfituese të përcjellë nga DRT-të përkatëse, ka verifikuar me përzgjedhje saktësinë e procedurës së ndjekur nga DRT dhe rregullsinë e trajtimit të kërkesës/ve dhe ka hartuar listën përmbledhëse të subjekteve përfituese dhe ja ka dërguar Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit. Siç ka konstatuar, Grupi i Auditimit të KLSH, në Projekt Raportin e Auditimit nr.284/7.prot., datë 02.08.2023, nga kampioni i zgjedhur për auditim në të dy rastet, ka rezultuar se, praktikat e verifikuara nga Grupi i Punës në DPT, “janë gjetur pa probleme, përmbanin të gjithë dokumentacionin në përputhje me kriteret e përcaktuara në VKM-në nr.225, datë 13.04.2022 dhe VKM-në nr.569, datë 25.08.2022, si edhe sasia e litrave të rimbursuara për tre mujorin rezultoi në përputhje me këto kriteret..”(cituar nga gjetjet e Projekt Raportit, faqe 126-127). Në këtë kuadër, Grupi i Punës në DPT me veprimet dhe mosveprimet e tij në asnjë rast nuk ka ndikuar në tejkalimin e planit të shpenzimeve. Në lidhje me titullin e gjetjes “Mos kryerje në kohë e procedurës për kompensim për shoqëritë e transportit”, sqarojmë se Grupi i Punës në DPT, në çdo rast ka vepruar në zbatim dhe në përputhje të plotë me dy Vendimet e Këshillit të Ministrave dhe urdhrat e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve të sipërcituara. Grupi i Punës në DPT, brenda 5 ditëve pune nga marrja e dokumentacionit të përcjellë nga DRT-të përkatëse, ka verifikuar saktësinë e dokumentacionit për përfitim financiar të subjekteve përfituese të përcjellë nga DRT-të përkatëse, ka verifikuar me përzgjedhje saktësinë e procedurës së ndjekur nga DRT dhe rregullsinë e trajtimit të kërkesës/ve dhe ka hartuar listën përmbledhëse të subjekteve përfituese të cilën ja ka dërguar Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit. Edhe në lidhje me rastin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të KLSH, në Projekt Raportin e Auditimit nr.284/7.prot., datë 02.08.2023, ku citohet se: “Në adresën elektronike të Grupit të Punës në DPT, në datë 23.01.2023 është dërguar kërkesa për kompensim karburanti për këto shoqëri transporti së bashku me praktikën e plotë nga DRT Tiranë, me justifikimin se kërkesat janë dërguar në DRT brenda afatit, por punonjësi përgjegjës ka qenë me leje dhe nuk u dërgua në afat kërkesa për kompensim pranë DPT. Grupi i Punës në DPT, në datë 25.01.2023, ka përcjellë në formë elektronike këtë kërkesë për kompensim pranë Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit në DPT”. Në lidhje me këtë situatë, referuar VKM-së nr.569, datë 25.08.2022, pika III.1, është përcaktuar se: “Kërkesat për kompensim do të pranohen deri në datën 1 dhjetor 2022”. Grupi i Punës në DPT, ka njoftuar me e-mail Drejtorët Rajonal, si dhe pikat e kontaktit në Drejtoritë Rajonale, më datë 20.12.2022 (njëmbëdhjetë ditë pune para datës të përcaktuar si afat i fundit i pranimit të kërkesave), ku ju ka rikujtuar afatin përfundimtar, për pranimin e kërkesave për kompensim, si dhe trajtimin dhe përcjelljen e tyre në DPT. Kjo në mënyrë që edhe Grupi i

Punës në DPT të kishte kohën e mjaftueshme për të verifikuar praktikën dhe t'i përcillte tek Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për të vijuar me kompensimin. Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr.118, datë 25.08.2022 “Për ngritjen e Grupit të Punës për zbatimin me korrektësi të “VKM-së nr.225, datë 13.04.2022 dhe VKM-së nr.569, datë 25.08.2022 – Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së kompensimit për shoqëritë e linjave të transportit qytetase, rrethqytetase dhe ndërqytetase, pjesë e paketës Anti-krizë, faza II-të”, në pikën 4 të tij, përcakton se: “Grupi i Punës në DPT brenda 5 (pesë) ditëve pune nga marrja e dokumentacionit të përcjellë nga DRT-ja, harton listën përmbledhëse të subjekteve përfituese”. Në këtë rast, siç rezulton qartë edhe nga gjetjet e Grupit të Auditimit të KLSH, në Projekt Raportin e Auditimit nr.284/7 Prot., datë 02.08.2023, Grupi i Punës në DPT i ka marrë këto praktika nga DRT Tiranë më datë 23.01.2023 dhe i ka verifikuar dhe përcjellur për kompensim me datë 25.01.2023, brenda 2 ditëve pune. Në këtë kuadër, Grupi i Punës në DPT me veprimet dhe mosveprimet e tij në asnjë rast nuk ka ndikuar mos kryerjen në kohë të procedurës për kompensim për shoqëritë e transportit.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Me datë 23.01.2023, nga Grupi i Punës është përcjellë në mënyrë elektronike kërkesa për kompesim, e dërguar nga Drejtoria Rajonale Tatimore për 3 pika dhe është kërkuar informacion mbi statusin e tyre. Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë ka patur vonesë në dërgimin e informacionit dhe kjo ka sjellë edhe kalimin e praktikave jashtë afatit. Me fondin e akorduar nga MFE sipas shkresës me nr. 926/1 prot., datë 26.01.2023, me lëndë “Saktësim institucioni” për transferimin e fondeve buxhetore për vitin 2022, DFB ka vijuar me procesin e kompesimit për 2 praktika në vlerën 3,250,300 lekë. Për arsye të pamjaftueshmërisë së fondeve buxhetore, tejkalimit të afateve ligjore të VKM- së nuk u krye kompesimi i praktikës së tretë në vlerë 452,300 lekë dhe ndodhur në këtë situatë pamundësie kjo praktikë nuk është ekzekutuar.

Statusi: Pjesërisht i zbatuar.

12.1 Rekomandimi: Nga ana e DPT të mos pranohen projektet e rishikuara në vlerë nga AKSHI si pasojë e studimit të tregut përtej fondeve buxhetore të miratuara për projektet respektive.

Në të njëjtën kohë DPT të mos paraqesë projekte në fushën e teknologjisë së informacionit në kushtet e emergjencës, por të përmirësojë procedurën e planifikimit buxhetor afatmesëm nëpërmjet strukturave të GMS në bashkëpunim me përfaqësuesin e AKSHI-t.

Menjëherë e në vijimësi

Qëndrimi i Subjektit: Sikundër është përmendur në informacionin lidhur me rekomandimin nr.10, takimet e GMS-së, pjesë e çdo takimi dhe përcjellje informacioni, ka qënë edhe Drejtori i TIK i atashuar në DPT i cili ka përcjell edhe materialet përkatëse. Në lidhje me mospranimin e vlerës së investimeve të rishikuara mbi vlerën e kërkuar në fazën fillestare, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve e ka zbatuar këtë rekomandim në kërkesën e përcjellë të ndryshuar për “Përmirësim e sistemit e-tax” (shkresa nr.2478/3, datë 27.03.2023 e në vijim).

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Mbi projektet e rishikuara në vlerë nga AKSHI, Drejtoria e Përgjithshme nuk e ka pranuar vlerën e investimit të rishikuar mbi vlerën e kërkuar në fazën fillestare mbi projektin “Përmirësim i sistemit e-tax”.

Statusi: I zbatuar.

13.1 Rekomandimi: Nga ana e DPT të përcaktohen përgjegjësitë për ndërmarrjen e angazhimeve të reja përtej afatit të përcaktuar në kuadrin rregullator dhe të merren masa për iniciimin e procedurave të prokurimit me detajimin e fondeve .

Menjëherë e në vijimësi

Qëndrimi i Subjektit: Për sa i përket këtij rekomandimi, nga ana e Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse angazhimet kanë qenë të planifikuara në regjistrin e parashikimit të prokurimeve dhe kalimi i afatit ka të bëjë me njoftimin e kontratës e cila është botuar dhe në Buletinin e Njoftimeve të APP, bazuar në Vendimin nr.807, datë 16.11.2016.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga auditimi për veprimtarinë e vitit 2023 nuk janë konstatuar angazhimet janë jashtë afatit 15 tetor të vitit buxhetor për projektet e DPT.

Statusi: I zbatuar.

14.1 Rekomandimi: Titullari i DPT të marrë masa për përcaktimin e një rregulloreje të brendshme për disiplinimin e procesit të ekzekutimit të fondeve buxhetore në kohë dhe për konstatimet e faturave në fushën e teknologjisë së informacionit të reflektojë problematikën në marrëveshjet dhe procedurat në bashkëpunim me AKSHI.

Menjëherë e në vijimësi

Qëndrimi i Subjektit: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në raport menaxhimi kontraktor ndiqet me AKSHI-n nëpërmjet SMK, e cila nuk ka një manual përdorimi. Me shkresën nr.12625, datë 25.07.2023 është drejtuar Drejtorisë TIK në DPT mbi Manualin dhe Rregullorin e SMK, ku me anë të shkresës nr.12625/1, datë 27.07.2023 janë përcjellë vetëm për Manual përdorimi, por jo për rregullore. Në aspektin e disiplinimit të fondeve mbështetëse në ligje, VKM dhe Udhëzime nga MFE për buxhetin. Ligji nr.9936,, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimi plotësues nr.2, datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, Vendimin nr.887, datë 27.12.2022 “Për procedurën e menaxhimit të investimeve publike”, si dhe në njohje të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin e kontrollit financiar”.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Me shkresën nr.12625, datë 25.07.2023 është drejtuar Drejtorisë TIK në DPT mbi Manualin dhe Rregullorin e SMK, ku me anë të shkresës nr.12625/1, datë 27.07.2023 janë përcjellë vetëm për Manual përdorimi, por jo për rregullore.

Statusi: I pa zbatuar.

15.1 Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse në DPT të marrin masa që të kryhet një proces i kujdesshëm i inventarit si edhe të merren masa për sistemimin e situatës për materialet e pa dorëzuara nga ish punonjësit, me qëllim rritjen e cilësisë së informacionit që gjenerohet nga pasqyrat financiare krahasuar me gjendjen fizike.

Strukturat përgjegjëse në DPT dhe struktura përgjegjëse në AKSHI-t të marrin masat për zgjidhjen e problematikave të konstatuara gjatë procesit të ndjekur për kalimin e aseteve nga DPT tek AKSHI, me qëllim finalizimin sa më të shpejtë të këtij procesi.

Menjëherë e në vijimësi

Qëndrimi i Subjektit: Inventari i realizuar në bazë të Urdhërit të Titullarit nr.19871, datë 11.12.2023. Shkresa drejtuar ish-punonjësve: z. D. S., shkresa nr.1922, datë 30.01.2024; z. K. P. shkresë nr.1922/2, datë 30.01.2024; z. K. F. shkresa nr.1922/1, datë 30.01.2024; z. I. C. shkresa nr.1922/3, datë 30.01.2024. Gjithashtu Drejtoria TIK në DPT për disa rekomandime ku një ndër to është për zgjidhjen çështjes së inventarit të ish punonjësit z. K. P. me shkresën nr.5749/41, datë 14.12.2023.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Drejtoria e Përgjithshme e ka ngritur Komisionin e Inventarizimit, ku janë paraqitur edhe shkresat drejtuar ish- punonjësve, po ashtu

edhe për zgjidhjen e çështjes së inventarit të ish punonjësit z. K. P.. Kalimi i aseteve nga DPT tek AKSHI, nuk është kryer.

Statusi: I pa zbatuar.

16.1 Rekomandimi: Nga ana e titullarit të DPT-së të përcaktohen procedura konfirmuese mbi vendimet gjyqësore dhe efektin e pritshëm të tyre në ciklin e menaxhimit të shpenzimeve buxhetore me qëllim shmangien e efekteve negative për buxhetin e shtetit.

DPT t'i bëjë të ditur MFE që të marrë masat për përcjelljen e kësaj problematike pranë Drejtorisë së Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, ku konkretisht Sektori i Kontabilitetit të kësaj drejtorie të marrë masat për shqyrtimin e situatës, në mënyrë që të përcaktohen edhe procedurat që do të ndiqen për njohjen e këtyre detyrimeve dhe përlllogaritjen e provizioneve nga njësitë publike në zbatim të kuadrit ligjor.

Menjëherë e në vijimësi

Qëndrimi i Subjektit: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e ka për detyrim ligjor uljen e detyrimeve të prapametura. Procesi i vendimeve gjyqësore është pjesë e një komisioni, jo vetëm i DFB ku detyra e saj në raport me vendimet gjyqësore të formës së prerë është garancia e fondeve për likuidimin dhe uljen e detyrimeve të prapambetura që rrjedhin nga vendimet. Në lidhje me njohjen e detyrimeve si provigjon, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve i është drejtuar Drejtorisë së Harmonizimit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, e cila ka konfirmuar saktësinë e procedurës së ndjekur deri më tani nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, si dhe MFE do të marrë masa në nxjerjen e Udhëzimit për provigjone në periudhat në vijim. Deri më tani nuk ka udhëzim mbi trajtimin e provigjoneve. Shkresa nr.1337, datë 09.08.2023 e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, kthyer pergjigje me shkresën nr.14755/1, datë 16.10.2023, protokolluar me tonën me nr.13377/1, datë 17.10.2023.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Harmonizimit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë kanë patur komunikim shkresor mes tyre mbi procedurat që do të ndiqen për njohjen e këtyre detyrimeve dhe përlllogaritjen e provizioneve nga njësitë publike në zbatim të kuadrit ligjor por deri më tani nuk ka një procedurë ndjekjeje për llogaritjen e provizioneve.

Statusi: I pa zbatuar.

17.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të marrë masa që në aktivitetet e planifikimit për kontroll të reflektohet stoku i kontrolleve të mbartura nga viti i kaluar dhe në bashkëpunim me DRT të shkëmbejë në kohë informacion për problematikat e kontrolleve tatimore.

Drejtoria e Përgjithshme Tatimeve të marrë masa për plotësimin e organikës në kuadër të ndryshimeve të strukturës së miratuar me VKM me qëllim arritjen e objektivave të institucionit. Drejtoria e Përgjithshme Tatimeve të hartojë strategji dhe plane operationale të dedikuara për secilin nga sektorët të evidentuar me risk të lartë si pasojë e rregullave të thyera të evidentuara nga moduli i menaxhimit të riskut.

Menjëherë e në vijimësi

Qëndrimi i Subjektit: Drejtoria e Menaxhimit të Riskut në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve thekson se nuk ka detyrë funksionale që të rakordojë stokun e prapambetur të kontrolleve tatimore të planifikuara por të pa filluara, duke qënë se planifikimet e kryera bazohen në orët në dispozicion të DRT-ve, që DMR-së i vihen në dispozicion të miratuara dhe mbi to planifikon kontrollet tatimore për çdo DRT. Lidhur me rekomandimin për vendet vakante, sqarojmë se një vend që është në strukturën e DMR, është shpallur në DAP në fillim të 2024 dhe po ndiqet përfundimi i procesit.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga auditimi i zhvilluar ne terren konstatohet se në aktivitetet e planifikimit për kontroll nuk është reflektuar stoku i kontrolleve të prapambetura përderisa sa ekziston ende një stok i këtyre kontrolleve edhe pse numri ka ardhur në rënie si dhe nuk ka bashkëpunim me DRT për të shkëmbyer në kohë informacion për problematikat e kontrolleve tatimore. Gjithashtu është konstatuar se ekzistojnë ende vanakca në DMR. Si dhe nuk është sepse nga auditimi i vitit 2023 nuk kanë hartuar plane operacionale dedikuar sektorevë me risk të lartë si pasojë e rregullave të thyera të evidentuara nga moduli i menaxhimit të riskut.

Statusi: I pa zbatuar.

18.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të merren masa për vendosjen në funksionim të Programit “E-Inspektor” i cili shërben për regjistrimin e veprimeve të punës së Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren me qëllim rritjen e transparencës dhe monitorimit në kryerjen e kontrolleve tatimore si dhe të reflektohen në urdhrat e punës, parashikimet e bëra për kontrolle të inventarit fizik sipas planeve të miratuara.

Menjëherë e në vijimësi

Qëndrimi i Subjektit: Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren nuk e shikon të arsyeshme vendosjen në funksionim të programit E-Inspektori sipas rekomandimit nga ana e KLSH-së, pasi programi nuk ka sjellë rezultatet e pritshme në drejtori. Gjatë periudhës së përdorimit ka patur problematika të tilla si: Mungesa e valëve në zona të caktuara, Problematika me hartën dixhitale, subjekte jashtë zonës së mbulimit gjë që sillte alert në programin E-inspektori (dalje nga zona), Probleme me GPS. Problematikat e sipërcituara janë bërë shkak i pengesave në mbarëvajtjen e punës së përditshme nga ana e grupeve të punës.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Rekomandimi nuk është pranuar dhe nuk është zbatuar.

Statusi: I pa pranuar.

19.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Investigimit të Brendshëm Antikorrupsion të hartohen dhe raportohen sipas frekuencës së kërkuar në manualin e punës, planet vjetore dhe strategjike si dhe të kryhet raportimi në kohë mbi rezultatet e punës.

Menjëherë e në vijimësi

Qëndrimi i Subjektit: Drejtoria Invstigimit të Brendshëm Antikoorupsion ka përgatitur Planin e Punës Operacional Janar-Qershor 2024, me nr.1 prot., datë 03.01.2024. Gjithashtu, nga ana e kësaj drejtorie është kryer dhe raporti i punës për periudhën Janar-Dhjetor 2023, me nr.2 prot, datë 25.01.2024.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Është kryer në afat raportimi me shkresën nr.2, datë 25.01.2024 “Evidenc mbi punën e kryer nga DIBA për punën e kryer për periudhën janar-dhjetor 2023”. Me shkresën nr.122 prot., datë 05.01.2024 është hartuar plani i punës operacional për peridhën janar-qershor 2024.

Statusi: I zbatuar.

20.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të merren masa për koordinimin dhe miratimin në kohë nga niveli i duhur hierarkik të aktivitetit monitorues në DRT.

Menjëherë e në vijimësi

Qëndrimi i Subjektit: Ky rekomandim, është duke u ndjekur në vijimësi nga Drejtoria e Kontrollit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga auditimi i zhvilluar në DPT, konkretisht për aktivitetin e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor për vitin 2023, nuk janë konstatuar tejkallim të afatit të programeve të kontrollit pa miratim nga Drejtori i Përgjithshëm.

Statusi: I zbatuar.

21.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të implementohen procedura rakordimi me DRT me qëllim planifikimin e saktë të burimeve kohore dhe njerëzore në dispozicion për kryerjen e kontrolleve sipas aktivitetit vjetor.

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të ngrihet grup pune për të analizuar shkaqet e performancës në rënie të zbulimeve nga kontrollet dhe të merren masa me qëllim përmirësimin e treguesve.

Menjëherë e në vijimësi

Qëndrimi i Subjektit: Bazuar Urdhërit Nr.215, datë 06.12.2023, me Nr 19639 Prot., datë 06.12.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për analizimin e shkaqeve të performancës në rënie të zbulimeve nga kontrolli: është urdhëruar grupi i punës për zbatimin e këtij rekomandimi. Qëllimi kryesor i kësaj analize është për të evidentuar dhe njëkohësisht për të nxjerrë dhe analizuar shkaqet e performancës në rënie të zbulimeve të kontrollit. Grupi i punës në lidhje me planifikimin dhe realizimin e kontrolleve për vitin 2022 (Objekt kontrolli të auditit) krahasimi i të dhënave të KLSH-së për vitin 2022 me vitin 2021: Ka bërë shtjellimin e trajtimit të Raport Kontrollit të KLSH, Pika 2.6.4 (faqja 110-119) “Auditimi i përputhshmërisë së procedurave të ndjekura nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor” duke analizuar dhe trajtuar edhe një herë të dhënat e raport kontrollit midis të dhënave të DK në DPT, DRT-ve dhe DMR-së.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga auditimi i veprimtarisë së DPT për vitin 2023, konkretisht i Drejtorisë së Kontrollit, është konstatuar se nuk është kryer procedura rakordimi për kontrollet e mbartura me DRT, me qëllim planifikimin e saktë të burimeve kohore dhe njerëzore në dispozicion për kryerjen e kontrolleve sipas aktivitetit vjetor. Sipas Urdhërit Nr 215, datë 06.12.2023, me Nr 19639 Prot., datë 06.12.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për analizimin e shkaqeve të performancës në rënie të zbulimeve nga kontrolli: është ngritur grupi i punës për zbatimin e këtij rekomandimi, ku qëllimi kryesor i kësaj analize ka qënë evidentimi dhe njëkohësisht nxjerra dhe analiza e shkaqeve të performancës në rënie të zbulimeve të kontrollit.

Statusi: Zbatuar pjesërisht.

22.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të merren masa për rakordimin e aktivitetit auditues që në fillim të vitit me qëllim shmangien e auditimeve paralele, për çdo ndryshim plani të merret miratimi nga strukturat përkatëse nga MFE, si dhe të vijohet me rikontrolle për tatimpaguesit e evidentuar me problematika nga auditimi në DTM.

DAB të marrë masa për shpërndarje të drejtë të veprimtarisë audituese, sipas audituesve të brendshëm në dispozicion gjatë hartimit të planit vjetor të auditimit dhe programeve individuale të auditimit për çdo subjekt të audituar.

Menjëherë e në vijimësi

Qëndrimi i Subjektit: Drejtoria e Auditimit të Brendshëm me shkresën nr.15327/1 prot., datë 03.10.2023 ka përcjellë pranë MFE planin vjetor dhe strategjik 2024-2026, nëpërmjet të cilit rezulton të jetë miratuar veprimtaria e DAB për periudhën 2024-2026, planifikim i cili shmang auditimet paralele me institucione të tjera. Për periudhën 01.01.2024 deri 30.12.2024 nga ana e DAB/DPT nuk ka patur ndryshim plani, nëse do të lind nevoja të kishte, miratimi i ndryshimit të planit në MFE është kërkesë e Manualit të Auditimit të Brendshëm. Drejtoria e Auditit të

Brenshëm ka marrë masat e duhura për një shpërndarje të drejtë të veprimtarisë audituese sipas audituesve të brendshëm në dispozicion. Në pasqyrën nr.5 (Kosto e auditimit) është përlllogaritur buxheti faktik i audituesve në fakt dhe përlllogaritja e burimeve sipas strukturës së miratuar. Nga raporti i veprimtarisë së DAB/DPT dokumentuar me shkresën nr.2606/1 prot., datë 15.02.2024, nga pasqyra angazhimet për çdo auditues DAB-ja ka hartuar dhe monitoruar ngarkesën për çdo auditues duke bërë një shpërndarje të drejtë të punës dhe duke harmonizuar subjektet e vlerësuara në bazë risku me aftësitë profesionale të audituesve.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: DAB ka rakorduar aktivitetin auditues në planin vjetor të 2023, duke shmangur auditimet paralele që kryhen edhe nga KLSH. Plani vjetor nuk ka pësuar ndryshime gjatë vitit. Nga titullari i institucionit nuk është marrë vendimi për rikontroll ndaj tatimpaguesit, i konstatuar me problematika në auditimin e DAB në DTM.

Statusi: Zbatuar pjesërisht.

23.1 Rekomandime: Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të merren masa për kryerjen e procedurave të kërkuara nga aktet ligjore në fushën e prokurimit publik me fillimin e vitit buxhetor duke caktuar njësinë e prokurimit në kohë, me qëllim fillimin dhe përfundimin e procedurave të prokurimit brenda afateve të parashikuara në kuadrin rregullator përkatës.

Menjëherë e në vijimësi

Qëndrimi i Subjektit: Ky rekomandim është zbatuar për vitin 2023.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga auditimi i veprimtarisë së Sektorit të Prokurimit për periudhën 2023, ka rezultuar se me urdhër të titullarit të institucionit nr.229, datë 09.01.2023 kanë ngritur njësinë e prokurimit brenda afateve ligjore. Por janë konstatuar se procedurat e prokurimit nuk janë përfunduar në kohë sipas afateve të parashikuara në kuadrin rregullator përkatës.

Statusi: Zbatuar pjesërisht.

24.1 Rekomandimi: DPT të analizojë situatën duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse, si dhe nëpërmjet Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Statistikës të marrë masa për dërgimin në ISSH, së të gjithë listë-pagesave të kontributeve të deklaruara e të paguara.

Menjëherë e në vijimësi

Qëndrimi i Subjektit: Dërgimi i listëpagesave në Institutin e Sigurimeve shoqërore është një sistem tërësisht elektronik. Kushti i vendosur nga DPT me miratim të vetë Institutit të sigurimeve shoqërore është: Një listëpagesë dërgohet nga sistemi i tatimeve E-Tax në Institutin e sigurimeve shoqërore vetëm pasi është kryer pagesa e plotë (sipas deklarimit) dhe janë kaluar në buxhet të ardhurat për Sigurime shoqërore dhe shëndetsore. Evidentimi i një numri të caktuar të listëpagesave që nuk ka vajtur në sigurime nuk është fakt për të lënë një rekomandim pasi këto listëpagesa do të dërgohen në sigurime vetëm pasi të kenë plotësuar kushtin ligjor për pagesë të plotë në buxhet të detyrimit të deklaruar.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Rekomandimi nuk është pranuar dhe nuk është zbatuar.

Statusi: I pa pranuar.

25.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve në bashkëpunim me DAP, të marrë masa për plotësimin e vendeve vakante, pjesë të shërbimit civil, në zbatim të urdhrin nr.33, datë 12.02.2020, të Kryeministrit; rekrutimet e emërimet në ATQ, të kryhen nëpërmjet konkurrimit të hapur, si dhe nëpërmjet Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të marrë masa për hartimin e planit operacional dhe strategjisë menaxhuese, me qëllim planifikimin e rekrutimeve për punonjësit që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Menjëherë e në vijimësi

Qëndrimi i Subjektit: Me implementimit të strukturës së re organizative është mundësuar shpallja e vende vakante. Për nëpunësit civil nuk mund të përgatitet plan i veçantë apo strategji pasi ligji mbi nëpunësin civil dhe aktet nënligjore në zbatim të tij përcaktojnë procedurat që ndiqen për shpalljen e vendeve vakante. Drejtoria e Burimeve Njerëzore ka për detyrë të përcjell çdo vit planin vjetor të shpallje vendeve vakante të ATQ, pranë njësisë përgjegjëse Departamentit të Administratës Publike.

Drejtoria e Burimeve Njerëzore dërgon planin vjetor të vakancave për shpallje vendeve dhe planifikimi dhe strategjia menaxhuese bëhet nga njësia përgjegjëse DAP. Për pozicionet e punës që nuk janë pjesë e shërbimit civil, strategjia menaxhuese për rekrutime ndiqet në përputhje me Rregulloren nr.10, datë 31.01.2020 “Për marrëdhëniet e punës të personelit jonëpunës civil, në Administratën Tatimore Qendrore”, miratuar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm. Deri aktualisht janë nisur 53 pozicione vakante në DAP për plotësimin e tyre.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Me shkresën nr.21953 prot., datë 30.12.2022, Drejtoria e Burimeve Njerëzore në DPT, ka dërguar në DAP, “Planifikimin e nevojave për pranimin në shërbimin civil për vitin 2023”, të miratuar nga titullari i institucionit. Punësimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve bëhet edhe në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, prandaj hartimi i Planit operacional dhe strategjisë menaxhuese është detyrë e drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, e përcaktuar në Rregulloren e brendshme të institucionit, e miratuar me urdhër të Ministrit të Financave. Në zbatim të saj është i domosdoshëm planifikimi dhe strategjia për rekrutimet e punonjësve që punësohen me Kod Pune.

Statusi: Zbatuar pjesërisht.

26.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrë masa për unifikimin e kriterëve të posaçme për pozicionin e inspektorit në Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, kur detyrat funksionale janë të njëjta, me qëllim rritjen e performancës individuale dhe institucionale në këtë fushë.

Menjëherë e në vijimësi

Qëndrimi i Subjektit: Për Administratën Tatimore Qendrore, referuar Urdhrit nr.69, datë 26.05.2023 “Për miratimin e Strukturës Organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”, të Kryeministrit, si dhe Urdhrit nr.189, datë 08.08.2023, “Për miratimin e Organigramës së Administratës Tatimore Qendrore” të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, është miratuar struktura e re së bashku me Organigramën. Ky rekomandim po ndiqet në vijimësi.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga strukturat përgjegjëse për zbatimin e këtij rekomandimi nuk u paraqit asnjë dokument mbi ecurinë e tij.

Statusi: I pa zbatuar.

27.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë ndaj strukturave përgjegjëse për mosplotësim të dosjeve të personelit, si dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore në DPT dhe Sektorët e Burimeve Njerëzore në Drejtoritë Rajonale, të marrin masa për plotësimin dhe përditësimin e të gjitha dosjeve të punonjësve, me dokumentacionin e nevojshëm.

Menjëherë e në vijimësi

Qëndrimi i Subjektit: Nga sektori i Rekrutimit dhe Promovimit pranë DBNJ, për çdo rekrutim të ri janë njoftuar punonjësit si dhe DRT-të përkatëse për plotësimin e dokumentacionit në dosjet

e personelit sipas pozicionit. Ky është një proces që është në vijimësi dhe ndiqet për çdo emërim rast pas rasti.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: U verifikuan disa dosje personeli të cilat ishin konstatuar me mangësira: si librezat pune, raport mjeko-ligjorë, certifikata etj, ku u konstatuan plotësimi i tyre.

Statusi: I zbatuar.

28.1. Rekomandimi: Titullari i Institucionit të marrë masa për kryerjen e mbledhjeve të GMS me pjesëmarrjen e nivelit drejtues të njësisë, në mënyrë që GMS të ofrojë mbështetje dhe këshilla për vetë titullarin, si dhe të marrë masa për plotësimin e mangësive të evidentuara në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Në vijimësi

Qëndrimi i Subjektit: Nëpunësi Autorizues së bashku me Nëpunësin Zbatues kanë zbatuar me rigorozitet rekomanimin e dhënë mbi GMS-në. Përkatësisht:

1. Takimi i parë më 19.04.2023 mbi “Prioritete buxhetore si dhe kërkesat shtesë”,
2. Takimi i dytë më 09.08.2023 mbi “Kërkesat buxhetore PBA 2024-2026 sipas prioriteteve”,
3. Takimi i tretë më 23.08.2023 mbi “Kërkesat buxhetore dhe kërkesat shtesë të argumentuara”,
4. Takimi i katërt më 07.12.2023 mbi “Drejtoritë e reja Rajonale dhe kërkesat buxhetore”.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga verifikimi i shkresave të vëna në dispozicion grupit të auditimit, u konstatua se GMS ka mbajtur 4 takime gjatë vitit 2023.

Statusi: I zbatuar.

29.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm, edhe në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Posaçëm, të marrë masa me sistemin e gjyqfituesve në kushtet e vakancave në strukturë, me qëllim shmangien e efekteve negative në buxhetin e shtetit.

Brenda datës 31.12.2023

Qëndrimi i Subjektit: Ky rekomandim do të ndiqet në vijimësi pasi afati i vendosur ka qenë i kushtëzuar nga procesi i ristrukturimit të ATQ. Afati i planifikuar për realizimin e këtij rekomandimi është brenda 6 mujorit të parë të 2024. Me implementimin e strukturës së re organizative Komisioni i Posaçëm, në varësi dhe kriterëve për çdo pozicion do marrë në shqyrtim praktikatat gjyqësore me qëllim ekzekutimin e tyre.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Me shkresën nr.7010/1 prot., datë 02.05.2023, DPT ka njoftuar Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, mbi masat e marra në zbatim të Vendimit nr.122, datë 12.10.2022, “..kërkesë për përfundimin e procesit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për 64 nëpunës civilë gjyqfitues”. Sipas Vendimit të KMSHC nr.11, datë 31.01.2024, protokolluar në DPT me nr.3078, datë 15.02.2024, DPT për vitin 2023, ka sistemuar vetëm 1 gjyqfitues. Pas shkresës së DAP me nr.3876/4., datë 20.06.2022, “Akt emërimi me kusht”, me shkresën nr.10517/1 prot., datë 28.06.2023, DPT ka vendosur fillimin e marrëdhënieve të punës, për nëpunësin A. S.

Statusi: I pa zbatuar.

B. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Drejtorinë Ligjore dhe Teknike, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për të

gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjeve gjyqësore.

Brenda datës 31.12.2023

Qëndrimi i Subjektit: Nga ana e strukturave përkatëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve kryesisht, të strukturës menaxhuese të burimeve njerëzore dhe strukturës e cila bën të mundur përfaqësimin e institucionit në proceset gjyqësore që kanë si objekt/fokus marrëdhëniet e punës ka patur bashkërendim të punës dhe bashkëpunim të shtuar me qëllim evidentimin e problematikave kryesore dhe përmirësimin/minimizimin e tyre në të ardhmen.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Për sa më sipër, subjekti i audituar nuk paraqiti një analizë të kryer nga drejtoritë përgjegjëse, mbi shkaqet që kanë sjellë humbje të proceseve gjyqësore, por sqarojnë se gjatë trajtimit të procedurave disiplinore në të ardhmen do bëjnë të mundur zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi.

Statusi: I pa zbatuar.

C. MASA DISIPLINORE

C.1 Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, gjerat “b”, “c” dhe “ç”; bazuar në nenin 57, 58 dhe 59, të Ligjit Nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar, si dhe në VKM nr.115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandohet Titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve vlerësimi i problematikave dhe shkeljeve të përshkruara në mënyrë të detajuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe të nisin procedurat për dhënien e masave disiplinore nga “Vërejtje” deri “Largim nga shërbimi civil”, për të gjithë punonjësit e konstatuar me përgjegjësi sipas çështjeve të trajtuara.

Qëndrimi i Subjektit: Lidhur me vlerësimin e shkeljes disiplinore bazuar në Ligjin Nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar, si dhe VKM nr.115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, për nxjerrje përgjegjësie sipas rekomandimit të lënë nga KLSH, sqarojmë se, titullari i institucionit ka vlerësuar problematikën dhe përgjegjësitë dhe me shkresën nr.1600 Prot., datë 24.01.2024, ka vendosur mosfillimin e procedimit disiplinor për nëpunësit që trajtohen në Raportin Përfundimtar, për shkak se veprimet/mosveprimet e tyre nuk përmbushin elementët e një shkelje disiplinore dhe nuk ka veprime të qëllimshme dhe me pasoja për institucionin. Rekomandimet e lëna dhe problematikën e trajtuara do të merren në konsideratë për përmirësimin e mëtejshëm të punës në realizimin e detyrave dhe objektivave që ka Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga subjekti i audituar është vendosur në dispozicion shkresa nr.1600 prot., datë 24.01.2024 “Mbi vlerësimin e shkeljeve dhe përgjegjësi sipas rekomandimit të KLSH”, ku shprehet se Drejtori i Përgjithshëm ka analizuar të gjitha gjetjet e trajtuara në raportin përfundimtar të KLSH dhe ka gjykuar e vlerësuar se shkeljet nuk përbëjnë element përbërës të një shkelje disiplinore, ku analiza është bazuar në performancën e strukturave të administratës tatimore në përmbushjen e objektivit kryesor që ka në mbledhjen dhe realizimin e të ardhurave tatimore. Në planin e masave të miratuar në zbatim të rekomandimeve, gjetjet e grupit të auditimit do të shërbejnë për përmirësimin e punës në përmbushjen e detyrave funksionale nga strukturat e administratës tatimore. Në përfundim ka vendosur mosfillimin e procedimit disiplinor për nëpunësit.

Statusi: Pa zbatuar.

C.2. Për punonjësit marrëdhëniet e punës së të cilëve rregullohen me Kodin e Punës

Bazuar në Ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe kontratën individuale të punës, pasi të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar shkeljet e evidentuara dhe të jenë identifikuar përgjegjësit në lidhje me këto shkelje, kërkojmë fillimin e dhënies së masave disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna” për të gjithë punonjësit e konstatuar me përgjegjësi sipas çështjeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Qëndrimi i Subjektit: Ky rekomandim është trajtuar sipas shkresës nr.1600 Prot., datë 24.01.2024. Informacioni është dhënë më sipër në pikën D.1.

Qëndrimi i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit: Nga subjekti i audituar është vendosur në dispozicion shkresa nr.1600 prot., datë 24.01.2024 “Mbi vlerësimin e shkeljeve dhe përgjegjësi sipas rekomandimit të KLSH”, ku shprehet se Drejtori i Përgjithshëm ka analizuar të gjitha gjetjet e trajtuara në raportin përfundimtar të KLSH dhe ka gjykuar e vlerësuar se shkeljet nuk përbëjnë element përbërës të një shkelje disiplinore, ku analiza është bazuar në performancën e strukturave të administratës tatimore në përmbushjen e objektivit kryesor që ka në mbledhjen dhe realizimin e të ardhurave tatimore. Në planin e masave të miratuar në zbatim të rekomandimeve, gjetjet e grupit të auditimit do të shërbejnë për përmirësimin e punës në përmbushjen e detyrave funksionale nga strukturat e administratës tatimore. Në përfundim ka vendosur mosfillimin e procedimit disiplinor për nënpunësit.

Statusi: Pa zbatuar.

Në mënyrë të përmbledhur zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

Tabela Statusi i rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm.

Nr	Emërtimi	Gjithsej	Pranuar	Zbatuar	Pjesërisht	Në proces	Pa zbatuar	Pa pranuar
1	Masa Organizative	29	24	7	6		11	5
2	Masa për 3E	1	1				1	
3	Masa Disiplinore	2	2				2	
	Gjithsej	32	27	7	6	0	14	5

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

Ligji Nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”, neni 15 dhe 30;

Shkresa Nr.284/12 Prot datë 09.10.2023, të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit me lëndë “Dërgim i Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe Rekomandimet”.

Shkresa Nr.5749/35 Prot., datë 30.10.2023, “Plani i masave për zbatimin e rekomandimeve sipas raportit të KLSH për auditimin në DPT njoftuar me Shkresën Nr.284/12 Prot., datë 09.10.2023, protokolluar në DPT me Nr.5749/33 Prot., datë 11.10.2023”

Shkresa Nr.5749/46 Prot., datë 04.09.2024, “Raportim lidhur me zbatimin e rekomandimeve sipas raportit të KLSH për auditimin në DPT njoftuar me shkresën Nr.284/12 Prot., datë 09.10.2023, protokolluar në DPT me Nr.5749/33 Prot., datë 11.10.2023”

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

Z. C. K., në cilësinë e Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve

Për sa më sipër me personat përgjegjës C. K..

Për sa është trajtuar në Projekt-raportin Nr. 473./5 datë 09.08.2024 nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me Nr.13085/44 Prot dhe datë 11.09.2024, protokolluar në KLSH me Nr.473/7 Prot., datë 16.09.2024 nga z. C. K., në cilësinë e ish Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: Pretendon se në pjesën e konsiderueshme të veprimeve dhe mosveprimeve të vlerësuara me përgjegjësi Drejtori i Përgjithshëm nuk ka përgjegjësi individuale të titullarit të institucionit për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi

i mëparshëm, konkretisht ngarkimin më përgjegjësi për mos zbatimin e rekomandimeve nr 2.1, 3.1, 7.1, 8.1, 9.1, 14.1, 15.1, 16.1, 17.1, 21.1, 26.1, 29.1.

Oëndrimi i grupit të auditimit: Nga shqyrtimi i observacionit të z. K., sqarojmë janë paraqitur të njëjtat shpjegime si në projekt raportin e auditimit dhe në planin e masave dhe në raportimin lidhur me zbatimin e rekomandimeve sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit njoftuar me shkresën nr. 284/12 Prot., datë 09.10.2023, për periudhën nga data 01.01.2022 deri me datën 31.12.2022. Pra nuk janë vendosur në dispozicion fakte të reja, arsyetim ligjor si dhe dokumentacion i ri justifikues që mbështesin pretendimin kundrejt konstatimeve të grupit të auditimit, për të cilat nuk kemi pasur dijeni në fazën e projekt raportit të auditimit, kjo pjesë e observacionit nuk merret në konsideratë.

Gjetje: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas shkresës Nr.284/12 Prot datë 09.10.2023, të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit me lëndë “Dërgim i Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe Rekomandimet”, konstatohet se nga 32 rekomandime të lëna, subjekti ka pranuar 27 rekomandime, ose 84% e tyre dhe nuk ka pranuar 5 rekomandime. Janë zbatuar plotësisht 7 rekomandime, janë zbatuar pjesërisht 6 rekomandime dhe nuk janë zbatuar 14 rekomandime ose 51.9 % e tyre, si më poshtë:

- Nga 29 “Masa Organizative”, janë pranuar 24 masa, nga të cilat 7 janë zbatuar plotësisht, 6 masa janë zbatuar pjesërisht, 11 masa janë pa zbatuar dhe 5 masa janë pa pranuar.
- Është rekomanduar 1 “Masë për eliminimin e paligjshmërive në administrimin e fondeve publike dhe menaxhimin me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike”, ku nga verifikimi rezultojnë se është pranuar masa por nuk është zbatuar.
- Janë rekomanduar 2 “Masa Disiplinore” në kompetencë të Titullarit, të cilat janë pranuar nga ana e subjektit por nuk janë zbatuar.

Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për strukturat e ngarkuara në planin e masave, të cilët nuk kanë realizuar zbatimin e rekomandimeve, si dhe rikërkojmë të merren masa nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e rekomandimeve që janë në proces zbatimi, pjesërisht të zbatuara si dhe të pa zbatuara të dërguara me shkresën Nr.284/12 Prot., të Kryetarit të KLSH datë 09.10.2023, konkretisht për masat organizative, rekomandimet nr.1, 2, 3, 7, 8, 9, 11, 14, 15, 16, 17, 21, 22, 23, 25, 26, 29, për masën për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike, rekomandimin nr.1 si dhe për dy rekomandimet për masat disiplinore, rekomandimi nr.1 dhe 2.

2.2. Mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për planifikimin dhe realizimin e të ardhurave tatimore gjithsej dhe sipas strukturës dhe llojit të tyre.

Drejtorja e Kontabilitetit dhe Statistikës është e organizuar në dy sektorë, Sektorin e Statistikës dhe Analizës, si dhe Sektorin e Kontabilitetit dhe Pagesës, gjithsej me 14 punonjës. Deri në fund të vitit 2023, kjo strukturë paraqitet me 2 vakanca, përkatësisht në pozicionet e specialistit, në secilin sektor. Pas ndryshimeve strukturore në DPT, kjo drejtori është pakësuar me 1 pozicion specialisti në Sektorin e Kontabilitetit dhe Pagesës, duke u planifikuar të funksionojë gjithsej me 13 punonjës.

Lidhur me kërkesën e grupit të auditimit për vendosjen në dispozicion të raporteve të performancës për aktivitetin e kësaj drejtorie, konstatohet se monitorimi i performancës së drejtorisë kufizohet vetëm në raportin vjetor të DPT i cili paraqet një informacion përmbledhës në rang institucional. Rregullorja e Funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore, miratuar me urdhër nr. 193, datë 12.08.20220, të Ministrit të Financave përcakton se objekt i Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Statistikës është hartimi dhe implementimi i rregullave për monitorimin e zbatimit të ligjit lidhur me kontabilizimin e të ardhurave në sistemin tatimor,

dhe ndjekja e treguesve të performancës nëpërmjet raportimit të drejtorive sipas indikatorëve përkatës. Monitorimin e funksionimit të sistemit të pagesave të detyrimeve tatimore dhe kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, me qëllim lehtësimin e procedurave të pagesës nga tatimpaguesit, lehtësimin e punës në bankat e nivelit të dytë dhe përgatitjen e informacionit në lidhje me këto pagesa dhe përmirësimin e përpunimit të të dhënave të pagesave për qëllime të administratës tatimore. Mbikëqyr dhe ndjek në vazhdimësi zbatimin e procedurave operative që duhet të zbatohen lidhur me pagesën e detyrimeve tatimore dhe kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga tatimpaguesit si dhe monitoron funksionimin e rregullt të sistemit të pagesave që është ngritur.

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion dhe intervistave të kryera me DPT konstatohet se plani i të ardhurave është përgatitur nga MFE, dhe është përcjellë për njohje dhe zbatim pranë DPT. Nga ana e DPT nuk dokumentohet kontributi përgjatë përlllogaritjes së planit të të ardhurave nëpërmjet analizave lidhur me parashikimin e arkëttimeve, projekt plane, apo raporteve të tilla të ngjashme, konfirmuar edhe nga vetë përfaqësuesit e institucionit, se DPT ka vetëm një rol zbatues të planit të të ardhurave.

Grupi i auditimit shqyrtoi Projektligjin për buxhetin e vitit 2023, në të cilin për planifikimin e të ardhurave i referohet synimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për rritjen e të ardhurave, si dhe mbajtjen nën kontroll të defiçitit buxhetor dhe borxhit publik. Ky program bazohet në faktorët që do impaktojnë këtë periudhë dhe risqet e mundshme që mund të shfaqen (inflacioni, importet, çmimet, investimet, energjia elektrike etj). Metodologjia e programimit të të ardhurave është raportuar si e bazuar në modelet bashkëkohore të programimit, dhe në analizën e detajuar të faktorëve që ndikojnë në secilën taksë dhe tatim. Modeli i përdorur bazohet në parashikimet makroekonomike për periudhën 2022-2025 si rritja nominale, deflatori, analiza e importeve të grup produkteve kryesore, analiza e serive kohore si dhe modelet e bazuar në koeficientin e elasticitetit “Buoyancy” dhe “Effective Tax Rate” për çdo taksë. Në mënyrë të detajuar treguesit kryesore për vlerësimin e të ardhurave, sipas projektbuxhetit janë:

- Rritja nominale të PBB-së, duke analizuar këtë efekt në mënyrë të integruar me faktorë të tjerë për çdo taksë në veçanti, të ndërlidhur me të dhënat historike dhe projeksionet e çmimeve në tregjeve ndërkombëtare tek taksat ad-valorem si Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, Renta Minerare dhe Taksa Doganore.
- Kursi i pritshëm i këmbimit të dy monedhave kryesore: USD dhe EURO me Lekun;
- Çmimet në bursë të karburantit, energjisë, që ndikojnë në të ardhurat nga TVSH-ja dhe Renta minerare;
- Sasitë e pritshme të importit të mallrave.

Krahasuar me të pritshmin e vitit 2023, të ardhurat gjithsej të buxhetit të shtetit janë parashikuar të rriten me 7.7 %, ndërkohë që **të ardhurat tatimore nga tatimet dhe doganat janë programuar të rriten me 8% ose +42.2 miliardë lekë.**

Të ardhurat tatimore dhe doganore, përfshirë edhe kontributet e mbledhura nga administrata tatimore janë parashikuar bazuar në analizën e trendit historik të 60 grup-produkteve kryesore, për një periudhë shumëvjeçare. Sipas projektbuxhetit, aktorët që janë marrë në konsideratë të cilët ndikojnë në rritjen e të ardhurave për vitin 2023 janë:

- Kuadri makroekonomik me rritja reale të Prodhimit të Brendshëm Bruto 3.2%, inflacioni i parashikuar 3%, duke analizuar të këtë efekt në mënyrë të integruar me faktorë të tjerë për çdo taksë në veçanti, të ndërlidhur me të dhënat historike dhe projeksionet e çmimeve në tregjeve ndërkombëtare tek taksat ad-valorem si Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, Renta Minerare dhe Taksa Doganore. Në projektion janë përfshirë, faktorë që lidhen me rritjen nominale e PBB-së, kursin mesatar të këmbimit EURO-Lek dhe USD-Lek, si dhe çmimet brent të naftës bruto dhe mineraleve të tjera.

- Paketa e Fiskale 2023, me propozimet në lidhje me ndryshimet e bëra në kuadrin e hartimit të paketës fiskale 2023, të cilat prekin sjellin efekte në Akcizë, Tatimin mbi Fitimin, Tatimin mbi të Ardhurat nga Punësimi dhe Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore, të cilat janë listuar më poshtë.
- Të ardhura të shuara nga mirë administrimi në kuadër të hartimit të Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave, në të cilën për një periudhë 4 vjeçare parashikohet një rritje e të ardhurave me 1.5% PBB, e cila e për çdo vit llogaritet një rritje prej 0.37% të PBB.

Në zbatim të ligjit nr.84 /2022 datë 24.11.2021 "Për buxhetin e vitit 2023", me shkresën e MFE nr. 2701 prot., date 08.02.2023 dhe protokolluar në DPT, nr 2111 prot datë 13.02.2023, është përcjellë planifikimi vjetor i të ardhurave tatimore për periudhën Janar-Dhjetor 2023 progresiv, dhe i ndarë për çdo muaj, në vlerën totale prej **191,480 milion lekë**. Plani i të ardhurave është planifikuar si më poshtë:

Tatim mbi Vlerën e Shtuar (neto)	43,180 milion lekë
Tatim mbi Fitimin	49,500 milion lekë
Tatim mbi të Ardhurat Personale	49,000 milion lekë
Taksa Nacionale dhe të Tjera	49,800 milion lekë

Gjithashtu në këtë shkresë është përcaktuar edhe totali i rimbursimit në vlerën 18,500 milion lekë, së bashku me planifikimin e këtij zëri për çdo muaj. Sipas aneksit bashkëlidhur shkresës ku detajohet plani mujor, konstatohet se totali i planit për këtë zë rezulton 18,000 milion lekë, dhe jo 18,500 milion lekë.

Me shkresën nr. 2703 prot datë 08.02.2023 është përcjellë nga MFE planifikimi total vjetor dhe i ndarë sipas muajve, i të ardhurave të DPT për *kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore*, në vlerën totale prej 123,800 milion lekë.

Në vijim, me shkresën nr/ 2615, prot datë 21.02.2023 të MFE, prot në DPT nr. 2831, prot datë 23.02.2023 është përcjellë detajimi i të ardhurave të taksave nacionale dhe të tjera, sipas zërave përkatës. Nga auditimi konstatohet se po në këtë shkresë, është përcaktuar sërish edhe planifikimi vjetor dhe mujor i të ardhurave të TVSH (neto), dhe rimbursimit, pavarësisht se për këto zëra ishte dërguar fillimisht plani me shkresën nr. 2701 prot në MFE datë 08.02.2023. Me ridërgimin e kësaj shkresë konstatohen se janë kryer ndryshime në vlerën totale të zërit të rimbursimeve, fillimisht i planifikuar në 18,500 milion lekë, dhe tanimë ky zë është programuar në vlerën 18,000 milion lekë, pra 500 milion lekë më pak.

Me shkresën nr.3615, prot datë 21.02.2023 të MFE, prot në DPT nr.2831, prot datë 23.02.2023 është përcjellë plani i të ardhurave të DPT për rimbursimin e TVSH (sërish 18,000 mijë lekë) si dhe është detajuar plani për taksat nacionale e të tjera për vitin 2023.

Konkretisht, plani i miratuar sipas muajve për vitin 2023, dhe sipas llojit të të ardhurave paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Tabela: Plani mujor fillestar i DPT për vitin 2023

Nr.	Planet mujore të DPT për vitin 2023						
	E M E R T I M I	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
	D.P.T TOTAL (Bruto)	30,996,000	22,259,000	34,650,000	26,506,000	23,024,000	24,153,000
A	Te Ardhurat Tatimore gjithsej (bruto)	19,083,000	13,214,000	25,363,000	15,341,000	13,411,000	14,524,000
1	Tatimi Vlerës së Shtuar (bruto)	7,732,000	4,520,000	4,243,000	4,573,000	4,283,000	3,793,000
	- Tatimi Vlerës së Shtuar (neto)	7,032,000	3,020,000	2,743,000	2,973,000	2,683,000	2,193,000
	- Rimbursimi T.V.SH.-se	700,000	1,500,000	1,500,000	1,600,000	1,600,000	1,600,000
2	Tatim mbi Fitimin	2,410,000	2,428,000	10,673,000	3,611,000	2,922,000	4,106,000
3	Ardhura Personale	5,268,000	3,354,000	3,790,000	4,175,000	3,630,000	3,657,000
4	Taksat Nacionale	1,673,000	912,000	357,000	982,000	576,000	968,000
5	Taksa Qarkullimit Rrugor	1,800,000	1,800,000	1,800,000	1,800,000	1,800,000	1,800,000
6	Kazinot dhe Lodrat	200,000	200,000	200,000	200,000	200,000	200,000
7	Tatimi nga Energjika	0	0	4,300,000	0	0	0
8	Dënimet Administrative	0	0	0	0	0	0

B	Te Ardhurat Tatimore gjithsej (neto)	18,383,000	11,714,000	23,863,000	13,741,000	11,811,000	12,924,000
C	Kontributet e Sigurimeve gjithsej	11,913,000	9,045,000	9,287,000	11,165,000	9,613,000	9,629,000
D=B+C	D.P.TATIMEVE TOTAL (Neto)	30,296,000	20,759,000	33,150,000	24,906,000	21,424,000	22,553,000
	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	viti 2023
	26,859,000	27,232,000	28,023,000	26,973,000	31,976,000	30,629,000	333,280,000
	15,404,000	17,299,000	17,964,000	16,061,000	21,812,000	20,004,000	209,480,000
	4,814,000	5,129,000	5,429,000	5,377,000	5,722,000	5,565,000	61,180,000
	3,214,000	3,529,000	3,829,000	3,777,000	4,122,000	4,065,000	43,180,000
	1,600,000	1,600,000	1,600,000	1,600,000	1,600,000	1,500,000	18,000,000
	2,618,000	2,691,000	4,068,000	2,848,000	4,374,000	6,751,000	49,500,000
	4,180,000	5,404,000	3,774,000	3,958,000	3,750,000	4,060,000	49,000,000
	1,592,000	1,865,000	2,383,000	1,568,000	1,656,000	1,318,000	15,850,000
	1,800,000	1,800,000	1,900,000	1,900,000	1,900,000	1,900,000	22,000,000
	400,000	410,000	410,000	410,000	410,000	410,000	3,650,000
	0	0	0	0	4,000,000	0	8,300,000
	0	0	0	0	0	0	0
	13,804,000	15,699,000	16,364,000	14,461,000	20,212,000	18,504,000	191,480,000
	11,455,000	9,933,000	10,059,000	10,912,000	10,164,000	10,625,000	123,800,000
	25,259,000	25,632,000	26,423,000	25,373,000	30,376,000	29,129,000	315,280,000

Burimi: Të dhëna të DPT

Nga auditimi konstatohet se pavarësisht se sipas projekt ligjit është argumentuar se krahasuar me të pritshmin e vitit 2023, të ardhurat gjithsej të buxhetit të shtetit janë parashikuar të rriten me 7.7 %, ndërkohë që të ardhurat tatimore nga tatimet dhe doganat janë programuar të rriten me 8%, nëse i referohemi planit fillestar të miratuar me ligjin e buxhetit të vitit 2023, rezultojnë se faktikisht, **të ardhurat nga TVSH (bruto)** rezultojnë të jenë planifikuar **vetëm 7.2% më tepër se realizimi i vitit 2022**. Ky nivel rritjeje në plan, vjen si rezultat i një planifikimi për rimbursimet e kryera rreth 20% më pak se rimbursimet e vitit 2022, dhe një rritjeje të të ardhurave neto nga TVSH në rreth 25% më shumë re realizimi i vitit paraardhës për këtë zë. Gjithashtu, të ardhurat nga tatimi mbi fitimin, pavarësisht projekcionit të rritjes së të ardhurave, konstatohet se në planin sipas Ligjit të Buxhetit ka reflektuar vetëm normat e inflacionit të pritshëm (rreth 3%), duke miratuar një plan për tatim fitimin me vetëm 3.6% më shumë se realizimi i vitit 2022. Në ndryshim nga të ardhurat e tjera, të ardhurat personale rezultojnë të jenë planifikuar 3.3% më pak se viti paraardhës. Konkretisht, tabela e mëposhtme paraqet nivelin e planifikimit të të ardhurave të vitit 2023 sipas Ligjit të Buxhetit, krahasimisht me realizimin faktik të tyre në vitin 2022:

Në mijë lekë

Tabela: Analiza krahasimore e planit fillestar, me realizimin e vitit paraardhës

Emërtimi	Fakti 2022	Plani fillestar 2023	Diferenca
D.P.TATIMEVE TOTAL (Bruto)	308.041.398	333.280.000	8,2%
(Tatimet + Rimbursime + Kontribute)			
Te Ardhurat Tatimore gjithsej (arketim)	189.576.225	209.480.000	10,5%
<i>Nga te cilat:</i>			
Tatimi Vlerës se Shtuar (bruto)	57.068.399	61.180.000	7,2%
- Tatimi Vlerës se Shtuar (neto)	34.587.338	43.180.000	24,8%
- Rimbursimi i kryer (gjithsej)	22.481.061	18.000.000	-19,9%
Tatim mbi Fitimin	47.796.671	49.500.000	3,6%
Ardhura Personale	50.695.818	49.000.000	-3,3%
Taksat dhe Tarifa Nacionale	13.666.033	15.850.000	16,0%
Taksa Qarkullimi Rrugor	18.249.964	22.000.000	20,5%
Lojrat e Fatit	1.972.682	3.650.000	85,0%
Te tjera kontribut solidariteti nga Energjia	(0.02)	8.300.000	NA
Dënimet Administrative	126.659		-100,0%
Te Ardhurat Tatimore gjithsej (neto)	167.095.164	191.480.000	14,6%
Kontributet e Sigurimeve gjithsej	118.465.172	123.800.000	4,5%
- Tarifa jo Tatimore	3.295.493		-100,0%
D.P.TATIMEVE TOTAL (Neto)	285.560.337	315.280.000	10,4%

Burimi: Të dhëna të DPT

Me urdhrin nr.3090, prot datë 28.02.2023 “Për detajimin e planit të të ardhurave për vitin 2023” të Drejtorit të Përgjithshëm z. C. K., është ngritur grupi i punës për detajimin e planit të të ardhurave për vitin 2023.

Për sa trajtuar më sipër konstatohet se planifikimi i të ardhurave në nivel MFE-DPT është shtrirë përgjatë harkut kohor Janar-Shkurt 2023, ndërkohë që njohja e drejtorive rajonale me planin e miratuar është mundësuar vetëm përgjatë muajit Mars. Kjo situatë ka shkaktuar që përgjatë 3-mujorit të parë të vitit 2023 realizimi i të ardhurave të administratës tatimore nuk ka qenë i bazuar në një planifikim mujor për nivelet e pritshme të realizimit të të ardhurave.

Konkretisht, shkresa e parë e planit për DRT-të është përcjellë sipas shkresës nr. 3090/1, prot datë **16.03.2023** të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, duke cituar se është dërguar plani vetëm për muajin **Mars 2023**, **pra jo një plan progresiv përgjatë të gjithë muajve sipas DRT-ve.**

Përgjatë muajve në vijim, planifikimi ka vijuar po në nivel muaji, dhe i dërguar sipas shkresave të mëposhtme, të cilat sikur vërehen, datojnë **në mes/fund muaji:**

-Për muajin Prill, plani mujor për DRT-të është përcjellë me shkresën nr. 6660, prot datë 14.04.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm.

-Për muajin Maj, plani mujor për DRT-të është përcjellë me shkresën nr. 8822, prot datë 19.05.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm.

-Për muajin Qershor, plani mujor për DRT-të është përcjellë me shkresën nr. 10610, prot datë 16.06.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm.

-Për muajin Korrik, plani mujor për DRT-të është përcjellë me shkresën nr. 12138, prot datë 19.07.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm.

-Për muajin Gusht, plani mujor për DRT-të është përcjellë me shkresën nr. 13504, prot datë 11.08.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm.

-Për muajin Shtator, plani mujor për DRT-të është përcjellë me shkresën nr. 14888, prot datë 13.09.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm.

-Për muajin Tetor, plani mujor për DRT-të është përcjellë me shkresën nr. 16177, prot datë 10.10.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm.

-Për muajin Nëntor, plani mujor për DRT-të është përcjellë me shkresën nr. 17884, prot datë 19.11.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm.

-Për muajin Dhjetor, plani mujor për DRT-të është përcjellë me shkresën nr. 20258, prot datë 14.12.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm.

2.b Ndryshimet në planin e të ardhurave

Në zbatim të **Aktit Normativ nr.5, datë 18.10.2023**, me shkresën e MFE nr. 19769, prot datë 30.10.2023, prot në DPT nr. 17345 prot date 02.11.2023, është përcjellë plani i rishikuar i të ardhurave në vlerën 200,134 milion lekë, pra 8,654 milion lekë më shumë se plani i përcaktuar në Ligjin e Buxhetit (5% më shumë), më hollësisht si më poshtë:

<i>Tatim mbi Vlerën e Shtuar</i>	<i>47,334 milion lekë</i>
<i>Tatim mbi Fitimin</i>	<i>59,000 milion lekë</i>
<i>Tatim mbi të Ardhurat Personale</i>	<i>56,000 milion lekë</i>
<i>Taksa Nacionale dhe të Tjera</i>	<i>37,800 milion lekë</i>

Për sa më sipër konstatohet se me Aktin Normativ nr. 5 përgjithësisht vërehet se ka pësuar rritje në planin e të ardhurave për të gjitha zërat, ku përjashtim përbën plani për të ardhurat nga taksat nacionale e të tjera, për të cilat ka patur rënie me 12.000 milion lekë (24% më pak); dhe plani i rimbursimit të TVSH-së, për të cilin nuk ka pësuar ndryshime. Më hollësisht planifikimi për të ardhurat nga TVSH-ja ka pësuar një rritje prej 4,154 milion lekë (10% më shumë); plani për të ardhurat nga tatimi mbi fitimin paraqitet 9,500 milion lekë më shumë (19%); plani për tatimin e të ardhurave personale me një rritje prej 7,000 milion lekë (14%). Për ndryshimet në planin e të ardhurave sipas aktit normativ, situata paraqitet e ngjashme sikundër për planin fillestar, ku sërisht nuk dokumentohet roli i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për këtë vendimarrje.

Me shkresën nr. 19768, prot datë 30.10.2023 të MFE, prot në DPT nr. 17302 prot datë 01.11.2023, është përcjellë plani i rishikuar i të ardhurave për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, ku ky plan ka ndryshuar në 139,900 milion lekë, nga 123,800 milion lekë të planifikuara me ligjin e buxhetit.

Në mijë lekë

Tabela: Plani mujor i rishikuar i DPT për vitin 2023

Nr.	Planet mujore te DPT për vitin 2023						
	EMERTIMI	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR
	D.P.TATIMEVE TOTAL (Bruto)	31,198,000	23,391,000	38,254,000	28,153,000	26,235,000	29,402,000
		0	0	0	0	0	0
A	Te Ardhurat Tatimore gjithsej (bruto)	19,142,000	13,311,000	28,003,000	16,243,000	15,138,000	18,070,000
		0	0	0	0	0	0
1	Tatimi Vlerës së Shtuar (bruto)	7,799,000	4,288,000	4,557,000	4,443,000	4,461,000	5,247,000
	- Tatimi Vlerës së Shtuar (neto)	7,099,000	2,788,000	3,057,000	2,843,000	2,861,000	3,647,000
	- Rimbursimi T.V.SH.-se	700,000	1,500,000	1,500,000	1,600,000	1,600,000	1,600,000
2	Tatim mbi Fitimin	2,397,000	2,477,000	12,433,000	4,223,000	3,431,000	4,565,000
3	Ardhura Personale	5,158,000	3,805,000	4,173,000	4,876,000	4,674,000	5,006,000
4	Taksat Nacionale	1,908,000	861,000	700,000	821,000	692,000	1,412,000
5	Taksa Qarkullimit Rrugor	1,700,000	1,700,000	1,700,000	1,700,000	1,700,000	1,700,000
6	Kazinot dhe Lodrat	180,000	180,000	140,000	180,000	180,000	140,000
7	Tatimi nga Energjitika	0	0	4,300,000	0	0	0
8	Dënimet Administrative	0	0	0	0	0	0
B	Te Ardhurat Tatimore gjithsej (neto)	18,442,000	11,811,000	26,503,000	14,643,000	13,538,000	16,470,000
		0	0	0	0	0	0
C	Kontributet e Sigurimeve gjithsej	12,056,000	10,080,000	10,251,000	11,910,000	11,097,000	11,332,000
		0	0	0	0	0	0
D=B+C	D.P.TATIMEVE TOTAL (Neto)	30,498,000	21,891,000	36,754,000	26,553,000	24,635,000	27,802,000
		0	0	0	0	0	0
	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	PLANI VITIT
	30,934,000	31,154,000	30,147,000	28,996,000	31,649,000	28,521,000	358,034,000
				0			
	17,455,000	19,692,000	18,688,000	16,196,000	20,187,000	16,009,000	218,134,000
				0			
	5,782,000	6,024,000	6,554,000	5,652,000	5,340,000	5,187,000	65,334,000
	4,182,000	4,424,000	4,954,000	4,052,000	3,740,000	3,687,000	47,334,000
	1,600,000	1,600,000	1,600,000	1,600,000	1,600,000	1,500,000	18,000,000
	3,147,000	3,929,000	4,044,000	3,007,000	3,736,000	3,311,000	50,700,000
	5,299,000	6,245,000	4,495,000	4,131,000	3,913,000	4,225,000	56,000,000
	1,347,000	1,614,000	1,655,000	1,426,000	1,118,000	1,246,000	14,800,000
	1,700,000	1,700,000	1,800,000	1,800,000	1,900,000	1,900,000	21,000,000
	180,000	180,000	140,000	180,000	180,000	140,000	2,000,000
	0	0	0	0	4,000,000	0	8,300,000
	0	0	0	0	0	0	0
	15,855,000	18,092,000	17,088,000	14,596,000	18,587,000	14,509,000	200,134,000
				0			
	13,479,000	11,462,000	11,459,000	12,800,000	11,462,000	12,512,000	139,900,000
				0			
	29,334,000	29,554,000	28,547,000	27,396,000	30,049,000	27,021,000	340,034,000
				0			

Burimi: Të dhëna të DPT

Sikundër vërehet më sipër, ndryshimet në Aktin Normativ, pavarësisht se janë miratuar në datën 18.10.2023, dhe janë përcjellë pranë DPT për dijeni në datën 02.11.2023, këto ndryshime konstatohet se kanë patur efekt edhe mbi muajt paraardhës, dhe jo vetëm në muajin Nëntor dhe Dhjetor. Kryerja e ndryshimeve në periudha për të cilat realizimi është kryer në ndjekje të një plani të përcaktuar më parë me ligjin vjetor të buxhetit, sjell si pasojë kryerjen e ndryshimeve pas faktit, të cilat ndjekin trendin e realizimit dhe nuk janë më kriter vlerësimi, për sa kohë nuk janë relevant me realizimin.

Ndryshimet që kanë ndodhur përgjatë vitit lidhur me planin e të ardhurave sipas drejtorive rajonale tatimore, paraqiten si më poshtë:

Në mijë lekë

Tabela: Analiza e planit fillestar në nivel DRT-je, krahasuar me planin përfundimtar të 2022, dhe ndryshimet gjatë vitit 2023

DRT	Plani përfundimtar i te ardhurave të vitit 2022	Ligji i Buxhetit 2023	Aktit Normativ nr.5, datë 18.10.2023	Ndryshimi plan perf. –plan fillestar	Ndryshim i ne %
DRT Bruto (tatime + rimbursime+kontribute)	308,655,000	333,280,000	358,034,000	24,754,000	7.4%
D. R. T. Berat	4,081,000	4,253,000	4,487,000	234,000	5.5%
D. R. T. Diber	4,491,000	4,418,000	4,752,000	334,000	7.6%
D. R. T. Durrës	17,397,000	17,993,000	21,354,000	3,361,000	18.7%
D. R. T. Elbasan	7,982,000	8,396,100	9,130,100	734,000	8.7%
D. R. T. Fier	9,427,000	9,600,000	10,819,000	1,219,000	12.7%
D. R. T. Gjirokaster	2,822,600	3,087,000	3,407,500	320,500	10.4%
D. R. T. Korçë	6,244,000	6,511,000	7,081,000	570,000	8.8%
D. R. T. Kukës	2,115,000	2,251,000	2,520,500	269,500	12.0%
D. R. T. Lezhe	4,284,000	4,378,000	4,728,500	350,500	8.0%
D. R. T. Sarandë	2,320,000	2,422,100	2,914,600	492,500	20.3%
D. R. T. Shkodër	6,880,000	7,061,000	7,761,000	700,000	9.9%
D. R. T. Tiranë	116,783,000	117,953,800	130,084,800	12,131,000	10.3%
D. R. Tatimpaguesit e mëdhenj	117,648,400	138,288,000	140,866,000	2,578,000	1.9%
D. R. T. Vlorë	6,180,000	6,668,000	8,128,000	1,460,000	21.9%

Burimi: Të dhëna të DPT përpunuar nga grupi i auditimit

Për sa më sipër konstatohet se krahasimisht me planin fillestar të të ardhurave, plani ka pësuar një rritje në masën 7.4%, respektivisht në vlerën 24,754,000 mijë lekë. Përqindja më e lartë e rritjes së planit të të ardhurave konstatohet në DRT Vlorë me 21.9%, ndjekur nga DRT Sarandë me 20.3%, dhe DRT Durrës, me rreth 18.7% më shumë se plani fillestar. Në raport me vlerën e rritjes, konstatohet se rritja më e madhe e planit përqendrohet në DRT Tiranë, 12,131,000 mijë lekë më shumë, ndjekur nga DRT Durrës me 3,361,000 mijë lekë më shumë, dhe DRT me 2,578,000 mijë lekë më shumë se plani me Ligjin e Buxhetit.

2.c Realizimi i të ardhurave tatimore

Referuar raportimit të kryer nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, realizimi i të ardhurave në total (bruto) paraqitet në vlerën 366,874 milion lekë, pra 8,840 milion lekë më shumë, (ose 2.47%) se plani i rishikuar i të ardhurave i cili rezulton në vlerën 358,034 milion lekë. Në krahasim më vitin 2022 ku të ardhurat janë realizuar në vlerën 308,041 milion lekë, të ardhurat paraqiten 49,091 milion lekë më shumë, ose 15.94% më shumë.

Për sa i përket nivelit të realizimit për total zërat, krahasimisht me planin e rishikuar dhe realizimin e vitit paraardhës, situata paraqitet si më poshtë.

Në mijë lekë

Tabela: Realizimi i planit të ardhurave të DPT për vitin 2023, kundrejt planit dhe vitit paraardhës

	Emërtimi	Realizimi 2022	Realizimi 2023	Plani përfundimtar 2023	Diferenca plan - fakt	Diferenca a plan - fakt %	Diferenca 2023 – 2022	Diferenca 2023 – 2022 %
A	D.P.TATIMEVE TOTAL (Bruto)	308,041,398	366,874,372	358,034,000	8,840,372	2.47%	58,832,974	19.1%
	(Tatimet + Rimbursime + Kontribute)		357,132,813					
B	Te Ardhurat Tatimore gjithsej (arketim)	189,576,225	227,619,454	218,134,000	9,485,454	4.35%	38,043,229	20.1%
	<i>Nga te cilat:</i>		217,877,895					
1	Tatimi Vlerës se Shtuar (bruto)	57,068,399	68,657,656	65,334,000	3,323,656	5.09%	11,589,257	20.31%
	- Tatimi Vlerës se Shtuar (neto)	34,587,338	46,043,114	47,334,000	(1,290,886)	-2.73%	11,455,776	33.12%
	- Rimbursimi i kryer (gjithsej)	22,481,061	22,614,542	18,000,000	4,614,542	25.64%	133,481	0.59%
2	Tatim mbi Fitimin	47,796,671	54,986,282	50,700,000	4,286,282	8.45%	7,189,611	15.04%
3	Ardhura Personale	50,695,818	57,999,211	56,000,000	1,999,211	3.57%	7,303,393	14.41%
4	Taksat dhe Tarifa Nacionale	13,666,033	14,339,846	14,800,000	(460,154)	-3.11%	673,813	4.93%
5	Taksa Qarkullimi Rrugor	18,249,964	19,545,556	21,000,000	(1,454,444)	-6.93%	1,295,592	7.10%
6	Lojrat e Fatit	1,972,682	2,176,798	2,000,000	176,798	8.84%	204,117	10.35%
7	Te tjera kontribut solidariteti nga Energjia	(0.02)	9,741,559	8,300,000	1,441,559	17.37%	0	0.00%
8	Dënimet Administrative	126,659	172,545	0	172,545		45,887	36.23%
C	Te Ardhurat Tatimore gjithsej (neto)	167,095,164	205,004,912	200,134,000	4,870,912	2.43%	28,168,188	16.86%

			195,263,353		195,263,353			
D	Kontributet e Sigurimeve gjithsej	118,465,172	139,254,918	139,900,000	(645,082)	-0.46%	20,789,746	17.55%
	- Tarifa jo Tatimore	3,295,493	2,785,820				(509,673)	-15.47%
E	D.P.TATIMEVE TOTAL (Neto)	285,560,337	344,259,830	340,034,000	4,225,830	1.24%	58.699.493	20,56%
	(Tatimet neto + Kontributet)	(0)	334,518,271	0				

Burimi: Të dhëna të DPT përpunuar nga grupi i auditimit

Të ardhurat tatimore neto për vitin 2023 paraqiten me një realizim prej rreth 4.87 miliard lekë më tepër se plani i rishikuar, dhe rreth 28.17 miliard lekë më tepër se viti paraardhës. Ky nivel realizimi paraqitet në rreth 4,22 miliard lekë më tepër se plani për total DPT, referuar realizimit të të ardhurave nga kontributet e sigurimeve që rezultojnë rreth 0.65 miliard më pak se planifikimi i tyre. Zërat kryesorë që paraqiten me mosrealizim janë taksa e qarkullimit rrugor, e cila konstatohet me mos realizim në vlerën 1.45 miliard lekë, dhe taksat e tarifave nacionale të cilat paraqiten me një mos realizim prej rreth 0.46 miliard lekë. Sikundër paraqitet edhe në tabelën e mësipërme, të ardhurat nga rimbursimi janë tejkaluar me rreth 4.6 miliard lekë më tepër se planifikimi i tyre, problematikë kjo e konstatuar edhe në auditimet e mëparshme.

Rakordimi i të ardhurave tatimore të vitit 2023 me Degën e Thesarit Tiranë janë kryer sipas shkresës nr.1671, prot datë 25.01.2024. Analitikisht, të ardhurat tatimore krahasimisht me vitin 2022 sipas raportit, paraqiten si më poshtë:

Në mijë lekë

Tabela: Të ardhurat tatimore krahasimisht me vitin 2022 sipas raportit

	Emërtimi	Realizimi 2023-2022	
		2022	2023
A	D.P.T Total (Bruto) pa rivlerësim (Tatimet + Rimbursime + Kontribute)	302,429,446	366,874,372
B	Te Ardhurat Tatimore gjithsej (arketim)	183,964,273	227,619,454
	Nga te cilat:		
1	Tatimi Vlerës se Shtuar (bruto)	57,068,399	68,657,656
	- Tatimi Vlerës se Shtuar (neto)	34,587,338	46,034,089
	- Rimbursimi i kryer (gjithsej)	22,481,061	22,614,542
2	Tatim mbi Fitimin	47,796,671	54,986,282
3	Ardhura Personale	45,083,867	57,999,211
4	Taksat dhe Tarifa Nacionale	13,666,033	14,339,846
5	Taksa Qarkullimi Rrugor	18,249,964	19,545,556
6	Lojrat e Fatit	1,972,682	2,176,798
7	Te tjera pa identifikuar	-	9,741,559
8	Dënimet Administrative	126,659	172,545
C	Te Ardhurat Tatimore gjithsej (neto)	161,483,213	205,004,912
D	Kontributet e Sigurimeve gjithsej	118,465,172	139,254,918
	- Tarifa jo Tatimore	3,826,206	3,295,493
E	D.P.TATIMEVE TOTAL (Neto)	279,948,385	344,259,830
	(Tatimet neto + Kontributet)		334,518,271
	Tatim Fitimi i thjeshtuar	59,431	61,918
	Totali I te ardhurave ne ETAX	305,784,369	359,980,550
	Te ardhura nga rivlerësimi	5,611,953	

Burimi: Të dhëna të DPT përpunuar nga grupi i auditimit

-Sikundër është konstatuar edhe në auditimin e mëparshëm të KLSH, në realizimin e të ardhurave (E tax 359,980,550 mijë lekë) janë përfshirë edhe arkëtimet për tarifave të ndryshme jo tatimore sipas tabelës së mëposhtme, të cilat nuk janë të përfshira në planin e të ardhurave sipas llojit.

Në lekë

Tabela: Arkëtimet për tarifave jo tatimore 2023-2022

Kodi i te ardhurave	Përshkrimi	Realizimi 2022	Realizimi 2023
7110101	Tarife per Shërbimet Konsullore	350,301,984	285,487,836
7110102	Tarife Per pajisjen me Dëshmi Aftësie per Drejtim Automjeti	329,722,675	405,786,800
7110115	Tarife sherbimi per kalimin e kufirit me avion	872,971,396	355,369,378

7110117	Tarife sherbimi per sherbimet e radiokomunikacionit	460,005,491	455,828,495
7110119	Tarife sherbimi per perdorimin e aparateve televizive	1,282,491,571	1,283,347,256
Shuma		3,295,493,117	2,785,819,765

Burimi: Të dhëna të DPT përpunuar nga grupi i auditimit

-Të ardhura të tjera që nuk janë të përfshira në planin e të ardhurave të DPT, dhe janë përfshirë në realizim, janë të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, të cilat paraqiten në vlerën **61,918 mijë lekë**.

Nëse i referohemi realizimit të planit vetëm sipas zërave për të cilët është përcjellë plani i të ardhurave nga MFE, pa përfshirë efektin e kontributeve shoqërore dhe shëndetësore, situata paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Tabela: Realizimi i planit sipas zërave për të cilët është përcjellë plani i të ardhurave nga MFE, pa përfshirë efektin e kontributeve shoqërore dhe shëndetësore

Nr	EMËRTIMI	Fakti 2022	Plani final	Fakti 2023	Diferenca plan/fakt	Niveli i realizimit
A	Te Ardhurat Tatimore gjithsej (arketim)	183.964.273	218.134.000	227.619.454	9.485.454	104%
	Nga te cilat:			217.877.895	217.877.895	NA
1	Tatimi Vlerës se Shtuar (bruto)	57.068.399	65.334.000	68.657.656	3.323.656	105%
	- Tatimi Vlerës se Shtuar (neto)	34.587.338	47.334.000	46.034.089	-1.299.911	97%
	- Rimbursimi i kryer (gjithsej)	22.481.061	18.000.000	22.614.542	4.614.542	126%
2	Tatim mbi Fitimin	47.796.671	50.700.000	54.986.282	4.286.282	108%
3	Ardhura Personale	45.083.867	56.000.000	57.999.211	1.999.211	104%
4	Taksat dhe Tarifa Nacionale	13.666.033	14.800.000	14.339.846	-460.154	97%
5	Taksa Qarkullimi Rrugor	18.249.964	21.000.000	19.545.556	-1.454.444	93%
6	Lojrat e Fatit	1.972.682	2.000.000	2.176.798	176.798	109%
7	Tatimi nga Energjitika		8,300,000	9,741,559	1,441,559	117%
8	Dënimet Administrative	126.659	0	172.545	172.545	NA
C	Te Ardhurat Tatimore gjithsej (neto)	161,483,213	200,134,000	205,004,912	NA	NA

Burimi: Të dhëna të DPT përpunuar nga grupi i auditimit

A. Të ardhurat Tatimore

Referuar të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të ardhurat tatimore janë realizuar 227.6 miliard lekë, pra 9.5 miliard lekë më shumë se plani (ose 4.35% më shumë) i cili paraqitet në vlerën 218.1 miliard lekë. Ky nivel realizimi paraqitet rreth 38 miliard lekë më tepër se viti paraardhës, në të cilin të ardhurat janë realizuar në vlerën 189.6 miliard lekë.

Në terma neto, të ardhurat janë realizuar në shumën 205 miliard lekë, përkundrejt planit prej 200.1 miliard lekë, me një tejkalim në shumën 4.9 miliard lekë. Të analizuara sipas llojit të tatimeve, problematika paraqiten në drejtim të mos realizimit me ndikim më të madh nga taksat nacionale dhe taksa e qarkullimit rrugor. Nga analiza e tejkalimit të realizimit të të ardhurave nga TVSH (bruto), tejkalimit të realizimit të rimbursimeve të kryera, konstatohet se efekti final i këtij raporti është mos realizimi në vlerën 1.29 miliard lekë, dhe në vitin 2022 ky raport rezultonte 2.9 miliard lekë.

A.1 Tatimi mbi vlerën e shtuar (bruto) është realizuar në vlerën rreth 68.6 miliard lekë, përkundrejt planit prej 65.3 miliard lekë (realizimi në masën 105%), pra me një tejkalim në vlerën 3.3 miliard lekë. Krahasimisht me vitin 2022 në të cilin të ardhurat nga TVSH ishin arkëtuar në vlerën 57 miliard lekë, reflektohet një rritje prej rreth 11.6 miliard lekë.

Në lekë

Tabela: Të dhënat analitike të përfshira në të ardhurat bruto nga TVSH

Kodi i te ardhurave	Emërtimi	Realizimi 2022	Realizimi 2023
7030100	Tatimi mbi vlerën e shtuar(bruto)	56,810,899,118	68,347,625,905
7090102	Kamat vonesa nga Tatimi mbi vlerën e shtuar	73,275,875	107,287,074
4665504	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar	184,223,821	202,742,558
	Shuma	57,068,398,814	68,657,655,537

Burimi: Të dhëna të DPT përpunuar nga grupi i auditimit

Tatimi mbi vlerën e shtuar (neto) është realizuar në vlerën rreth 46 miliard lekë, përkundrejt planit prej 47.3 miliard lekë (realizimi në masën 97.27%), pra me një nënrealizim në vlerën 1.2 miliard lekë. Krahasimisht me vitin 2022 në të cilin të ardhurat nga TVSH neto ishin arkëtuar në vlerën 34.5 miliard lekë, reflektohet një rritje prej rreth 11.5 miliard lekë. **Rimbursimi i TVSH**, i planifikuar në vlerën 18 miliard lekë, është realizuar 4.6 miliard lekë më shumë, duke rezultuar në vlerën 22.6 miliard lekë. Pra, pothuajse në të njëjtat nivele me rimbursimin e vitit 2022 (0.13 miliard më shumë se realizimi në vitin 2022).

Nga analiza krahasimore mes raportimit të DPT dhe treguesve të konsoliduar fiskal të publikuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, konstatohen diferenca.

Sipas analizave të DPT, diferenca në terma bruto konstatohet se i përket përfshirjes së raportimit të kamatëvonesave sipas llogarisë 7090102 “Kamatëvonesa nga tatimi mbi vlerën e shtuar” në shumën 107.287,074 lekë për efekt të realizimit të planit nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Ndërkohë, depozitimet e përkohshme në llogarinë 4665504 janë raportuar në të dyja rastet si e ardhur për efekt të realizimit të të ardhurave tatimore përgjatë vitit buxhetor.

Për sa i përket diferencës në të ardhura neto të raportuara konstatohet se ajo vjen edhe si pasojë e rimbursimit të kryer nga drejtoritë rajonale tatimore për tatimin mbi vlerën e shtuar. Rimbursimet e kryera për tatimin mbi vlerën e shtuar nga aparati qendror i DPT raportohen në shumën 22,614,131,523 lekë ndërkohë që nga drejtoritë rajonale tatimore është rimbursuar shuma prej 410,327 lekë, pra në total rimbursuar në shumën 22,614,541,850 lekë. Kjo vlerë e rimbursimit në total të kryer për vitin buxhetor 2023 rakordon me shumën e paraqitur në treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar për buxhetin e shtetit të vitit 2023.

Rimbursimet e kryera nga Drejtoritë Rajonale Tatimore të cilat kanë kaluar nëpërmjet llogarisë 7030100 “TVSH mbi mallrat dhe shërbimet brenda vendit” në shumën 410,327 lekë dhe i përket DRT Korçë.

Për pagesat e raportuara si rimbursim TVSH në vlerën 22,614,131,523 lekë, konstatohet se përfshijnë pagesa në zbatim të ligjit për TVSH-ne nga DRTVSH ne DPT, rimbursim i cili kryhet që nga viti 2015 i qendëruar nëpërmjet drejtorisë së rimbursimit të TVSH-së në njësinë shpenzuese, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

A.2 Të ardhurat nga Tatimi mbi Fitimin janë realizuar në vlerën 55 miliard lekë, kundrejt planit në vlerën 50.7 miliard lekë (realizimi në masën 108%), pra me një realizim 4.3 miliard lekë më shumë. Krahasimisht me vitin 2022, konstatohet se të ardhurat nga TF janë realizuar 7.2 miliard lekë më shumë. Analitikisht në këto të ardhura, përfshihen llogaritë si më poshtë:

Në lekë

Tabela: Të dhënat analitike të përfshira në të ardhurat bruto nga TF

Kodi i te ardhurave	Përshkrimi	Shuma 2022	Shuma 2023
7001100	Tatimi mbi Fitimin nga Ndërmarrjet e Sektorit Publik	1,409,210,047	1,795,496,960
7001200	Tatimi mbi Fitimin nga Subjektet e Sektorit Privat	12,005,652,931	12,920,420,066
7001300	Tatimi mbi fitimin nga Subjektet e "Lojërave te Fatit"	236,050,533	99,616,048
7090106	Kamat vonesa nga Tatim Fitimi	103,875,360	143,948,830
4665503	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Tatim Fitimit	34,041,881,792	40,026,800,218
Shuma		47,796,670,663	54,986,282,122

Burimi: Të dhëna të DPT përpunuar nga grupi i auditimit

Sikundër vërehet nga tabela e mësipërme, të ardhurat nga tatim fitimi realizohen më së shumti nga depozitimet e përkohshme të tatimit mbi fitimit (parapagimet e kësteve), të cilat paraqiten në vlerën rreth 40 miliard lekë, krahasuar me 34 miliard lekë që ishin në vitin paraardhës. Nga auditimi konstatohet se nga DPT, në momentin e dorëzimit të deklarimeve në fund të vitit ku kryhet edhe përlllogaritja e detyrimeve faktike të tatimit mbi fitimit, nuk kryhet netimi i

Ilogarisë së parapagimeve, si veprim rregullues për njohjen e të ardhurës, problematikë kjo e konstatuar edhe në auditimin paraardhës të KLSH.

Nga auditimi paralel i kryer nga KLSH pranë Ministrisë së Financave, u kërkua informacion pranë Drejtorisë së Programimit të Statistikës dhe Analizës së të ardhurave tatimore në planifikimin e të ardhurave a planifikohen për zërin e të ardhurave të tatim fitimit edhe paradhëniet e kësteve të paguara, apo nëse merret për bazë vetëm vlera që ka rezultuar sipas formularit të deklarimit të tatim fitimit, nga ku u raportua se në hartimin e projekt buxhetit, administrata tatimore nuk proceson parapagimet, pasi ato përcaktohen e vlerësohen në fillim të vitit. Paradhëniet e kësteve sipas MFE shërbejnë për analiza periodike gjatë vitit. Konkretisht raportimi i parapagimeve në të ardhura sipas llojit të tatimit për të cilin janë shpërndarë sipas raportit të realizimit të të ardhurave tatimore, paraqitet si më poshtë:

Në lekë

Tabela: Raportimi i parapagimeve në të ardhura sipas llojit të tatimit

Nr. Llogarisë	Përshkrimi llogarisë	Shuma 2022	Shuma 2023	Raportuar si e ardhur për:
4665	Depozitime te tjera (për tu sistemuar ne te Ardhmen)	34,473,704,161	40,547,055,132	
4665100	Depozitime te tjera ne ruajtje , Te vitit ushtrimor			
4665502	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Tatimit në Burim	81,086,444	115,702,570	TAP
4665503	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Tatim Fitimit	34,041,881,792	40,026,800,218	TF
4665504	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar	184,223,821	202,742,558	TVSH
4665505	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Taksave Nacionale	713,214	501,591	Taksa dhe tarifa nacionale
4665506	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Tarifave Kombëtare	492,367	663,153	Taksa dhe tarifa nacionale
4665507	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Lojërave të fatit	115,562	107,163	Tatime lojërat e fatit
4665508	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Rentës Minerare	1,296,201	596,237	Taksa dhe tarifa nacionale
4665509	Depozitime të përkohshme për Gjobat	3,821,599	6,162,363	
4665510	Depozitime të përkohshme për Listëpagesën	155,707,330	189,114,901	Kontribute
4665511	Depozitime të përkohshme për Tatim Fitimin e Thjeshtuar	4,365,831	4,664,378	

Burimi: Të dhëna të DPT përpunuar nga grupi i auditimit

Si rezultat, raportimi i tyre në realizimin e të ardhurave të tatimit mbi fitimin, në kushtet kur nga ana e MFE konfirmohet se nuk përfshihen në planifikim, rezulton me mbi vlerësim të raportimit për këtë zë të të ardhurave.

Teprica e llogarisë së parapagimeve sipas pasqyrës se konsoliduar dhe Drejtorisë se Kontabilitetit në DPT, paraqitet si më poshtë:

Në lekë

Tabela: Teprica e llogarisë së parapagimeve sipas pasqyrës se konsoliduar dhe Drejtorisë se Kontabilitetit në DPT

Nr. Llogarisë	Përshkrimi llogarisë	2022	2023	Burimi
466	Kreditore per mjete ne ruajtje	177,110,689,996	217,618,519,773	Konsoliduar(kontb.ardhurave DPT+DRT)
466	Kreditore per mjete ne ruajtje	177,103,547,953	217,610,500,504	DPT (kontb.ardhurave)

Burimi: Të dhëna të DPT përpunuar nga grupi i auditimit

Për sa më sipër kjo llogari konstatohet se vijon me një rritje prej rreth 40 miliard lekë krahasuar me vitin 2022, vlerë kjo e njëjtte më parapagimet e kësteve të tatimit mbi fitimit, trajtuar më sipër.

Nga analiza krahasimore mes raportimit të DPT dhe treguesve të konsoliduar fiskal të publikuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, konstatohen diferenca. Nga auditimi mbi rakordimin me të dhënat e treguesve fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar konstatohet se janë raportuar të ardhura nga tatimi mbi fitimin shuma prej 64,576 milion lekë.

Sipas analizave të DPT, ndër faktorët kryesorë që ndikojnë në mosrakordim konstatohet se janë përfshirja e kamatëvonesave si e ardhur dhe mos evidentimi i kthimeve të këtij tatimi të kryera nga Drejtoritë Rajonale Tatimore. Nga krahasimi i llogarive analitike të të ardhurave

konstatohet se në raportim nga DPT nuk janë përfshirë kthimet e tatim fitimit të kryera nga drejtoritë rajonale tatimore për tatimin mbi fitimin të cilat zvogëlojnë tepricën e llogarisë 7001200 “Tatimi mbi Fitimin nga Subjektet e Sektorit Privat” në shumën 12,288,963 lekë sipas tabelës së mëposhtme:

Në lekë

Tabela: Kthimet e tatim fitimit të kryera nga drejtoritë rajonale tatimore për tatimin mbi fitimin

Kod inst	Institucioni	Vlera
1010047	Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës (0707)	(7,501,105)
1010049	Drejtoria Rajonale Tatimore Fier (0909)	(1,987,826)
1010055	Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë (1515)	(1,420,049)
1010076	Drejtoria Rajonale Tatimore Vlore (3737)	(1,379,983)
Shuma		(12,288,963)

Burimi: Të dhëna të DPT të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Faktori i dytë që ndikon në mosrakordimin e të dhënave të raportuara nga DPT me atë të treguesve fiskalë të konsoliduar konstatohet se është teprica e llogarisë 7090106 “Kamatëvonesa nga tatim fitimi” në shumën 144 milion lekë, që për efekt të planit është raportuar si e ardhur tatimore nga DPT, ndërkohë që në tabelën e treguesve fiskalë të konsoliduar është raportuar në zërin e të ardhurave jo tatimore. Për sa i përket depozitimeve të përkohshme për tatimin e fitimit konstatohet se është raportuar në të dyja rastet si e ardhur tatimore që lidhet me arkëtimet e vitit buxhetor.

Në lekë

Tabela: Analiza krahasimore e realizimit 2023-2022 mes raportimit të DPT dhe MFE në SIFQ

Klasa e të ardhurës	Përshkrimi	Realizimi 2022	Realizimi 2023
7001100	Tatimi mbi fitimin sektori publik	1,409,210,047	1,795,496,960
7001200	Tatimi mbi fitimin sektori privat	12,005,652,931	12,920,420,066
7001300	Tatimi mbi fitimin subjekte lojra fati	236,050,533	99,616,048
7090102	Kamatëvonesa nga Tatimi mbi fitimin	103,875,360	143,948,830
4665503	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Tatimit mbi fitimin	34,041,881,792	40,026,800,218
4665511	Depozitime të përkohshme për Tatim fitimin e thjeshtuar	4,365,831	4,664,378
7001500	Te ardhura nga sektori Energjitik	0	9,741,558,788
Shuma ne Statistike DPT (nuk përfshin mjete ne ruajtje per TFTH)		47,796,670,663	64,727,840,910
Rimbursim nga DRT		14,383,565	12,288,963
Shuma ne SIFQ (nuk përfshin kamata por përfshin mjete ne ruajtje per TFTH) e publikuar ne Fiskale		47,682,777,569	64,576,267,495

Burimi: Të dhëna të DPT të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Për sa trajtuar më sipër, tatim fitimi i detajuar me zëra, i publikuar ne fiskale rezulton i njëjtë me vlerën ne tabele , konkretisht 64,576 milion leke per vitin 2023.

A.3 Tatimi mbi të Ardhurat Personale është realizuar sipas të dhënave të DPT në vlerën rreth 58 miliard lekë, kundrejt planit prej 56 miliard lekë (104%), pra rreth 2 miliard lekë më shumë. Krahasimisht me vitin 2022, konstatohen se janë realizuar të ardhura nga tatimi mbi të ardhurat personale në vlerën rreth 13 miliard lekë më shumë. Analitikisht në këto të ardhura janë raportuar llogaritë si më poshtë:

Në lekë

Tabela: Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale analitike

Kodi i te ardhurave	Përshkrimi	Shuma 2022	2023
7000100	Nga te punësuarit e Sektorit Buxhetor dhe Publik	10,054,675,066	12,591,344,995
7000100	Ditar manual nga Dega thesarit Tirane	743,104	1,183,712
7000200	Nga te punësuarit e Sektorit privat	18,200,281,968	21,182,834,551
7000300	Tatim mbi te Ardhurat nga Interesat	2,198,300,121	2,451,941,665
7000400	Tatim mbi te Ardhurat nga Qiratë	4,625,442,876	4,847,143,888
7000500	Tatim mbi Fituesit e Lojërave te Fatit	83,937,995	63,743,928
7000600	Tatim mbi te ardhurat personale biz vogël	1,495,997	2,291,601
7000700	Tatim për Deklaratën Individuale Vjetore te te Ardhurave	1,033,690,626	1,417,445,184
7000900	Te tjera Tatime mbi te Ardhurat ne Burim	2,628,743,129	3,487,655,563
7009100	Tatimi mbi te ardhurat nga Dividendët dhe Aksionet	4,242,746,890	5,877,342,559
7009200	Tatim mbi te Drejtën e Autorit dhe Pronësinë Intelektuale	344,594,581	305,386,978

7021100	<i>Tatim, shitja e pasurisë se paluajtshme</i>	1,451,346,492	5,450,044,865
7021200	<i>Tatim, trashëgimia dhe dhurimi</i>	39,879,031	84,399,214
7090112	<i>Kamat vonesa nga Tatim ne Burim</i>	22,962,901	24,847,138
7090114	<i>Kamat vonesa nga Tatim DIVA</i>	6,097,004	16,774,171
7090115	<i>Kamat vonesa nga TABV</i>	50,211	173,244
7090116	<i>Kamat vonesa nga Tatim mbi te ardhurat nga punësimi</i>	22,627,885	24,739,562
7115652	Gjoha për deklarim Tatim ne burim	45,906,630	55,399,725
4665502	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Tatimit në Burim	81,086,444	115,702,570
Shuma		45,084,608,951	58,000,395,113

Burimi: Të dhëna të DPT të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Nga analiza krahasimore mes raportimit të DPT dhe treguesve të konsoliduar fiskal të publikuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, konstatohen diferenca. Shuma e mësipërme prej 57,999 milion lekë nuk rakordon me shumën e raportuar në treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar, pasi sipas analizave të DPT, për shkak të faktorëve të mëposhtëm:

- ditat manual në llogarinë 7000100 “nga të punësuarit e sektorit buxhetor dhe publik” e evidentuar në rakordimin e kryer nga DPT me degën e thesarit Tiranë në shumën 1,184 mijë lekë.

- kthimit të tatimit që është realizuar nga DRT për llogarinë 7000900 “Të tjera tatime mbi të ardhurat në burim” shuma 378,758 leke, për llogarinë 7000700 “Tatim për deklarimet individuale vjetore te te ardhurave” shuma 390,630 leke, për llogarinë 7021200 “Tatim nga trashëgimia dhe dhurimi” shuma 396,148 leke , sipas tabelës së mëposhtme ne nivel DRT-je:

Në lekë

Tabela: Analiza në nivel DRT për mos rakordimin e të ardhurave personale

Kodi institucionit	Institucioni	Vlera
1010047	Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës	(99,311)
1010042	Drejtoria Rajonale Tatimore Berat	(20,968)
1010055	Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë	(258,479)
1010040	Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë	(957,308)
Shuma		(1,336,066)

Burimi: Të dhëna të DPT të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

-raportimit nga ana e DPT të kamatëvonesave në llogaritë 7090112-7090114-7090115-7090116 në shumën totale 66,534 mijë lekë për efekt të realizimit të planit të të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale.

- raportimit nga ana e DPT e gjobave për Deklarim te Tatimit ne burim në llogaritë 7115652 ne shumën totale 55,400 mijë lekë për efekt të realizimit të planit të të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale.

Për sa i përket depozitimeve të përkohshme për deklaratën e tatimit në burim, në të dy raportimet është klasifikuar si e ardhur tatimore.

Në lekë

Tabela: Analiza krahasimore e raportimit të të ardhurave personale 2023-2022

Klasa e te ardhurës	Përshkrimi	Realizimi 2022	Realizimi 2023
	Tatimi mbi te Ardhurat Personale	44,905,877,874	57,762,758,703
7000100	Nga te punësuarit e Sektorit Buxhetor dhe Publik	10,054,675,065	12,591,344,995
	Ditar Manual ne Thesar	743,103	1,183,712
7000200	Nga te punësuarit e Sektorit privat	18,200,281,968	21,182,834,551
7000300	Tatim mbi te Ardhurat nga Interesat	2,198,300,121	2,451,941,665
7000400	Tatim mbi te Ardhurat nga Qerate	4,625,442,876	4,847,143,888
7000500	Tatim mbi Fituesit e Lojrave te Fatit	83,937,995	63,743,928
7000600	Tatim mbi te ardhurat personale biz vogel	1,495,997	2,291,601
7000700	Tatim per Deklaraten Individuale Vjetore te te Ardhurave	1,033,690,626	1,417,445,184
7000900	Te tjera Tatime mbi te Ardhurat ne Burim	2,628,743,129	3,487,655,563
7009100	Tatimi mbi te ardhurat nga Dividentet dhe Aksionet	4,242,746,890	5,877,342,559
7009200	Tatim mbi te Drejten e Autorit dhe Pronesine Intelektuale	344,594,581	305,386,978
7021100	Tatim, shitja e pasurise se paluajtshme	1,451,346,492	5,450,044,865
7021200	Tatim, trashëgimia dhe dhurimi	39,879,031	84,399,214
7090112	Kamat vonesa nga Tatim ne Burim	22,962,901	24,847,138
7090114	Kamat vonesa nga Tatim DIVA	6,097,004	16,774,171

7090115	Kamat vonesa nga TABV	50,211	173,244
7090116	Kamat vonesa nga Tatim mbi te ardhurat nga punesimi	22,627,885	24,739,562
	Totali kamate per TAP	51,738,001	66,534,115
7115652	Gjoha per deklarim Tatim ne burim	45,906,630	55,399,725
4665502	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Tatimit në Burim	81,086,444	115,702,570
	Te ardhura nga rivleresimi pasurive	5,611,952,623.50	0
	Shuma ne Statistike DPT (nuk perfshin ditarin manual ne thesar)	50,695,818,470.50	57,999,211,401
	Rimbursim nga DRT	3,541,239	1,336,066
	Shuma ne SIFQ (nuk perfshin kamata dhe gjoha por perfshin dhe Ditarin manual) e publikuar ne Fiskale	50,595,375,703.50	57,877,125,207

Burimi: Të dhëna të DPT të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Për sa trajtuar më sipër, tatimi mbi te ardhurat i detajuar me zëra, i publikuar ne fiskale rezultojnë i njëjtë për vlerën ne table 57,877 milion leke për vitin 2023.

Plani analitik sipas zërave të tatimit mbi të ardhurat personale, krahasimisht me realizimin paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

Në mijë lekë

Tabela: Plani analitik sipas zërave të tatimit mbi të ardhurat personale

	Përshkrimi	Plani përfundimtar	Fakti 2023	Diferenca	% realizimit
A.	Tatimi mbi te ardhurat personale	56,000,000	57,999,211	1,999,212	3.57%
1	Tatimi mbi pagë nga listëpagesa	33,212,244	33,798,919	586,675	1.77%
I,1	Nga të punësuarit e Sektorit Publik	12,453,839	12,591,345	137,506	1.10%
I,2	Nga të punësuarit e Sektorit Privat	20,758,405	21,207,574	449,169	2.16%
2	Tatim mbi të Ardhurat nga Interesat	2,403,376	2,451,942	48,566	2.02%
3	Tatim mbi të Ardhurat nga Qeratë	4,625,761	4,847,144	221,383	4.79%
4	Tatim mbi Fituesit e Lojrave të Fatit	74,505	63,744	(10,761)	-14.44%
5	Tatim mbi A.Personale Biznesi Vogël me xhiro 2-8 mln leke	1,724	2,465	741	42.95%
6	Te tjera Tatime mbi te Ardhurat ne Burim	3,601,998	3,683,605	81,607	2.27%
7	Tatimi mbi të ardhurat nga Dividentët dhe Aksionet	5,328,816	5,877,343	548,527	10.29%
8	Tatim mbi të Drejtën e Autorit dhe Pronësise Intelektuale	290,169	305,387	15,218	5.24%
9	Tatimi mbi Deklaratën Individuale Vjetore të të ardhurave	1,371,043	1,434,219	63,176	4.61%
10	Tatim, shitja e pasurisë së paluajtshme	5,011,067	5,450,045	438,978	8.76%
11	Tatim, trashëgimia dhe dhurimi	79,295	84,399	5,104	6.44%

Burimi: Të dhëna të DPT të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Nga sa më sipër konstatohet se janë realizuar të gjitha të ardhurat e përfshira në këtë zë, me përjashtim të të ardhurave nga Tatimi mbi Fituesit e Lojrave të Fatit, i cili rezultojnë i realizuar në rreth 14.44% më pak se plani.

A.4 Taksat dhe Tarifa Nacionale janë realizuar sipas të dhënave të DPT në vlerën rreth 14.3 miliard lekë, kundrejt planit prej 14.8 miliard lekë (97%), pra rreth 0.5 miliard lekë më pak. Krahasimisht me vitin 2022, konstatohen se janë realizuar të ardhura nga taksat dhe tarifave nacionale në vlerën rreth 0.7 miliard lekë më shumë. Analitikisht në këto të ardhura janë raportuar llogaritë si më poshtë:

Në mijë lekë

Tabela: Plani analitik sipas zërave të taksave dhe tarifave Nacionale

	Përshkrimi	Fakt 2022	Fakt 2023	Plan fillestar 2023	Plan final 2023	Plan final - fakt 2023	% realizimit planit 2023
A=B+C	TAKSAT dhe TARIFA NACIONALE	13,666,033	14,339,846	15,850,000	14,800,000	(1,050,000)	-3.11%
B	Tarifa Kombëtare	908,818	787,840	1,192,000	1,192,000	-	-33.91%
C	Taksa Kombëtare	12,757,215	13,552,006	14,658,000	13,608,000	(1,050,000)	-0.41%
			2,785,820	-	-	-	
1	Tarife shërbimi per Qarkullimin e Automjeteve te Huaja	77,707	83,595	100,000	100,000	-	-16.40%

2	Tarife per regjistrimin e Lojrave te Fatit , Llotarive , Kazinove etj	142,289	153,642	200,000	200,000	-	-23.18%
3	Tarife sherbimi per licensat radiotelevizive	10,930	7,711	12,000	12,000	-	-35.74%
4	2. Tarife sherbimi per perdorimin e aparateve televizive		1,283,347	-	-	-	
5	6. Tarife sherbimi per sherbimet e radiokomunikacionit		455,828	-	-	-	
6	Takse nacionale per lejen e ushtrimit te veprimtarise se peshkimit	22,745	20,823	25,000	25,000	-	-16.71%
7	Takse nacionale e karbonit per benzinen, benzolin dhe gazoilin	2,276,150	2,476,959	2,500,000	2,500,000	-	-0.92%
8	Takse nacionale per ambalazhet plastike te lengjeve te ambalazuara	1,964,780	2,046,755	2,200,000	2,000,000	(200,000)	2.34%
9	Takse mbi te drejten e perdorimit te truallit shteteror	1,429	1,557	2,000	2,000	-	-22.17%
10	Taksë mbi Primet e shkruara	1,540,201	1,708,575	1,735,000	1,435,000	(300,000)	19.06%
11	Taksa per regjistrim fillestar per automjete luksoze	150,290	186,998	160,000	160,000	-	16.87%
12	Taksa e përvitshme per automjetet luksoze	265,384	290,806	285,000	285,000	-	2.04%
13	Takse per automjetet e perdorura te transportit	5,419,441	5,869,654	6,400,000	6,100,000	(300,000)	-3.78%
14	9.Tarife sherbimi per kalimin e kufirit me avion		355,369	-	-	-	
15	Taksa portuale	807	739	1,000	1,000	-	-26.07%
16	Taksa e Akteve dhe e Pulles	155,653	97,117	200,000	200,000	-	-51.44%
17	Taksa e rentes minerare	958,902	850,528	1,150,000	900,000	(250,000)	-5.50%
18	3 .Tarife per Sherbimet Konsullore		285,488	-	-	-	
19	1.Tarife Per paisjen me Dëshmi Aftësie per Drejtim Automjeti		405,787	-	-	-	
20	Tarife per Regjitrin ne arsimin e Larte	159,214	143,547	180,000	180,000	-	-20.25%
21	Tarifa per pasaporte lundrimi te personave	1,127	1,656	-	-	-	
22	Tarifa per aktet administrative	516,555	396,065	700,000	700,000	-	-43.42%
23	Taksa e rentes per Hidrokarbure	116	85	-	-	-	
24	Taksa e Qumështit Pluhur		-	-	-	-	
25	Taksa e pijeve te Homogjenizuara		-	-	-	-	
26	Taksa e Hirrës së Qumështit		-	-	-	-	
27	Taksa e Krem Qumështit		-	-	-	-	
28	Taksa e lëndës djegëse e përdorur si karburant për mjete lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi jashtë territorit të Shqipërisë		-	-	-	-	
29	Tarife , gjoba, interesa	997	1,624		-		
30	Taksa te tjera , gjoba, interesa	1,317	1,411		-		

Burimi: Të dhëna të DPT të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Pra, sikundër vërehet nga tabela e mësipërme, mos realizimi ka ardhur kryesisht për shkak të nivelit të realizimit të taksës së rentës minerare, automjetet e përdorura, taksës nacionale për ambalazhet plastike të lengjeve të ambalazuara, dhe Taksës mbi Primet e shkruara.

Drejtoria Kontabilitet Statistikës pranë DPT paraqet detajimin e zërit Taksa nacionale dhe të tjera sipas grupimit për efekte të publikimit të treguesve fiskal si më poshtë:

Në lekë

Tabela: Detajimi i zërit Taksa nacionale dhe te tjera

Klasa e te ardhurës	Përshkrimi	Realizimi 2022	Realizimi 2023
	Taksa nacionale e te tjera	33,883,229,768	36,053,869,112
7032100	Takse mbi llogaritë	14,876,676	6,711,676
7032200	Takse mbi Bingot dhe Lojrat Aritmetike	21,194,286	27,614,932
7032300	Takse mbi Automatet e Lojrave te Fatit dhe Bingot	4,724,874	180,000
7032400	Takse mbi Kazinote	1,930,888,304	2,139,123,721
7032500	Takse mbi lojrat Sportive	0	16,894
7033009	Takse nacionale per lejen e ushtrimit te veprimtarise se peshkimit	22,744,567	20,823,119
7033010	Takse nacionale e karbonit per benzinen, benzolin dhe gazoilin	2,276,150,358	2,476,958,973
7033011	Takse nacionale per ambalazhet plastike te lengjeve te ambalazhuara (shishe, bidona etj)	1,964,780,098	2,046,754,525
7033012	Taksa e rentes minerare	956,763,967	848,381,957
7033014	Takse mbi te drejten e perdorimit te truallit shtetedor nga persona juridik tregtare	1,429,129	1,556,642
7033018	Taksë mbi Primet e shkruara	1,540,200,976	1,708,575,027
7033019	Taksa per regjistrim fillestar per automjete luksoze	150,290,000	186,998,000
7033020	Taksa e pervitshme per automjetet luksoze	265,384,157	290,805,725
7033021	Takse rente për Hidrokarbure	115,506	84,849
7049100	Takse per automjetet e perdorura te transportit	5,419,441,250	5,869,654,294
7050500	Taksa e Qarkullimit e perdorimit te Karburantit Rrugor	18,249,963,768	19,545,555,879
7081005	Taksa portuale	806,992	739,330
7081006	Taksa e Akteve dhe e Pulles	155,653,432	97,116,778
7110104	Tarifa per pasaporte lundrimi te personave	1,127,000	1,656,000
7110105	Tarifa per aktet administrative	516,555,012	396,065,354
7110109	Tarife per Regjistrim ne arsimin e Larte	159,213,527	143,546,817
7110111	Tarife per regjistrimin e Lojrave te Fatit , Llotarive , Kazinove etj	142,288,943	153,642,497
7110116	Tarife sherbimi per licensat radiotelevizive	10,929,924	7,710,664
7110118	Tarife sherbimi per Qarkullimin e Automjeteve te Huaja	77,707,022	83,595,459
7090105	Kamat vonesa nga Tatim mbi lojrat e fatit	851,865	3,003,790
7090108	Kamat vonesa nga Taksa kombetare	136,374	169,014
7090111	Kamat vonesa nga Tarifa kombetare	420,527	714,357
7090113	Kamat vonesa nga Taksa e rentes minerare	841,665	1,549,572
	Totali kamate per taksa e te tjera	2,250,431	5,436,733
7115650	Gjoha per deklarim te vonuar loja fati	30,000	40,000
7115651	Gjoha per deklarim te vonuar Tarifa kombetare	83,963	246,019
7115653	Gjoha per deklarim te vonuar Taksa kombetare	467,035	740,241
4665505	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Taksave Nacionale	713,214	501,591
4665506	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Tarifave Kombëtare	492,367	663,153
4665507	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Lojrave të fatit	115,562	107,163
4665508	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Rentës Minerare	1,296,201	596,237
	Shuma ne Statistike DPT Total Taksa (TN+TQ+TLF)	33,888,678,541	36,062,200,249
	Rimbursim nga DRT	0	0
	Shuma ne SIFQ (nuk perfshin kamata dhe gjoha) e publikuar ne Fiskale	33,885,847,112	36,055,737,256

Burimi: Të dhëna të DPT të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Nga analiza krahasimore mes raportimit të DPT dhe treguesve të konsoliduar fiskal të publikuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, konstatohen diferenca. Taksat nacionale e te tjera te detajuar me zëra është 36,062 mije leke, dhe i publikuar ne fiskale është 36,056 mije leke me ndryshim, sipas argumentit të DPT vetëm per vlerën e kamatëvonesave dhe gjobave per deklaratat e taksave ne shumen 6.4 milion leke. Ndërkohe e krahasuar me vlerën e tabelës se treguesve fiskal te konsoliduar ne shumen 40,188 milion lekë, ekziston një diferencë prej 4,132 milion lekë e cila e cila sipas DPT mund të vijë si rezultat i vlerës se takse se rentës ne Drejtorinë e Përgjithshme te Doganave, e cila mbetet objekt verifikimi nga ky institucion.

A.5 Taksat nga Qarkullimi Rrugor janë realizuar në vlerën rreth 19.5 miliard lekë, kundrejt planit prej 21 miliard lekë (93%), pra rreth 1.5 miliard lekë më pak. Krahasimisht me vitin

2022, konstatohen se janë realizuar të ardhura nga taksat e qarkullimit rrugor në vlerën rreth 1.3 miliard lekë më shumë.

A.6 Të ardhurat nga Lojërat e Fatit janë realizuar në vlerën rreth 2.2 miliard lekë, kundrejt planit prej 2 miliard lekë (109%), pra rreth 0.2 miliard lekë më shumë. Krahasimisht me vitin 2022, konstatohen se janë realizuar të ardhura nga taksat e qarkullimit rrugor në vlerën rreth 0.1 miliard lekë më shumë. Analitikisht, situata paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Tabela: Të dhëna analitike të të ardhurave nga lojërat e fatit

Kodi I te ardhurave	Përshkrimi	Shuma 2022	2023
7032100	Takse mbi lotaritë	14,876,676	6,711,676
7032200	Takse mbi Bingot dhe Lojrat Aritmetike	21,194,286	27,614,932
7032300	Takse mbi Automatet e Lojrave te Fatit dhe Bingot	4,724,874	180,000
7032400	Takse mbi Kazinotë	1,930,888,304	2,139,123,721
7032500	Takse mbi lojrat Sportive	0	16,894
7090105	Kamat vonesa nga Tatim mbi lojrat e fatit	851,865	3,003,790
7115650	Gjoha per deklarim te vonuar lojra fati	30,000	40,000
4665507	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Lojrave të fatit	115,562	107,163
Shuma		1,972,681,567	2,176,798,176

Burimi: Të dhëna të DPT të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

A.7 Të ardhurat e Tatimit nga Energjitika

Tatimi mbi Energjetikën per vitin 2023 është realizuar ne vlerën 9,741,559 mije leke dhe është planifikuar ne vlerën 8,300,000 mije lekë, të cilat përfshijnë të ardhurat nga DTM dhe DRT Korçe si më poshtë:

Në mijë lekë

Tabela: Të dhëna mbi të ardhurat e tatimit nga energjitika

Kodi	Institucioni	Realizimi
1010041	Drejtoria Rajonale Tatimore Tatimpaguesit e Mëdhenj	9,739,059,128
1010055	Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë	2,499,660
Total		9,741,158,788

Burimi: Të dhëna të DPT të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Këto te ardhura janë arkëtuar zbatim te ligjit 98/2022 “Per Krijimin e kontributit te solidaritetit gjate kohëzgjatjes se periudhës se krizës energjetike”. Procedurat e deklarimit dhe pagesës direkt ne thesar per këtë kategori te përkohshme te te ardhurave janë ndjekur nga Drejtoritë Rajonale Tatimore te cilat kane patur ne administrim tatimpagues qe i janë përfshirë zbatimit te ligjit 98/2022.

Të ardhurat nga Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore janë realizuar në vlerën 139,254 miliard lekë, kundrejt planit 139,900 miliard lekë (99.54%), pra me një diferencë prej 645 miliard lekë më pak. Krahasimisht me vitin 2022, konstatohen se këto të ardhura janë rritur me 20,789 miliard lekë. Analitikisht në këto të ardhura përfshihen llogaritë e mëposhtme:

Në lekë

Tabela: Të dhëna analitike mbi të ardhurat nga Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore

Kodi I te ardhurave	Përshkrimi	Shuma 2022	Shuma 2023
7090101	Kamat vonesa te kontributeve te sig. shoqerore	118,186,207	175,697,301
7090104	Kamat vonesa te kontributeve te sig. shendetesore	20,574,673	29,781,386
7115101	Gjoha te sigurimeve shoqerore nga punedhenesi	310,611,031	385,458,471
7115118	Gjoha te sigurimeve shendetesore nga punedhenesi	52,289,145	65,167,196
7115119	Gjoha per mosdeklarim punonjesish	100,608,973	107,548,873
7115654	Gjoha per deklarim te vonuar Sig Shoq,shend,dhe tap	73,852,689	95,189,173
75	Kontributet e Sigurimeve Gjithsej	117,633,342,108	138,206,960,766
750	Kontribute nga te punesuarit	45,065,622,620	52,633,153,958
7500	Kontribute te sektorit buxhetor te punesuar	16,803,665,795	19,293,264,022
7500100	Sigurime shoqerore	12,932,812,074	14,721,210,506
7500200	Sigurime shendetesore	2,402,623,359	2,804,616,268
7500400	Kontribute suplementar	1,468,230,362	1,767,437,248
7501	Kontribute te sektorit shteteror te punesuar	2,564,039,658	3,106,920,180
7501100	Sigurime shoqerore	2,151,671,417	2,611,152,243

7501200	Sigurime shendetesore	400,839,383	481,799,572
7501400	Kontribute suplementar	11,528,858	13,968,365
7502	Kontribute te sektorit Privat te punesuar	25,697,917,167	30,232,969,756
7502100	Sigurime shoqerore	20,911,187,742	24,627,897,674
7502200	Sigurime shendetesore	4,725,722,385	5,533,505,294
7502400	Kontribute suplementar	61,007,040	71,566,788
751	Kontribute nga te punedhenesi	68,191,075,318	80,552,793,714
7510	Kontribute te sektorit buxhetor te punedhenes	22,859,007,855	26,776,983,093
7510100	Sigurime shoqerore	20,442,882,955	23,958,225,467
7510200	Sigurime shendetesore	2,404,544,476	2,805,282,350
7510400	Kontribute suplementar	11,580,424	13,475,276
7511	Kontribute te sektorit shteteror te punedhenes	3,809,078,401	4,618,711,659
7511100	Sigurime shoqerore	3,395,784,190	4,121,590,941
7511200	Sigurime shendetesore	400,992,810	482,448,122
7511400	Kontribute suplementar	12,301,401	14,672,596
7512	Kontribute te sektorit Privat te punedhenes	41,522,989,062	49,157,098,962
7512100	Sigurime shoqerore	36,723,946,963	43,537,366,328
7512200	Sigurime shendetesore	4,724,419,552	5,532,524,791
7512400	Kontribute suplementar	74,622,547	87,207,843
752	Kontribute nga te vetpunesuarit	4,376,644,170	5,021,013,094
7520	Kontribute nga te vetpunesuarit	4,376,644,170	5,021,013,094
7520100	Sigurime shoqerore	3,408,291,528	3,873,577,479
7520200	Sigurime shendetesore	968,352,642	1,147,435,615
4665510	Depozitime të përkohshme për Listëpagesën	155,707,330	189,114,901
	Shuma	118,465,172,156	139,254,918,067

Burimi: Të dhëna të DPT të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Nga auditimi konstatohet se DPT në të ardhurat e kontributeve (**139,254 miliard lekë**), ka përfshirë dhe depozitimet e përkohshme dhe kamatvonesat e gjobat për listëpagesat të cilat nuk lidhen vetëm me kontributet por edhe me tatimin mbi të ardhurat personale, si element i listëpagesës për efekt të realizimit të planit.

Pa marrë parasysh efektet e mësipërme, të ardhurat tatimore gjithsej nga kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, paraqiten në shumën **138,206 miliard lekë**, pasi të ardhurat nga kamatvonesat e kontributeve dhe gjobat për punëdhënësit rezultojnë në vlerën 858 miliard lekë dhe depozitimet e përkohshme (llog. 4665510), në vlerën 189 miliard lekë.

Sipas llojit të sektorëve, të ardhurat nga kontributet trajtohen më hollësisht në drejtimin 2.4 të këtij raporti.

-Nga auditimi konstatohet se në realizimin e të ardhurave tatimore, raportohen edhe të ardhurat që arkëtohen si gjoba të sistemit tatimor, problematikë kjo e konstatuar edhe në auditimin e mëparshëm, ku konkretisht sipas Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Llogaria 70 “Tatime dhe taksat”, citohet se *“Në këtë kategori përfshihen tatimet dhe taksat e mbledhura nga njësitë e qeverisjes qendrore (tatimet e taksat kombëtare) dhe të njëjstive të vetëqeverisjes vendore, kamatvonesat që lidhen me to, si dhe ato tarifa të vendosura nga këto dy qeverisje në kthim të të cilave nuk ka kosto. **Ndërsa gjobat që lidhen me tatimet dhe taksat janë përfshirë në titullin e të ardhurave jo tatimore**”.*

Konkretisht nga DPT janë raportuar si gjoba të sistemit tatimor, në llogaritë e mëposhtme:

Nr. Llogarisë	Përshkrimi llogarisë	Shuma 2022	Shuma 2023	Raportuar si e ardhur per
	Gjoba te sistemit Tatimor	706,686,752	876,172,790	
7115101	<i>Gjoba te sigurimeve shoqërore nga punëdhënësi</i>	310,611,031	385,458,471	Kontribute
7115118	<i>Gjoba te sigurimeve shëndetësore nga punëdhënësi</i>	52,289,145	65,167,196	Kontribute
7115119	<i>Gjoba per mos deklarim punonjësish</i>	100,608,973	107,548,873	Kontribute
7115499	<i>Te tjera gjoba</i>	122,837,286	166,383,092	
7115650	<i>Gjoba per deklarim te vonuar loja fati</i>	30,000	40,000	Tatime lojrat e fatit
7115651	<i>Gjoba per deklarim te vonuar Tarifa kombëtare</i>	83,963	246,019	Taksa dhe tarifa nacionale

7115652	<i>Gjoba per deklarim Tatim ne burim</i>	45,906,630	55,399,725	TAP
7115653	<i>Gjoba per deklarim te vonuar Taksa kombetare</i>	467,035	740,241	Taksa dhe tarifa nacionale
7115654	<i>Gjoba per deklarim te vonuar Sig Shoq,shend,dhe tap</i>	73,852,689	95,189,173	Kontribute

Burimi: Të dhëna të DPT të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Gjithashtu, sipas të dhënave të DPT, rezulton se Drejtoria e Kontrollit gjatë rivlerësimeve tatimore të kryera, ka realizuar të ardhura nga detyrimet dhe penalitetet për periudhën 2023/2022, si më poshtë:

Rrethet	Viti 2023 (000/lekë)				Viti 2022 (000/lekë)			
	Detyrim	Gjoba	Ulje humbje	Total	Detyrim	Gjoba	Ulje humbje	Total
Berat	51,700	17,304	21,934	90,938	23,131	9,800	26,155	59,085
Diber	52,740	13,847	14,553	81,140	20,686	6,341	110	27,137
Durrës	424,753	305,011	78,140	807,904	199,187	216,960	76,442	492,589
Elbasan	126,688	77,253	70,602	274,543	57,535	20,451	116,407	194,393
Fier	103,378	60,352	78,608	242,338	124,348	88,627	49,637	262,612
Gjirokastr	22,264	5,320	114,935	142,519	16,266	3,407	25,680	45,353
Korçe	36,203	14,008	35,683	85,894	54,939	23,785	34,856	113,580
Kukës	12,024	2,433	0	14,457	5,184	2,206	1,235	8,625
Lezhe	365,104	113,660	55,442	534,206	1,288,528	324,588	51,959	1,665,075
Sarandë	4,424	1,701	0	6,125	5,120	4,398	0	9,518
Shkodër	93,570	27,193	96,219	216,982	155,642	91,745	21,073	268,460
Vlorë	163,534	45,533	83,599	292,666	108,226	29,329	34,783	172,338
Tirana	1,639,609	1,056,151	371,011	3,066,771	1,138,047	519,736	450,282	2,108,065
DTM	1,963,554	631,526	10,270,815	12,865,895	2,927,282	852,934	1,469,041	5,249,257
Shuma	5,059,545	2,371,292	11,291,541	18,722,378	6,124,119	2,194,307	2,357,660	10,676,087

Burimi: Të dhëna të DPT të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Për sa më sipër, konstatohet se edhe këto penalitete të aplikuara, pra konkretisht 2,371 milion lekë për vitin 2023, dhe 2.194 milion lekë për vitin 2022, në momentin a likuidimit të tyre nga ana e subjekteve, nga ana e DPT raportohen si të ardhura tatimore, në zërat respektiv ku janë konstatuar mungesa e të ardhurave (të tilla si TVSH, TF), në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018.

Nga auditimi paralel i kryer nga KLSH pranë Ministrisë së Financave, u kërkua informacion pranë Drejtorisë së Programimit të Statistikës dhe Analizës së të ardhurave tatimore nëse përfshihen në planifikim edhe të ardhurat nga gjobat/penalitetet, nga e cila u argumentua se **këto të ardhura nuk janë pjesë e planit, pasi nuk mund të projektohen**. Në llogarinë e kuadrit fiskal, zëri i gjobave dhe interesave nuk përfshihet në të ardhurat tatimore nga tatimet dhe doganat. Gjobat dhe penalitetet pasqyrohen në llogari më vete në kuadrin fiskal. Të ardhurat nga gjobat dhe penalitetet llogariten e pasqyrohen në evidencën ditore por në rakordimin që institucionet e të ardhurave bëjnë me thesarin në fund të muajit, këto të ardhura nuk përfshihen në llogaritë e të ardhurave tatimore.

Për sa më sipër konstatohet se raportimi nga DPT i tyre si të ardhura, në kushtet kur nga MFE konfirmohet se nuk janë të përfshira në planifikim, rezulton në një raport realizimi të të ardhurave që nuk është në koherencë, apo i krahasueshëm me planin.

Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:

Z. C. K. me detyrë Drejtor i Përgjithshëm

Znj. M. S. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave dhe Kontabilitetit

2.3 Mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për arkëtimin e detyrimeve tatimore.

Misioni i Administratës Tatimore është mbledhja e të ardhurave tatimore përmes procedurave të thjeshta dhe me kosto minimale, duke zbatuar legjislacionin tatimor, për financimin e buxhetit të shtetit shqiptar. Nenet 88-103 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar përcaktojnë përgjegjësinë ligjore të Administratës Tatimore për mbledhjen e detyrimit tatimor të papaguar për të cilat nuk është ushtruar e drejta e ankimit apo kanë kaluar të gjitha fazat e shqyrtimit administrativ dhe gjyqësor. Për arritjen e këtyre qëllimeve, Administrata Tatimore i asiston tatimpaguesit me shërbime, në mënyrë që ata t’i përmbushin vetë detyrimet e tyre tatimore sipas legjislacionit në fuqi.

Në Rregulloren e funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore, me nr. 193, të datës 12.08.2020, janë të përfshira drejtoritë, misioni, struktura dhe detyrat e tyre. Administrata tatimore qendrore është e organizuar në drejtori dhe njësi të tjera sipas funksioneve të mëposhtme:

a) Funksionet bazë dhe operacionale, ku bëjnë pjesë:

shërbimi, regjistrimi dhe edukimi i tatimpaguesit; menaxhimi i riskut, rimbursimi i tatimeve, kontrolli tatimor; mbledhja e detyrimeve tatimore/zbatimi i masave shtrënguese; hetimi tatimor; investigimi i brendshëm antikorrupsion, auditi i brendshëm.

Funksionet mbështetëse, ku bëjnë pjesë: financa, statistikave dhe analiza, teknologjia e informacionit, shërbimi ligjor e teknik, shërbimet administrative, burimet njerëzore dhe marrëdhëniet institucionale. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve duhet të marrë masa për garantimin e mbledhjes së detyrimeve të prapambetura, duke siguruar respektimin e të drejtave të tatimpaguesve, uljen e ekspozimit ndaj risqeve që lidhen me mbledhjen e detyrimeve të prapambetura dhe në të njëjtën kohë evidentimin sa më real të gjendjes së detyrimeve tatimore, bazuar në të dhënat e dërguara nga Drejtoritë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Rajone dhe NJTM, sipas evidencave që raportohen çdo muaj nga ana e tyre. Në rastin kur pagesat nuk realizohen në kohë sipas afateve për pagesën në bazë të vetëdeklarimit, detyrimi tatimor kalon për ndjekje nga strukturat e ngarkuara për mbledhje e detyrimeve në DRT.

Mbledhja e detyrimeve të papaguara kryhet nga drejtoritë përgjegjëse të mbledhjes me forcë të detyrimeve të papaguara, në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Në DPT, procesi i koordinimit të mbledhjes së detyrimeve tatimore kryhet nga Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, megjithatë, është nën përgjegjësinë e DPT që nëpërmjet drejtorive të saj të garantojë udhëheqjen metodologjike dhe strategjike, zhvillimin e politikave dhe procedurave në funksion të mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara, zhvillimin e planeve operacionale, përcaktimin dhe monitorimin e targetave operacionale dhe varësinë funksionale mbi Drejtoritë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Rajone. Mbledhja e detyrimeve të papaguara kryhet sipas përcaktimeve në manualin e mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara. Ky Manual i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara mbështet në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” nën 135, paragrafet “3” dhe “4”. Ky Manual është detyruar për administratën tatimore. Strukturat e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në DPT dhe Rajone, kanë për detyrë të zbatojnë procedurat e përshkruara në këtë Manual. Ky rol në DPT realizohet nëpërmjet Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara (DMDTP) e cila është e organizuar me një strukturë prej 12 punonjësish dhe funksionon si vijon:

Tabela nr. Struktura e Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara

Viti 2023	Plan	Fakt
Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara	12	9
Drejtor Drejtorie	1	1
Spektori i Përcaktimit të Standarteve për Procedurat Ligjore të Mbledhjes me Forcë	3	1
Përgjegjës Spektori	1	
Inspektori i Parë	1	1
Inspektori i Parë	1	
Spektori i Monitorimit dhe Analizës	4	3
Përgjegjës Spektori	1	1
Inspektori i Parë	1	
Inspektori i Parë	1	1
Inspektori i Parë	1	1
Spektori i Monitorimit të Zbatimit të Masave Shtrënguese	4	4
Përgjegjës Spektori	1	1
Inspektori i Parë	1	1
Inspektori i Parë	1	1
Inspektori i Parë	1	1

Burimi: Të dhëna të DPT të përpunuar nga audituesit e KLSH.

Struktura faktike e Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara nuk është në përputhje me strukturën Organizative të miratuar me Urdhrin nr. 69, datë 26.05.2023 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”, Urdhrit Nr. 189 datë 08.08.2023 “Për miratimin e Organigramës së Administratës Tatimore Qendrore” të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë ku struktura e Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara është përcaktuar me 12 punonjës. Kjo drejtori ka 3 vende të lira/vakante konkretisht: 1 përgjegjës sektori dhe 1 inspektor në Sektorin e Përcaktimit të Standardeve për Procedurat Ligjore të Mbledhjes me Forcë dhe 1 inspektor në Sektorin e Monitorimit dhe Analizës. Personeli i pamjaftueshëm në këtë funksion kyç të administratës tatimore ka ndikuar negativisht në objektivat e mbledhjes së detyrimeve tatimore, si edhe në menaxhimin e rasteve të reja të detyrimit tatimor të papaguar të cilat duhen trajtuar sa më herët me procedurën e mbledhjes. Me shkresën nr. 19072/2 prot, datë 18.11.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm është bërë transferimi i përkohshëm i N. Xh., në pozicionin drejtor i komanduar. Më 23.05.2023 është ngarkuar përkohësisht si drejtor i Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara. Më datë 27.12.2023 z. N. Xh. është larguar me dorëheqje nga detyra. Për vitin 2023, nga Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore janë parashikuar për realizim:

1. Menaxhimi i detyrimeve të reja me moshë deri 2 vjet **01.01.2023 – 31.12.2023**
2. Menaxhimi i detyrimeve tatimore të papaguara të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore & TAP **01.01.2023 – 31.12.2023**
3. Trajtimi (kartelizimi, dokumentimi) i borxhit të vjetër me vlerë të lartë (rekomandim i FMN-së) **01.01.2023 -31.12.2023**

Në vijim të rekomandimit të FMN-s, gjatë vitit 2023, bazuar në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Grupi i Punës pranë DMDTP-s ka kryer verifikimin dhe analizimin e masave të marra për detyrimet tatimore të papaguara ndaj 40 subjekteve nga 100 subjekte, e realizuar në masën 40 %.

Për vitin 2023, plani operacional i DMDTP si pjesë e Planit Operacional të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, është përcjellë me vendim nr. 39, datë 29.12.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve në rolin e Kryetarit të Komitetit Operacional duke përcaktuar drejtimet e më poshtme, në zbatim të të cilave janë marrë edhe masat respektive:

1. Përmirësim i raporteve të menaxhimit, Afati tre mujori i parë.

2. Përmirësim i procedurave për rikuperimin e detyrimeve tatimore të papaguara. Afati gjatë gjithë vitit.

Nga auditimi i dokumentacionit rezultojnë se në zbatim të planit operacional, drejtoria DMDTP ka përmirësuar raportet në sistemin:

1. Përmirësuar raportin ekzistues në modulën e borxhit në sistemin C@ts “Lista Analitike e Debitorëve”
2. Dizenuar raportin e ri “Pasqyra e Gjendjes së Debitorëve”
3. Dizenuar raportin e ri “Klasifikimi sipas Moshës së Borxhit”
4. Përmirësuar në manualin lidhur me masën e sigurimit të detyrimit tatimor (Pezullim të Aktivitetit në Doganë)

Mbi Inspektimet e Kryera për Mbledhjen e Detyrimeve Tatimore të Papaguara

Sektorët e Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Drejtorinë të Përgjithshme duhet të garantojnë që të gjithë Drejtoritë e Mbledhjes së Detyrimeve në Rajone, të kenë planet e punës dhe objektiva operacionale për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara. Këto plane dhe objektiva duhet të jenë në përputhje me planin strategjik të DPT dhe rregulloren e brendshme. Gjithashtu Sektorët e Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Drejtorinë të Përgjithshme duhet të përgatisin plane inspektimi për të kontrolluar nëse Rajonet kanë:

zbatuar plotësisht planet e tyre operacionale,

mbajtur regjistratë të saktë, të plotë dhe të azhurnuar të debitorëve,

ndjekur procedurën të përcaktuar të masave shtrënguese,

Së bashku me planet e inspektimeve, mund të kryejnë inspektime të posaçme që nxiten nga shqetësime që lindin nga raportet e Drejtorive të Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Rajone.

Për inspektimet e kryera dhe për çdo vizitë inspektimi duhet të hartohet Raporti ku të trajtohen zbulimet e inspektimit, dhe duhet të përfshihen:

shpjegime për çdo ndryshim nga plani dhe/ose objektivat,

çdo parregullsi procedurale të identifikuar,

çdo çështje teknike të identifikuar,

çdo nevojë specifike për trajnim të identifikuar,

rekomandimet për veprim.

Nga auditimi i veprimtarisë së drejtorisë DMDTP rezultojnë se gjatë vitit 2023 nuk është kryer asnjë inspektim në asnjë rajon për të kontrolluar apo monitoruar rajonet nëse kanë zbatuar plotësisht planet e tyre operacionale, nëse kanë mbajtur regjistratë të saktë dhe të azhurnuar të debitorëve, nëse kanë ndjekur procedurat e përcaktuara për masat shtrënguese. Duke çënuar realizimin e objektivit të saj që është udhëheqja metodologjike dhe strategjike, zhvillimi i politikave dhe procedurave në funksion të mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara, zhvillimi i planeve operacionale, përcaktimin dhe monitorimin e targetave operacionale dhe varësinë funksionale mbi Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Rajone, me qëllim maksimizimin e arkëtimit të detyrimeve tatimore të papaguara duke zbatuar parimin e analizës së riskut, me koston më të ulët të mundshme, ndërkohë që të sigurohet respektimi i të drejtave të tatimpaguesve duke zbatuar me korrektësi legjislativën tatimor në fuqi.

Nga auditimi ka rezultuar se:

Struktura faktike e Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara nuk është në përputhje me strukturën Organizative të miratuar me Urdhrin nr. 69, datë 26.05.2023 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore” dhe Urdhrin Nr. 189 datë 08.08.2023 “Për miratimin e Organigramës së Administratës Tatimore Qendrore” të Ministrit të Financave dhe

Ekonomisë ku struktura e Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara është përcaktuar me 12 punonjës. Kjo drejtori ka 3 vende të lira/vakante konkretisht: 1 përgjegjës sektori e 1 inspektor në Sektorin e Përcaktimit të Standardeve për Procedurat Ligjore të Mbledhjes me Forcë dhe 1 inspektor në Sektorin e Monitorimit dhe Analizës. Personeli i pamjaftueshëm ka ndikuar negativisht në objektivat e mbledhjes së detyrimeve tatimore, si edhe në menaxhimin e tyre. Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara (DMDTP) gjatë vitit 2023 nuk ka kryer asnjë inspektim në asnjë drejtori rajonale tatimore.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në:

Urdhrin nr. 69, datë 26.05.2023 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”

Urdhrin Nr. 189 datë 08.08.2023 “Për miratimin e Organigramës së Administratës Tatimore Qendrore” të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë

Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, KREU XI, “Mbledhja me force e detyrimit tatimorë i papaguar”, neni 88” Autoriteti dhe kompetencat për të mbledhur detyrimit tatimorë të papaguar”, nenin 135, paragrafet “3” dhe “4”

Manualin e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, Kreu 2.1.1 “Inspektimi”.

Situata e detyrimeve tatimore të papaguara në afat deri në 31 Dhjetor 2023 paraqitet si më poshtë:


Tabela nr. Detyrimet tatimore të papaguara për vitin 2023 (në vlerë)

Në mijë lekë

Rajonet	Gjendja e detyrimeve në fillim të vitit	Detyrime te shtuara		Detyrime te pakësuara			Detyrime ne fund te vitit
		Detyrime te shtuara	Subjekte të Transferuar	Arkëtuar Gjithsej	Subjekte të Transferuara	Kthyer për Sistemim	
Qendror	108,419,282	25,084,481	19	19,024,353	131,814	236,746	114,110,868
VIP	12,484,604	7,568,325	79,476	7,128,553	-	393,887	12,609,964
JUG	10,850,010	3,936,074	36,786	2,556,771	4,632	405,735	11,855,732
VERI	15,014,094	3,937,687	35,948	2,383,103	15,783	-	16,588,843
DPT	146,767,990	40,526,567	152,229	31,092,781	152,229	1,036,368	155,165,408

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Ecuria e detyrimeve tatimore të papaguara progresive sipas muajve përgjatë vitit 2023 krahasuar me vitin paraardhës, ecuria sipas muajve rezulton si më poshtë:



Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Në grafikun e mësipërm është paraqitur ecuria e detyrimeve tatimore të papaguara progresive sipas muajve të vitit 2022 dhe 2023 nga ku në janar të vitit 2023 detyrimet janë në vlerën

148,588,045 mijë lekë, 13,653,363 mijë lekë më shumë se vitin 2022 i cili ka qenë në vlerën 134,934,682 mijë lekë. Detyrimet tatimore të të paguara në muajin dhjetor 2023 është në vlerën 155,165,408 mijë lekë, 8,207,929 mijë lekë më shumë se vitin 2022 i cili ka qenë në vlerën 146,957,479 mijë lekë.

Tabela nr. Detyrimet tatimore të papaguar për vitin 2023 (në numër)

Në numër

Rajonet	Numri i subjekteve						Nr. i subjekteve në fund të vitit
	Nr. i subjekteve në fillim të vitit	Detyrime te shtuara		Detyrime te pakësuara			
		Detyrime te shtuara	Subjekte të Transferuar	Arkëtuar Gjithsej	Subjekte të Transferuara	Kthyer për Sistemim	
Qendror	123,482	188,396	3	245,446	19	4,730	127,185
VIP	257	2,328	12	2,334	-	24	239
JUG	38,938	74,986	4	76,879	5	4,220	32,824
VERI	19,813	19,095	8	18,137	3	-	20,775
DPT	182,490	284,805	27	342,796	27	8,974	181,023

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Gjendja e detyrimeve të papaguara në fillim të vitit 2023 paraqitet në vlerën rreth 146,767 milion lekë që i përket një numri prej 182,490 subjektsh debitore, dhe në fund të vitit 2023 këto detyrime rezultojnë në vlerën rreth 155,165 milion lekë që i përket një numri prej rreth 181,023 subjektsh debitore. Ka një rritje prej rreth 8,397 milion lekë të detyrimeve të papaguara dhe me një ulje prej 1,467 debitorëve të pakësuar në fund të vitit. Në tabelën e mësipërme janë pasqyruar edhe subjektet të cilat transferojnë aktivitetin e tyre nga një DRT në një tjetër DRT. Krahasuar me një vit më parë stoku i borxhit ka një nivel ulje (ku ulja e pësuar neto nga viti i kaluar është 3.5 miliard lekë dhe 8,855 subjekte debitorë duke qenë se detyrimi për vitin 2022 ishte rreth 11.8 miliard lekë dhe 10,322 subjekte debitorë). Detyrimet e shtuara gjatë vitit 2023 janë 40 miliard lekë ose afërsisht 3 miliard lekë më shumë krahasuar me vitin 2022, ku detyrimet e shtuara ishin 37 miliard lekë. Arkëtimet paraqiten në vlerën 31 miliard lekë, krahasuar më vitin paraardhës ku arkëtimin ishin 24 miliard lekë, këtë vit janë mbledhur afërsisht 7 miliard lekë më shumë.

Detyrimet e shtuara gjatë vitit 2023- Burimi i krijimit

Nr.	DRT	Shtesa e borxhit sipas evidencave	Borxhi i krijuar nga vetëdeklarimi	Borxhi i krijuar nga kontrollet, detyrimet e vlerësuara nga administrata tatimore (njoftim vlerësime, gjoba sistemi etj)
1	Qendror	25,084,480	17,408,523	7,675,957
2	VIP	7,568,325	5,027,742	2,540,584
3	JUG	3,936,074	3,151,623	784,451
4	VERI	3,937,687	2,581,684	1,356,003
	Totali	40,526,566	28,169,572	12,356,994

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Tabela nr. Debitorët që zënë peshën më të madhe në masën e detyrimit tatimor të papaguar

Në lekë

NIPT	SUBJEKTI	DRT	Statusi	Detyrimi Total 31.12.2023
J.....D	A..	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë	Pasiv	8,869,574,082
L.....E	T. O. T.	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës	Pasiv	6,801,707,489
L.....C	D. O. A.	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë	Pasiv	5,058,306,709
L.....I	I. R. AND T. C. – IRTC	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë	Pasiv	4,270,465,042
K.....H	O. i Sh.s së E. E. G.	DTM	Aktiv	4,181,312,367
K.....C	E. - K SHPK	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë	Pasiv	3,818,330,793

K.....P	T. A. Ltd. - D. Sh.	DTM	Pasiv	2,165,236,369
K.....H	K.	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhë	Pasiv	1,788,016,660
K.....H	T. B.	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë	Pasiv	1,766,869,353
L.....Q	G. A. B.	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë	Aktiv	1,322,512,034
L.....O	E.-C.	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhë	Pasiv	1,060,321,977
K.....T	B. A.	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë	Aktiv	1,058,507,631
L.....A	A.	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë	Aktiv	888,326,768
L.....G	F.	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë	Pasiv	855,602,717
L.....M	A.-2013	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë	Pasiv	841,183,030
K.....T	A. M. R. A. O.	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë	Pasiv	819,859,906
L.....M	S. P. A.	DTM	Pasiv	819,531,855
K.....A	K.	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhë	Pasiv	776,565,637
L.....S	P. & A C.	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë	Pasiv	758,489,889
K.....E	K. 2003	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhë	Pasiv	748,810,481
L.....J	E.-03 G.	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhë	Pasiv	699,686,464
L.....D	F. - I.	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhë	Pasiv	657,652,777
K.....P	E. SHPK	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë	Pasiv	639,294,168
K.....V	C. A.	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë	Pasiv	638,919,950
K.....P	T. C. & P.	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë	Pasiv	587,963,105
J.....H	S. D. S. L. Dega ne Shqiperi	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier	Aktiv	577,174,093
K.....H	X.	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë	Pasiv	569,625,176
K.....E	H.	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë	Aktiv	560,581,138
K.....L	I.	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë	Pasiv	547,179,252
L.....A	T. E.	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë	Pasiv	537,005,853

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Në tabelën e mësipërme janë paraqitur 30 nga debitorët që zënë peshën më të madhe në masën e detyrimit tatimor të papaguar. Nga të dhënat e mësipërme, nga 30 debitorët më të mëdhenj janë 6 subjekte aktive në vlerën 8,588 milionë lekë të cilat zënë 16 % të total vlerës dhe 24 pasive në vlerën 46,096 milion lekë të cilat zënë 84 % të total vlerës debitore. Subjektet me vlerën më të lartë të detyrimit tatimor të papaguar e zënë subjektet në Drejtorinë Rajonale e Tatimeve Tiranë, 19 subjekte ose 63 % e totalit, Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhë 6 subjekte ose 20 % e totalit, Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj 3 subjekte ose 10 % e totalit, Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës 1 subjekt ose 3 % e totalit dhe Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier 1 subjekt ose 3 % e totalit.

Tabela nr. Detyrimi tatimor i papaguar në proces gjyqësor

Në mijë lekë

Rajonet	Në Proces Gjyqësor		Në Proces Apeli	
	<i>nr.subj.</i>	<i>shuma</i>	<i>nr.subj.</i>	<i>Shuma</i>
Qendror	1,135	9,247,334	-	-
VIP	110	2,601,820	17	327,734
JUG	156	930,966	-	-
VERI	-	1,173,436	-	-
Totali	1,401	13,953,556	17	327,734

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Shënim: Rajoni Jugor përfshin DRT- Fier, Vlorë, Sarandë, Gjirokastrë, Berat
Rajoni Verior përfshin DRT- Shkodër, Lezhë, Kukës, Dibër
VIP -Njësia e Tatimpaguesve të Mëdhenj
Rajoni Qendror DRT- Tiranë, Elbasan, Korçë, Durrës

Referuar subjekteve në proces gjyqësor rezultojnë 1,401 subjekte me detyrim total 13 miliard lekë. Krahasuar me vitin 2022 janë rreth 10 subjekte më shumë me një vlerë të detyrimeve të papaguara të ankmuara në gjykatë prej rreth 901 milion lekë më shumë.

Për sa i përket trendit të proceseve gjyqësore me vlerë më të madhe sipas rajoneve situata paraqitet e ngjashme me një vit më parë, ku Rajoni Qendror rezulton me një vlerë të detyrimeve të ankmuara prej rreth 9 miliard lekë për 1,135 subjekte, ndjekur nga VIP me rreth 2 miliard


lekë për 110 subjekte. Rajoni Qendror rezulton i njëjtë me vitin e kaluar 9 miliard lekë për 1,135 subjekte, VIP në vlerën 2 miliard lekë për 110 subjekte, rajoni jugor 930 milion për 156 subjekte dhe rajoni verior në vlerën 1 miliard lekë ku numri i subjekteve nuk është i përcaktuar. Trendin më të lartë të rritjes krahasuar me vitin paraardhës e ka rajoni jugor me rritje në vlerën 529 milion lekë krahasuar me vitin 2022, ndjekur nga rajoni verior me 203 milion lekë dhe Vipi me 168 milion lekë. Përsa i përket subjekteve në proces apelimi rezultojnë në vlerën 327 milion lekë për 17 subjekte. Krahasuar me vitin e kaluar janë shtuar 6 subjekte, me vlerë 216 milion lekë.

Tabela nr. Stoku i detyrimeve sipas rajoneve.

Në mijë lekë

Rajoni	Gjendja në fillim të vitit		Gjendja në fund të vitit		Rritje/ Ulje	Pesha qe ze rritja/ ulja %
	Nr.Subjekte	Detyrimi total	Nr.Subjekte	Detyrimi total		
QENDROR	123,482	108,419,282	127,185	114,110,869	5,691,587	68%
VERI	257	12,484,604	239	12,609,965	125,361	1%
JUG	38,938	10,850,010	32,824	11,855,732	1,005,722	12%
VIP	19,813	15,014,094	20,775	16,588,843	1,574,749	19%
Totali	182,490	146,767,990	181,023	155,165,408	8,397,419	100%

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT



Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Sipas asaj çfarë është paraqitur edhe më lart asnjë rajon nuk ka pësuar ulje të detyrimeve, krahasuar me vitin e kaluar rajoni VIP i kishte ulur detyrimet me 6 % të total detyrimit. Për sa i përket stokut të detyrimeve tatimore te papaguara sipas rajoneve siç vërehet nga tabela e mësipërme rajoni Qendror ka peshën më të madhe të rritjes së detyrimeve të papaguara afërsisht me 68 % të total detyrimit ose 5,691 milion lekë rritje. Më pas vjen rajoni Jug me rritje prej 1,005 milion lekë rritje ose 12 % e total rritjes së detyrimit të papaguar, dhe rajoni Veri ka pësuar një rritje me 125 milion lekë ose 1 % e total rritjes.


Tabela nr. Detyrimi tatimor i papaguar i ndarë sipas moshës

Në mijë lekë

MOSHA E DETYRIMEVE TE PAPAGUARA NE AFAT DERI NË 31.12.2022							
Periudha	Detyrimet deri 3 muaj	Detyrimet 3 - 6 muaj	Detyrimet 6-12 muaj	Detyrimet nga 1- 2 vite	Detyrimet nga 2- 5 vite	Detyrimet mbi 5 vite	Total
Detyrime të papaguara në afat	5,194,453	3,253,888	6,445,491	12,591,040	42,552,611	85,127,938	155,165,421

Pesha specifike në %	3%	2%	4%	8%	27%	55%	100%

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT



Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Referuar moshës së detyrimeve të papaguara në vitin 2023 vërehet se peshën më të madhe të stokut të detyrimit sipas moshës e zënë detyrimet me moshë borxhi detyrimet mbi 5 vite të cilat zënë rreth 55 % të total detyrimit, nga 2-5 vite me peshë 27 %, nga 1- 2 vite zënë 8 %, nga 6-12 muaj zënë 4 %, detyrimet deri në 3 muaj zënë 3 % dhe në fund 2 % e zënë detyrimet 3 -6 muaj. Krahasuar me vitin e kaluar uljen më të lartë të detyrimit tatimor e ka pësuar detyrimet 1- 2 vite në vlerën 3 miliard lekë dhe rritjen më të madhe detyrimet mbi 5 vite në vlerën 13 miliard lekë.

Për sa i përket moshës së detyrimeve sipas llojit të tatimit, situata paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. Detyrimi tatimor i papaguar sipas llojit dhe moshës

Në mijë lekë

MOSHA E BORXHIT	TATIM MBI TË ARDHURAT PERSONALE	TATIM FITIMI	TVSH	SIGURIME	TË TJERA	TOTALI
<i>borxhi deri ne 3 muaj</i>	265,829	848,529	1,933,312	1,479,758	667,025	5,194,453
<i>borxhi nga 3 - 6 muaj</i>	101,943	744,962	1,123,074	1,009,090	274,820	3,253,888
<i>borxhi nga 6-12 muaj</i>	76,801	2,324,742	1,833,092	1,569,294	641,560	6,445,491
<i>borxhi nga 1-2 vjet</i>	132,209	5,426,822	4,029,200	2,005,612	997,197	12,591,040
<i>borxhi nga 2-5 vjet</i>	283,257	13,942,195	15,080,751	5,249,631	7,996,777	42,552,611
<i>borxhi mbi 5 vjet</i>	1,434,371	21,511,284	31,268,723	11,196,153	19,717,406	85,127,938
TOTALI	2,294,408	44,798,529	55,268,146	22,509,533	30,294,775	155,165,409

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Mosha e detyrimeve tatimore sipas llojit në bazë rajoni.

Tabela nr. Mosha e detyrimeve – Sipas rajoneve

Në mijë lekë

Rajoni Qendror						
Mosha e borxhit	Detyrimet Tatimore					
	Tatim mbi te ardhurat personale TAP	Tatim Fitimi	TVSH	Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	Te tjera	Total

<i>borxhi deri ne 3 muaj</i>	170,913	414,211	903,960	987,631	521,812	2,998,527
<i>borxhi nga 3 - 6 muaj</i>	97,055	522,397	745,182	771,049	199,085	2,334,767
<i>borxhi nga 6-12 muaj</i>	65,625	1,481,173	1,060,867	1,162,492	477,458	4,247,616
<i>borxhi nga1-2 vjet</i>	108,996	1,911,452	2,165,099	1,390,827	733,267	6,309,641
<i>borxhi nga 2-5 vjet</i>	231,134	9,899,066	12,067,227	3,780,455	7,391,609	33,369,491
<i>borxhi mbi 5 vjet</i>	1,227,431	15,585,898	23,038,759	8,344,103	16,654,636	64,850,827
Totali- Rajoni Qendror	1,901,153	29,814,196	39,981,094	16,436,558	25,977,868	114,110,869
VIP						
<i>borxhi deri ne 3 muaj</i>	37,052	360,440	673,779	92,082	61,664	1,225,017
<i>borxhi nga 3 - 6 muaj</i>	875	115,515	133,523	3,080	13,936	266,929
<i>borxhi nga 6-12 muaj</i>	4,617	312,981	226,495	13,788	22,769	580,651
<i>borxhi nga1-2 vjet</i>	14,576	2,558,060	368,165	53,138	43,053	3,036,992
<i>borxhi nga 2-5 vjet</i>	6,832	2,335,729	883,062	33,304	135,143	3,394,070
<i>borxhi mbi 5 vjet</i>	8,096	2,451,270	1,308,276	27,164	311,499	4,106,306
Totali- VIP	72,049	8,133,995	3,593,300	222,558	588,063	12,609,965
Rajoni Jugor						
<i>borxhi deri ne 3 muaj</i>	57,240	22,265	193,591	195,905	55,798	524,799
<i>borxhi nga 3 - 6 muaj</i>	3,986	67,987	132,581	140,713	49,268	394,535
<i>borxhi nga 6-12 muaj</i>	6,407	150,806	135,671	230,033	85,310	608,227
<i>borxhi nga1-2 vjet</i>	6,388	119,997	219,762	314,739	123,220	784,106
<i>borxhi nga 2-5 vjet</i>	39,039	320,759	726,696	747,844	190,026	2,024,364
<i>borxhi mbi 5 vjet</i>	133,799	1,415,892	2,939,671	1,596,325	1,434,014	7,519,701
Totali- Rajoni Jugor	246,859	2,097,706	4,347,972	3,225,559	1,937,636	11,855,732
Rajoni Verior						
<i>borxhi deri ne 3 muaj</i>	624	51,613	161,982	204,140	27,751	446,110
<i>borxhi nga 3 - 6 muaj</i>	27	39,063	111,788	94,248	12,531	257,657
<i>borxhi nga 6-12 muaj</i>	152	379,782	410,059	162,981	56,023	1,008,997
<i>borxhi nga1-2 vjet</i>	2,249	837,313	1,276,174	246,908	97,657	2,460,301
<i>borxhi nga 2-5 vjet</i>	6,252	1,386,641	1,403,766	688,028	279,999	3,764,686
<i>borxhi mbi 5 vjet</i>	65,045	2,058,224	3,982,017	1,228,561	1,317,257	8,651,104
Totali- Rajoni Verior	74,347	4,752,632	7,345,780	2,624,858	1,791,208	16,588,843

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Detyrimet sipas statusit të tatimpaguesve

Tabela nr. Detyrimet tatimore të papaguara sipas statusit Aktiv/ Pasiv

Në mijë lekë

DRT	Tatimpagues Aktivë		Tatimpagues Pasivë		Borxhi deri me 31.12.2023		Subj. Aktiv		Subj. Pasiv	
	Nr.	Vlera e Borxhit	Nr.	Vlera e Borxhit	Nr.	Vlera e Borxhit	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
Qendror	45,687	22,825,204	81,498	91,285,665	127,185	114,110,869	36%	20%	64%	80%
VIP	228	9,016,102	11	3,593,863	239	12,609,965	95%	71%	5%	29%
JUG	11,654	4,818,670	21,170	7,037,062	32,824	11,855,732	36%	41%	64%	59%
VERI	7,907	4,168,244	12,868	12,420,599	20,775	16,588,843	38%	25%	62%	75%
Totali	65,476	40,828,220	115,547	114,337,188	181,023	155,165,408	36%	26%	64%	74%

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Subjekte me status Aktive janë në numër 64,476 ose 36 % e total numrit të subjekteve debitoare, me vlerë detyrimi 40.8 miliard lekë ose 26 % e total detyrimit të papaguar.

Subjektet me status Pasive janë numër 115,547 subjekte ose 63.8 % mbi numrin gjithsej të subjekteve, me vlerë 114 miliard lekë ose 74 % mbi total detyrimin e papaguar.

Krahasuar me vitin e kaluar vërehet një rritje në numrin e subjekteve me status pasiv ose kërkesë për çregjistrim, në 2022 subjektet me status Pasiv ishin 64 % e numrit total të subjekteve dhe 72 % e masës së detyrimit total. Siç vërehet nga tabela e mësipërme në Rajonin Qendror vlera e detyrimit të papaguar nga subjektet me status Pasiv zënë 80 % e total detyrimit për këtë rajon. Krahasuar me vitin e kaluar dhe rajonet e tjera, rajoni verior ka pësuar rritjen më të madhe të detyrimeve me 11 % të masës së detyrimit total. Numri më i lartë i subjekteve pasiv që përbejnë pjesën më të konsiderueshme të detyrimeve të papaguara, është një tregues edhe për vështirësinë në mbledhjen e këtyre detyrimeve, për sa kohë këto subjekte nuk vijojnë aktivitetin e tyre.

Detyrimet sipas llojit të Tatimit për vitin 2023


Detyrimi tatimor i papaguar i ndarë sipas llojit të tatimit paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. Detyrimi tatimor i papaguar sipas llojit të tatimit

Në mijë lekë

Lloji i tatimit	Gjendja e detyrimeve në fillim të vitit	Detyrime të shtuara gjatë vitit		Detyrime pakësuar gjatë vitit			Vlera e detyrimeve në fund të vitit	Nga këto në Proces Gjyqësor
		Detyrime të shtuara	Subjekte të Transferuar	Arkëtuar Gjithsej	Subjekte të Transferuara	Kthyer per Sistemim		
Tatim Fitimi	42,695,956	8,669,978	17,456	6,395,003	17,456	172,402	44,798,529	2,776,705
TVSH	52,085,175	8,766,678	109,559	5,100,477	109,559	483,230	55,268,146	9,005,212
Sig. Shoqërore	20,453,682	18,564,772	20,511	16,489,574	20,511	19,347	22,509,532	1,042,772
TAP	2,101,264	1,117,496	1,329	772,706	1,090	151,886	2,294,407	162,098
DIVA	403,840	535,792	-	472,147	-	5,745	461,740	20,290
Tatimi në burim	5,336,354	1,727,680	1,090	1,104,158	1,329	75,135	5,884,502	271,674
Të tjera	23,691,720	1,144,169	2,284	758,715	2,284	128,622	23,948,552	674,806
TOTAL	146,767,990	40,526,567	152,229	31,092,780	152,229	1,036,367	155,165,408	13,953,556

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT




Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Për sa i përket gjendjes së stokut të detyrimeve të papaguara në afat sipas llojit të tatimit, rezulton se zëri TVSH me peshën më të madhe në stokun e detyrimeve të papaguara në afat, 36% me një vlerë prej rreth 55.2 milion lekë, ndjekur nga Tatim Fitimi me 29% ose në vlerën prej rreth 44,7 milion lekë, e më pas zëri “Të Tjera” me 15 % ose në vlerën prej rreth 23,9 milion lekë, zëri Sigurimet Shoqërore & Shëndetësore me 15 % ose në vlerën prej rreth 22.5 milion lekë., dhe zëri Tatim në Burim me rreth 4 %, ose në vlerën prej rreth 5,8 milion lekë.

Krahasuar me një vit më parë, sikundër vërehet në tabelën e mëposhtme, kemi një rritje pothuajse të njëtrajtshme në të gjitha llojet e tatimit, rritjen më të lartë e kanë detyrimet përsa i përket tatimit në burim dhe sigurimeve shoqërore.

Detyrimet sipas llojit të Tatimit 2022 vs 2023

Detyrimi i papaguar sipas llojit te tatimit, 2022 vs 2023



Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Më hollësisht për zërin e Tatim Fitimit, gjendja e detyrimeve në vitin 2023 rezultoi 2,147 milion lekë më shumë se viti paraardhës ose me 5 % rritje (në vitin 2022 këto detyrime paraqiten në vlerën 42,651 milion lekë); zëri i TVSH-së rezultoi 3,182 milion lekë më shumë ose me 6 % rritje (në vitin 2022 këto detyrime paraqiten në vlerën 52,085 milion lekë); zëri i Sigurimeve Shoqërore 2,063 milion lekë më shumë ose 10 % rritje (në vitin 2022 këto detyrime paraqiten në vlerën 20,455 milion lekë); zëri TAP 185 milion lekë më shumë ose 9 % rritje (në vitin 2022 këto detyrime paraqiten në vlerën 2.109 milion lekë); zëri DIVA 78 milion lekë më pak ose 15 % ulje (në vitin 2022 këto detyrime paraqiten në vlerën 540 milion lekë); zëri Tatim në burim 684 milion lekë më shumë se viti paraardhës ose me 13 % rritje (në vitin 2022 këto detyrime paraqiten në vlerën 5,199 milion lekë) dhe zëri të tjera 256 milion lekë më shumë ose 1 % rritje (në vitin 2022 këto detyrime paraqiten në vlerën 23,691 milion lekë).

Tabela nr. Detyrimet e papaguara sipas llojit të tatimit- të ndara në Detyrim/Gjohje/Interes sipas DRT- ve

Lloji i tatimit	DRT	Detyrim	Gjohje	Interes	Në mijë lekë
					Detyrim+ Gjohje+ Interes
TAP	Qendror	1,355,968	357,065	188,119	1,901,153
	VIP	60,382	8,608	3,058	72,049
	JUG	173,889	45,733	27,237	246,859
	VERI	34,280	20,135	19,932	74,347
	Tot. i DRT- ve	1,624,520	431,541	238,347	2,294,407
Tatim Fitim	Qendror	19,499,495	9,472,504	842,198	29,814,196
	VIP	2,897,236	3,852,897	1,383,862	8,133,995
	JUG	1,283,600	733,801	80,305	2,097,706
	VERI	3,407,403	1,125,669	219,560	4,752,632
	Tot. i DRT- ve	27,087,733	15,184,871	2,525,925	44,798,529
TVSH	Qendror	23,068,889	15,258,997	1,653,209	39,981,094
	VIP	1,390,883	2,073,628	128,790	3,593,300
	JUG	2,571,595	1,547,204	229,173	4,347,972
	VERI	4,413,923	2,181,193	750,664	7,345,780
	Tot. i DRT- ve	31,445,290	21,061,021	2,761,835	55,268,147
SIGURIME SHOQERORE DHE SHENDETESORE	Qendror	12,580,887	3,153,170	702,500	16,436,558
	VIP	168,501	42,825	11,231	222,558
	JUG	2,542,320	549,989	133,250	3,225,559
	VERI	1,983,993	494,991	145,874	2,624,858
	Tot. i DRT- ve	17,275,702	4,240,975	992,855	22,509,532
Te Tjera	Qendror	16,210,978	9,066,566	700,324	25,977,868
	VIP	137,170	426,895	23,998	588,063
	JUG	771,173	1,092,604	73,859	1,937,636

	VERI	479,737	391,486	920,003	1,791,226
	Tot. i DRT- ve	17,599,058	10,977,551	1,718,184	30,294,793
Totali i llojeve te tatimit		95,032,303	51,895,960	8,237,146	155,165,408

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Rajoni Qendror ka detyrimet më të larta krahasuar me rajonet e tjera për të gjitha llojet e tatimeve ku është llogaritur detyrimi+ gjoba+ interesi. Duke ju referuar gjobave të llogaritura sipas llojit të tatimit, gjobat e llogaritura mbi TVSH- n në vlerën 21,061 mijë lekë zënë pjesën më të madhe të detyrimeve duke u pasuar nga gjobat e llogaritura mbi Tatim Fitimin në vlerën 15,258 mijë lekë. Në total për të gjithë rajonet, principali i detyrimeve tatimore të akumuluar përbën rreth 61 % të vlerës totale të detyrimeve tatimore, për t'u ndjekur më pas nga penalitetet (gjobat) me 33 % dhe 6 % kamatëvonesat (interesat).

Detyrimet e papaguara të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për vitin 2023 janë në vlerën 22,509 milion lekë nga të cilat 21,316 milion lekë, ose 95 % e vlerës i përkasin subjekteve private dhe 1,192 milion lekë, ose 5 %.

Tab. Detyrimet e papaguara të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të subjekteve private dhe enteve buxhetore

Në mijë lekë

Sig. shoq. 31.12.2023	22,509,532	% qe ze
Ent Buxhetor, Ndërmarrje shtetërore	1,192,575	5%
Subjekte Private	21,316,957	95%

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Tab. Detyrimet e papaguara të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të enteve buxhetore sipas rajoneve

Në mijë lekë

Rajoni	2022	2023	Diferenca
Jugor	175,244	170,846	-4,398
Qendror	867,722	877,639	9,917
Verior	119,710	139,232	19,523
VIP	4,651	4,857	206
Totali	1,167,328	1,192,575	25,247

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Detyrimet e papaguara të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të enteve buxhetore nga viti 2022 në vitin 2023 janë rritur në vlerën 25,247 mijë lekë. Rajoni Verior ka tendencën më të madhe të rritjes së detyrimeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të enteve publike, nga viti 2022 në 2023 ka pësuar rritje në vlerën 19,522 mijë lekë, duke u pasuar nga Rajoni Qendror me rritje në vlerën 9,917 mijë lekë dhe VIP me rritje në 205 milion lekë. Në ndryshim nga dy rajonet e tjera, Rajoni Jugor paraqitet në ulje të detyrimeve në vlerë 4,398 milion lekë.

Tab. Entet Buxhetore dhe Ndërmarrje Shtetërore sipas statusit

Në mijë lekë

Statusi	Rajoni Qendror		Rajoni VIP		Rajoni Verior		Rajoni Jugor	
	Nr. ENT/NSH	Sigurime 31.12.2023	Nr. ENT/NSH	Sigurime 31.12.2023	Nr. ENT/NSH	Sigurime 31.12.2023	Nr. ENT/NSH	Sigurime 31.12.2023
Aktiv	234	287,641	6	4,857	68	114,536	54	148,294
Pasiv	90	575,129			23	13,218	20	7,411
Kërkesë për Çregjistrim	64	14,869			48	11,479	27	15,141
Tot.	388	877,639	6	4,857	139	139,232	101	170,846

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Tab. Entet Buxhetore dhe Ndërmarrje Shtetërore sipas rajoneve
Në mijë lekë

Rajoni Qendror			Rajoni VIP		Rajoni Veror		Rajoni Jugor	
ENT/ NSH	Nr. ENT/ NSH	Sigurime 31.12.2023	Nr. ENT/ NSH	Sigurime 31.12.2023	Nr. ENT/ NSH	Sigurime 31.12.2023	Nr. ENT/ NSH	Sigurime 31.12.2023
Ent Buxhetor	360	357,481	3	4,751	116	87,461	80	18,204
Ndërmarrje shtetërore	28	520,158	3	106	23	51,771	21	152,642

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Në seksionin 3.3.2 “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor” të Manualit përcaktohet se administrata tatimore ka autoritetin dhe kompetencat e dhëna për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara. Kjo mundësohet nga Sistemi C@TS, në të cilin ekzekutohet në gjitha veprimet automatike lidhur me menaxhimin e detyrimeve tatimore të papaguara pa ndërhyrje manual nga zyrtarët e tatimeve. Funkzioni i mbledhjes me forcë kryhet në secilën nga DRT që përfshihen në 4 rajonet. Ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar, dhe Udhëzimi nr.24 datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar parashikojnë instrumentet që DPT duhet dhe mund të përdorë për mbledhjen me forcë të detyrimit tatimor.

Mbi vendosjen e Barrës Hipotekore dhe Njoftimi për vendosjen e Barrës Siguruese

Manuali i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, çështja 4.4.6 “Njoftimi për vendosjen e Barrës Hipotekore dhe Njoftimi për vendosjen e Barrës Siguruese”, përcakton se me qëllim sigurimin e pagimit të detyrimeve tatimore nga tatimpaguesit, administrata tatimore duhet të vendosë për marrjen e masave të sigurimit për ekzekutimin e detyrimit duke vendosur masa sigurimi të pasurisë nëpërmjet barrëve siguruese për pasuritë e luajtshme dhe hipotekës për pasuritë e paluajtshme të tatimpaguesit. Nga auditimi konstatohet se struktura përgjegjëse në DPT ka planifikuar fond për Barre Hipotekore në programin buxhetor për vitin 2023 për çdo DRT.

Ecuria e detyrimeve tatimore të papaguara

Në seksionin 3.3.1 “Kërkesat për evidentim dhe analizë” të Manualit përcaktohet se çdo muaj Sektori i Monitorimit, Analizës për Masat Shtërnguese në Drejtoritë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Rajone, përgatit raporte dhe analiza lidhur me situatën e detyrimeve tatimore të papaguara të cilat dërgohen brenda datës 8 të çdo muaji pasardhës në rrugë elektronike dhe brenda datës 14 në rrugë zyrtare pranë DMDTP në DPT, e cila më pas përpunon materialin përmbledhës për të gjitha drejtoritë rajonale si dhe raporton te strukturat drejtuese mbi ecurinë e këtyre detyrimeve.

Masat shtërnguese të marra për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara dhe arkëtimet gjatë vitit 2023 paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. Masat shtërnguese ne Rajonin Verior

Në mijë lekë

DREJTORIA E MBLEDHJES SË DETYRIMEVE TATIMORE TË PAPAGUARA RAJONI VERIOR							
Nr.	LLOJET E MASAVE SHTRËNGUESE	Të		Të		Të	
		Vendosura		Arkëtuara		Liruara	
		nr.raste	Shuma	nr.raste	Shuma	nr.raste	shuma e masës shtërnguese
1	Njoftim dhe kërkesë për të paguar	2,364	7,418,060	54	110,681	0	-
2	Urdhër bllokim të llogarive bankare	2,111	9,190,057	51	41,084	29	21,967
3	Urdhër ekzekutime	337	165,859	-	-	-	-
4	Njoftim i përgjithshëm për vendosjen e barrës hipotekore dhe siguruese	1,195	9,711,706	-	-	106	80,340

5	Njoftim tatimpaguesit për vendosjen e barrës hipotekore dhe siguruese	1,195	9,711,706	-	-	106	80,340
6	Njoftim për vendosjen e barrës hipotekore	1,195	9,711,706	-	-	97	75,116
7	Njoftim për vendosjen e barrës siguruese	1,195	9,711,706	-	-	97	75,116
8	Urdhër sekuestrimi	-	-	-	-	35	28,670
9	Njoftim transferimi detyrimi tatimor palës së tretë	-	-	-	-	-	-
10	Njoftim dhe kërkesë për të paguar nga palët e treta në zbatim të nenit 98	-	-	-	-	-	-
11	Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionerit, Administratorit	-	-	-	-	-	-
12	Kërkesë për pezullim të aktivitetit në Doganë	865	8,159,715	48	76,481	55	44,390
13	Njoftim për vendosjen e masës së sigurimit tatimor në QKB	602	8,120,799	2	794	2	5,866
14	Konfiskim I 50% te xhiros ditore (URDHER PUNE)	46	40,605	37	6,134	-	-
15	Konfiskim I 50% te xhiros ditore(njoftime)	1,064	1,162,209	1518	443,100	-	-
Total		12,169	73,104,128	1710	678,274	527	411,805

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Siç vërehet edhe nga tabela rezulton se në Rajonin Verior masa shtrënguese që është përdorur më shumë është “Njoftim dhe kërkesë për të paguar” për 2,364 raste dhe Urdhër bllokim të llogarive bankare për 2,111 raste dhe nuk ka përdorur në asnjë rast masën shtrënguese “Urdhër sekuestrimi”, “Njoftim transferimi detyrimi tatimor palës së tretë”, “Njoftim dhe kërkesë për të paguar nga palët e treta në zbatim të nenit 98”, “Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionerit, Administratorit”. Kërkesa për pezullim të aktivitetit në Doganë është përdorur për 865 raste.

Tabela nr. 37 Masat shtrënguese në Rajonin DTM

Në mijë lekë

DREJTORIA E MBLEDHJES SË DETYRIMEVE TATIMORE TË PAPAGUARA RAJONI DTM							
Nr.	LLOJET E MASAVE SHTRËNGUESE	Të		Të		Të	
		Vendosura		Arkëtuara		Liruara	
		nr.raste	Shuma	nr.raste	shuma	nr.raste	shuma e masës shtrënguese
1	Njoftim dhe kërkesë për të paguar	2155	7,076,031	1899	4,507,834	-	-
2	Urdhër bllokim të llogarive bankare	236	9,277,997	172	1,451,140	150	1,314,475
3	Urdhër ekzekutime	131	599,862	78	280,550	3	207,486
4	Njoftim i përgjithshëm për vendosjen e barrës hipotekore dhe siguruese	10	4,987,033	-	-	-	-
5	Njoftim tatimpaguesit për vendosjen e barrës hipotekore dhe siguruese	3	60,421	-	-	-	-
6	Njoftim për vendosjen e barrës hipotekore	3	19,391	-	-	-	-
7	Njoftim për vendosjen e barrës siguruese	6	57,006	-	-	-	-
8	Urdhër sekuestrimi	-	-	-	-	-	-
9	Njoftim transferimi detyrimi tatimor palës së tretë	-	-	-	-	-	-
10	Njoftim dhe kërkesë për të paguar nga palët e treta në zbatim të nenit 98	9	89,652	-	-	-	-
11	Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionerit, Administratorit	-	-	-	-	-	-
12	Kërkesë për pezullim të aktivitetit në Doganë	23	2,033,061	6	46,610	6	74,390

13	Njoftim për vendosjen e masës së sigurimit tatimor në QKB	16	5,110,818	4	9,758	4	9,758
Total		2,592	29,311,272	2,159	6,295,892	163	1,606,109

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Siç vërehet edhe nga tabela nga të dhënat për Rajonin DTM, masa shtrënguese që është përdorur më shumë është “Njoftim dhe kërkesë për të paguar” për 2155 raste dhe 236 raste dhe nuk ka përdorur në asnjë rast masën shtrënguese “Urdhër sekuestrimi”, “Njoftim transferimi detyrimi tatimor palës së tretë”, “Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionarit, Administratorit”. Kërkesa për pezullim të aktivitetit në Doganë është përdorur për 23 raste.

Tabela nr. 38 Masat shtrënguese në Rajonin Jugor

Në mijë lekë

DREJTORIA E MBLEDHJES SË DETYRIMEVE TATIMORE TË PAPAGUARA RAJONI JUGOR							
Nr.	LLOJET E MASAVE SHTRËNGUESE	Të Vendosura		Të Arkëtuara		Të Liruara	
		nr.raste	shuma	nr.raste	shuma	nr.raste	shuma e masës shtrënguese
1	Njoftim dhe kërkesë për të paguar	3,311	3,140,790	1,810	1,009,266	-	-
2	Urdhër bllokim të llogarive bankare	2,159	2,647,144	1,184	1,010,393	342	106,120
3	Urdhër ekzekutime	158	59,976	158	59,976	4	1,819
4	Njoftim i përgjithshëm për vendosjen e barrës hipotekore dhe sigurose	690	1,102,603	-	-	-	-
5	Njoftim tatimpaguesit për vendosjen e barrës hipotekore dhe sigurose	1,791	2,475,109	62	30,487	-	-
6	Njoftim për vendosjen e barrës hipotekore	1,872	2,457,954	62	30,868	51	23,786
7	Njoftim për vendosjen e barrës sigurose	1,720	2,322,849	209	113,263	111	50,627
8	Urdhër sekuestrimi	-	-	-	-	-	-
9	Njoftim transferimi detyrimi tatimor palës së tretë	-	-	-	-	-	-
10	Njoftim dhe kërkesë për të paguar nga palët e treta në zbatim të nenit 98	2	923	-	-	-	-
11	Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionerit, Administratorit	-	-	-	-	-	-
12	Kërkesë për pezullim të aktivitetit në Doganë	931	1,143,654	177	78,836	41	18,651
13	Njoftim për vendosjen e masës së sigurimit tatimor në QKB	158	616,783	12	3,908	1	403
14	Konfiskim I 50% te xhiros ditore	10	3,689	3	857	-	-
Total		12,802	15,971,474	3,677	2,337,854	550	201,406

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Siç vërehet edhe nga tabela për Rajonin Jugor, masa shtrënguese që është përdorur më shumë është “Njoftim dhe kërkesë për të paguar” për 3,311 raste dhe “Urdhër bllokim të llogarive bankare” për 2,159 raste si dhe nuk ka përdorur në asnjë rast masën shtrënguese “Urdhër sekuestrimi”, “Njoftim transferimi detyrimi tatimor palës së tretë”, “Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionerit, Administratorit”. Kërkesa për pezullim të aktivitetit në Doganë është përdorur për 931 raste.

Tabela nr. Masat shtrënguese në Rajonin Qendror

Në mijë lekë

DREJTORIA E MBLEDHJES SË DETYRIMEVE TATIMORE TË PAPAGUARA RAJONI QENDROR							
Nr.	LLOJET E MASAVE SHTRËNGUESE	Të Vendosura		Të Arkëtuara		Të Liruara	
		nr.raste	Shuma	nr.raste	shuma	nr.raste	shuma e masës shtrënguese
1	Njoftim dhe kërkesë për të paguar	27,390	106,550,021	4,896	5,642,746	-	-
2	Urdhër bllokim të llogarive bankare	26,916	109,836,839	6,060	8,185,793	5,208	-
3	Urdhër ekzekutime	2,914	757,610	2,914	775,710	-	-

4	Njoftim i përgjithshëm për vendosjen e barrës hipotekore dhe siguruese	-	-	-	-	-	-
5	Njoftim tatimpaguesit për vendosjen e barrës hipotekore dhe siguruese	18,923	138,971,679	2,525	2,516,449	-	-
6	Njoftim për vendosjen e barrës hipotekore	-	-	43	36,662	46	-
7	Njoftim për vendosjen e barrës siguruese	541	34,326,185	103	151,823	112	-
8	Urdhër sekuestrimi	-	-	-	-	-	-
9	Njoftim transferimi detyrimi tatimor palës së tretë	-	-	-	-	-	-
10	Njoftim dhe kërkesë për të paguar nga palët e treta në zbatim të nenit 98	-	-	-	-	-	-
11	Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionerit, Administratorit	-	-	-	-	-	-
12	Kërkesë për pezullim të aktivitetit në Doganë	1,107	85,068,753	120	462,123	143	-
13	Njoftim për vendosjen e masës së sigurimit tatimor në QKB	12,637	109,122,971	422	1,172,067	436	-
14	Konfiskim I 50% te xhiros ditore						
Total		90,428	584,634,058	17,083	18,943,373	5,945	-

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Sic vërehet edhe nga tabela nga të dhënat për Rajonin Qendror, masa shtrënguese që është përdorur më shumë është “Njoftim dhe kërkesë për të paguar” për 27,390 raste dhe “Urdhër bllokim të llogarive bankare” për 29,916 raste si dhe nuk ka përdorur në asnjë rast masën shtrënguese “Urdhër sekuestrimi”, “Njoftim transferimi detyrimi tatimor palës së tretë”, “Njoftim dhe kërkesë për të paguar nga palët e treta në zbatim të nenit 98”, “Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionerit, Administratorit”, “Njoftim i përgjithshëm për vendosjen e barrës hipotekore dhe siguruese”. Nga sa më sipër rezulton se nuk janë përdorur të gjithë masat shtrënguese në rajone për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara sipas legjislacionit tatimor dhe se këto masa të marra se kanë përmbyshur njaftueshëm misionin e tyre. Kërkesa për pezullim të aktivitetit në Doganë është përdorur për 1,107 raste.

Nga auditimi ka rezultuar se:

Gjendja e detyrimeve tatimore të papaguara në fillim të vitit 2023 paraqitet në vlerën rreth 146,767 milion lekë që i përket një numri prej 182,490 subjektsh debitore, dhe në fund të vitit 2023 këto detyrime rezultojnë në vlerën rreth 155,165 milion lekë që i përket një numri prej rreth 181,023 subjektsh debitore. Detyrimet e shtuara gjatë vitit 2023 janë 40 miliard lekë ose afërsisht 3 miliard lekë më shumë krahasuar me vitin 2022, ku detyrimet e shtuara ishin 37 miliard lekë. Arkëtimet paraqiten në vlerën 31 miliard lekë, krahasuar më vitin paraardhës ku arkëtimin ishin 24 miliard lekë, këtë vit janë mbledhur afërsisht 7 miliard lekë më shumë.

Referuar subjekteve në proces gjyqësor rezultojnë 1,401 subjekte me detyrim total 13 miliard lekë. Krahasuar me vitin 2022 janë rreth 10 subjekte më shumë me një vlerë të detyrimeve të papaguara të ankimuar në gjykatë prej rreth 901 milion lekë më shumë.

Referuar moshës së detyrimeve të papaguara në vitin 2023 vërehet se peshën më të madhe të stokut të detyrimit sipas moshës e zënë detyrimet me moshë borxhi detyrimet mbi 5 vite të cilat zënë rreth 55 % të total detyrimit, nga 2-5 vite me peshë 27 %, nga 1- 2 vite zënë 8 %, nga 6-12 muaj zënë 4 %, detyrimet deri në 3 muaj zënë 3 % dhe në fund 2 % e zënë detyrimet 3 -6 muaj. Krahasuar me vitin e kaluar uljen më të lartë të detyrimit tatimor e ka pësuar detyrimet 1- 2 vite në vlerën 3 miliard lekë dhe rritjen më të madhe detyrimet mbi 5 vite në vlerën 13 miliard lekë.

Subjekte me status Aktive janë në numër 64,476 ose 36 % e total numrit të subjekteve debitore, me vlerë detyrimi 40.8 miliard lekë ose 26 % e total detyrimit të papaguar.

Subjektet me status Pasive janë numër 115,547 subjekte ose 63.8 % mbi numrin gjithsej të subjekteve, me vlerë 114 miliard lekë ose 74 % mbi total detyrimin e papaguar.

Për sa i përket gjendjes së stokut të detyrimeve të papaguara në afat sipas llojit të tatimit, rezulton se zëri TVSH me peshën më të madhe në stokun e detyrimeve të papaguara në afat,

36% me një vlerë prej rreth 55.2 milion lekë, ndjekur nga Tatim Fitimi me 29% ose në vlerën prej rreth 44,7 milion lekë, e më pas zëri “Të Tjera” me 15 % ose në vlerën prej rreth 23,9 milion lekë, zëri Sigurimet Shoqërore & Shëndetësore me 15 % ose në vlerën prej rreth 22,5 milion lekë., dhe zëri Tatim ne Burim me rreth 4 %, ose në vlerën prej rreth 5,8 milion lekë. Rajoni Qendror ka detyrimet më të larta krahasuar me rajonet e tjera për të gjitha llojet e tatimeve ku është llogaritur detyrimi+ gjoba+ interesi. Duke ju referuar gjobave të llogaritura sipas llojit të tatimit, gjobat e llogaritura mbi TVSH- n në vlerën 21,061 mijë lekë zënë pjesën më të madhe të detyrimeve duke u pasuar nga gjobat e llogaritura mbi Tatim Fitimin në vlerën 15,258 mijë lekë. Në total për të gjithë rajonet, principali i detyrimeve tatimore të akumuluar përbën rreth 61 % të vlerës totale të detyrimeve tatimore, për t’u ndjekur më pas nga penalitetet (gjobat) me 33 % dhe 6 % kamatëvonesat (interesat).

Detyrimet e papaguara të sigurimeve shoqërore për vitin 2023 janë në vlerën 22,509 milion lekë nga të cilat 21,316 milion lekë, ose 95 % e vlerës i përkasin subjekteve private dhe 1,192 milion lekë, ose 5 %.

Numri i subjekteve, në fund të vitit 2023 të cilat rezultojnë me detyrime tatimore të papaguara arrin në 181,023 subjekte, në vlerën 155,165,408 mijë lekë. Masat shtrënguese në të gjitha rajonet janë marrë për 117,991 raste, të cilat janë edhe të përsëritura për një subjekt disa here gjatë vitit. “Urdhri i bllokimit të llogarive bankare”, i cili pas “Njoftim dhe kërkesë për të paguar” është masa më e përdorur si masë shtrënguese është nisur për 31,422 raste për të gjitha rajonet. Masat shtrënguese të marra janë të pakta duke marrë parasysh numrin e subjekteve debitore dhe se këto masa shtrënguese janë për numër rastesh, masa të përsëritura për të njëjtat subjekte. Duke mos marrë masat e duhura shtrënguese rritet vështirësia e mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në:

Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar, KREU XI, “Mbledhja me force e detyrimit tatimorë i papaguar”, neni 88” Autoriteti dhe kompetencat për të mbledhur detyrimin tatimorë të papaguar”,

Ligjin nr. 9928, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”

Udhëzimin nr.24 datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar dhe Manualin, në seksionin 3.3.2 “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor”

Sipas anekseve shoqëruese të Pasqyrave Financiare, gjendja e debitorëve në fund të periudhës në auditim, gjendja e detyrimeve me 31.12.2023, jashtë sistemit C@TS, paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. Detyrimi tatimor i papaguar jashtë sistemit c@ts

Në lekë

Emërtimi	Detyrimet jashtë sistemit C@TS, 31.12.2020	Detyrimet jashtë sistemit C@TS, 31.12.2021	Detyrimet jashtë sistemit C@TS, 31.12.2022
Tatim mbi te ardhurat personale	58,993,901.00	56,844,018	4,542,205
Tatim mbi fitimin	2,772,290.00	2,772,290	1,945,256
Deklarata Individuale Vjetore e të Ardhurave (DIVA)			
Takse e tatim mbi biznesin e vogël	63,750.00	63,750	1,017,655
Tjera tatime	17,556,858.00	18,655,210	12,754,490
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar(TVSH)	10,609,113.00	10,609,113	6,194,564
Akciza	2,107,792,556.00	2,107,792,556	2,106,993,328
Taksa e rrugës	165,000.00	165,000	165,000
Gjoba dhe kamatvonesa,sekuestrime e zhdëmtime	10,113,513.00	10,113,513	10,113,513
Sigurime shoqërore e shëndetësore	217,302,943.00	213,798,546	208,922,741
Sigurime shoqërore	178,924,414.00	175,781,514	171,565,365

Kontribute shoqërore te punësuar (punëmarrës)	148,345,324.00	105,016,303	77,419,400
Kontribute shoqërore punëdhënës	30,579,090.00	70,765,211	94,145,965
Sigurime shëndetësore	38,378,529.00	38,017,032	37,357,376
Kontribute shëndetësore te punësuar (punëmarrës)	34,031,663.00	35,524,103	29,601,812
Kontribute shëndetësore punëdhënës	4,346,866.00	2,492,929	7,755,564
Të tjera	60,562,530.00	3,468,220	
Shtypshkrime	1,144,724.00	861,694	
1 % Grante	1,273,976.00	1,593,423	1,076,062
Pulla (me çmim blerje)	321,467,297.00	288,222,896	
Totali	2,809,818,452	2,714,960,228	2,353,724,814

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Referuar të dhënave të mësipërme, rezulton se Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka një vlerë detyrimi tatimor të papaguar jashtë sistemit C@TS në vlerën 2,351,817,199 lekë, i cili paraqiten me ulje krahasuar me vitin paraardhës në vlerën 1,907,615 lekë. Sipas informacionit të dhënë, situata e debitorëve jashtë këtij sistemi është në kontabilitetin e DR Tatimore dhe përbën detyrime të krijuara para vitit 2015, që i përkasin kohës kur jo te gjitha deklaratat tatimore ishin te informatizuara apo situatës për sigurime shoqërore e shëndetësore para se të kalonin ne ndjekje e administrim nga Administrata Tatimore si agjent tatimorë.

Në zbatim të Urdhrit Nr. 209, datë 06.12.2023 “Për trajtimin e problemeve të identifikuar nga grupi i punës në DPT lidhur me detyrimeve tatimore të papaguara jashtë sistemit c@ts” nga titullari i institucionit, pranë DPT është ngritur grupi i punës, i cili ka trajtuar problematikën në bashkëpunim me DRT. Grupi i punës përbëhet nga: P. K. (Kryetar), F. H. (Anëtare), L. T. (Anëtare), A. B. (Anëtare). Në këtë urdhër është përcaktuar afati i realizimit të detyrave nga grupi i punës deri me datë 10.04.2024. Pas verifikimit të situatës dhe informacionit analitikë të marrë nga DRT, me anë të Memos nr. 5445/45 prot., datë 09.04.2024 është dërguar relacioni përmbledhës mbi veprimtarinë e grupit të punës tek Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve. Grupi i punës ka përshkruar arsyet për të cilat nuk ekziston mundësia e hedhjes në sistem ndër të cilat subjekte të paidentifikuar me Nipt/ Nid apo adresë, me status ç’regjistruar, nuk ka modul në sistem. Pjesën me te madhe në këto detyrime e zë akciza e cila i përket kohës para vitit 2012, kur kjo lloj e ardhure deklarohet dhe paguhej në Administratën Tatimore, ndërkohë që tani arkëtohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Ky detyrim akcize prej 2,106,993,328 lekë i përket vetëm 1 tatimpaguesi, “A.” SHA me Nipt J.....D, sipas informacionit nuk mund të hidhet në sistem pasi nuk ka modul në sistem. Po e njëjta situatë paraqitet edhe për 1 subjekt me detyrime të taksës së solidaritetit në vlerën 165,000 lekë për të cilën nuk ekziston mundësia e hedhjes në sistem duke qenë se s’ka modul në sistem. Diferenca tjetër përfaqëson detyrim të ndryshime të papaguara të akumuluar ndër vite për disa subjekte që nuk kanë qenë të regjistruar në sistemin tatimor. Rezultojnë subjekte pa Nipt ose që nuk kanë gjeneralitet e mjaftueshme për tu regjistruar në sistem, subjektet me status PASIV/C’regjistruar. Vlerën më të lartë të detyrimeve pas akcizës e zënë sigurimet shoqërore dhe shëndetsore.

Tabela nr. Detyrimi jashtë sistemit c@ts sipas llojit të tatimit

Në lekë

Lloji i Tatimit	Detyrimi Total 2022
TF	1,945,256
TVSH	6,194,564
Sigurimet Shoqërore dhe Shendetsore	208,928,741
TAP	4,542,205
Tatimi mbi Te ardhurat personale te Biznesit te Vogël	1,017,655
Tatime te tjera	12,754,490
Taksa e rrugës	165,000
Grante 1 %	1,070,062
Gjoha sekuestrimi	10,113,513
Total	246,731,486

Akciza	2,106,993,328
Shuma totale	2,353,724,814

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Tabela nr. Detyrimi jashtë sistemit c@ts sipas DRT- ve dhe llogaritje detyrim+ gjobe+ interes

Drejtoria Rajonale	31.12.2023	Detyrim	Gjobe	Interes
DRT Diber	48,918,116	48,759,316	158,800	
DRT Durrës	66,864,339	66,831,083		33,256
DRT Elbasan	181,269	147,458		33,811
DRT Fier	4,766,573	1,774,460	2,200,943	791,170
DRT Gjirokaster	14,593,722	5,726,924	6,776,998	2,089,800
DRT Korçë	8,793,914	8,393,281	363,020	37,613
DRT Kukës	42,666,392	42,666,392		
DRT Sarande	18,864,267	16,188,623	1,900,617	775,027
DRT Shkodër	11,913,051	6,933,338	3,836,227	1,143,486
DRT Tirane	2,133,277,218	2,119,525,822	13,058,611	692,785
DRT Vlore	2,573,200	273,200	2,300,000	
Totali	2,353,412,061	2,317,219,897	30,595,216	5,596,948
Zbritur taksa e rrugës, grande 1 %, gjoba sekuestrimi të cilat ngelen ne kontabilitet	11,348,575	11,348,575		
Detyrimi i mbetur	2,342,063,486	2,305,871,322	30,595,216	5,596,948

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Drejtoritë rajonale kanë vënë në dispozicion listat analitike me problematikat përkatëse. Vlera e detyrimeve duke ju referuar të dhënave nga grupi i punës është 2,353,412,061 lekë, vlera e mbetur i përket Drejtorisë së Kontabilitetit.

Për ndjekjen e procedurës të hedhjes së detyrimeve në sistemin c@ts, janë krijuar grupe pune në DPT por nuk është përfunduar nga të gjitha drejtoritë rajonale, duke lënë me detyrime jashtë sistemit. Nga çfarë analizuar për situatën për secilën drejtori rajonale grupi ka konstatuar se:

- Nuk ekziston mundësia e hedhjes në sistem për këto detyrime për 924 subjekte në masën 36 % ose 89,249,785 lekë, të vlerës totale të DRT- ve 2,353,412,061 lekë, duke përjashtuar nga vlera totale detyrimin tatimor për 1 subjekt në vitin 2010 në përgjegjësinë Akcizë në vlerën 2,106,993,328 lekë të DRT Tiranë për të cilën nuk ka modul për hedhjen e saj dhe e cila është në juridiksion të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe vlerën 165,000 lekë për 1 subjekt i cili paraqitet me detyrime të taksës së solidaritetit për të cilin po ashtu nuk ka modul në sistem.
- Ekziston mundësia teknike që Drejtoritë Rajonale përkatëse të kryejë procesin e hedhjes së detyrimeve në sistem në total për 775 subjekte në vlerën 150,192,552 lekë dhe 6 individë në vlerën 5,176,509 për:
 - a) DRT Tiranë, për 13 subjekte në vlerën 25,218,532 lekë kontabilizuar në periudhën 2009-2013, drejtoria përkatëse raporton se nuk ka dokumentacion të tërhequr nga arkiva për hedhjen e tyre në sistem.
 - b) DRT Kukës, për 81 subjekte në vlerën 27,641,090 lekë kontabilizuar në periudhën 2009-2013, drejtoria përkatëse po vazhdon procesin e hedhjes.
 - c) DRT Durrës, për 121 subjekte në vlerën 47,140,680 lekë (me status aktiv subjekte me vlerë 5,167,718 lekë dhe me status Pasiv janë 105 subjekte me vlerë 41,972,962 lekë), janë të regjistruar dhe kanë përgjegjësi tatimore, jashtë sistemit ka lindur në periudhat para se të regjistroheshin.
 - d) DRT Diber, për 509 subjekte në vlerën 38,251,122 lekë, janë në proces hedhje si dhe për 16 subjekte në vlerën 10,594,766 lekë me status ligjor Ente Publike.

e) DRT Korçë, për 2 subjekte, Ente Publike në vlerën 42,269 lekë; për 6 subjekte, individë me detyrime tatimore të DIVA në vlerën 5,176,509 lekë, nuk kanë përgjegjësi të çelura në sistem, 1 person i vdekur; për 11 nipte në vlerën 360,827 lekë të cilat rezultojnë me status aktiv/ pasiv, me detyrime në periudha para regjistrimit të subjektit në sistemin tatimor; si dhe për 22 nipte në vlerën 943,266 lekë detyrimi mund të hidhet në sistem në periudhën e parë për të njëjtën përgjegjësi tatimore të çelur.

- DRT Korçë, 2 subjektet në vlerën 233,854 lekë, rezultojnë të hedhura në sistem Në kontabilitet ka ngelur që nga viti 1999 ku u vendos një taksë për ndërtimin e rrugës, grande 1 %, gjoja sekuestrimi në vlerën 11,348,575.


Tabela nr. Detyrimi jashtë sistemit c@ts sipas llojit të tatimit sipas DRT- ve

	Totali i DRT- ve	Sipas grupit te punës	Diferenca
DRT FIER	4,766,573	4,766,573	0
DRT SARANDE	18,864,267	18,864,267	0
DRT SHKODER	11,913,052	11,913,051	-1
DRT VLORE	2,573,200	2,573,200	0
DRT TIRANE	2,132,376,860	2,133,277,218	900,358
DRT GJIROKASTER	14,593,722	14,593,722	0
DRT KORCE	8,312,778	8,793,914	481,136
DRT DURRES	66,864,359	66,864,339	-20
DRT DIBER	48,898,556	48,918,116	19,560
DRT ELBASAN	181,269	181,269	0
DRT KUKES	42,666,392	42,666,392	0
Tot.	2,352,011,028	2,353,412,061	1,401,033

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Grupi auditues ka analizuar të dhënat e tabelës me vlera sipas DRT- ve me listat analitike të paraqitura në Memo ku rezulton se ka një diferencë në vlerën 1,401,033 lekë. Po ashtu rezulton se procesi i hedhjes së këtyre detyrimeve në sistem nuk është kryer dhe se grupi ka kryer vetëm konstatimin e tyre nëse ekziston ose jo mundësia e hedhjes në sistem pa dhënë asnjë rezultat në zgjidhjen e tyre.

Detyrimi tatimor jashtë sistemit c@ts- Memo



Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Në totalin e detyrimit tatimor jashtë sistemit c@ts grupi i punës ka konstatuar se nga vlera totale 93 % e subjekteve nuk mund të hidhen në sistem dhe vetëm 7 % e subjekteve kanë mundësi hedhje duke bashkëpunuar me sektorin e tyre juridik Drejtoria Rajonale përkatëse.

Tab. Detyrimet tatimore te subjekteve tatimore jashtë sistemit c@ts që nuk mund të hidhen në sistem

Arsyet	Vlera	Nr. Subjekte
Nuk jane te identifikuar me Nipt/ Nid apo adrese	46,438,303.00	695
Kaluar ne status Pasiv	33,226,330.00	134
Me status ç'regjistruar	9,585,152.00	95
Mungon moduli ne sistem	2,107,158,328.00	2
Totali	2,196,408,113.00	926.00

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Nga auditimi ka rezultuar se:

Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve ka një vlerë detyrimi tatimor të papaguar jashtë sistemit C@TS në vlerën 2,351,817,199 lekë. Bazuar në Urdhrin Nr. 209, datë 06.12.2023 “Për trajtimin e problemeve të identifikuar nga grupi i punës në DPT lidhur me detyrimeve tatimore të papaguara jashtë sistemit c@ts” është ngritur grupi i punës i cili ka identifikuar mundësinë dhe pamundësinë e hedhjes në sistem. Grupi i punës ka përshkruar arsyet për të cilat nuk ekziston mundësia e hedhjes në sistem ndër të cilat subjekte të paidentifikuar me Nipt/ Nid apo adresë, me status ç’regjistruar, nuk ka modul në sistem. Nuk ekziston mundësia e hedhjes në sistem për këto detyrime për 924 subjekte në masën 36 % ose 89,249,785 lekë, të vlerës totale të DRT- ve 2,353,412,061 lekë, duke përfshiruar nga vlera totale detyrimin tatimor për 1 subjekt në vitin 2010 në përgjegjësinë Akcizë në vlerën 2,106,993,328 lekë të DRT Tiranë për të cilën nuk ka modul për hedhjen e saj dhe e cila është në juridiksion të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe vlerën 165,000 lekë për 1 subjekt i cili paraqitet me detyrime të taksës së solidaritetit për të cilin po ashtu nuk ka modul në sistem. Ekziston mundësia teknike që Drejtoritë Rajonale përkatëse të kryejë procesin e hedhjes së detyrimeve në sistem në total për 775 subjekte në vlerën 150,192,552 lekë dhe 6 individë në vlerën 5,176,509 lekë. Në kontabilitet ka ngelur që nga viti 1999 ku u vendos një taksë për ndërtimin e rrugës, grande 1 %, gjoba sekuestrimi në vlerën 11,348,575. Në totalin e detyrimit tatimor jashtë sistemit c@ts grupi i punës ka konstatuar se nga vlera totale 93 % e subjekteve nuk mund të hidhen në sistem dhe vetëm 7 % e subjekteve kanë mundësi hedhje duke bashkëpunuar me sektorin e tyre juridik Drejtorja Rajonale përkatëse. Mangësitë e identifikuar në drejtim të hedhjes në sistem të këtyre detyrimeve si edhe mungesa e moduleve në sistem për hedhjen e detyrimeve. Ekzistenca e detyrimeve tatimore jashtë sistemit aktual sjell mangësi në raportimin e të dhënave lidhur me debitorët për sa kohë mbahen jashtë sistemit; gjendja e lartë e detyrimeve tatimore jashtë sistemit sjell vështirësi në arkëtimin dhe monitorimin e procesit të ndjekjes me forcë të borxhit tatimor nga DRT dhe DPT. Gjendja e lartë e detyrimeve tatimore jashtë sistemit sjell vështirësi në arkëtimin dhe monitorimin e procesit të ndjekjes së mbledhjes me forcë të borxhit tatimor nga DRT dhe DPT.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në:

Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, KREU XI, “Mbledhja me force e detyrimit tatimorë i papaguar”, neni 88” Autoriteti dhe kompetencat për të mbledhur detyrimit tatimorë të papaguar”,

Ligjin nr. 9928, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”

Urdhrin e brendshëm nga titullari i DPT, Nr. 209, datë 06.12.2023 “Për trajtimin e problemeve të identifikuar nga grupi i punës në DPT lidhur me detyrimeve tatimore të papaguara jashtë sistemit c@ts”.

Për veprime dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi N. Xh. në pozicionin Drejtor, Drejtorja e Mbledhjes Detyrimit Tatimore të papaguara për vitin 2023 dhe C. K. në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 13085/20, datë 02.08.2024, protokolluar në KLSH me nr. 473/3 Prot., datë

05.08.2024, nga z. E. M., Drejtor i Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, ku është shprehur si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Administrata Tatimore në funksion të maksimalizimit të mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara me qëllim arkëtimin e tyre, në funksion të uljes së stokut të borxhit është angazhuar maksimalisht dhe në gjetjen e zgjidhjeve të përshtatshme për borxhet e vjetra. Në funksion të ezaurimit të gjitha masave shtrënguese, Administrata Tatimore në bashkëpunim me institucionet ndërvepruese po merr të gjitha masat e nevojshme në garantimin e efikasitetit të masave shtrënguese.

Në zbatim të Planit të Masave të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve “Për zbatimin e Rekomandimeve të KLSH-së” është ngritur grupi i punës me Urdhrin Nr. 209 Prot., datë 06.12.2023, “Për marrjen e masave në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale Tatimore si dhe Drejtoritë e Kontrollit Tatimor pranë DRT-ve për hedhjen në sistem të detyrimeve tatimore për të cilat ka module përkatëse, si dhe propozimin e zgjidhjeve për rastet e tjera”.

Në përfundim të detyrave të lëna sipas këtij urdhri, grupi i @nës ka hartuar Memon nr. 5449/45, date 09.04.2024. Lidhur me listën e subjekteve të identifikuar si të mundshme për tu hedhur në sistemin tatimor, në xijim DPT në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale Tatimore do të ndjekë në mënyrë të vazhdueshme të gjithë procesin. Koha për realizimin e këtij procesi do të jetë në varësi të punës apo ngarkesës së Drejtorisë Rajonale Tatimore sipas planifikimit që do të kryejnë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi auditues i qëndron konstatimeve mbi mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara nga DMDTP.

2.4 Mbi deklarimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, arkëtimi dhe rakordimi me ISSH dhe FSDKSH

Në zbatim të pikës nr. 4, të Programit të Auditimit nr. 473/1, datë 15.04.2024, ndryshuar me shkresën nr. 473/2 prot., datë 18.07.2024, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Detajimi i “Planit të të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” në zbatim të ligjit 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”;
- Planifikimi, realizimi dhe monitorimi i të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore (ISSH);
- Planifikimi, realizimi dhe monitorimi i të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shëndetësore (FSDKSH);

- Dërgimi në ISSH, të listëpagesave me të dhëna statistikore dhe të kontributeve të paguara. Në zbatim të nenit 4 dhe 14, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Administrata Tatimore Qendrore është e ngarkuar për administrimin e tatimeve, taksave dhe kontributeve në nivel kombëtar në rolin e agjentit tatimor që mbledh dhe transferon në buxhetin e shtetit tatimet dhe taksat. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është autoriteti tatimor qendror i vetëm në Republikën e Shqipërisë, që zbaton dhe administron tatimet kombëtare, pagesat publike dhe mbledhjen e kontributeve. Të ardhurat nga kontributet, nënkuptojnë të ardhurat nga pagesat për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Mbi planifikimin, realizimin dhe monitorimin e të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

-“Plani i të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” në zbatim të ligjit 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, është detajuar me shkresën nr. 2703 prot., datë 08.02.2023 të MFE, protokolluar në DPT me nr. 2028 prot., datë 10.02.2023. Referuar kësaj shkrese, plani i të ardhurave për ISSH dhe FSDKSH për vitin 2023, është në vlerën **123,800,000 mijë lekë**.

-Me shkresën nr. 19768 prot, datë 30.10.2023 të MFE, është dërguar në DPT, Akti Normativ nr. 5, datë 18.10.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”. Nga auditimi u konstatua se plani i të ardhurave është në vlerën **139,900,000 mijë lekë**, në rritje krahasuar me planifikimin fillestar me 16,100,000 mijë lekë ose në masën 1.13 %.

Tabela në vijim paraqet në mënyrë të përmbledhur planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, të cilat mbliidhen nga DPT, për llogari të ISSH dhe FSDKSH.

Tabela nr. 1 Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore

në 000/lekë

Emërtimi	Realizimi Faktik 2023	Plani 2023 referuar Ligjit 84/2022 të Buxhetit	Plani 2023 sipas Aktit Normativ nr. 5, datë 18.10.2023	Diferenca	%
Kontribute	1	2	3	4= 3-2	5
Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	139,254,918	123,800,000	139,900,000	16,100,000	1.13%

Burimi: Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

DPT në të ardhurat e kontributeve për vlerën **139,254,918 mijë lekë**, ka përfshirë:

1. Të ardhurat tatimore gjithsej nga kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të konfirmuara në shumën **138,206,961 mijë lekë**. Me shkresën nr. 1671 prot., datë 25.01.2024, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve i ka dërguar Degës së Thesarit Tiranë, “Evidencën e të Ardhurave Tatimore dhe Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore, për periudhën 01 Janar - 31 Dhjetor 2023”;

2. Të ardhurat nga kamat vonesa të kontributeve dhe gjodat për punëdhënësit në vlerën **858,842 mijë lekë**;

3. Depozitimet e përkohshme (llog. 4665510), në vlerën **189,115 mijë lekë**, të cilat lidhen me kontributet dhe me tatimin mbi të ardhurat personale.

Nga auditimi mbi saktësinë e mbledhjes dhe raportimit të të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të cilat mbliidhen në DPT, u konstatua se për efekt raportimi, DPT përfshin si të ardhur nga kontributet edhe të ardhurat nga gjodat për deklarim të vonuar të kontributeve dhe TAP, gjoda për mosdeklarim punonjësish dhe depozitime të përkohshme për listëpagesën e kontributeve dhe TAP, në vlerën totale për 391,853 mijë lekë, vlerë e cila nuk është e përfshirë si e ardhur në raportimet që bëhen në ISSH dhe FSDKSH, referuar shkresave mbi treguesit e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për vitin 2023, veprim ky i cili ka sjellë mosraportim të saktë të të ardhurave nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në Raportin vjetor të DPT, si dhe në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime të udhëzimit nr. 8, datë 09.08.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, të MFE i cili citon: “Llogaria 70 ”Tatime dhe taksat dhe tatimet” Në këtë kategori përfshihen tatimet dhe taksat e mbledhura nga njësitë e qeverisjes qendrore (tatimet e taksat kombëtare) dhe të njëjve të vetëqeverisjes vendore, kamatëvonesat që lidhen me to, si dhe ato tarifa të vendosura nga këto dy qeverisje në kthim të të cilave nuk ka kosto. Ndërsa, gjodat që lidhen me tatimet dhe taksat janë përfshirë në të ardhurat jo tatimore”.

Tabela në vijim paraqet në mënyrë analitike llogaritë e të ardhurave të përfshira si e ardhur nga kontributet.

Tabela nr. 2 Të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore

në lekë

A	Llogaria	Përshkrimi	Shuma
		Të ardhurat nga kamat vonesat e gjodat	858,842,400
	7090101	Kamat vonesa të kontributeve të sig. shoqërore	175,697,301
	7090104	Kamat vonesa të kontributeve të sig. shëndetësore	29,781,386
	7115101	Gjoda të sigurimeve shoqërore nga punëdhënësi	385,458,471
	7115118	Gjoda të sigurimeve shëndetësore nga punëdhënësi	65,167,196
	7115119	Gjoda për mosdeklarim punonjësish	107,548,873
	7115654	Gjoda për deklarim të vonuar sig. shoq. shënd. dhe tap	95,189,173
B=1+2+3	75	Kontributet e Sigurimeve Gjithsej	138,206,960,766
1	750	Kontribute nga të punësuarit	52,633,153,958

	7500	Kontribute nga të punësuarit në sektorin buxhetor	19,293,264,022
	7500100	Sigurime shoqërore	14,721,210,506
	7500200	Sigurime shëndetësore	2,804,616,268
	7500400	Kontribut suplementar	1,767,437,248
1.1	7501	Kontribute nga të punësuarit në sektorin shtetëror	3,106,920,180
	7501100	Sigurime shoqërore	2,611,152,243
	7501200	Sigurime shëndetësore	481,799,572
	7501400	Kontribut suplementar	13,968,365
1.2	7502	Kontribute nga të punësuarit në sektorin privat	30,232,969,756
	7502100	Sigurime shoqërore	24,627,897,674
	7502200	Sigurime shëndetësore	5,533,505,294
	7502400	Kontribut suplementar	71,566,788
2	751	Kontribute nga punëdhënësi	80,552,793,714
2.1	7510	Kontribute nga punëdhënësi në sektorin buxhetor	26,776,983,093
	7510100	Sigurime shoqërore	23,958,225,467
	7510200	Sigurime shëndetësore	2,805,282,350
	7510400	Kontribut suplementar	13,475,276
2.2	7511	Kontribute nga punëdhënësi në sektorin shtetëror	4,618,711,659
	7511100	Sigurime shoqërore	4,121,590,941
	7511200	Sigurime shëndetësore	482,448,122
	7511400	Kontribut suplementar	14,672,596
2.3	7512	Kontribute nga punëdhënësi në sektorin privat	49,157,098,962
	7512100	Sigurime shoqërore	43,537,366,328
	7512200	Sigurime shëndetësore	5,532,524,791
	7512400	Kontribut suplementar	87,207,843
3	7520	Kontribute nga të vetëpunësuarit	5,021,013,094
	7520100	Sigurime shoqërore	3,873,577,479
	7520200	Sigurime shëndetësore	1,147,435,615
	4665510	Depozitime të përkohshme për listëpagesën	189,114,901
A+B		Shuma e Përgjithshme	139,254,918,067

Burimi: Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

Për sa më sipër, si dhe referuar Raportit të DPT për vitin 2023, të ardhurat nga kontributet janë raportuar në vlerën **139,254,918 mijë lekë**. Krahasuar me të ardhurat e mbledhura në vitin 2022, ato janë rritur në vlerën 20,789,746 mijë lekë ose në masën 17.6% më shumë. Tabela në vijim paraqet realizimin faktik të të ardhurave nga kontributet për periudhën 2021-2023.

Tabela nr. 3 Realizimi faktik të të ardhurave nga kontributet për periudhën 2021-2023 në 000/lekë

E M Ë R T I M I	Realizimi Faktik 2021	Realizimi Faktik 2022	Realizimi Faktik 2023
Të ardhura nga Kontributet e Sigurimeve	106,266,160	118,465,172	139,254,918

Burimi: Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

Nga auditimi u konstatua se, faktorët që kanë ndikuar në rritjen e të ardhurave nga kontributet për vitin 2023, krahasuar me vitin 2022 janë:

- Rritja e pagës minimale sipas VKM nr. 113, datë 01.03.2023 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, ku paga minimale është miratuar në nivelin 40,000 lekë nga 34,000 lekë, që ishte më parë dhe ka ndikuar në kufirin e poshtëm dhe në kufirin maksimal të deklarimit të kontributeve të sigurimeve, për pasojë kanë sjellë rritje të tyre.

- Rritja e pagës së administratës publike me VKM nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”.

- Si dhe rritja e numrit të të punësuarve. Këto ndryshime kanë dhënë efekt në rritjen e të ardhurave nga kontributet edhe në sektorin privat. Tabela në vijim paraqet numrin e të

punësuarve në total për vitin 2023, si dhe krahasimi me vitin 2022.

Tabela nr. 4 Numri i të punësuarve në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022

Viti	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2023	712,258	714,053	719,435	719,507	723,283	732,451	731,812	724,279	725,399	722,076	719,369	715,860
2022	695,400	697,468	702,544	703,820	709,634	718,939	718,982	713,115	712,804	709,291	709,377	706,803
2023 vs 2022	2.40%	2.40%	2.40%	2.20%	1.90%	1.90%	1.80%	1.60%	1.80%	1.80%	1.40%	1.30%

Burimi: Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

Sa më sipër, konstatohet se numri i të punësuarve në total për vitin 2023, ka qenë 1.9% më i lartë se në vitin 2022. Përçindje më e lartë e numrit të të punësuarve ka qenë në 3 muajt e parë të vitit, duke qëndruar konstante me 2.4%, por në muajt në vazhdim deri në fund të vitit rezultojnë me rënie numri i të punësuarve. Në dhjetor 2023, numri i të punësuarve paraqitet 1.3% më i lartë në krahasim me vitin 2022.

Të dhënat mbi llojet e kontributeve sipas sektorëve paraqiten në tabelën nr. 5:

Tabela nr. 5 Llojet e kontributeve sipas sektorëve.

në lekë

Kontribute	Buxhetor	Shtetëror	Privat	Vetëpunësuar	Totali
Shoqërore	38,679,435,973	6,732,743,184	68,165,264,002	3,873,577,479	117,451,020,638
Shëndetësore	5,609,898,618	964,247,694	11,066,030,085	1,147,435,615	18,787,612,012
Suplementar	1,780,912,524	28,640,961	158,774,631	-	1,968,328,116
Totali	46,070,247,115	7,725,631,839	79,390,068,718	5,021,013,094	138,206,960,766
Në % ndaj totalit	33%	6%	57%	4%	100%

Burimi: Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

Nga analiza e të dhënave u konstatua se, pjesa më e madhe e kontributeve realizohet nga sektori privat me 79,390,069 mijë lekë ose në masën 57%. Më pas vjen sektori buxhetor me 46,070,247 mijë lekë ose në masën 33%, e ndjekur nga sektori shtetëror me 7,725,632 mijë lekë ose në masën 6%, e në fund të vetëpunësuarit, në vlerën 5,021,013 mijë lekë ose në masën 4%. Sigurimet shoqërore janë realizuar në vlerën 117,451,021 mijë lekë, sigurimet shëndetësore në 18,787,612 mijë lekë dhe kontributet suplementare në 1,968,328 mijë lekë.

Tabela në vijim paraqet planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të Drejtorive Rajonale Tatimore (DRT), të cilat në bazë të legjisllacionit, mblihdhen nga DPT.

Tabela nr. 6 Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave të kontributeve, nga DRT

në 000

lekë

Drejtoritë Rajonale	Plani 2023, AN nr. 5, datë 18.10.2023	Realizimi faktik 2023	Fakt/Plan %
Kontribute gjithsej	139,900,000	139,254,918	99.5
DRT Berat	2,980,000	2,983,839	100.1
DRT Dibër	2,460,000	2,465,918	100.2
DRT Durrës	12,400,000	12,240,826	98.7
DRT Elbasan	5,675,000	5,674,316	100
DRT Fier	6,610,000	6,555,637	99.2
DRT Gjirokastrë	2,220,000	2,233,900	100.6
DRT Korçë	4,625,000	4,603,488	99.5
DRT Kukës	1,650,000	1,649,335	100
DRT Lezhë	3,100,000	3,071,556	99.1
DRT Sarandë	1,695,000	1,640,873	96.8
DRT Shkodër	5,240,000	5,144,797	98.2
DRT Tiranë	54,075,000	53,698,269	99.3
DTM	32,575,000	32,789,956	100.7
DRT Vlorë	4,595,000	4,502,207	98

Burimi: Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

Në analizë të të dhënave të mësipërme, rezulton se të ardhurat e kontributeve të sigurimeve të DRT-ve, nga planifikimi në vlerën 139,900,000 mijë lekë, janë realizuar në vlerën 139,254,918 mijë lekë, ose 645,082 mijë lekë më pak, në përqindje 0.5 më pak se plani i rishikuar. Me mosrealizim rezultojnë DRT Durrës, Fier, Korçë, Lezhë, Sarandë, Shkodër, Tiranë e Vlorë.

Nga dokumentacioni që disponon grupi i auditimit të KLSH, DRT Fier ka raportuar në Planin vjetor 2023, vlerën 6,705,993 mijë lekë, si dhe realizimin faktik 6,553,659 mijë lekë. Ndërsa në planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, e dhënë nga Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës në DPT, planifikimi raportohet 6,610,000 mijë lekë dhe realizimi faktit 6,555,637 mijë lekë.

Gjithashtu, edhe DRT Vlorë ka raportuar në Planin vjetor 2023, vlerën 4,584,799 mijë lekë, si dhe realizimin faktik 4,502,221 mijë lekë. Ndërsa planifikimi i të ardhurave, e dhënë nga Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës është 4,595,000 mijë lekë dhe realizimi faktik 4,502,207 mijë lekë.

Në lidhje me sa më sipër, grupi i auditimit kërkoi informacion te Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës, ku rezultoi se me shkresën nr. 17884 prot., datë 09.11.2023, kjo drejtori ka përcjellë në DRT Fier e DRT Vlorë, “Planin e të ardhurave për muajin Nëntor 2023”, bazuar në shkresën e MFE nr. 19769 prot., datë 30.10.2023, mbi ndryshimin e planit të të ardhurave vjetore, sipas Aktit Normativ nr. 5, datë 18.10.2023.

Për sa më sipër, nga auditimi u konstatua se DRT Fier dhe DRT Vlorë, nuk kanë përfshirë në planin akumulativ të kontributeve, ndryshimet e dërguara nga Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës sipas AN nr. 5, datë 18.10.2023, veprim që ka sjellë raportim të pasaktë nga këto Drejtori Rajonale, të planifikimit dhe realizimin e të ardhurave për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për vitin 2023, si dhe në kundërshtim me pikën nr. 6, neni 4 “Përgjegjësitë dhe detyrat e Drejtorit të Drejtorisë Rajonale” dhe neni 23 “Përgjegjësitë dhe detyrat e drejtorit/përgjegjësit të Drejtorisë/Sektorit të Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave në DRT”, të Rregullores “Për funksionimin e Drejtorive Rajonale Tatimore”, miratuar me Urdhrin nr. 192, datë 120.8.2020 të Ministrit të Financave.

Mbi planifikimin, realizimin dhe monitorimin e të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shëndetësore (FSDKSH).

-“Plani i të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” në zbatim të ligjit 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, është detajuar me shkresën nr. 2703 prot., datë 08.02.2023, të MFE, protokolluar në DPT me nr. 2028 prot., datë 10.02.2023. Referuar këtij plani, me shkresën nr. 2383/1 prot, datë 28.02.2023, Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës ka përcjellë planin e të ardhurave në FSDKSH për vitin 2023, në vlerën **16,933,000 mijë lekë.**

- Në zbatim të Aktit Normativ nr. 5, datë 18.10.2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës me shkresën nr. 18410 prot., datë 17.11.2023, ka dërguar planin e të ardhurave të kontributeve shëndetësore për FSDKSH viti 2023, në vlerën **18,644,000 mijë lekë.**

- Me shkresën nr. 341 prot, datë 10.01.2024, janë dërguar në FSDKSH, treguesit mbi realizimin e të ardhurave për kontributet e sigurimeve shëndetësore, për periudhën Janar - Dhjetor 2023. Nga auditimi rezultoi se, plani i të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shëndetësore për vitin 2023, është realizuar në vlerën 18,882,561 mijë lekë ose në masën 101.3%.

Tabela në vijim paraqet në mënyrë të përmbledhur planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shëndetësore.

Tabela nr. 7 Planifikimi dhe realizimi i planit të kontributeve shëndetësore, viti 2023

në 000/ lekë

Emërtimi	Plani 2023, referuar Ligjit të Buxhetit	Plani 2023, ndryshuar me AN nr. 5, datë 18.10.2023	Realizimi Faktik 2023	Ndryshimi Fakt/Plan
Sig. Shëndetësore	16,933,000	18,644,000	18,882,561	101.3%

Burimi: Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

Tabela në vijim paraqet planifikimin dhe realizimin e planit të kontributeve shëndetësore, sipas Drejtorive Rajonale për vitin 2023.

Tabela nr. 8 Planifikimi dhe realizimi i planit të kontributeve shëndetësore sipas DRT 000/lekë

Drejtoritë Rajonale	Plani 2023, AN nr. 5, datë 18.10.2023	Realizimi Faktik 2023	Diferenca Fakt-Plan	Në %
Sig. shëndetësore	18,644,000	18,882,561	238,561	101.3
DRT Berat	398,568	404,131	5,562	101.4
DRT Dibër	328,882	315,884	-12,998	96.0
DRT Durrës	1,653,834	1,659,355	5,521	100.3
DRT Elbasan	759,504	772,280	12,775	101.7
DRT Fier	883,670	907,498	23,827	102.7
DRT Gjirokastrë	296,718	291,637	-5,081	98.3
DRT Korçë	618,980	626,357	7,377	101.2
DRT Kukës	220,288	208,290	-11,998	94.6
DRT Lezhë	413,800	416,555	2,755	100.7
DRT Sarandë	226,388	233,835	7,447	103.3
DRT Shkodër	700,189	689,390	-10,799	98.5
DRT Tiranë	7,194,130	7,298,925	104,795	101.5
DTM	4,336,010	4,445,458	109,448	102.5
DRT Vlorë	613,039	612,968	-71	100.0

Burimi: Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

Referuar planifikimit së të ardhurave nga kontributet rezulton se, të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shëndetësore të DRT për vitin 2023, janë tejkaluar në vlerën 238,561 mijë lekë ose në masën 1.3% më shumë se plani i rishikuar. Disa drejtori rajonale paraqiten me mosrealizim të planit si, DRT Dibër në masën 4%, DRT Gjirokastrë në masën 1.7%, DRT Kukës në masën 5.4%, e DRT Shkodër në masën 1.5% të planit.

Tabela në vijim, paraqet realizimin e planit të kontributeve shëndetësore sipas Drejtorive Rajonale, për vitin 2023, si dhe krahasimi me vitin paraardhës.

Tabela nr. 9 Realizimi i kontributeve shëndetësore të DRT-ve dhe krahasimi me vitin 2022 në 000/lekë

Drejtoritë Rajonale	Realizimi Faktik 2022	Realizimi Faktik 2023	Diferenca 2023-2022	Në %
Sig. Shëndetësore	16,100,358	18,882,561	2,782,203	117.3
DRT Berat	353,739	404,131	50,392	114.2
DRT Dibër	283,053	315,884	32,831	111.6
DRT Durrës	1,393,975	1,659,355	265,379	119.0
DRT Elbasan	674,822	772,280	97,457	114.4
DRT Fier	814,678	907,498	92,820	111.4
DRT Gjirokastrë	253,089	291,637	38,547	115.2
DRT Korçë	545,341	626,357	81,016	114.9
DRT Kukës	184,387	208,290	23,903	113.0
DRT Lezhë	365,714	416,555	50,840	113.9
DRT Sarandë	190,834	233,835	43,001	122.5
DRT Shkodër	601,123	689,390	88,267	114.7
DRT Tiranë	6,093,548	7,298,925	1,205,377	119.8
DTM	3,826,508	4,445,458	618,950	116.2

DRT Vlorë	519,546	612,968	93,422	118.0
-----------	---------	---------	--------	-------

Burimi: Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

Realizimi i planit të të ardhurave për kontributet shëndetësore të vitit 2023, krahasuar me vitin paraardhës, rezulton në rritje me 2,782,203 mijë lekë, ose 17.3% më shumë se realizimi i planit të vitit 2022.

Mbi planifikimin, realizimin dhe monitorimin e të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore (ISSH).

-“Plani i të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” në zbatim të ligjit 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, është detajuar me shkresën nr. 2703 prot., datë 08.02.2023, të MFE, protokolluar në DPT me nr. 2028 prot., datë 10.02.2023. Referuar këtij plani, me shkresën nr. 2835/1 prot, datë 28.02.2023, Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës ka përcjellë planin e të ardhurave në ISSH për vitin 2023, në vlerën **106,867,000 mijë lekë**.

- Në zbatim të Aktit Normativ nr. 5, datë 18.10.2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës me shkresën nr. 17705/1 prot., datë 17.11.2023, ka dërguar planin e të ardhurave të kontributeve shoqërore për ISSH viti 2023, në vlerën **121,256,000 mijë lekë**.

- Me shkresën nr. 345 prot., datë 10.01.2024, janë dërguar në ISSH, treguesit mbi realizimin e të ardhurave për kontributet e sigurimeve shoqërore, për periudhën Janar - Dhjetor 2023. Nga auditimi rezultoi se, plani i të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore për vitin 2023, është me mosrealizim për vlerën 883,643 mijë lekë ose 0.7%, më pak se plani.

Tabela në vijim paraqet në mënyrë të përmbledhur planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore.

Tabela nr. 10 Planifikimi dhe realizimi i planit të kontributeve shoqërore, viti 2023 në 000/ lekë

Emërtimi	Plani 2023, referuar Ligjit të Buxhetit	Plani 2023, ndryshuar me AN nr. 5, datë 18.10.2023	Realizimi Faktik 2023	Ndryshimi Fakt/Plan
Sig. shoqërore	106,867,000	121,256,000	120,372,357	99.3%

Burimi: Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Tabela në vijim paraqet planifikimin dhe realizimin e planit të kontributeve shoqërore, sipas Drejtorive Rajonale për vitin 2023.

Tabela nr. 11 Planifikimi dhe realizimi i planit të kontributeve shoqërore sipas DRT 000/lekë

Drejtoritë Rajonale	Plani 2023, AN nr. 5, datë 18.10.2023	Realizimi Faktik 2023	Diferenca Fakt-Plan	Në %
Sig. shoqërore	121,256,000	120,372,357	-883,643	99.3
DRT Berat	2,581,432	2,579,708	-1,723	99.9
DRT Dibër	2,131,118	2,150,034	18,916	100.9
DRT Durrës	10,746,166	10,581,472	-164,695	98.5
DRT Elbasan	4,915,496	4,902,037	-13,459	99.7
DRT Fier	5,726,330	5,648,139	-78,190	98.6
DRT Gjirokastrë	1,923,282	1,942,264	18,981	101.0
DRT Korçë	4,006,020	3,977,132	-28,889	99.3
DRT Kukës	1,429,712	1,441,045	11,333	100.8
DRT Lezhë	2,686,200	2,655,001	-31,199	98.8
DRT Sarandë	1,468,612	1,407,038	-61,574	95.8
DRT Shkodër	4,539,811	4,455,407	-84,404	98.1
DRT Tiranë	46,880,870	46,399,344	-481,526	99
DTM	28,238,990	28,344,498	105,508	100.4

DRT Vlorë	3,981,961	3,889,239	-92,722	97.7
-----------	-----------	-----------	---------	------

Burimi: Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

Referuar planifikimit së të ardhurave nga kontributet rezulton se, të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore të DRT për vitin 2023, paraqiten me mosrealizim në vlerën 883,643 mijë lekë ose 0.7% më pak se plani. Vetëm 4 drejtori rajonale paraqiten me tejkalim të planit si, DRT Dibër në masën 0.9%, DRT Gjirokastrë në masën 1%, DRT Kukës në masën 0.8%, e DTM në masën 0.4% të planit.

Tabela në vijim, paraqet realizimin e planit të kontributeve shoqërore sipas Drejtorive Rajonale, për vitin 2023, si dhe krahasimi me vitin paraardhës.

Tabela nr. 12 Realizimi i kontributeve shoqërore të DRT-ve dhe krahasimi me vitin 2022 në 000/ lekë

Drejtoritë Rajonale	Realizimi Faktik 2022	Realizimi Faktik 2023	Diferenca 2023-2022	Në %
Sig. Shëndetësore	102,364,814	120,372,357	18,007,544	117.6
DRT Berat	2,255,089	2,579,708	324,619	114.4
DRT Dibër	1,960,784	2,150,034	189,251	109.7
DRT Durrës	8,960,284	10,581,472	1,621,188	118.1
DRT Elbasan	4,307,397	4,902,037	594,640	113.8
DRT Fier	5,167,875	5,648,139	480,264	109.3
DRT Gjirokastrë	1,692,839	1,942,264	249,425	114.7
DRT Korçë	3,476,104	3,977,132	501,028	114.4
DRT Kukës	1,294,324	1,441,045	146,721	111.3
DRT Lezhë	2,349,600	2,655,001	305,401	113.0
DRT Sarandë	1,168,895	1,407,038	238,143	120.4
DRT Shkodër	3,936,586	4,455,407	518,821	113.2
DRT Tiranë	38,839,578	46,399,344	7,559,766	119.5
DTM	23,618,230	28,344,498	4,726,268	120.0
DRT Vlorë	3,337,230	3,889,239	552,009	116.5

Burimi: Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

Realizimi i planit të të ardhurave për kontributet shoqërore të vitit 2023, krahasuar me vitin paraardhës, rezulton në rritje me 18,007,544 mijë lekë, ose 17.6% më shumë se realizimi i planit të vitit 2022.

Nga auditimi mbi realizimin e të ardhurave të kontributeve nga DRT, u konstatua se:

- Nuk kanë raportuar në DPT, me një analizë performance mbi mos realizimin e të ardhurave të kontributeve;

- Në raportimin e të ardhurave të kontributeve shëndetësore për vitin 2023, DRT Dibër, DRT Gjirokastrë e DRT Kukës paraqiten me mosrealizim të planit, ndërsa në raportimin e të ardhurave të kontributeve shoqërore, janë po këto Drejtori që paraqiten me tejkalim të planit vjetor. Për sa më sipër, konkludohet se nga DRT Dibër, DRT Gjirokastrë e DRT Kukës nuk kanë kryer raportime të sakta të realizimit faktik për vitin 2023, veprime në kundërshtim me pikën nr. 6, neni 4 “Përgjegjësitë dhe detyrat e Drejtorit të Drejtorisë Rajonale” dhe neni 23 “Përgjegjësitë dhe detyrat e drejtorit/përgjegjësit të Drejtorisë/Sektorit të Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave në DRT”, të Rregullores “Për funksionimin e Drejtorive Rajonale Tatimore”, miratuar me Urdhrin nr. 192, datë 120.8.2020 të Ministrit të Financave.

Mbi dorëzimin e listëpagesave në ISSH nga DPT.

Në zbatim të pikës nr. 1, të kreut VI “Shkëmbimi i informacionit për kontributet dhe pagesat”, të VKM nr. 77, datë 28.01.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”, DPT dhe ISSH kanë nënshkruar Marrëveshjen e Bashkëpunimit nr. 11422, datë 19.05.2017, dhe nr. 4473, datë 19.05.2017.

Bazuar në procedurën e komunikimit on-line midis sistemeve informatike, të ngritura nga institucionet, DPT dërgon në ISSH:

a) Deklaratën e listëpagesës me të dhënat përmbledhëse të saj, sipas të gjitha rubrikave, për çdo NIPT;

b) Shumat e kontributeve dhe interesave, të derdhura sipas NIPT-eve, muajve dhe bankën ku është bërë derdhja;

c) Listëpagesat për çdo NIPT, me të dhënat sipas të gjitha rubrikave, për çdo person, të identifikuar edhe me numrin personal, shuma e kontributeve e të cilave është derdhur plotësisht. Këto të dhëna transmetohen edhe për çdo version të fundit të listëpagesës.

Një listëpagesë dërgohet nga sistemi i tatimeve E-Tax në ISSH, vetëm pasi është kryer pagesa e plotë (sipas deklaramit) dhe janë kaluar në buxhet, të ardhurat për sigurime shoqërore dhe shëndetësore.

Nga auditimi konstatohen listëpagesat për vitin 2023, të deklaruara dhe të dërguara elektronikisht në ISSH, nga ku janë 1,527,720 subjekte/tatimpagues në total, që kanë deklaruar ose duhet të deklaronin një listëpagesë për periudhën janar-dhjetor 2023. Numri i listëpagesave totale të regjistruara në sistem për të gjitha versionet, normale dhe me ndryshime nga tatimpaguesi ose ndryshime nga inspektori konstatohet 1,549,658. Listëpagesa normale të deklaruara nga tatimpaguesi në versionin e parë, konstatohen 1,500,104, si dhe listëpagesa me ndryshime nga tatimpaguesi ose inspektori tatimor rezultojnë 48,554. Numri total i listëpagesave të padeklaruara nga tatimpaguesit për periudhën në fjalë rezulton 26,616. Numri i listëpagesave të regjistruara në sistem për të gjitha versionet, (normale dhe ndryshime nga tatimpaguesi ose ndryshime nga inspektori), për të cilat është paguar plotësisht vlera e detyrimit principal për kodet e të ardhurave të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore rezulton 1,438,234. Numri i listëpagesave për të cilat është paguar plotësisht vlera e detyrimit principal dhe janë dërguar në ISSH elektronikisht nëpërmjet sistemit E-tax është 1,437,951.

Gjithashtu, konstatohet se numri i listëpagesave për Sektorin Buxhetor për vitin 2023, për të cilat është paguar plotësisht vlera e detyrimit principal dhe janë dërguar në ISSH është 19,348. Numri i listëpagesave për Sektorin Jo buxhetor për vitin 2023, për të cilat është paguar plotësisht vlera e detyrimit principal dhe janë dërguar në ISSH është 2,412. Si dhe, numri i listëpagesave për Sektorin Privat për vitin 2023, për të cilat është paguar plotësisht vlera e detyrimit principal dhe janë dërguar në ISSH është 1,412,191.

Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:

z. C. K. me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Tatimeve dhe Nëpunësi Autorizues i institucionit;

znj. M. S. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Statistikës.

Për sa më sipër, është mbajtur Akt konstatimi nr. 4, datë 26.07.2024

Për sa trajtuar në Akt Konstatimin nr.4, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 13085/21 datë 01.08.2024, prot në KLSH me nr.473/3, prot datë 05.08.2024, nga znj. M. S. ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Grupi i KLSH konstaton se DPT përfshin në të ardhura të realizuara të ardhurat nga gjobat e sigurimeve për të cilat sqarohet se ky informacion është i kontabilizuar dhe listëpagesa konsiderohet deklarata tatimore. Rubrikat e saj përfshijnë edhe gjoba, e cila kontabilizohet si detyrim. DPT nuk mund të raportojë të ardhurat për gjoba të deklarimit të vonuar të listëpagesës për ISSH dhe FSDKSSH ku vetë kjo e ardhur është në total. Të ardhurat në llogarinë mjete në ruajtje janë në total për listëpagesë dhe jo për rubrika të listëpagesës. Raportimi në mënyrë shkresore i të ardhurave për ISSH dhe FSDKSSH bëhet për qëllim informues dhe nuk ndikon në nivelin e të ardhurave që MF ju akordon.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër, grupi i auditimit sqaron se për sa kohë nga MFE të ardhurat nga gjobat apo kamatëvonesat nuk përfshihen në plan, për efekt analizimi të realizimit kundrejt planit, këto të ardhura nuk duhet të përfshihen, për të qenë të krahasueshme.

2.5. Mbi trajtimin, miratimin dhe kryerjen e procedurës së rimbursimit të TVSH-së.

Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së (DRTVSH) është përgjegjëse për trajtimin, miratimin dhe kryerjen e procedurës së rimbursimit të TVSH-së në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale Tatimore, Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut në DPT dhe Drejtorinë TIK të Tatimeve. Kjo drejtori përgjatë vitit 2023 ka funksionuar me 1 drejtor dhe 9 inspektorë, pra 10 punonjës, ku nuk kanë rezultuar vakanca. Pas ndryshimeve në strukturën e DPT, organizimi i saj ka ndryshuar në 11 punonjës, pra përkatësisht 1 drejtor dhe 10 inspektorë.

Sipas Rregullores për Funksionimin e DPT, detyrat e Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së, konsistojnë në lehtësimin për zbatimin me përpikmëri të legjislacionit tatimor në fushën e rimbursimit të TVSH-së si dhe unifikimin e procedurës së ndjekur lidhur me trajtimin e praktikave; kryerjen e procedurës së rimbursimit të TVSH-së bazuar në analizën e riskut dhe nëpërmjet sistemit të thesarit, sipas rastit.

Kërkesat për rimbursim në DRTVSH

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023, pranë DRTVSH-së, janë regjistruar **2,877 kërkesa** për rimbursim nga **2,027 kërkesa** të regjistruara në 2022, me vlerë totale **49,538 milion lekë** nga **38,163 milion lekë** në 2022. Gjithsej **janë pranuar 1,690 kërkesa** nga **1,483 kërkesa** të pranuar në 2022, me një rritje në numër rreth 13.9% krahasuar me 2022, me vlerë **28,743 milion lekë** nga **28,577 milion lekë** në 2022, me një rritje në vlerë rreth 0.5% krahasuar me 2022, dhe **1,187 kërkesa** me vlerë **20,795 milion lekë** nga **544 kërkesa** në 2022, me vlerë **9,585 milion lekë**, **nuk janë pranuar** për mosplotësim të kriterëve ligjore. Klasifikimi sipas kategorisë së aktivitetit:

- Nga 1,690 kërkesa të pranuar, **96 kërkesa me vlerë 841 milion lekë**, janë bërë nga tatimpagues të klasifikuar si **eksportues me risk zero**, kërkesa e të cilëve duhet të miratohen dhe rimbursohet automatikisht brenda 30 ditëve nga data e kërkesës;
- Nga 1,690 kërkesa të pranuar, **874 kërkesa me vlerë 11,466 milion lekë**, janë bërë nga tatimpagues të klasifikuar si **eksportues**, kërkesa e të cilëve duhet të miratohet dhe rimbursohet brenda 30 ditëve nga data e kërkesës;
- Nga 1,690 kërkesa të pranuar, **720 kërkesa me vlerë 16,436 milion lekë**, janë bërë nga tatimpagues të klasifikuar si **jo-eksportues**, kërkesa e të cilëve duhet të miratohet dhe rimbursohet brenda 60 ditëve nga data e kërkesës.

Rimbursimet

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023, janë rimbursuar në total (*FIFO+Këste*) **22,614 milion lekë nga 22,469 milion lekë të rimbursuara në vitin 2022, ose rreth 0.6 % më shumë se në 2022**. Janë miratuar dhe rimbursuar **1,659 kërkesa** të trajtuara sipas metodës FIFO, nga **1,520 kërkesa** të pranuar në 2022, me një rritje në numër me rreth **9.1%** krahasuar me 2022, me vlerë totale për rimbursim **26,976 milion lekë nga 25,890 milion lekë në 2022**, pra me një rritje në vlerë rreth **4.1%** më shumë krahasuar me 2022. *Theksojmë se pjesa më e madhe vlerës së rimbursuar, rreth 63.9 % është dhënë për tatimpaguesit e DTM.*

Koha e Rimbursimit

Në lidhje me kohën e procesimit (Koha mesatare e miratimit të kërkesës për rimbursim të TVSH-së, nga data e kërkesës deri në datën miratimit të kërkesës), për periudhën Janar-Dhjetor 2023, janë miratuar dhe rimbursuar **1,659 kërkesa FIFO**, koha mesatare e procesimit ka qenë **31 dite nga 45 ditë** që ishte për 2022, ku **56 %** të kërkesave janë procesuar brenda **30 ditëve**. Rreth **43 %** e kërkesave janë procesuar brenda afatit **60-ditorë**. Sqarojmë se për vetëm **1%** e kërkesave janë procesuar mbi **120 ditë** dhe kryesisht arsyeja ka qenë mospagimi i detyrimeve

për “1900-Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore”, nga ana e tatimpaguesve.

Mbi planifikimin dhe realizimin e buxhetit të vitit 2023 në zërin Rimbursimi TVSH-së.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për vitin 2023 bazuar në Ligjin Nr.84/2022 "Për Buxhetin e vitit 2023", është njohur me planin mujor dhe progresiv të rimbursimit të TVSH-së, me shkresën e Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë Nr.3615 Prot., datë 21.02.2023 “Plani i të ardhurave për Administratën Tatimore për vitin 2023”, protokolluar në DPT me Nr.2831 Prot., datë 23.02.2023.

Për vitin 2023 rimbursimi për TVSH-në bazuar në ligjin vjetor të buxhetit është programuar në shumën për **18,000,000 mijë lekë**, i cili nuk ka ndryshuar gjatë vitit dhe është realizuar në shumën **22,614,132 mijë lekë** duke rezultuar me tejkalim në shumën **4,614,132 mijë lekë, ose 25.63%** më shumë kundrejt planit të rimbursimit.

Në mijë lekë

Emërtimi	Realizimi Faktik 2022	Plani 2023 referuar Ligjit të Buxhetit	Realizimi Faktik 2023	Diferenca Fakt-Plan	% ndaj Planit
Rimbursimi i kryer	22,469,292	18,000,000	22,614,132	4,614,132	25.63%

Burimi: DRTVSH në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, përpunuar nga KLSH.

Tabela në vijim paraqet realizimin mujor të rimbursimit të TVSH-së kundrejt planit të miratuar:

Në mijë lekë

Nr	Periudha	Plani 2023	Realizimi Faktik	Diferenca Fakt/Plan	Diferenca %
1	Janar	700,000	736,504	36,504	5%
2	Shkurt	1,500,000	1,713,070	213,070	14%
3	Mars	1,500,000	1,400,565	(99,435)	-7%
4	Prill	1,600,000	1,583,226	(16,774)	-1%
5	Maj	1,600,000	2,130,613	530,613	33%
6	Qershor	1,600,000	1,546,370	(53,630)	-3%
7	Korrik	1,600,000	1,649,134	49,134	3%
8	Gusht	1,600,000	1,496,021	(103,979)	-6%
9	Shtator	1,600,000	2,337,642	737,642	46%
10	Tetor	1,600,000	1,260,063	(339,937)	-21%
11	Nëntor	1,600,000	3,076,855	1,476,855	92%
12	Dhjetor	1,500,000	3,684,068	2,184,068	146%
Totali		18,000,000	22,614,132	4,614,132	26%

Burimi: DRTVSH në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, përpunuar nga KLSH.

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme rezultojnë se plani i rimbursimit mujor është tejkaluar ndjeshëm në 7 muajt të vitit 2023, konkretisht në muajt: Janar +5%, Shkurt +14%, Maj +33%, Korrik +3%, Shtator +46%, Nëntor +92% dhe Dhjetor +146%, ndërsa kemi mosrealizim të planit të rimbursimit në muajt Mars -7%, Prill -1%, Qershor -3%, Gusht -6% dhe Tetor -21%. Tabela në vijim paraqet realizimin faktit të rimbursimit të TVSH-së sipas Drejtorive Rajonale Tatimore, kundrejt planit të buxhetit.

Në mijë lekë

Nr	DRT Tatimore	Plani 2023	Realizimi Faktik	Diferenca Fakt/Plan	Diferenca %
1	DRT Berat	279,000	284,281.30	5,281.30	1.89%
2	DRT Dibër	133,000	370,732.19	237,732.19	178.75%
3	DRT Durrës	1,150,000	2,007,151.30	857,151.30	74.53%
4	DRT Elbasan	370,000	557,961.62	187,961.62	50.80%
5	DRT Fier	812,000	936,717.34	124,717.34	15.36%
6	DRT Gjirokastrë	113,000	142,837.72	29,837.72	26.41%
7	DRT Korçë	320,000	410,344.89	90,344.89	28.23%

8	DRT Kukës	80,000	480,511.91	400,511.91	500.64%
9	DRT Lezha	124,000	222,188.06	98,188.06	79.18%
10	DRT Saranda	99,000	167,630.54	68,630.54	69.32%
11	DRT Shkodra	255,000	313,988.51	58,988.51	23.13%
12	DRT Tirana	2,545,000	1,809,744.02	-735,255.98	-28.89%
13	DRT Mëdhenj	11,355,000	14,457,833.99	3,102,833.99	27.33%
14	DRT Vlora	365,000	452,208.26	87,208.26	23.89%
Totali		18,000,000	22,614,132	4,614,132	25.63%

Burimi: DRTVSH në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, përpunuar nga KLSH.

Sa më sipër konstatohet se në 13 Drejtori Rajonale Tatimore është tejkaluar ndjeshëm plani i rimbursimit, konkretisht në DTM, Durrës, Shkodër, Korçë, Kukës, Lezhë, Dibër, Berat, Elbasan, Fier, Vlorë, Gjirokastrë dhe Sarandë të cilët së bashku kanë paguar më tepër se fondet e planifikuara për rimbursimin shumë totale për 5,349,388 mijë lekë, ose ka tejkaluar fondet e parashikuara për rimbursim e TVSH-së, ndërsa në DRT Tiranë nuk kanë realizuar planin e rimbursimit për 735,255.98 mijë lekë. Referuar të dhënave si më lart, peshën më të madhe të rimbursimit të TVSH-së e zë Drejtoria e Tatim Paguesve të Mëdhenj në vlerën për 14,457,833.99 mijë lekë, ose 63.93 %, të totalit të realizimit faktik të Rimbursimit të TVSH-së në DPT, ndërkohë që kjo drejtori në mbyllje të periudhës ushtrimore rezulton me një realizim të planit në masën +27.33% e ndjekur më pas më DRT Durrës, e cila ka paguar shumë 2,007,151.30 mijë lekë, duke e realizuar planin e rimbursimit në masën 74.53%, duke tejkaluar në shumë 781,837 mijë lekë.

Në konkluzion: Shpenzimet e Rimbursimeve të TVSH-së, për të gjitha Drejtoritë Rajonale Tatimore, janë tejkaluar dukshëm në krahasim me planin e rimbursimeve, veprime këto në kundërshtim me nenin 14 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, sipas të cilat DPT është autoriteti i vetëm qendror që zbaton dhe administron tatimet kombëtare, pagesat publike sipas legjislacionit tatimor, Ligjin Nr.84/2022 "Për Buxhetin e vitit 2023", dhe shkresat e MFE mbi planin mujor dhe progresiv të rimbursimit të tatimit mbi vlerën e shtuar.

Tatimpagues të rimbursuar me metodën FIFO dhe me Këste.

Në periudhën ushtrimore 2023, janë miratuar dhe rimbursuar **1,659 kërkesa** të trajtuara sipas metodës FIFO me vlerë totale **26,976,674 mijë lekë** nga të cilat **4,362,542 mijë lekë** janë rimbursuar nëpërmjet metodës së kompensimit dhe **22,614,132 mijë lekë** janë rimbursuar me thesar. Tabela në vijim paraqet kërkesat e aprovuara për Rimbursimin e TVSH-së sipas Drejtorive Rajonale për vitin 2023:

Rimbursuar sipas DRT-ve (000 Lekë)			
Nr	Drejtoria Tatimore	Kërkesa të aprovuara	Vlera e miratuar
1	DRT Berat	55	284,281
2	DRT Dibër	26	370,732
3	DRT Durrës	394	2,007,151
4	DRT Elbasan	88	557,962
5	DRT Fier	170	936,717
6	DRT Gjirokastrë	35	142,838
7	DRT Korçë	94	410,345
8	DRT Kukës	14	480,512
9	DRT Lezha	35	222,188
10	DRT Saranda	23	167,631
11	DRT Shkodra	68	313,989
12	DRT Tirana	292	1,809,744
13	DRT Mëdhenj	269	14,457,834
14	DRT Vlora	96	452,208
Totali		1,659	22,614,132

Burimi: DRTVSH në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, përpunuar nga KLSH.

Marrëveshjet me këste

Nga auditimi është konstatuar se përgjatë vitit 2023, nuk ka pasur marrëveshje me këste me tatimpaguesit.

Kërkesat në proces

Deri në datë 31.12.2023 në Drejtorinë e Rimbursimit rezultojnë se janë në proces në total rreth **145 kërkesa** nga **171 kërkesa** që rezultonin në 31.12.2022, me një rënie në numër kërkesash me rreth 17% krahasuar me 2022, kurse në vlerë ka rritje me rreth 7.8% krahasuar me vitin 2022, nga **6,274 milion lekë në 5,818 milion lekë** në 31.12.2022.

Kërkesat në proces të regjistruara sipas viteve (000 Lekë)		
Viti	Numri i kërkesave	Vlera e kërkesave
2018	1	5
2019	2	45
2020	4	11,193
2021	10	30,152
2022	4	1,405,554
2023	124	4,826,811
Total	171	6,273,760

Burimi: DRTVSH në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, përpunuar nga KLSH.

Mbi stokun e rimbursimit të TVSH-së.

Stoku i rimbursimeve për kërkesat e miratuara dhe të pa likuiduara nga administrata tatimore, i raportuar nga DRTVSH më datë 31.12.2023, **është 0 lekë**. Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së **ka raportuar gjendjen e stokut të rimbursimit të TVSH-së, deri në 31.12.2023, në shumën 0 lekë**, në Drejtorinë e Analizës dhe Kontabiliteti për datën 31.12.2023.

Nga auditimi konstatohet se sistemi C@ts nuk mundëson një kartelë analitike të subjektit ku të paraqitet gjendja e stokut të rimbursimit të TVSH-së, vlera e miratuar për rimbursimin e TVSH-së, pagesat si dhe gjendja në fund e llogarisë së tatimpaguesit, pasi në momentin e miratimit përfundimtar të kërkesës për rimbursim, kjo shumë del jashtë sistemit C@TS, në pritje të lëshimit të Urdhër Pagesës për Rimbursim. **Të gjitha të dhënat në lidhje subjektet të cilëve ju është miratuar kërkesa për rimbursimin e TVSH-së mbahen nga jashtë sistemit C@ts, në format Excel nga Drejtori i Rimbursimit të TVSH-së dhe inspektorët përkatës. Fakt ky që ndërpret vijueshmërinë e gjurmës së auditimi, është format lehtësisht i manipulueshëm si dhe ka risk të lartë gabimi njerëzor gjatë mbartjes së informacionit.**

Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në mbyllje të periudhës ushtrimore **nuk mban akte rakordimi me tatimpaguesit në lidhje me detyrimin e konstatuar për rimbursimin e TVSH-së**, në mbyllje të periudhës ushtrimore me qëllim vërtetësinë e detyrimeve ndaj të tretëve para hartimit të pasqyrave financiarë, në zbatim të Udhëzimit të MFE, Nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare të NJQP”, ku përcaktohet se “3.1 Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, pika 30 ku citohet: Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementëve të tjerë, konform kritereve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjorë, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve.”

Nga auditimi u konstatua se, në mbyllje të periudhës ushtrimore 2023, rezultojnë **9 kërkesa për rimbursimin e TVSH-së të pranuar por të pa miratuara në vlerën totale për 100,569,976 lekë, të cilat megjithëse kanë kaluar afati maksimal prej 60 ditëve nga data e paraqitjes së tyre nuk janë rimbursuar**, veprime këto në kundërshtim me:

Ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 75/1, “Rimbursimi i TVSH-së dhe kompensimi i detyrimeve tatimore”, ku përcaktohet se “Personat e tatueshëm, të regjistruar për TVSH-në, që rezultojnë me tepriçë kreditore,

kanë të drejtë të paraqesin kërkesën për rimbursimin e TVSH-së së paguar tepër pranë Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Kjo kërkesë paraqitet sipas formularit të miratuar “Kërkesë për rimbursimin e TVSH-së”. **Brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tatimpaguesit dhe brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tatimpaguesve eksportues, Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në bashkëpunim me drejtorinë rajonale tatimore, ku është i regjistruar tatimpaguesi, verifikojnë situatën tatimore të tatimpaguesit dhe miratojnë tepricën kreditore si të rimbursueshme. Kur është e nevojshme, administrata tatimore ushtron kontroll bazuar në analizën e riskut.** Përgesë e tepricës kreditore të rimbursueshme kryhet brenda pesë ditëve, nëpërmjet sistemit të thesarit, në bazë të rregullave të përcaktuara në udhëzimin e Ministrit të Financave. Në rast të kundërt, personit të tatueshëm i lind e drejta e mos pagesës së detyrimeve të tjera tatimore në masën e TVSH-së së pretenduar për rimbursim.”

VKM Nr.953 datë 29.12.2014 “Për dispozitat zbatuese të Ligjit Nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar pika 3 dhe 4 të nenit 10, ku citohet se “3. Personat e tatueshëm, vlera e eksporteve të të cilëve, të kryera në periudhën/at tatimore për të cilën/at kërkohet rimbursimi, përbën më shumë se 50% deri në 70% të vlerës së përgjithshme të shitjeve, përfshirë eksportet, rimbursohen brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim të TVSH-së, duke iu nënshtruar më parë procedurës së analizës së riskut. Nëse nga analiza e riskut rezulton se personi i tatueshëm që klasifikohet në këtë kategori duhet t’i nënshtrohet procesit të kontrollit tatimor, e gjithë procedura, përfshirë kontrollin, përfundon brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës. Edhe nëse nuk ka përfunduar në afat procedura e kontrollit, brenda afatit 30-ditor nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim, kryhet rimbursimi i TVSH-së nëpërmjet sistemit të thesarit.

4. Të gjithë personat e tatueshëm që kryejnë eksporte, por nuk klasifikohen në pikën 1 të këtij neni, rimbursohen brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës duke i u nënshtruar procedurës së analizës së riskut.”.

Konkluzion: Referuar Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe VKM-së Nr.953, datë 29.12.2014 “Për dispozitat zbatuese të Ligjit Nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, konstatohet se, **i gjithë procesi i Rimbursimit të TVSH-së, duhet të zgjasë jo më shumë se 60 ditë dhe mos likuidimin brenda këtij afati i kërkesave të pranuar por jo të miratuara në vlerën 100,569,976 lekë, pavarësisht kryerjes ose jo të procesit të kontrollit tatimor, konsiderohet si një detyrim i pa paguar dhe duhet të përshihet dhe raportohet në stokun e detyrimeve të prapambetura. Pra, sa më sipër stoku i rimbursimit më 31.12.2023, sipas gjykimit të grupit të audituesve të KLSH, më së paku është 100,569,976 lekë.**

Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:

Z. Gj. S., në cilësinë e Drejtor i DRTVSH;

Z. C. K., në cilësinë e Drejtorit i Përgjithshëm.

Për sa trajtuar në Projektraport, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr.13085/45, prot datë 11.09.2024, prot në KLSH me nr.473/6, prot datë 16.09.2024, nga Drejtori i Përgjithshëm i DPT, znj. E. Ç. ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Lidhur me gjetjet e rimbursimeve të TVSH-së, për të gjitha DRT janë tejkuluar dukshëm në krahasim me planin e rimbursimeve, sqarojmë se plani i rimbursimeve vjen i miratuar nga MFE, pavarësisht nga propozimet që mund të bëhen nga Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së. Kërkesat për rimbursim nga subjektet bëhen në mënyrë të vazhdueshme dhe Drejtoria e Rimbursimit ka për detyrë ti shqyrtojë të gjitha këto kërkesa pavarësisht planit. DRTVSH shqyrton gjatë gjithë kohës mundësinë e mos tejkalimit të planit të rimbursimeve. Stoku i rimbursimit të TVSH-së më datë

31.12.2023 për kërkesa të miratuara dhe të pa likuiduara është 0. Pra, më datë 31.12.2023 DRTVSH nuk ka patur detyrime të palikuiduara lidhur me TVSH-në e miratuar për rimbursim, e për rrjedhojë nuk janë mbajtur edhe akte rakordimi me tatimpaguesit. Të dhënat në lidhje me subjektet mbahet në Excel për nevoja të brendshme, duke qenë se kalimi i rimbursimeve në Degën e Thesarit nuk mundësohet automatikisht nëpërmjet Platformës Dixhitale të Rimbursimit, por pasi të jenë printuar formularët e rimbursimit “Njoftim për Miratimin e Rimbursimit të TVSH-së” dhe “Urdhër-Pagesë Rimbursimi për TVSH-në”. Lidhur me stokun e llogaritur sipas metodës së grupit të auditimit, DRTVSH nuk është dakort sepse është në kundërshtim me definicionit e stokut, ku : $Stoku\ i\ rimbursimit\ të\ TVSH-së\ është\ vlera\ e\ TVSH-së\ e\ aprovuar\ për\ tu\ rimbursuar\ ga\ administrata\ tatimore,$ në pritje për tu kaluar në Degën e Thesarit. Pra, nga ana e KLSH merrem në vlerësim edhe kërkesat që janë në proces, të pa miratuara për rimbursim, detyrimi i të cilave është i pamaturuar ku teprica kreditore është e lirë dhe e përdorshme nga tatimpaguesi. $Stoku\ i\ Rimbursimit\ të\ TVSH-së\ llogaritet:\ stoku\ në\ fund = stoku\ në\ çelje + kërkesat\ e\ miratuara\ gjatë\ periudhës-kompensimet-rimbursimet\ e\ kryera.$ Kërkesat për rimbursim për të cilat tatimpaguesi nuk kanë likuiduar detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, nga DRTVSH nuk mund të rimbursohen pavarësisht tejkalimit të afatit 60 ditor të rimbursimit. Gjithashtu, DRTVSH është e detyruar të presë përfundimin e akteve të kontrollit nga DRT-të përkatëse për subjektet që i nënshtrohen kontrollit tatimor. Këto janë 9 rastet e kërkesave për rimbursim, të pranuar por të pa miratuara për vlerën 100,569,976.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa trajtuar në observacionin e paraqitur, sqarojmë se konkluzionet e grupit të auditimit lidhur me procesin e ndjekur për përcaktimin e planit të rimbursimit dhe rolin e MFE dhe DPT në këtë proces janë trajtuar në rekomandimet e lëna. Në lidhje me stokun e rimbursimit të TVSH-së, në mbyllje të periudhës ushtrimore dhe sqarojmë se referuar Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 75/1, “Rimbursimi i TVSH-së dhe kompensimi i detyrimeve tatimore”, pika 1 dhe VKM Nr.953 datë 29.12.2014 “Për dispozitat zbatuese të Ligjit Nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar pika 3, neni 10, vërehet se i gjithë procesi i rimbursimit të TVSH-së, duhet të përfundojë brenda 60, ditëve. Pra pas përfundimit të afatit ligjor tatimpaguesit i lind një e drejtë e konstatuar për rimbursimin e TVSH-së. Në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit (SKK 1) “Kudri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare” citohet: “Me qëllim që të përmbushin objektivat e tyre, pasqyrat financiare përgatiten mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Sipas kësaj metode, efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera njihen në pasqyrat financiare kur ato ndodhin (dhe jo kur para ja ose ekuivalentet e saj arkëtohen ose paguhen) dhe njihen në kontabilitet e raportohen në Pasqyrat financiare të periudhave kontabël, të cilave u përkasin. Pra, kjo vlerë duhet ti shtohet shumës së stokut të rimbursimit të TVSH-së dhe të paraqitet në pasqyrat financiare të institucionit.

2.6 Mbi organizimin, funksionimin dhe vlerësimin e përputhshmërisë me kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullative të veprimtarisë së drejtorive në hartimin dhe mbështetjen e programeve, si dhe në funksionet operacionale.

2.6 Mbi organizimin, funksionimin dhe vlerësimin e përputhshmërisë me kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullative të veprimtarisë së drejtorive në hartimin dhe mbështetjen e programeve, si dhe në funksionet operacionale.

2.6.1 Auditimi i përputhshmërisë së procedurave të ndjekura Drejtoria e Menaxhimit të Riskut.

Drejtorja e Menaxhimit të Riskut përgjatë vitit 2023 ka funksionuar në bazë të Urdhrit Nr.69 datë 26.05.2023 “Për Miratimin e Strukturës Organizative dhe të Numrit të Përgjithshëm të Personelit të Administratës Tatimore Qendrore”, në varësi të Drejtorisë së Hartimit të Programeve, drejtohet nga Drejtori i Drejtorisë së DMR dhe është e organizuar në 2 sektorë:

- Sektori i Analizës së Riskut me 1 Përgjegjës dhe 10 Specialistë (2 pozicione vakante - Përgjegjësi i Sektorit dhe 1 Inspektor).
- Sektori i Hartimit të Strategjive për Trajtimin e Risqeve me 1 Përgjegjës dhe 6 Specialistë (1 pozicion vakant).

Objektivi parësor i modelit të riskut që ushtron veprimtarinë DMR është identifikimi mbi bazën e kriterëve të miratuara dhe zhvilluara paraprakisht i tatimpaguesve që përbëjnë risk potencial lidhur me përmbushjen, veprimtaria tregtare e të cilëve do të verifikohet dhe trajtohet nga ana e administratës tatimore në harmoni me procedurat ligjore në fuqi. Konstatohet se kjo drejtori nuk është plotësuar me numrin e nevojshëm të punonjësve sipas strukturës.

Sistemi i Menaxhimit të Riskut ka për qëllim të ndikojë në përmirësimin e mbledhjes së të ardhurave të parashikuara duke siguruar:

- Menaxhimin eficient dhe transparent të ardhurave tatimore;
- Evidentimin dhe zvogëlimin e risqeve të mos përmbushjes së objektivave të administratës tatimore;
- Inkurajimin dhe rritjen e shkallës së zbatimit dhe respektimit vullnetar të përmbushjes së detyrimeve tatimore, si dhe sigurimin e nxitjes së besimit publik ndaj integritetit dhe efikasitetit të Administratës Tatimore;

Objektivat e Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut për vitin 2023 janë:

1. Zhvillimi dhe zbatimi i projekteve sektoriale të përmbushjes dhe reduktimi i nivelit të riskut.
2. Zgjerimi i kapaciteteve për të ekzaminuar të dhënat nga burime të ndryshme gjatë analizës së riskut të përmbushjes së tatimeve;
3. Përdorimi i burimeve të informacionit nga palë të treta dhe sigurimi që çdo informacion të jetë i integruar në modelin e kontrollit duke u bërë një faktor për vlerësimin e riskut
4. Hartimi i analizave cilësore që fokusohet në target risqe specifike
5. Monitorimi i rregullt i niveleve të përmbushjes.
6. Forcimi i kapaciteteve dhe bashkëpunimi i pandërprerë me bizneset duke synuar marrjen e një baze të plotë të dhënash.

Aktivitetet e programuara dhe të realizuara gjatë vitit 2023 në funksion të arritjes së objektivave kanë qenë realizimi i trajnimeve nga ekspertë të FMN-së lidhur me Menaxhimin e Riskut të Përmbushjes si dhe trajnime për programin e përpunimit të të dhënave me volum të madh (R-Studio) si dhe trajnime nga ekspertë të Administratës Suedeze.

Drejtoria e Menaxhimit të Riskut në DPT është përgjegjëse për menaxhimin e përzgjedhjes automatike të tatimpaguesve për kontroll, bazuar në kriteret e miratuara të riskut. Hartimi i planeve mujore të kontrollit dhe hedhja e evidencave të kontrollit në një plan-fakt të përbashkët për 14 DRT. Drejtoria e Menaxhimit të Riskut përzgjedh 70% të tatimpaguesve për kontroll tatimor të plotë në vend sipas të dhënave të regjistrimit elektronik të riskut me përjashtim të DTM ku përzgjedhja për kontroll të tatimpaguesve të vlerësuar me risk të lartë përfshin 50% të totalit të planit mujor të kontrollit.

Drejtoria e Menaxhimit të Riskut ka si objektiv parësor nëpërmjet modulit të riskut identifikimin mbi bazën e kriterëve të miratuara dhe zhvilluara paraprakisht të tatimpaguesve që përbëjnë risk potencial të cilët duhet të verifikohet dhe trajtohet nga ana e administratës tatimore në harmoni me procedurat ligjore në fuqi.

Tatimpaguesit renditen duke filluar nga vlerësimi më i lartë tek ai më i ulët dhe subjektet që kanë numrin më të lartë të kriterëve të thyera të riskut vlerësohen më riskun më të lartë dhe listohen të parët në “Dokumentin e listës së subjekteve”. Janë kryer ekzekutimet e modulit të riskut për planet sektoriale, për rimbursimin e TVSH-së apo nevoja të tjera analizash. Gjate vitit 2023 DMR ka ekzekutuar modulën e riskut 2 herë në vit çdo 6 muaj dhe bazuar në rezultatet e tij dhe renditjen e tatimpaguesve planifikon kontrollet tatimore mujore për pjesën e 70%, si më poshtë:

- Plan Kontrolli Janar-Qershor 2023, datë 10.01.2023;
- Plan Kontrolli Korrik-Dhjetor 2023, datë 01.07.2023.

Rregullat e modulit të riskut janë në proces të vazhdueshëm përmirësimi pasi ndikohen drejtpërdrejtë nga ndryshimet në paketat fiskale, nga sjellja e tatimpaguesve si dhe nga dinamika e mjedisit ekonomik. Në kuadër të përmirësimit të funksionalitetit të rregullave dhe përshtatjes me ndryshimin e pragut të TVSH-së dhe Tatim Fitimit, pas testeve të vazhdueshme për evidentimin e problematikave të tyre, DMR ka bërë ndryshimet e nevojshme në logjikë si dhe në përditësimin e dokumentit në Word. Në bashkëpunim me specialist në Drejtorinë TIK për të siguruar mbarëvajtjen e modelit, zhvillimet e reja dhe përditësimin janë analizuar të dhënat nga Modeli i Riskut. Është përditësuar Moduli i riskut me hedhjen në Live të rregullave të reja të shtuara me Vendim Nr.31, datë 29.07.2023:

- CITGAP - Xhiro afër pragut 8 milion për TF.
- CITGAP15% - Xhiro i afrohet pragut 14 milion lekë për TVSH-në
- VATGAP - Xhiro i afrohet pragut 10 milion lekë për TVSH-në.
- TPAMDPY- Ndryshim me ulje i totalit të kontributeve.
- SPAY- Mbi 50% e punonjësve me pagë minimale.
- VATEMP - Mbi 6 punonjës pa përgjegjësi TVSH-je.

Përzgjedhja e subjekteve përgjatë kësaj periudhe për t'u kontrolluar është bërë duke marrë në konsideratë si variabël kryesor orët në dispozicion për kontroll nga ana e secilës DRT. Ky është faktori i parë kufizues në përzgjedhjen e subjekteve për kontroll, ndërkohë që nga ana e Drejtorisë së Kontrollit ky variabël përkthehet në numër subjektësh për t'u kontrolluar bazuar në eksperiencat e mëparshme për kohën mesatare të shpenzuar për një kontroll.

Konstatohet se për vitin 2023 nga vetëdeklarimet e Drejtorive Rajonale nuk janë filluar 109 kontrole nga 2,982 kontrole të planifikuara ose rreth 4% e totalit, duke krijuar një stok të subjekteve të planifikuara për kontroll dhe të pa kontrolluara, si pasojë dhe e mos koordinimit midis Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut dhe Drejtorive Rajonale.

Referuar Manualit të Riskut, Drejtoritë Rajonale Tatimore i dërgojnë Drejtorisë së Kontrollit në DPT, brenda datës 10 të çdo muaji, raportin mbi aktivitetin e kontrollit të muajit të kaluar, përfshirë kontrollet e plota dhe vizitat fiskale. Drejtoritë e Kontrollit në DPT përpilon raportin mujor i cili shqyrtohet dhe nga Drejtoritë e Menaxhimit të Riskut për qëllime të objektivitetit të punës në lidhje me kriteret e riskut. Mbi këtë bazë Drejtoritë e Menaxhimit të Riskut raporton rregullisht brenda datës 20 të çdo muaji te nëndrejtori i Përgjithshëm i varësisë. Nga auditimi konstatohet mungesa e dokumentimit të raportimit mujor të DMR-së.

Drejtoritë e Menaxhimit të Riskut pas marrjes së konfirmimit për realizueshmërinë e kontroleve duke marrë në konsideratë numrin e subjekteve si variabël ka realizuar përzgjedhjen automatike të atyre subjekteve të cilat janë renditur më lart në bazë të Modulit të Riskut (CRM), pjesë përbërëse e sistemit të informatizuar të deklaramentit të tatimeve nga ana e tatimpaguesve. Në të gjitha rastet, tatimpaguesit e përzgjedhur për kontroll sipas Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut në DPT janë referuar për kontroll të plotë sipas Modulit të Menaxhimit të Riskut dhe planeve sektoriale. Konstatohet se edhe pse përzgjedhja e subjekteve për kontroll është automatike, detajimi i subjekteve për secilën Drejtori kryhet manualisht, pasi sistemi nuk merr në konsideratë:

- *Subjektet e planifikuara për kontroll në planet e mëparshme të kontrollit të cilat nuk janë realizuar brenda afateve të përcaktuara, janë në proces kontrolli apo janë hequr nga lista e subjekteve të planifikuara, të cilat eliminohen manualisht nga punonjësit e Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut, në bazë të informacionit të marrë nga Drejtoritë Rajonale.*
- *Renditjen e subjekteve me të njëjtin numër rregullash të thyera.*

Në analizat e kryera është bërë e mundur evidentimi i numrit të kriterëve që thyhen nga sektorët si dhe numrit të “shmangies potenciale” e shprehur në pikë. Me anë të këtij informacioni i cili gjenerohet automatikisht, është bërë e mundur analizimi dhe trajtimi i sektorëve më me risk ose prioritar. Në tabelën e mëposhtme janë renditur 10 aktivitetet me risk nga 561 aktivitetet gjithsej:

Kodi	Përshkrimi	Numri i rregullave të thyera	% e Nr të rregullave të thyera
I5630	Aktivite të shërbimit të pijeve	14,109	6%
G4711	Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuar me mbizotërim ushqimor, pije dhe duhan	7,854	3%
G4690	Tregtia me shumicë jo e specializuar	7,418	3%
G4719	Shitje të tjera me pakicë në dyqane jo të specializuara	6,900	3%
F4120	Ndërtimi i ndërtesave rezidenciale e jo rezidenciale	6,365	3%
I5610	Restorante dhe shërbim ushqimor i lëvizshëm	5,649	2%
G4771	Tregtia me pakicë e veshjeve në dyqane të specializuara	5,097	2%
G4773	Shitja e përgatitja e artikujve farmaceutike në dyqane të specializuara	5,023	2%
I5510	Hotele dhe struktura të ngjashme	4,325	2%
H4941	Transporti rrugor i mallrave	3,966	2%
Te tjera		173,824	72%
Total		240,530	100%

Burimi: DMR në Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga K.LSH.

Në bazë të zgjedhjes së tatimpaguesve për kontroll realizohet nëpërmjet hartimit të listave përfundimtare për kontroll bazuar në rezultatet e gjeneruara nga Moduli i Riskut Tatimore ato dërgohen të nënshkruara nga Drejtori i Përgjithshëm jo më vonë se data 25 e çdo muaji për kontrollet që do të ushtrohen në muajt pasardhës. Drejtoria e Menaxhimit të Riskut ka realizuar hartimin e listave për tatimpaguesit e zgjedhur për kontroll si më poshtë:

Planet e kontrollit të dërguara në DRT për (Rasti 1/70%)

Muaji	Nr. Prot	Data	Përshkrimi
Janar	21643/1	12/27/2022	Shkresë Përcjellëse
Shkurt	1691	02/03/2023	Shkresë Përcjellëse
Mars	3020/1	2/27/2023	Shkresë Përcjellëse
Prill	6500/1	04/12/2023	Shkresë Përcjellëse
Maj	7524/1	05/03/2023	Shkresë Përcjellëse
Qershor	9449	5/26/2023	Shkresë Përcjellëse
Korrik	11123	6/26/2023	Shkresë Përcjellëse
Gusht	12807	7/27/2023	Shkresë Përcjellëse
Shtator	14161	8/29/2023	Shkresë Përcjellëse
Tetor	15712	9/29/2023	Shkresë Përcjellëse
Nëntor	17105	10/27/2023	Shkresë Përcjellëse
Dhjetor	18932	11/30/2023	Shkresë Përcjellëse

Burimi: DMR në Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga K.LSH.

Planet e kontrollit të dërguara në DRT për (Rasti 2/30%)

Muaji	Nr. Prot	Data	Përshkrimi
Janar	247	01/10/2023	Shkresë Përcjellëse
Shkurt	1067	1/25/2023	Shkresë Përcjellëse
Mars	3020	2/27/2023	Shkresë Përcjellëse
Prill	6996	3/25/2023	Shkresë Përcjellëse
Maj	7521	05/03/2023	Shkresë Përcjellëse
Qershor	9400	5/25/2023	Shkresë Përcjellëse
Korrik	10996	6/23/2023	Shkresë Përcjellëse
Gusht	12642	7/25/2023	Shkresë Përcjellëse
Shtator	13963	8/24/2023	Shkresë Përcjellëse
Tetor	15560	9/27/2023	Shkresë Përcjellëse
Nëntor	16960	10/25/2023	Shkresë Përcjellëse
Dhjetor	18799	11/24/2023	Shkresë Përcjellëse

Burimi: DMR në Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga K.LSH.

Kontrollet planifikuara sipas DRT-ve viti 2023

Raste kontrolli/DRT	BR	DB	DTM	DR	EL	FR	GJI	KO	KU	LE	SR	SHK	TR	VL	Tot
Raste 1 nga 70% (Nga moduli, rimbursimet dhe palët e treta)	89	68	360	179	222	237	50	135	23	58	39	227	347	131	2,165
Raste 2 nga 30%	25	19	253	47	37	40	21	34	6	13	2	62	181	17	757
Raste 3 nga Prokuroria				17	10								25	8	60
Totali	114	87	613	243	269	277	71	169	29	71	41	289	553	156	2,982

Burimi: DMR në Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga K.LSH.

Nga analiza e tabelës së mësipërme rezulton janë planifikuar për kontroll 2,982 subjekte, nga të cilët 2,165 janë të propozuar nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut, 757 subjekte janë propozuar nga Drejtoritë Rajonale dhe 60 raste janë referuar nga KLSH-së për rikontrolle dhe nga Prokuroria për fillim kontrolli. Drejtoritë Rajonale që zënë peshën më të madhe janë Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj me 613 kontrolle ose rreth 20.5% të totalit dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë me 553 kontrolle ose rreth 18.5% të kontrolle totale të planifikuara.

Me shkresën nr.2868 prot, datë 23.02.2023 Drejtori i Përgjithshëm ka nxjerr urdhërin nr.42 prot, datë 23.02.2023 për ngritjen e “Komitetit të Riskut dhe përcaktimin e rregullave të funksionimit të tij”. Komiteti i Riskut ka për detyrë zbatimin e një sistemi modern të menaxhimit të rrezikut të pajtueshmërisë dhe promovimin e zhvillimit të strategjive të integruara të përmirësimit të pajtueshmërisë, në veçanti komiteti do të:

- Identifikoje dhe do t’ju jap prioritet rreziqeve të mëdha të pajtueshmërisë sipas një procesi të strukturuar të vlerësimit të rreziqeve.
- Identifikoje ato rreziqe të pajtueshmërisë që përfaqësojnë një nivel të mjaftueshëm kërcënimi për të tërhequr vëmendjen e vazhdueshme të ekzekutivit të lartë.
- Sigurojë që një strategji reaguese e integruar në mënyrë të përshtatshme, të veprorë për secilin prej këtyre rreziqeve të rrepta të pajtueshmërisë.
- Monitorojë zbatimin dhe efektivitetin e strategjive.
- Të miratojë listën e ndarjes në sektorë ekonomikë në Modulin e Riskut.
- Të hartojë strategji afatshkurtra ose plane të veprimit në kuadër të një Administrate Tatimore Inteligjente.

1. Komiteti mbledhet minimalisht një herë në muaj, por edhe herë të tjera nëse cilësohet e nevojshme.
2. Komiteti do të mbështetet nga Sekretariati Teknik, i cili përbëhet nga jo më pak se dy anëtarë ku njëri prej tyre është pjesë e DMR.
3. Sekretariati Teknik përgatit dhe i propozon komitetit planin e punës dhe afatet për zbatimin e detyrave të caktuara nga komiteti, si dhe raporton periodikisht për ecurinë e procesit, por jo më pak se një herë në muaj.

Gjatë vitit 2023 ky komitet ka realizuar gjithsej 14 mbledhje ku për secilin takim DMR ka planifikuar detyra konkrete me problematikat me grupime tatimpaguesish për secilën Drejtoria Rajonale, vendimet me numër dhe datë pasqyrohen në tabelën si më poshtë:

Nr Vendimi	Nr. Prot	Data
1	3019	27.02.2023
2	5209	21.03.2023
3	6500	12.04.2023
4	7524	03.05.2023
5	9448	26.05.2023
6	11122	26.06.2023
7	11633	06.07.2023
8	12806	27.07.2023
9	14160	29.08.2023
10	15711	29.09.2023
11	16877	24.10.2023
12	17104	27.10.2023
13	18931	30.11.2023
14	20733	22.12.2023

Nga auditimi i Vendimeve të Komitetit të Riskut në DPT, është konstatuar konkretisht se në Vendimin e Komitetit të Riskut Nr.6, datë 26.06.2023 (nr.11172 prot), pika 3 është kryer “Miratimin e propozimit të DRT Tiranë për ndryshimin e pikës (2) Kapitulli II në “Manualin e Kontrollit Tatimor” sipas shkresës nr.26613, datë 09.06.2023, protokolluar në tonën me nr.10295, datë 09.06.2023 për ndryshimin e përzgjedhjes së tatimpaguesve që do të kontrollohen: 50% nga propozimet e DRT Tiranë dhe 50% nga DMR”. Ndryshim i Manualit të Riskut sipas pikës së mësipërme. Veprime të cilat janë në kundërshtim me përcaktimet e Urdhërit Nr.42, datë 23.02.2023 “Ngritjen e Komitetit të Riskut dhe përcaktimin e rregullave të funksionimit të tij”, konkretisht: Pika 2 “Komiteti i Riskut ka për detyrë zbatimin e një sistemi modern të menaxhimit të rrezikut të pajtueshmërisë dhe promovimin e zhvillimit të strategjive të integruara të përmirësimit të pajtueshmërisë. Në veçanti, komiteti do të: - **Identifikojë dhe do t’ju japë prioritet rreziqeve të mëdha të pajtueshmërisë sipas një procesi të strukturuar të vlerësimit të rreziqeve.**

Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Menaxhimit të Riskut pranë DPT nuk ka iniciuar asnjë program kontrolli përgjatë vitit 2023 pranë organizatave jo fitimprurëse (OJF) që operojnë në vendin tonë. Referuar informacionit të vendosur në dispozicion nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut, rezulton se nga ana e DPT në 5 vitet e fundit nuk janë kryer për asnjë rast propozim kontrole pranë këtyre subjekteve, pavarësisht qarkullimit të lartë që këto subjekte realizojnë ku nga databaza e aktivitetit të TOP 200 OJF-vë në harkun e 5 vjeçarit të fundit, ekzistojnë OF me qarkullim deri në 728,808,724 lekë por gjithashtu edhe për riskut që këto biznese mbartin të tilla si diferenca mes të ardhurave/shpenzimeve të deklaruara në pasqyrat financiare të dorëzuara në C@ts, krahasuar me situatën që është raportuar në FDP, pagave të ulëta të deklaruara në listëpagesa, tatimit në burim, pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit etj.

Gjatë vitit 2023, nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut është hartuar Plani Sektorial i Turizmit, miratuar me vendimin Nr.5 datë 26.05.2023. Plani i Turizmit është zhvilluar për periudhën Maj- Gusht 2023 për të gjitha subjektet që operojnë në fushën e turizmit dhe Bar-Restorante.

Plani Sektorial i Turizmit.

Problematikat kryesore për Planin Sektorial të Turizmit kanë dalë nga të dhënat në sistemin tatimor për subjektet pjesë e planit pasi janë kryer një sërë analizash për risqe të ndryshme të cilat i janë dërguar D.V.K.T për verifikim me problematikat si më poshtë:

- TP Turizëm pa fatura për periudhë 1 javore.
- Rënie Xhiro krahasim mujor.
- TP ≥ 7 punonjës pa përgjegjësi TVSH-je.
- Subjekte me përgjegjësi tatimore por me rënie qarkullimi nga java në javë më shume se me 10%.
- Subjekte me përgjegjësinë e TVSH-së por që kanë pak fatura ose kanë pak qarkullim në pikun orar 12.00-16.00 për fundjavë.
- TP pa çadra për periudhë 1 javore.
- TP me numër dhoma deri 50% të kapacitetit.
- Subjektet me xhiro totale për 3 dite më të vogël se 1 milionë lekë dhe ndërkohë kanë 10 ose më shumë punonjës aktivë.
- Akomodim me çmime të ulëta.
- TP me çadra me çmim të ulët për fundjavë.

Nga analiza lidhur mbi rezultatet e Planit Sektorial të Turizmit të vitit 2023 rezulton se: Referuar xhiros nga fiskalizimi për të gjithë niptet e popullatës së turizmit, për muajin Gusht 2023 kanë rezultuar me rritje të xhiros me 7%. Ndërsa për tatimpaguesit që rezultojnë në të dy vitet rritja e xhiros është 6%. Nga krahasimi i listëpagesave të periudhës 2023 - 2022 si

listëpagesa e fundit totale për popullatën e tatimpaguesve të sektorit turistik rezulton rritje në numrin e tatimpaguesve me +12 % krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë dhe një rritje me vetëm +2 % të numrit të punonjësve.

- Rritja në pagën mesatare për kontribute është +23 %.
- Rritje e TAP me + 33%.

Nga grupi i auditimit konstatohet se nuk ka një rakordim midis DMR dhe DVKT lidhur me rezultatet e planit operacional lidhur me listat e dërguara nga kjo drejtori, nëse është trajtuar problematika sipas listës së dërguar, nuk ka informacion sa % e subjekteve janë verifikuar dhe cilat janë problematikat më të shpeshta që janë konstatuar. Kjo në kundërshtim me piken 2 dhe piken 2.3 të urdhërit nr.42 prot, datë 23.02.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm për ngritjen e “Komitetit të Riskut dhe përcaktimin e rregullave të funksionimit të tij”

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

Z. O. L. në cilësinë e Përgjegjësit të Sektorit të Hartimit të Strategjive për Trajtimin e Risqeve
Z. I. K. në cilësinë e Drejtorit të Menaxhimit të Riskut
Z. C. K. në cilësinë e ish Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

Për sa më sipër me personat përgjegjës O. L., I. K. dhe C. K.

2.6.2 Auditimi i përputhshmërisë së procedurave të ndjekura nga Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren.

Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren ushtron funksionet në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit Nr.69 datë 26.05.2023 “Për miratimin e strukturës së organizative dhe numrit të përgjithshëm të personelit të administratës tatimore qendrore”.

Strukturat e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren janë njësi të specializuara zbatimi në përbërje të administratës tatimore qendrore dhe që kanë si funksion parësor:

- Marrjen e masave administrative edhe për kundërvajtjet administrative tatimore;
- Zbatimin e masave shtrënguese.

Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren është e organizuar në nivel qendror dhe rajonal në përbërje të DPT, si më poshtë:

- Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren në DPT;
- Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren Rajoni Verior;
- Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren Rajoni Qendror;
- Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren Rajoni Jugor;

Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren në DPT, ka në përbërje të saj 4 (katër) sektor:

- Sektori i Trajtimin të Ankesave;
- Sektori i Verifikimit dhe Monitorimit (Task-Forcë);
- Sektori i Koordinimit;
- Sektori i Analizës dhe Informacionit.

- Qëllim kryesor i veprimtarisë së këtij sektori është nxitja e përmbushjes vullnetare të detyrimeve dhe të parandalimi, zbulimi dhe dënimi për shkeljet e legjislacionit tatimor të kryera nga tatimpaguesit, nëpërmjet ushtrimit të kontroleve dhe verifikimeve në vend të aktivitetit të tyre.

- Drejtimet kryesore të punës, konsistojnë në marrjen dhe aplikimin e masave (dënimeve) administrative për kundërvajtjet administrative tatimore të konstatuara për rastet e shkeljeve të parashikuara në ligjin e procedurave tatimore dhe në udhëzimin e Ministrit të Financave dalë

në zbatim të tij, që kanë të bëjnë me verifikimin dhe konstatimin e kryerjes së veprimtarisë ekonomiko-tregtare pa u regjistruar; Mbajtjen, transportimin përdorimin dhe tregtimin e mallrave pa dokumentacionin e duhur tatimor; Punonjës të padeklaruar në organin tatimor etj., pa u kufizuar vetëm në to; Zbatimin e masave shtrënguese të parashikuara në legjislacionin tatimor në bashkëpunim me strukturat përkatëse të mbledhjes së borxhit tatimor, me qëllim mbledhjen e tatimeve dhe taksave të papaguara.

- Objekti i veprimtarisë dhe drejtimet kryesore të punës për strukturat e zbatimit janë verifikimi në terren i regjistrimit ose ç’regjistrimit; Verifikimi i deklarimit të punonjësve në organin tatimor; verifikimi i instalimit, funksionimit dhe mirëmbajtjes të pajisjeve fiskale dhe sistemeve të monitorimit të qarkullimit; verifikimi i mbajtjes së dokumentacionit tatimor dhe i pajisjes së mallrave me faturë tatimore dhe Verifikimi i përmbushjes së detyrimeve të tjera ligjore të tatimpaguesve

Gjatë vitit 2023, puna e Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren është bazuar në planet e punës që ka miratuar Komiteti Operacional paraqitura si më poshtë:

- | |
|---|
| 1-Vendimi Nr.31, datë 28.12.2022 “Miratimin e Planit të Punës së Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, për periudhën Janar-Dhjetor 2023” (Nr.21719/1 Prot., datë 28.12.2022); |
| 2-Vendimi Nr.33, datë 30.12.2022 “Miratimin e Planit të Punës së Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, për periudhën 04 Janar-31 Mars 2023” (Nr.21887/1 Prot., datë 30.12.2022); |
| 3-Vendimi Nr.36, datë 25.05.2023 “Miratimin e Planit të Punës së Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, për periudhën 01 Qershor-30 Shtator 2023” (Nr.9345/1 Prot., datë 25.05.2023); |
| 4-Vendimi Nr.37, datë 29.09.2023 “Miratimin e Planit të Punës së Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, për periudhën 02 Tetor-31 Dhjetor 2023” (Nr.15639/1 Prot., datë 29.09.2023). |

Nga auditimi i veprimtarisë së DVKT për vitin 2023 ka rezultuar se janë kryer 5,283 verifikime në terren dhe ka vendosur penalitete për 909 raste në vlerën totale 52,970,000 lekë.

Në Lekë							
Nr.	Plane Pune 2023	Prot	Datë	Subjekte të kontrolluara	Subjekte me shkelje	Numri i shkeljeve	Shkelje në Vlerë
1	Plan vjetor Janar-Dhjetor 2023	21719	28.12.2022	1,776	49	59	2,565,000
2	Plan Pune 04 Janar-31 Mars 2023	21887	30.12.2022	529	15	18	1,610,000
3	Plan Pune 01 Qershor-30 Shtator 2023	9345	25.05.2023	994	344	434	27,985,000
4	Plan Pune 02 Tetor-31 Dhjetor 2023	15639	29.09.2023	1,984	315	398	20,810,000
Total				5,283	723	909	52,970,000

Burimi: DVKT në DPT, përpunoi grupi i audituesve të KLSH.

Në mënyrë analitike të detajuar sipas natyrës së shkeljeve është paraqitur mëposhtë:

Lekë		
Lloji shkeljes	Nr shkeljeve	Shkelje në vlerë
Administrim blloqesh jotatimore	1	-
Lëshon fature me vlerë të ndryshme nga çmimi i afishuar	1	25,000
Lëshon fature tatimore me elemente jo të përcaktuar në ligj (jo të plote)	1	50,000
Lëshon faturë të pasakte tatimore (pa efekt detyrimi)	11	710,000
Mall pa fature tatimore BM	10	6,750,000
Mall pa fature tatimore BV	37	925,000
Mall pa fature tatimore BV me TVSH	2	100,000
Mosafishim të listës së çmimeve BM	18	1,800,000
Mosafishim të listës së çmimeve BV	4	200,000
Mosinstalim i sistemit të fiskalizimit (BV + TVSH)	4	200,000
Mosinstalim i sistemit të fiskalizimit (BV)	67	1,675,000
Mosinstalim i sistemit të fiskalizimit, BM	6	450,000
Moslëshim fature BM	90	6,750,000
Moslëshim fature BV	232	5,800,000
Moslëshim fature BV me TVSH	18	900,000
Moslëshim fature BV me TVSH (hera e dyte)	1	100,000
Moslëshim të biletave të shërbimit	3	50,000
Mosmbajtje pajisje fiskale në gjendje pune	2	50,000

Mos njoftim ne afat për ndërprerjen e internetit për transmetimin e te dhënave ne pajisjen e fiskalizuar	1	25,000
Mospajisje me certifikate elektronike BV	52	1,300,000
Mospajisje me certifikate elektronike BV me TVSH	14	700,000
Mospajisje me certifikate elektronike BM	12	900,000
Mospërditësim te dhënash për regjistrim	107	1,140,000
Nuk mban dokumentacion tatimor, BM	1	50,000
Nuk mban dokumentacion tatimor, BV	27	270,000
Pengim kontrolli	2	2,000,000
Punonjës i padeklaruar BM	55	14,400,000
Punonjës i padeklaruar BV	86	4,900,000
Subjekt i paregjistruar ne organin tatimor	29	-
Zhbllokim aktiviteti pas regjistrimit	15	750,000
Total	909	52,970,000

Burimi: DVKT në DPT, përpunoi grupi i audituesve të KLSH.

Plani Operacional përgjatë Sezonit Turistik.

Drejtimet kryesore operacionale ku do të veprohet gjatë sezonit turistik:

- Krijimi dhe përditësimi i regjistrimit të subjekteve sipas sektorëve në zonat turistike/bregdetare të R.SH dhe sensibilizimi i tyre gjatë periudhës 22-31 Maj 2023;
- Këshillimi në terren i subjekteve me risk për monitorimin e tyre nga Administrata Tatimore;
- Trajtimi i listave me subjekteve të ardhura nga Komiteti i Riskut;
- Verifikimi i tatimpaguesve që do të analizohen nga zyra me rënie të qarkullimit të xhiros në periudha një mujore krahasuar me periudha të njëjtë me të Qershor 2022, Korrik 2022, Gusht 2022 dhe Shtator 2022;
- Verifikimi i tatimpaguesve me risk (i ulët/i lartë) sipas analizës së qarkullimit të xhiros së deklaruar nga subjekti kundrejt qarkullimit të supozuar në bazë të të dhënave të kapacitetit dhe aktivitetit, sipas databazës të përditësuar nga strukturat e terrenit gjatë sezonit turistik 2023;
- Verifikimi i tatimpaguesve me risk të pragut të TVSH, përkatësisht tatimpaguesit që janë çregjistruar nga përgjegjësia tatimore e TVSH-së të cilat konsiderohen me risk për pragun e ndryshimit të përgjegjësisë tatimore;
- Verifikimi i tatimpaguesve që kanë blerje në ditët e fundit të muajit me vlera të larta;
- Verifikimi i tatimpaguesve në transportin turistik të pasagjereve në përputhje me licencimin përkatës, kontratën e operatorit turistik dhe pajisjen me bileta dhe/apo faturë tatimore për turistët e huaj apo edhe vendas;
- Verifikimi i tatimpaguesve në fushën e Agjensive udhëtimit/turistike në përputhje me licensën përkatëse;
- Kontrole në zonën e Shëngjinit gjatë zhvillimit të festivalit UNUM 01-06 Qershor;
- Verifikime/monitorime për aktivitetin e zhvilluar në qytetin e Korçës “F. e b.”;
- Kontrole në subjektet që ushtrojnë veprimtari argëtuese të jetës së natës;
- Trajtimi i denoncimeve nga Portali për Bashkëqeverisjen, Stop Informaliteti dhe institucione të tjera.

Nga Drejtorja e Menaxhimit të Riskut, janë vendosur në dispozicion listat e tatimpaguesve me risk për t’u verifikuar nga DVKT në terren, sipas fushave të riskut të identifikuar, si më poshtë:

Nr	Risqet e identifikuar
1	Tatimpagues me rritje të qarkullimit por me rënie të TVSH së detyrueshme për t’u paguar
2	Tatimpagues të cilët rezultojnë me TVSH të detyrueshme për t’u paguar për 2023 deri në 100.000. (Është vendosur fasha 100,000 lekë për TVSH e detyrueshme për t’u paguar e cila është një vlerë shumë e ulët për sektorin e turizmit)
3	Tatimpagues me çmim të ulët të çadrave
4	Tatimpagues për t’u monitoruar në terren pasi mund të ketë risk nëndeklarimi (Fundjavë 14,15,16 Korrik organizohet “T. F.”)
5	Tatimpagues me aktivitet akomodim me çmim dhomash shumë të ulëta
6	Tatimpagues me rënie xhiro krahasuar Qershor 2023-Qershor 2022
7	Tatimpagues të cilët nuk kanë lëshuar kupon për çadrat e dhëna me qera (edhe pse kanë kontratë me Agjencinë Kombëtare të Bregdetit për stacionet e plazhit, nga të dhënat e sipërfaqes është llogaritur nr hipotetik i çadrave dhe janë mbajtur TP mbi 50 çadra)
8	Tatimpagues me përgjegjësinë e TVSH-së por që kanë pak fatura ose kanë pak qarkullim në pikun orar 12.00-16.00 në datat 23,24,25 Qershor

Burimi: DMR në DPT, përpunoi grupi i audituesve të KLSH.

Nga kryqëzimi i të dhënave sipas listës me subjekte me kritere të thyera sipas analizës së riskut nga DMR me të dhënat e verifikimeve në terren nga DVKT përgjatë sezonit turistik 2023, ka rezultuar se janë kryer verifikime në terren vetëm për 430 subjekte nga totali prej 2,002 subjekte ose vetëm 21.5% e kampionit, konkretisht paraqitur si më poshtë:

Nr	Kriteret e riskut (DMR)	Numri i subjekteve sipas kritereve të riskut të thyera	Numri i subjekteve pa kontrolluar nga DVKT	Numri i subjekteve të kontrolluar nga DVKT	% Verifikimit
1	Lista për kriterin 1,2 dhe 6	832	641	191	22.96%
2	Lista për kriterin 3	122	104	18	14.75%
3	Lista për kriterin 4	47	30	17	36.17%
4	Lista për kriterin 5	522	413	109	20.88%
5	Lista për kriterin 7	122	103	19	15.57%
6	Lista për kriterin 8	357	281	76	21.29%
	Totali	2,002	1,572	430	21.5%

Burimi: DMR në DPT, përpunoi grupi i audituesve të KLSH.

Nga analiza e detajuar dhe nga shqyrtimi i akt konstatimeve të mbajtur nga inspektorët e DVKT, në sistemin informatik tatimor C@ts në lidhje me verifikimet në terren, ka rezultuar se ato janë jashtë tematikës së përcaktuar për verifikim nga analiza e riskut të DMR, që është verifikimi i çmimeve të ulëta të çadrave, sipas kriterit nr. 3 të thyer.

Përmbajtja e Akt Konstatimeve sipas C@ts	NIPT	Emri subjektit
Pa trajtuar tematikën e kriterit nr.3 "Tatimpagues me çmim të ulët të çadrave" të thyer sipas analizës së DMR	L.....O	D. D.
Pa trajtuar tematikën e kriterit nr.3 "Tatimpagues me çmim të ulët të çadrave" të thyer sipas analizës së DMR	K.....A	I. K.
Pa trajtuar tematikën e kriterit nr.3 "Tatimpagues me çmim të ulët të çadrave" të thyer sipas analizës së DMR	L.....A	I. T.
Pa trajtuar tematikën e kriterit nr.3 "Tatimpagues me çmim të ulët të çadrave" të thyer sipas analizës së DMR	L.....N	F. C.
Pa trajtuar tematikën e kriterit nr.3 "Tatimpagues me çmim të ulët të çadrave" të thyer sipas analizës së DMR	K.....D	Y. P.
Pa trajtuar tematikën e kriterit nr.3 "Tatimpagues me çmim të ulët të çadrave" të thyer sipas analizës së DMR	L.....H	E. K.
Pa trajtuar tematikën e kriterit nr.3 "Tatimpagues me çmim të ulët të çadrave" të thyer sipas analizës së DMR	K.....E	D. M.
Pa trajtuar tematikën e kriterit nr.3 "Tatimpagues me çmim të ulët të çadrave" të thyer sipas analizës së DMR	K.....M	A. D.
Pa trajtuar tematikën e kriterit nr.3 "Tatimpagues me çmim të ulët të çadrave" të thyer sipas analizës së DMR	K.....T	L. K.
Pa trajtuar tematikën e kriterit nr.3 "Tatimpagues me çmim të ulët të çadrave" të thyer sipas analizës së DMR	K.....S	B. (B. R.)
Pa trajtuar tematikën e kriterit nr.3 "Tatimpagues me çmim të ulët të çadrave" të thyer sipas analizës së DMR	K.....S	V. K.
Pa trajtuar tematikën e kriterit nr.3 "Tatimpagues me çmim të ulët të çadrave" të thyer sipas analizës së DMR	L.....A	D. B.
Pa trajtuar tematikën e kriterit nr.3 "Tatimpagues me çmim të ulët të çadrave" të thyer sipas analizës së DMR	L.....L	K.
Pa trajtuar tematikën e kriterit nr.3 "Tatimpagues me çmim të ulët të çadrave" të thyer sipas analizës së DMR	L.....I	Xh. M.
Pa trajtuar tematikën e kriterit nr.3 "Tatimpagues me çmim të ulët të çadrave" të thyer sipas analizës së DMR	L.....B	F. D.
Pa trajtuar tematikën e kriterit nr.3 "Tatimpagues me çmim të ulët të çadrave" të thyer sipas analizës së DMR	L.....L	Z. K.
Pa trajtuar tematikën e kriterit nr.3 "Tatimpagues me çmim të ulët të çadrave" të thyer sipas analizës së DMR	M.....F	F. A.
Pa trajtuar tematikën e kriterit nr.3 "Tatimpagues me çmim të ulët të çadrave" të thyer sipas analizës së DMR	L.....D	M. G. 012

Burimi: DMR në DPT, përpunoi grupi i audituesve të KLSH.

Nga analiza e detajuar dhe nga shqyrtimi i akt konstatimeve të mbajtur nga inspektorët e DVKT, në sistemin informatik tatimor C@ts në lidhje me verifikimet në terren, ka rezultuar se ato janë jashtë tematikës së përcaktuar për verifikim nga analiza e riskut të DMR, që është verifikimi tatimpaguesve për t'u monitoruar në terren pasi mund të ketë risk nëndeklarimi (Fundjavë 14,15,16 Korrik organizohet "T. F."), sipas kriterit nr. 4 të thyer.

Përmbajtja e Akt Konstatimeve sipas C@ts	NIPT	Emri subjektit
Pa trajtuar tematikën e kriterit nr.4 "Tatimpagues për t'u monitoruar në terren pasi mund të ketë risk nëndeklarimi - Fundjavë 14,15,16 Korrik organizohet "T. F." të thyer sipas analizës së DMR	L.....B	L. A.
Pa trajtuar tematikën e kriterit nr.4 "Tatimpagues për t'u monitoruar në terren pasi mund të ketë risk nëndeklarimi - Fundjavë 14,15,16 Korrik organizohet "T. F." të thyer sipas analizës së DMR	M.....D	M. Ç.
Pa trajtuar tematikën e kriterit nr.4 "Tatimpagues për t'u monitoruar në terren pasi mund të ketë risk nëndeklarimi - Fundjavë 14,15,16 Korrik organizohet "T. F." të thyer sipas analizës së DMR	L.....A	A.
Pa trajtuar tematikën e kriterit nr.4 "Tatimpagues për t'u monitoruar në terren pasi mund të ketë risk nëndeklarimi - Fundjavë 14,15,16 Korrik organizohet "T. F." të thyer sipas analizës së DMR	L.....J	Rr. S.
Pa trajtuar tematikën e kriterit nr.4 "Tatimpagues për t'u monitoruar në terren pasi mund të ketë risk nëndeklarimi - Fundjavë 14,15,16 Korrik organizohet "T. F." të thyer sipas analizës së DMR	K.....O	H. S.
Pa trajtuar tematikën e kriterit nr.4 "Tatimpagues për t'u monitoruar në terren pasi mund të ketë risk nëndeklarimi - Fundjavë 14,15,16 Korrik organizohet "T. F." të thyer sipas analizës së DMR	K.....D	C. To C.
Pa trajtuar tematikën e kriterit nr.4 "Tatimpagues për t'u monitoruar në terren pasi mund të ketë risk nëndeklarimi - Fundjavë 14,15,16 Korrik organizohet "T. F." të thyer sipas analizës së DMR	L.....B	A. Ç.
Pa trajtuar tematikën e kriterit nr.4 "Tatimpagues për t'u monitoruar në terren pasi mund të ketë risk nëndeklarimi - Fundjavë 14,15,16 Korrik organizohet "T. F." të thyer sipas analizës së DMR	M.....E	J. D.
Pa trajtuar tematikën e kriterit nr.4 "Tatimpagues për t'u monitoruar në terren pasi mund të ketë risk nëndeklarimi - Fundjavë 14,15,16 Korrik organizohet "T. F." të thyer sipas analizës së DMR	K.....H	H. Gj.
Pa trajtuar tematikën e kriterit nr.4 "Tatimpagues për t'u monitoruar në terren pasi mund të ketë risk nëndeklarimi - Fundjavë 14,15,16 Korrik organizohet "T. F." të thyer sipas analizës së DMR	M.....J	V.
Pa trajtuar tematikën e kriterit nr.4 "Tatimpagues për t'u monitoruar në terren pasi mund të ketë risk nëndeklarimi - Fundjavë 14,15,16 Korrik organizohet "T. F." të thyer sipas analizës së DMR	K.....F	S. M.
Pa trajtuar tematikën e kriterit nr.4 "Tatimpagues për t'u monitoruar në terren pasi mund të ketë risk nëndeklarimi - Fundjavë 14,15,16 Korrik organizohet "T. F." të thyer sipas analizës së DMR	L.....H	A. P.
Pa trajtuar tematikën e kriterit nr.4 "Tatimpagues për t'u monitoruar në terren pasi mund të ketë risk nëndeklarimi - Fundjavë 14,15,16 Korrik organizohet "T. F." të thyer sipas analizës së DMR	L.....U	I. M.
Pa trajtuar tematikën e kriterit nr.4 "Tatimpagues për t'u monitoruar në terren pasi mund të ketë risk nëndeklarimi - Fundjavë 14,15,16 Korrik organizohet "T. F." të thyer sipas analizës së DMR	M.....Q	I. Zh.
Pa trajtuar tematikën e kriterit nr.4 "Tatimpagues për t'u monitoruar në terren pasi mund të ketë risk nëndeklarimi - Fundjavë 14,15,16 Korrik organizohet "T. F." të thyer sipas analizës së DMR	L.....U	I. M.
Pa trajtuar tematikën e kriterit nr.4 "Tatimpagues për t'u monitoruar në terren pasi mund të ketë risk nëndeklarimi - Fundjavë 14,15,16 Korrik organizohet "T. F." të thyer sipas analizës së DMR	L.....F	Dh. - 001
Pa trajtuar tematikën e kriterit nr.4 "Tatimpagues për t'u monitoruar në terren pasi mund të ketë risk nëndeklarimi - Fundjavë 14,15,16 Korrik organizohet "T. F." të thyer sipas analizës së DMR	L.....U	B.

Burimi: DMR në DPT, përpunoi grupi i audituesve të KLSH.

Nga analiza e detajuar dhe nga shqyrtimi i akt konstatimeve të mbajtur nga inspektorët e DVKT, në sistemin informatik tatimor C@ts në lidhje me verifikimet në terren, ka rezultuar se ato janë jashtë tematikës së përcaktuar për verifikim nga analiza e riskut të DMR, që është verifikimi i tatimpaguesve me aktivitet akomodim me çmim dhomash shumë të ulëta, sipas kriterit nr.5 të thyer.

Përmbajtja e Akt Konstatimeve sipas C@ts	Emri subjektit
Pa trajtuar tematikën e kriterit nr.5 "Tatimpagues me aktivitet akomodim me çmim dhomash shumë të ulëta" të thyer sipas analizës së DMR	K. - I.
Pa trajtuar tematikën e kriterit nr.5 "Tatimpagues me aktivitet akomodim me çmim dhomash shumë të ulëta" të thyer sipas analizës së DMR	P. Shpk
Pa trajtuar tematikën e kriterit nr.5 "Tatimpagues me aktivitet akomodim me çmim dhomash shumë të ulëta" të thyer sipas analizës së DMR	B. -B
Pa trajtuar tematikën e kriterit nr.5 "Tatimpagues me aktivitet akomodim me çmim dhomash shumë të ulëta" të thyer sipas analizës së DMR	B.
Pa trajtuar tematikën e kriterit nr.5 "Tatimpagues me aktivitet akomodim me çmim dhomash shumë të ulëta" të thyer sipas analizës së DMR	Ll. F. Shpk
Pa trajtuar tematikën e kriterit nr.5 "Tatimpagues me aktivitet akomodim me çmim dhomash shumë të ulëta" të thyer sipas analizës së DMR	H. Z.
Gjithashtu, në lidhje me informacionet e ardhura për ndjekje nga burime të ndryshme të informacionit në Drejtorinë e Investigimit të Brendshëm Antikorrupsion në DPT, janë gjithsej 18 raste të verifikuara/investiguara, të cilat nuk përmbajnë dhe nuk plotësojnë kushtet e mjaftueshme për t'u regjistruar si çështje. Çështjet të trajtuara gjatë vitit 2023, në mënyrë analitike për çdo drejtori: 56 çështje, të ndara sipas DRT-ve: Tiranë 31 çështje; Elbasan 3 çështje; Sarandë 4 çështje; Vlorë 3 çështje; Fier 2 çështje; Berat 1 çështje; Durrës 7 çështje; Korçë 1 çështje; Shkodër 1 çështje; Gjirokastrë 1 çështje; Lezhë 1 çështje; Dibër 1 çështje.

Nga grupi i auditimit u përzgjedhën për kontroll 4 DRT, konkretisht Tirana, Durrësi, Saranda dhe Elbasani pasi janë drejtoritë me numrin më të madh të denoncimeve ku u verifikuan rastet për të cilat janë konstatuar shkelje administrative si dhe rastet pa ecuri.

Për DRT Tiranë, gjatë vitit 2023, nga DIBA në DPT, janë investiguar 31 ankesa nga të cilat për 6 ankesa janë konstatuar shkelje disiplinore dhe 31 punonjës janë referuar pranë Komisionit të Disiplinës në DPT, nga të cilat u kontrolluan 2 praktika të cilat pasqyrohen si më poshtë:

Rasti nr.1, ka ardhur me shkresën nr.5891 prot, datë 26.08.2022, ardhur nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, ku pretendohet për rritje me ritme të larta të numrit të subjekteve me detyrime të prapambetura, problematikë e cila është konstatuar në vazhdimësi në lidhje me mospagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore nga ana e subjekteve aktive. Për rastin në fjalë DIBA ka regjistruar çështjen nr.33, ardhur në DIBA në datë 05.12.2022, kaluar për ndjekje në regjistrin e vitit 2023 me Nr.06 Regj. Në lidhje me rastin DIBA ka referuar në Komisionin e Disiplinës 23 punonjës për të cilët janë marrë masat sipas parashikimeve ligjore. Çështja është mbyllur nga DIBA me shkresën nr.5293/1 prot., datë 21.03.2023, me lëndë “Konstatim i shkeljes disiplinore”.

Rasti nr.2, ka ardhur me e-mail, në adresën www.denoncime@tatime.gov. “Akt Abuziv, nr.14” në datë 01.01.2023, ku pretendohet se punonjësja e DTR Tirane, znj. E. B. është e punësuar në dy vende pune njëkohësisht në kundërshtim me ligjin. Në lidhje me rastin DIBA ka regjistruar çështjen me nr.7, ku në përfundim të verifikimeve ka referuar në Komisionin e Disiplinës 1 punonjës për të cilën janë marrë masat sipas parashikimeve ligjore. Çështja është mbyllur nga DIBA me shkresën nr.6048/1 prot., datë 03.04.2023, me lëndë “Konstatim i shkeljes disiplinore”.

Për DRT Durrës, gjatë vitit 2023, nga DIBA në DPT, janë investiguar 7 ankesa nga të cilat për 3 ankesa është konstatuar shkelje disiplinore dhe 8 punonjës janë referuar pranë Komisionit të Disiplinës në DPT, nga të cilat u kontrolluan 2 praktika të cilat pasqyrohen si më poshtë:

Rasti nr.1, ka ardhur me e-mail, në datën 05.04.2023, nga Drejtori i Përgjithshëm, ku kërkohet të investigohet në mënyrë të plotë subjekti “H. D. V.” për ndryshimet e deklaratave dhe listëpagesave si dhe punonjësit e tatimeve të përfshirë në lidhjen e Akt Marrëveshjeve për pagesë të detyrimeve me këste. DIBA ka regjistruar çështjen nr.14, datë 05.04.2023, Në lidhje me rastin DIBA ka referuar në Komisionin e Disiplinës 3 punonjës për të cilët janë marrë masat sipas parashikimeve ligjore. Çështja është mbyllur nga DIBA me shkresën nr.11174 prot, datë 05.07.2023, me lëndë “Konstatim i shkeljes disiplinore”.

Rasti nr.2, ka ardhur me e-mail, në datën 07.07.2023, nga Drejtoria e Hetimit Tatimor, ku kërkohet të investigohet ligjshmëria e procedurës së nxjerrjes jashtë përdorimit të mallrave të subjektit “C. Shpk”, DIBA ka regjistruar çështjen nr. 25, datë 07.07.2023, Në lidhje me rastin

DIBA ka referuar në Komisionin e Disiplinës 4 punonjës për të cilët janë marrë masat sipas parashikimeve ligjore. Çështja është mbyllur nga DIBA me shkresën nr.17747/1 prot, datë 07.11.2023, me lëndë “Konstatim i shkeljes disiplinore”.

Për DRT Sarandë, gjatë vitit 2023, nga Drejtoria e Investigimit të Brendshëm Antikorrupsion në DPT, janë investiguar 4 ankesa, nga të cilat u kontrollua 1 praktik e cilat pasqyrohet si më poshtë:

Rasti nr.1, ka ardhur me shkresën, Nr.1044/6 në datën 01.02.2023, nga KLSH, kaluar për trajtim ankesa e z. K. K., i cili pretendon se punonjësi i DRT Sarandë z. S. L. abuzon me orarin e punës. DIBA ka regjistruar çështjen nr.09, datë 01.02.2023, Në lidhje me rastin DIBA ka referuar në Komisionin e Disiplinës 1 punonjës për të cilët janë marrë masat sipas parashikimeve ligjore. Çështja është mbyllur nga DIBA me shkresën nr.1580/2 prot, datë 03.04.2023, me lëndë “Konstatim i shkeljes disiplinore”.

Për DRT Elbasan, gjatë vitit 2023, nga DIBA në DPT, janë investiguar 4, nga të cilat u kontrollua 1 praktik e cilat pasqyrohet si më poshtë:

Rasti nr.1, ka ardhur me shkresën nr.6514, datë 13.04.2023, “Akt Abuziv, nr.330” në datë 25.04.2023, nga z. I. S., ku pretendohet se disa subjekte nuk janë të rregullta dhe favorizohen nga punonjësit DRT Elbasan dhe në këto subjekte nuk kryen kontrole nga Administrata Tatimore. DIBA ka regjistruar rastin me Nr.6 R.D, datë 24.05.2023. Mbas verifikimit të rastit pretendimet e denoncuesit nuk qëndrojnë, informacioni nuk përmban elemente dhe nuk plotësohen kushtet e mjaftueshme për t’u regjistruar si çështje, nga DIBA është proceduar me mbyllje të rastit pa ecuri, me lëndë “Relacion mbi denoncimin e ardhur për Drejtorin e DIBA-s”.

Për sa më sipër me personat përgjegjës K. M. dhe C. K.

2.6.4 Auditimi i përputhshmërisë së procedurave të ndjekura nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor.

Nga auditimi i evidencat e realizimit të kontrolleve plan/fakt sipas DRT për vitin 2023 sipas DRT-ve me zbulime dhe evidencave të fazave në të cilat ndodhen kontrollet në proces të ndara sipas viteve të vënë në dispozicion konstatohet se:

- Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT ka funksion kontrollin e performancës së realizimit të detyrave nga Drejtoritë e Kontrollit në të gjitha DRT dhe ofrimi i asistencës së duhur profesionale dhe analiza e dhënave statistikore të situatës së kontrolleve.
- Objektiv i kryesor i Drejtorisë së Kontrollit në DPT është udhëheqja metodologjike e funksionimit të kontrollit tatimor dhe monitorimi i punës së drejtorive tatimore rajonale. Struktura e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor është miratuar me Urdhërin e Kryeministrit Nr.69 datë 26.05.2023 “Për miratimin e strukturës së organizative dhe numrit të përgjithshëm të personelit të administratës tatimore qendrore”.

Drejtoria e Kontrollit tatimor përbëhet si më poshtë:

1. Drejtori i Drejtorisë;
2. Sektori i Kontrollit Tatimor (1+10);
3. Sektori i Taksimit të dyfishtë (1+7);
4. Sektori Monitorimit dhe Standartizimit të Procedurave të Kontrollit Tatimor (1+3).

Drejtoria e Kontrollit Tatimor për vitin 2023 ka përfunduar kontrollet të cilat që kanë qenë në proces në datën 31.12.2022 dhe janë mbyllur brenda vitit 2023, këto kontrole janë kryer në DTM, DRT Fier, DRT Tiranë, i cili është shtyrë për shkak të kontrollit që ka ushtruar KLSH si dhe bazuar dhe në rekomandimin e Grupit të auditimit të KLSH së fundit në DPT. Nga

verifikimi i kontrolleve të ushtruara në drejtoritë rajonale nga inspektorët e kontrollit të D.K.T (Sektori i Kontrollit Tatimor dhe Sektori i Procedurave të Kontrollit dhe Monitorimit sipas programeve të kontrollit të miratuara), për zbatimin e legjislacionit tatimor konstatohet si më poshtë:

DRT Tiranë me Autorizim të Drejtorit të Përgjithshëm Nr.16946, datë 11.11.2022 dhe Program Kontrolli për periudhën Korrik 2019 –Prill 2022.

Inspektor: Neritan Matoshi, Pranvera Milori.

Raporti Përfundimtar i Kontrollit ka arritur në konkluzionin se:

- Hartimet e programeve të kontrollit duhet të jenë të veçanta, në lidhje me llojin e tatimeve të programuara për kontroll, duhet të jenë sa më të detajuara dhe me pika për probleme të cilat mund të sjellin zbulimin e detyrimeve tatimore.

- Nga DK në DRT Tiranë në hartimin e programeve të kontrollit të kihet parasysh që përveç pikave standarte të shtohen edhe pika të tjera të cilat kane të bëjnë me shkresa apo qarkore të dala nga DPT-ja në funksion të kontrolleve sa më të plota dhe më cilësore.

- Me mbylljen e kontrollit tatimor, në raportin përfundimtar të kontrollit, të pasqyrohen jo vetëm zbulimet, por edhe niveli i ri (ndryshimi) i treguesve fiskal/llojeve të tatimit pas kontrollit (ishte-bëhet). Kjo jo vetëm për të dhënë sa më të qarta efektet e kontrollit, por edhe për arsye se në disa raste, megjithëse subjekti ka dalë për kontroll të plotë tatimorë, pra me risk, zbulueshmëria nga kryerja e kontrollit është e tillë, sa që edhe pas kryerjes së kontrollit, treguesit e riskut ngelen të pa ndryshuar.

- Analiza e posteve të bilancit, nuk duhet të ketë karakter formal, por duke analizuar/shprehur për faktorët që kanë ndikuar në ndryshimin e tyre sipas periudhave nën kontroll dhe justifikimi i ndryshimeve, mbi bazë dokumentacioni.

- Huatë apo overdraft-et dhe ndryshimi i vlerës së tyre nga njëra periudhë objekt kontrolli në tjetrën, të trajtohen në mënyrë analitike, duke u shoqëruar/referuar me dokumentacion justifikues, si pjesë e dokumentacionit të raportit përfundimtar të kontrollit tatimor. Me të njëjtën mënyrë/formë të trajtohen edhe ndërhyrjet e ortakut me mjete likuiduese për nevojat e shoqërisë.

- Plotësimi i deklaratave mujore të ndiqet në mënyrë të pandërprerë dhe nëse konstatohen pasaktësi, të bëhet menjëherë me dije tatimpaguesi.

- Analiza e qarkullimit të parasë (cash flow), duhet të bëhet në mënyrë të detajuar, lidhur me verifikimin e saktësisë së të ardhurave dhe shpenzimeve pra me gjenerimin dhe përdorimin e parasë, për periudhën nën kontroll.

- Për tatimpaguesit me përgjegjësi tatimore TVSH, të bëhet në vazhdimësi krahasimi i të dhënave të transmetuara nga fiskalizimi me FDP-te mujore dhe për rastet kur të dhënat e kasave fiskale janë me të mëdha sesa deklaratimet në FDP-te mujore të njoftohet dhe të rakordohet me tatimpaguesin dhe në rastet kur gjykohet për mosdeklarim të bëhen vlerësimet përkatëse.

- Të bëhet analiza të vendeve dhe të kostove të punës. Kontrolli ka qenë vetëm konstatues dhe konfirmues i numrit të punonjësve që vetëdeklarohen nga tatimpaguesit dhe nuk ka argumentim të bazuar në zërbërthimin e analizave të kostove dhe vëllimeve të prodhimeve apo qarkullimit që realizon tatimpaguesi. Nuk ka analiza të vendeve të nevojshme të punës sipas veçantive të aktivitetit, volumit të qarkullimit të mallit dhe shërbimit, etj., të orientuar dhe nga detyrimi ligjor që kanë punëdhënësit për zbatim të kushteve të kontratave të punës, sipas Kodit të Punës.

- Në kontrollet e plota vazhdohet të mos trajtohen si duhet të gjitha metodikat e përfshira në Manualin e Kontrollit Tatimor. Në mjaft raste nuk bëhet inventarizimi i likuiditeteve (arkë dhe bank) dhe analiza e qarkullimit të tyre (cash flow), analiza e ndryshimit dhe gjendjes së kapitaleve, analiza e saldove të llogarive dhe inventarizimi i tyre në momentin e kontrollit (aseteve, bankave, klientëve apo furnitorëve), njësoj si bëhet për inventarin fizik të mallrave

dhe materialeve, si dhe mjaft metoda e mjete te tjera të përshkruara në Manual, që ndihmojnë për arritjen e saktë të zbulimit nga kontrolli.

- Në disa raste konstatohen se nuk bëhen analiza dhe të trajtohen në raport kontrolli referencat doganore evidentimi i tyre, zberthimi se përse dhe në çfarë artikujsh janë ndërhyrjet e doganave dhe krahasimi i çmimit të shitjes të këtyre artikujve, blerjeve dhe atyre te referencave doganore, për të gjykuar lidhur me saktësinë e deklarimeve te blerjeve dhe shitjeve te subjektit.

- Nga DRT Tirane, duhet te analizohen në mënyrë të detajuar llogarite klient-furnitor.

- Nga DRT Tirane, duhet të zbatohet Ligji Nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në R.SH.”, i ndryshuar, udhëzimit në zbatim të tij, neni 30 deri në nenin 38, nene në të cilat janë përcaktuar të drejtat e tatimpaguesit, neni 80.3, neni 81.1/1, neni 83 dhe neni 84.

- Observacionet e tatimpaguesit duhet të reflektohen në Raportin Përfundimtar të Kontrollit në mënyrë të detajuar duke dhënë të gjitha arsyet e pranimit apo mospranimit të kundërshtimeve të tatimpaguesit.

- Nga DRT Tirane të zbatohet procedura që parashikon Ligji Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 23 pika 3, si dhe neni 84, pika 1. RK përfundimtarë, të mbyllën në respektim të afateve procedurale që parashikon Ligji Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, që do të thotë, edhe në rastet kur tatimpaguesi nuk paraqet kundërshtim, afati i mbylljes se RK përfundimtar, që nga momenti i dërgimit të RK Projekt e deri në momentin kur kundërshtimi i tatimpaguesit, vlerësohet të jetë marrë nga grupi i kontrollit tatimor, është 39 dite kalendarike.

- Nga DRT Tirane, Vizitat fiskale duhet te trajtohen ne vazhdimësi nga ana procedurale, si kontroll i plote, pasi duhet të ndiqet procedura e Raportit Paraprak dhe Raportit Përfundimtar.

- Nga DRT Tiranë, të monitorohen nëpërmjet të dhënave nga dogana menjëherë dhe në mënyrë të vazhdueshme bizneset e vogla pa TVSH të cilët kryejnë importe për rishitje pa qenë të regjistruar në mënyre që regjistrimi i tyre me TVSH të behet sa më shpejt

- Nga DRT Tiranë, të ndiqen periodikisht raportet nga dogana në lidhje me import –eksportet në mënyrë që për diferencat e konstatuara të komunikohet me subjektin sa më shpejt dhe të saktësohen diferencat.

- Nga DRT Tiranë, të mbahen ne forme evidence të gjitha shkresat e DPT në lidhje me taksimit të dyfishtë për subjektet në mënyrë që të përdoren në analizat dhe kontrollet që do të bëhen edhe nga inspektorët e monitorimit dhe kontrollit nga zyra.

- Nga DRT Tiranë, të mbahen në forme evidence të gjitha Vendimet e Drejtorisë së Apelimit Tatimor si dhe këto Vendime të ngarkohen në sistem në mënyrë që dosja elektronike e subjektit të jetë sa më e plotë. E njëjta gjë vlen edhe për Vendimet e Gjykatave.

- Nga DRT Tiranë, të verifikohen rastet me te cilët kreditojnë TVSH-në me shkallë 6%, dhe 10% për tatimpaguesit me aktivitet hoteleri të verifikohen Çertifikatat e Akomodimi nga Ministria e Turizmit.

- Nga DRT Tiranë, të verifikohen rastet të cilët kanë aplikuar shkallën e tatim fitimit 5% të verifikohen lloji i aktivitetit që zhvillojnë dhe nëse zhvillojnë aktivitete në fushën e prodhimin/zhvillimin e software-ve a plotësojnë kushtet sipas VKM 730 datë 12.12.2018.

- Gjithashtu janë nxjerrë për rikontroll sipas problematikave të cituara në Raport Kontrolli, tatimpaguesit e mëposhtëm:

- "A. C." SHPK me NIPT K.....E

- H.-A. me NIPT L.....F

- G. K. 2018 me NIPT K.....F

- J. me NIPT K.....J

- K. Y. me NIPT L.....G

- E. D.V. me NIPT K.....E

Kontroll i Plotë në DTM, sipas Autorizimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve Nr.19155 prot, datë 11.11.2022, dhe Programit të Kontrollit Nr.19155/1 prot, datë 11.11.2022, të miratuar nga Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në DPT për periudhën korrik 2019-prill 2022 Inspektor P. K., M. A., E. P..

Raporti Përfundimtar i Kontrollit ka arritur në konkluzionin se:

- Çështjet në sistem nuk hapen menjëherë kur plani i muajt dërgohet në DRT.
- Paraqiten vonesa në menaxhimin e çështjeve nga drejtuesit dhe për pasojë edhe në firmosjen e raport kontrolleve dhe mbylljen e çështjeve.
- Në lidhje me pasqyrimin e veprimeve të kontrollit në sistemin informatik të tatimeve C@TS, (çështjet/dokumentat), ka vonesa në krijimin e çështjeve të kontrollit dhe rrjedhjen e çështjes (miratimin e raporti paraprak dhe përfundimtar), si dhe konstatohet mangësi në hedhjen në sistem të gjithë materialit justifikues të kryerjes së kontrollit, si leja e ndërtimit, karta teknologjike, proçes verbalet e mbajtura tek tatimpaguesi etj..
- Inspektorët angazhohen në program kontrolle të tjera paralele ndërkohë që janë duke kryer një kontroll tjetër. Prioriteti i kryerjes së një kontrolli nga kontrolli tjetër ose detyra shtesë që i caktohet nuk është gjithmonë mbyllja e kontrollit të parë. Konkretisht në rastin e kontrolleve për rimbursim ato kryheshin menjëherë.
- Konstatohen se për kontrollet në vend, raste të kontrolleve kryesisht në fushën e ndërtimit , prodhimit apo për lloje aktivitete specifike konstatohet se nuk citohet apo nuk depozitohet i gjithë dokumentacioni justifikues i përdorur dhe i domosdoshëm që ka ndikuar në gjykimin e deklarimit dhe llogaritjeve të detyrimeve fiskale, si psh të lejeve të ndërtimit, të kartave teknologjike, të marrëveshjeve ndërmjet kontraktorëve apo nënkontraktorëve etj, kërkesë kjo në zbatimin e Manualit të Kontrollit.
- Mungon përmbledhëse e gjetjeve dhe bazës ligjore përkatëse për të evidentuar diferencat mes Raport Kontrollit dhe Njoftim Vlerësimit për detyrimet tatimore, kjo bazuar në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2018, “Për proçedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 83, pika 2, “Raporti i Kontrollit Tatimor, jep rezultatet e kontrollit, shumën e vlerësimit të propozuar dhe referencat ligjore, që justifikojnë propozimin e bërë dhe nënshkruhet nga inspektori/inspektorët, e kontrollit tatimor.
- Vihet re se nga inspektorët e kontrollit në vend, kontrollin e kryqëzimit të faturave, në shumë raste e bëjnë me përzgjedhje, si dhe nuk evidentohet kryerje e tyre me transaksionet përkatëse , kusht ky që konsiderohet në fushën e zbatimit të TVSH, kur ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë mes furnizimit të kryer dhe kundërvlerës (pagesës) së marrë.
- Nga inspektorët e kontrollit në vend, duhet të kryhen analiza më të thelluara teknike si kontrolli i kapaciteteve të prodhimit, apo i matjeve të firove, i harxhimeve sipas skedave të makinerive, apo kartave teknologjike, kontrolli i autorizimeve apo lejeve të ndryshme që disponon tatimpaguesi, sipas llojit të aktivitetit, kontrollin e tyre për kushtet dhe aktualitetin e tyre, analiza e zërave të pasqyrave financiare si analiza sintetike për klientët dhe furnitorët, të krijimit dhe verifikimit të transaksioneve për llogarinë ortakë, analizë mbi destinimin e fitimit, analizë të cash floë. Huatë apo overdraft-et dhe ndryshimi i vlerës së tyre nga njëra periudhë objekt kontrolli në tjetrën, trajtohen në mënyrë përshkrimore, pa u shoqëruar/referuar me dokumentacion justifikues, si pjesë e dokumentacionit të raportit përfundimtar të kontrollit tatimor.
- Për konstatimet e diferencave nga dogana duhet të dërgohet shkresë zyrtare DR Doganës për konfirmim të të dhënave dhe të pritët konfirmimi përkatës , nuk duhet të vazhdojë kontrolli duke marrë për baze vetëm faturat origjinale që disponon tatimpaguesi Pasi DR Doganës mund të ketë të dhëna shtesë të tipit rivlerësim apo sistemim deklarate të cilat ndikojnë në gjykimin e drejtë për shitjet nga eksporti.
- Nga konstatimi i punës së inspektorëve nga zyra, si dhe nga konstatimet mbi analizën e pasqyrave financiare nga inspektorët, në vite, rezulton se nuk është respektuar afati i kontrollit

të pasqyrave financiare. Gjithashtu nuk ka evidenca dhe informacion, se sa tatimpaguesve u është bërë kontrolli i pasqyrave financiare, detyrë kjo funksionale bazuar në Manualin e Kontrollit nga Zyra.

- Nga kontrolli u konstatua se Inspektorët e kontrollit nga zyra, nuk rezultojnë të kenë plane për analizë me tematika të caktuara që dalin nga përpunimi i raporteve të deklarimeve të tatimpaguesve si psh: analiza mbi kredinë e TVSH-së, analiza në lidhje me rënien e xhiros, apo tatimpaguesit me xhiro të lartë dhe numër punonjësish të ulët, si dhe efektet tatimore që rezultojnë nga këto analiza.

- Rezultuan Çështje të hapura dhe të pambyllura në sistem, të cilat nuk janë mbyllur për arsye se janë çështje të vjetra dhe kërkojnë zgjidhje teknike në bashkëpunim me drejtorinë TIK.

- Nga kontrolli u konstatua se inspektorët e kontrollit nga zyra, nuk rezultojnë të kenë evidence për Vendimet e DAT-së dhe Vendimet e Gjykatës me të dhënat përkatëse dhe ekzekutimin e tyre. Nga grupi i kontrollit u la detyrë që DTM të krijojë regjistra për evidentimin e vendimeve të DAT dhe Vendimeve të Gjykatës.

- Gjithashtu janë nxjerrë për rikontroll sipas problematikave të cituara në Raport Kontrolli, tatimpaguesit e mëposhtëm:

- “G. C.” SHPK me NIPT K.....T

- “A.” SHPK me NIPT K.....T

Kontroll i Plote ne DRT Fier sipas Autorizimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve 8512., prot, datë 20.05.2022, dhe Programit të Kontrollit Nr.8512/1 prot, datë 20.05.2022, të miratuar nga Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në DPT për periudhën korrik 2019-prill 2022. Inspektorët: P. K., M. A..

Raporti Përfundimtar i Kontrollit ka arritur në konkluzionin se:

- Çështjet në sistem nuk hapen menjëherë kur plani i muajt dërgohet në DRT.

- Paraqiten vonesa në menaxhimin e çështjeve nga drejtuesit dhe për pasojë edhe në firmosjen raport kontrolleve dhe mbylljen e çështjeve.

- Në lidhje me pasqyrimin e veprimeve të kontrollit në sistemin informatik të tatimeve C@TS, (çështjet/dokumentat), ka vonesa në krijimin e çështjeve të kontrollit dhe rrjedhjen e çështjes (miratimin e raporti paraprak dhe përfundimtar), si dhe konstatohet mangësi në hedhjen në sistem të gjithë materialit justifikues të kryerjes së kontrollit, si leja e ndërtimit, karta teknologjike, proces verbalet e mbajtura tek tatimpaguesi etj.

- Inspektorët angazhohen në program kontrolle të tjera paralele ndërkohë që janë duke kryer një kontroll tjetër. Prioriteti i kryerjes së një kontrolli nga kontrolli tjetër ose detyra shtesë që i caktohet nuk është gjithmonë mbyllja e kontrollit të parë. Konkretisht në rastin e kontrolleve për rimbursim ato kryheshin menjëherë.

- Mungon përmbledhëse e gjetjeve dhe bazës ligjore përkatëse për të evidentuar diferencat mes Raport Kontrollit dhe Njoftim Vlerësimit për detyrimet tatimore, kjo bazuar në Ligjin Nr.9920, datë 19.05.2018, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 83, pika 2, “Raporti i Kontrollit Tatimor, jep rezultatet e kontrollit, shumën e vlerësimit të propozuar dhe referencat ligjore, që justifikojnë propozimin e bërë dhe nënshkruhet nga inspektori/inspektorët, e kontrollit tatimor.

- Në shumë raste nuk përputhen vlerat e gjetjeve të Raport Kontrollit me detyrimin në Njoftim Vlerësimin të gjeneruar nga sistemi tatimor, për gjetje/ulje të tepricës kreditore të TVSH-së, për gjetje/ulje të humbjes, llogaritjen e interesave që gjeneron sistemi, për arsyen e mos respektimit të afateve të miratimit nga struktura përkatëse e Drejtorisë Rajonale Tatimore (momentit të hedhjes dhe momentit të firmosjes dhe mbylljes së çështjes së kontrollit në sistemin tatimor nga titullari të Raport Kontrollit).

- Vihet re se nga inspektorët e kontrollit në vend, kontrollin e kryqëzimit të faturave në shumë raste e bëjnë me përzgjedhje, si dhe nuk evidentohet kryerje e tyre me transaksione, kusht ky

që konsiderohet në fushën e zbatimit të TVSH, kur ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë mes furnizimit të kryer dhe kundërvlerës (pagesës) së marrë. Gjithashtu vërehet se për tatimpaguesit eksportues apo transport ndërkombëtar, miratohet e gjithë shuma për rimbursim edhe për kredinë që i përket shitjeve brenda vendit me shkallë tatimore 20%, pavarësisht se ato zënë një pjesë të vogël në xhiron totale dhe analiza bëhet vetëm në treguesin e KMSH-së. Shkallë tatimore 20%, të kryhet vetëm në qoftëse bëhet analiza reale e kostos, dhe të ketë dokumentacion të njohur ligjor për të faktuar çmimet e tregut.

- Nga inspektorët e kontrollit në vend, vërehet se nuk ka analiza teknike si kontrolli i kapaciteteve të prodhimit, apo i matjeve të firove, i harxhimeve sipas skedave të makinerive, apo kartave teknologjike, kontrolli i autorizimeve apo lejeve të ndryshme që disponon tatimpaguesi, sipas llojit të aktivitetit, kontrollin e tyre për kushtet dhe aktualitetin e tyre, analiza e zërave të pasqyrave financiare si analiza sintetike për klientët dhe furnitorët, të krijimit dhe verifikimit të transaksioneve për llogarinë ortakë, analizë mbi destinimin e fitimit, analizë të cash floë. Huatë apo overdraft-et dhe ndryshimi i vlerës së tyre nga njëra periudhë objekt kontrolli në tjetrën, trajtohen në mënyrë përkrahore, pa u shoqëruar/referuar me dokumentacion justifikues, si pjesë e dokumentacionit të raportit përfundimtar të kontrollit tatimor.

- Konstatohet rivlerësimi i çmimeve me subjekte analoge pa dokument justifikues si dhe analiza e faktorëve, të cilët kanë ndikuar negativisht te treguesi i tvsh-së, nga inspektori i kontrollit janë përdorur çmimet me tregun si tregues krahasues për subjekte te ngjashëm të pa bazuara. Kjo bazuar në Ligjin nr. 9920 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Neni 72 Baza e mënyrave alternative të vlerësimit, pika 1 “Mënyrat alternative të vlerësimit nuk kufizohen”, por bazohen në: ç) Të dhënat e tërthorta, bazuar në çmimet e tregut të mallrave dhe shërbimeve të ngjashme, të çmimeve të referencave të qirave, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

- Programet e punës bashkëlidhur Njoftimeve të Kontrollit nuk kanë të përfshirë si pikë programi më vete kontrollin e autorizimeve për rindërtimin bazën ligjore dhe VKM 143, datë 13.02.2020, “Procedurat për lëshimin e autorizimit për subjektet e rindërtimit dhe për përjashtimin nga tatimi mbi vlerën e shtuar të furnizimit të mallrave e shërbimeve për qëllime të procesit të rindërtimit”, e ndryshuar me VKM Nr. 804, datë 30.09.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.143, datë 13.2.2020”. si dhe nuk kanë të përfshira dhe kushtet dhe rregullat e kontrollit të përcaktuara në shkresat Udhëzuese të DPT për procesin e rindërtimit.

- Mungesa e raporteve të inxhinierit të ndërtimit (Raporti i inxhinierit të ndërtimit përcakton vlerën reale të punimeve dhe zërthimin e bazës materiale për çdo objekt). Lejet e ndërtimit, vlefshmëria e tyre, vlera dhe afatet, pasi shkelja e lejes përkatëse të ndërtimit të lëshuar nga autoritetet e fushës sjell pasoja në pagesën e detyrimeve tatimore. Marrëdhëniet me pronarët e tokës, pronari i tokës ose blerësi i tokës mbi të cilën do të ngrihet ndërtesa, Të dhëna mbi aksionet nga pronarët e tokës – toka, forma i financimit etj. Licensat për çdo vend ndërtimi (pasi ka rëndësi në analizën e adresave sekondare, nëse janë me qera apo asete të kompanisë etj. Kushtet e kontratave të qerasë apo Aktet e pronësisë.

- Konstatohet se në shumicën e rasteve që nuk ka evidentim të aktit të konstatimit të inxhinierit të ndërtimit për të bërë të mundur verifikimin e vlerës reale të kryerjes të punimeve dhe zërthimin e bazës materiale për çdo situacionim të kryer në kundërshtim me Ligjin 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimor në R.SH”, i ndryshuar neni 86 “Bashkëpunimi me specialist të jashtëm”.

- Duhet të trajtohen në mënyrë analitike marrëdhëniet me kontraktorët, apo nënkontraktorët. Të dhënat e nënkontraktorëve dhe marrëveshjet përcaktojnë përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrimet mes palëve, mënyrën e financimit të projektit, të dhëna të finalizuara të nënkontraktuesve, furnizuesit kryesorë të lëndëve të para etj.

- Në raport Kontrolli duhet te sqarohet nëse ka mbaruar ndërtimi në momentin e kontrollit, ose në çfarë faze janë.
- Të dhënat e kontabilitetit duhet të jenë kontrolluar veçmas llogaritë që pasqyrojnë kostot që sipas manualit të kontrollit citohet Në rastin kur një kontraktues ndërtimi është i përfshirë në më shumë se një ndërtim, duhet që llogaritë të pasqyrojnë veçmas kostot e çdo ndërtimi, në mënyrë që të mund të përcaktohet kostoja përfundimtare gjithsej.
- Mungesa e inventarit material në moment të marrjes së autorizimit, analiza e përdorimit, situacionimit të këtij inventari për realizimin e vlerës së autorizimit dhe efektin e korrigjimit të tvsh-së për këtë inventar Kjo mungesë konstatohet edhe në dosjet e krijuara për çdo autorizim, por edhe në ato raport kontrole që janë kontrolluar për efekt Rindërtimi.
- Në DRT Fier nuk konstatohet të jenë bërë verifikime mbi çmimet nga grupi i Rindërtimit. Në Raport kontrollet e kryera për Rindërtimin është përmendur përciptazi me shprehje si; Çmimet janë dukshëm më të ulëta se subjektet e ngjashme, por nuk vihen referencat e këtyre krahasimeve. Përrjashtimi nga Tvsh-ja duhet të reflektohet në çmimin e shitjes së materialeve, për furnizimet e shërbimeve dhe mallrave të cilat duhet të jenë dukshëm se furnizimet e ngjashme me to në raste të tjera jo për qëllime të fatkeqësisë natyrore është përmendur përciptazi me shprehje si; Çmimet janë dukshëm më të ulëta se subjektet e ngjashme, por nuk vihen referencat e këtyre krahasimeve.
- Nga gjithë procesi i monitorimit nuk konstatohen të ketë analizë mbi sasinë e mallrave dhe shërbimeve të përcaktuara në listën e depozituar nga shoqëritë ndërtuese nuk shfrytëzohen brenda periudhës kohore të përcaktuar në lejen e ndërtimit ose nuk shfrytëzohen në funksion të aktivitetit të përcaktuar kjo e domosdoshme pasi pjesa e pashfrytëzuar e materialeve i nënshtrohet TVSH.
- Evidentimi në mënyrë periodike mbi efektet e faktorëve që ndikojnë në realizimin e apo mosrealizimin e preventivit sipas autorizimit, monitorimi i Tvsh-së dhe efekti i korrigjimit të saj si pasojë e monitorimit të kushteve të aktivitetit të përcaktuar rindërtim, duhet të jetë sa më efektiv dhe krahasues e i aksesueshëm nga administrata në çdo kohë.
- Gjithashtu janë filluar ecuritë disiplinore për disa inspektorë në lidhje me moszbatimin e procedurave tatimore gjatë ushtrimit të kontrollit.

Nga të dhënat dhe dokumentacioni për vitin 2023, konstatohet se:

- Ndjek planet e kontroleve mujore të dërguara në DRT-të, nga DMR (70% të modulit 1 të DMR si dhe 30% e propozuara nga DRT dhe të miratuara) mbi bazën e rezultateve të kontroleve mujore të raportuara nëpërmjet evidencave mujore, brenda datës 10 të çdo muaji;
- Analizon dhe përpunon vlerësimet e mbledhura mbi analizën e riskut për tatimpaguesit e kontrolluar nga të gjitha drejtoritë tatimore rajonale;
- Mban evidencë të detajuar në lidhje me numrin dhe llojin e kontroleve për çdo DRT, duke analizuar rezultatet dhe progresin e bërë kundrejt planit dhe kundrejt faktorëve të riskut mbi të cilët subjekti është përzgjedhur për kontroll kjo në bashkëpunim me DMR;
- Të gjitha të dhënat e raportuara nga DRT-të, mbas analizimit dhe përpunimit i dërgohen Drejtorisë së Analizës dhe Kontabilitetit, në DPT.

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion është konstatuar se numri i kontroleve të planifikuara gjatë vitit 2023 është 2,965 kontrole, ku 2,282 kontrole janë kontrole të plota dhe 683 kontrole janë vizita fiskale. Përgjatë vitit 2023 rezulton se kontrollet e realizuara janë 3,006, ku 2,373 kontrole janë të plota dhe 633 kontrole janë vizita fiskale. Konstatohet një tejkalim i kontroleve të realizuara prej 41 kontrollesh ose rreth 1.4% e totalit të kontroleve të planifikuara.

Realizimi i kontrolleve për vitin 2023 të detajuar sipas DRT-ve plan, fakt, zbulime.

Në mijë

lekë

Nr	Rrethet	Nr. Kontrollte te planifikuara gjithsej			Nr. Kontrollte te kryera gjithsej			Zbulimet sipas llojeve te tatimeve					Ulje Humbje TF	
		Plote	V.fiskale	Totali	Plote	V.fiskale	Totali	TVSH	T FIT	Sig Shoq	Te tjera	Gjithsej	Nr kont	Totali
1	Berat	92	21	113	90	19	109	50,184	14,823	28	3,969	69,004	11	21,934
2	Dibër	70	17	87	66	14	80	26,052	36,771	2,662	1,102	66,587	9	14,553
3	Durrës	158	85	243	166	84	250	165,959	490,905	20,531	52,369	729,764	18	78,140
4	Elbasan	200	70	270	241	43	284	138,937	50,150	2,942	11,912	203,941	21	70,602
5	Fier	207	72	279	257	73	330	101,732	49,551	540	11,907	163,730	15	78,608
6	Gjirokastër	58	12	70	62	9	71	16,056	9,334	1,009	1,185	27,584	7	114,935
7	Korçë	125	44	169	176	39	215	26,701	20,375	123	3,012	50,211	28	35,683
8	Kukës	21	10	31	32	8	40	10,795	2,895	467	300	14,457	-	-
9	Lezhe	54	19	73	49	15	64	277,498	194,692	1,368	5,206	478,764	4	55,442
10	Sarandë	32	12	44	9	25	34	2,235	3,640	-	250	6,125	-	-
11	Shkodër	236	52	288	253	48	301	72,408	41,297	1,013	6,045	120,763	18	96,219
12	Vlorë	121	37	158	124	37	161	133,783	68,971	1,294	5,019	209,067	9	83,599
13	Tirana	447	104	551	393	90	483	879,709	1,246,309	29,406	540,336	2,695,760	57	371,011
14	DTM	461	128	589	455	129	584	1,466,892	1,077,735	4,063	46,391	2,595,080	39	10,270,815
	Shuma	2,282	683	2,965	2,373	633	3,006	3,368,941	3,307,448	65,446	689,003	7,430,837	236	11,291,541

Burimi: Drejtoria e Kontrollit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, përpunuar nga KLSH.

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion është konstatuar se realizimi i numrit të kontrolleve për periudhën 12 mujore të vitit 2023 e krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022 është realizuar në masën 135% të kontrolleve ndërsa realizimi i zbulimeve është në masën 89%, e krahasuar me vitin 2022.

Numri i kontrolleve të kryera për vitin 2023 e krahasuar me vitin 2022 (70+30%).

Në mijë lekë

Emërtimi	Totali i rasteve të kontrollit		Zbulimet në vlerë (000)		Tatimet sipas zërave/Totalin e zbulimeve	Tatimet sipas zërave/Totalin e zbulimeve	Numri i kontrolleve në %	Zbulimet sipas zërave në %
	2023	2022	2023	2022	2023	2022	2023/2022	2023/2022
1.Kontroll fakt B.V	-	-	-	-	-	-	-	-
2.Kontroll fakt B.M	3,006	2,226	7,430,837	8,318,427	100%	100%	135%	89%
2.1. TVSH	2,907	2,169	3,368,941	3,432,069	44.51%	41.26%	134.02%	98.16%
2.2. Tatim fitimi	2,417	1,614	3,307,448	4,530,113	44.51%	54.46%	149.75%	73.01%
2.3. Sigurime Shoq Shën	2,395	1,652	65,446	73,130	0.88%	0.88%	144.98%	89.49%
2.4. Tatim mbi te ardhurat	2,377	1,235	14,645	9,458	0.20%	0.11%	192.47%	154.84%
2.5. Akcizë	-	2	-	257	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%
2.6. Lojëra fati	-	-	-	-	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%
2.7. Taksa nacionale	22	12	17,950	3,746	0.24%	0.05%	183.33%	479.18%
2.8. Të tjera	2,369	1,602	656,408	269,653	8.83%	3.24%	147.88%	243.43%
Shuma (1+2)								

Burimi: Drejtoria e Kontrollit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, përpunuar nga KLSH.

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion është konstatuar se realizimi i kontrolleve të planifikuara për vitin 2023 është në masën 101.38%, kemi një mbi realizim të planit të kontrolleve për vitin 2023 në masën 1.38%, ndikimin më të madh në mbi realizimin e planit të kontrolleve e kanë DRT Durrës me 102.88% të kontrolleve të realizuara, DRT Elbasan me 105.19% të kontrolleve të realizuara, DRT Fier me 118.28% të kontrolleve të realizuara, DRT Gjirokastër me 101.43% të kontrolleve të realizuara, DRT Korçë me 127.22% të kontrolleve të realizuara, DRT Kukës me 129.03% të kontrolleve të realizuara, DRT Shkodër me 104.51% të kontrolleve të realizuara dhe DRT Vlorë me 101.90% të kontrolleve të realizuara. Por theksojmë se ka një mosrealizim të kontrolleve në 2 DRT më të rëndësishme konkretisht DRT Tiranë me 12.34% të kontrolleve dhe DTM me 0.85% të kontrolleve.

Evidenca progresive për realizimin e planit të kontrollit 12 mujor 2022 (70+30%)

Nr.		Kontrolle plan.12 mujori 2023			Kontrolle fakt 12 mujori 2023			Realizimi i planit kontrolleve %		
		Të plota	V.fiskale	Gjithsej	Të plota	V.fiskale	Gjithsej	Gjithsej	Të plota	V.fiskale
1	Berat	92	21	113	90	19	109	96.46%	97.83%	90.48%
2	Dibër	70	17	87	66	14	80	91.95%	94.29%	82.35%

3	Durrës	158	85	243	166	84	250	102.88%	105.06%	98.82%
4	Elbasan	200	70	270	241	43	284	105.19%	120.50%	61.43%
5	Fier	207	72	279	257	73	330	118.28%	124.15%	101.39%
6	Gjirokastrë	58	12	70	62	9	71	101.43%	106.90%	75.00%
7	Korçë	125	44	169	176	39	215	127.22%	140.80%	88.64%
8	Kukës	21	10	31	32	8	40	129.03%	152.38%	80.00%
9	Lezhë	54	19	73	49	15	64	87.67%	90.74%	78.95%
10	Sarandë	32	12	44	9	25	34	77.27%	28.13%	208.33%
11	Shkodër	236	52	288	253	48	301	104.51%	107.20%	92.31%
12	Vlorë	121	37	158	124	37	161	101.90%	102.48%	100.00%
13	Tiranë	447	104	551	393	90	483	87.66%	87.92%	86.54%
14	VIP	461	128	589	455	129	584	99.15%	98.70%	100.78%
	Totali	2,282	683	2,965	2,373	633	3,006	101.38%	103.99%	92.68%

Burimi: Drejtoria e Kontrollit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, përpunuar nga KLSH.

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion është konstatuar se nga 2,313 kontrole të kryera sipas propozimit të Drejtorisë së Menaxhimit të riskut, konstatohet se 462 kontrole ose rreth 19.97% e totalit rezultojnë pa zbulime nga ana e inspektorëve të kontrollit. Zbulimi për kontroll është 2,452 mijë lekë, ndërsa për të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ishte 889 mijë lekë, krahasuar me vitin 2022 konstatohet se kemi rritje të zbulimit për kontroll në masën 175%.

Moduli 1 (70% DMR)

(000/lekë)

Drejtoria Rajonale	Gjithsej	Kontrolle të kryera raste 1			Total zbulime TVSH	Total zbulim e TF	Total zbulime sigurim e	Total zbulime te tjera	Totali (000)
		me zbulime	pa zbulime	pa zbulime %					
Berat	87	76	11	12.64%	23,412	9,789	-	2,653	35,854
Dibër	61	51	10	16.39%	20,316	12,756	1,046	902	35,020
Durrës	200	125	75	37.50%	120,972	423,578	18,129	30,729	593,408
Elbasan	245	215	30	12.24%	85,387	46,181	2,821	8,422	142,811
Fier	288	234	54	18.75%	57,827	23,147	503	10,279	91,756
Gjirokastrë	52	46	6	11.54%	12,473	5,018	894	945	19,330
Korçë	173	127	46	26.59%	22,776	11,344	123	1,531	35,774
Kukës	30	26	4	13.33%	9,652	772	435	300	11,159
Lezhë	51	39	12	23.53%	253,318	168,182	246	3,357	425,103
Sarandë	34	16	18	52.94%	2,235	3,640	-	250	6,125
Shkodër	240	215	25	10.42%	55,328	25,856	422	4,409	86,015
Vlorë	144	122	22	15.28%	90,907	14,223	1,285	3,890	110,305
Tirana	366	318	48	13.11%	798,188	980,968	28,809	354,632	2,162,597
DTM	342	241	101	29.53%	1,165,734	708,651	4,022	37,669	1,916,076
Totali	2,313	1,851	462	19.97%	2,718,525	2,434,105	58,735	459,968	5,671,333

Burimi: Drejtoria e Kontrollit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, përpunuar nga KLSH.

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion është konstatuar se nga 693 kontrole të kryera sipas propozimit të Drejtorive Rajonale Tatimore, 644 kontrole ose rreth 92.9% e totalit rezultojnë me zbulime nga ana e inspektorëve të kontrollit. Zbulimi për kontroll është 2.539 mijë lekë, ndërsa për të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ishte 1.143 mijë lekë, pra kemi rritje të konsiderueshme të zbulimit për kontroll ose e realizuar në masën 122% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Moduli 2 (30% DMR)

(000/lekë)

Nr	DRT	Kontrolle të kryera raste 2				Total zbulime TVSH	Total zbulime TF	Total zbulime sigurime	Total zbulime të tjera	Totali
		Gjithsej	Me zbulime	Pa zbulime	Pa zbulime në %					
1	Berat	22	22	0	0.00%	26,772	5,034	28	1,316	33,150
2	Dibër	19	19	0	0.00%	5,736	24,015	1,616	200	31,567
3	Durrës	50	44	6	12.00%	44,987	67,327	2,402	21,640	136,356
4	Elbasan	39	37	2	5.13%	53,550	3,969	121	3,490	61,130
5	Fier	42	36	6	14.29%	43,905	26,404	37	1,628	71,974
6	Gjirokastrë	19	18	1	5.26%	3,583	4,316	115	240	8,254
7	Korçë	42	33	9	21.43%	3,925	9,031	-	1,481	14,437
8	Kukës	10	10	0	0.00%	1,143	2,123	32	-	3,298

9	Lezhe	13	13	0	0.00%	24,180	26,510	1,122	1,849	53,661
10	Sarandë	0	0	0	0.00%	-	-	-	-	-
11	Shkodër	61	61	0	0.00%	17,080	15,441	591	1,636	34,748
12	Vlorë	17	17	0	0.00%	42,876	54,748	9	1,129	98,762
13	Tirana	117	103	14	11.97%	81,521	265,341	597	185,704	533,163
14	DTM	242	231	11	4.55%	301,158	369,084	41	8,722	679,005
	Totali	693	644	49	7.07%	650,416	873,343	6,711	229,035	1,759,505

Burimi: Drejtoria e Kontrollit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, përpunuar nga KLSH.

Nga auditimi i evidencave të fazave në të cilën ndodhen kontrollet të ndara sipas viteve, konstatohet një stok i lartë kontrollesh të papërfunduara nga viti 2017, ku deri në 31.12.2023 janë gjithsej 805 kontrolle, të pezulluara, të pafilluara ose në proces, konkretisht paraqitur si më poshtë:

Evidenca e fazave në të cilat ndodhen kontrollet në proces të ndara sipas viteve.

Kontrolle sipas viteve	Kontroll e gjithsej	Kontrolle pa filluar	Kontrolle pezulluar	Fazat në të cilën ndodhet kontrolli					
				Projekt Raport			Dërguar Raporti Paraprak	Opservacion nga subjekti	Raport Përfundimtar
				Inspektori	Përgjegjësi	Drejtori kontrollit			
2017	14	0	0	14	0	0	0	0	0
2018	17	0	17	0	0	0	0	0	0
2019	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2020	6	0	6	0	0	0	0	0	0
2021	20	0	11	8	0	0	1	0	0
2022	49	10	11	21	0	0	7	0	0
2023	699	99	2	389	0	0	193	14	2
Totali	805	109	47	432	0	0	201	14	2

Burimi: Drejtoria e Kontrollit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, përpunuar nga KLSH.

Gjithashtu rezultoi se në 805 kontrolle të pa filluara nga administrata tatimore janë përfshirë edhe kontrollet e planifikuara për muajin dhjetor 2023, të cilat janë nisur njoftimi për kontroll, kjo bazuar në Ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, konkretisht neni 81.1/1, ku përcaktohet se “Njoftimi për fillimin e kontrollit tatimor i dërgohet tatimpaguesit të paktën 30 ditë kalendarike përpara datës së fillimit të kontrollit të plotë tatimor të shkruar në njoftim, ndërsa në rastin e vizitave fiskale ky njoftim i dërgohet tatimpaguesit të paktën 10 ditë kalendarike përpara datës së fillimit të vizitës fiskale”. Konkretisht gjendja është si në vijim 109 kontrolle të pafilluara, 47 kontrolle të pezulluara, 432 kontrolle në fazë projekt raporti, 201 kontrolle dërguar projekt raporti, 14 kontrolle pritë observacion nga subjekti dhe 2 kontrolle në fazë raporti përfundimtar.

Nga analiza e të dhënave mbi evidencat e fazave në të cilat ndodhen kontrollet në proces, rezultoi se stoku i kontrolleve të papërfunduara nga Drejtoritë Rajonale Tatimore, vijon të jetë i konsiderueshëm në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, konkretisht nenet 81, 83 dhe 84. Konkretisht gjendja e stokut të kontrolleve për vitin 2023 rezultoi të jetë 805 kontrolle të pezulluara, të pafilluara ose në proces nga 1,140 kontrolle që kanë qenë për vitin 2022, duke pasur një ulje të vogël të tyre.

Konstatohet se Drejtoria e Kontrollit në DPT nuk rakordon gjendjen e kontrolleve në fund të vitit për ta përdorur si referim lidhur me planifikimet të cilat realizon për vitin pasardhës duke sjell vazhdimisht një numër të lartë të kontrolleve në proces ose të pafilluar në fund të vitit. Drejtoria e Kontrollit nuk ka praktikë verifikimin dhe kontrollin nga zyra të veprimtarisë kontrolluese të DRT-ve nëpërmjet mbledhjes dhe përpunimit të dhënave nga sistemi C@ts ku të verifikohet kontrollohet dhe analizohen fenomene të cilat janë si bazë për arritjen e konkluzioneve në mirëfunksionimin e Drejtorive të Kontrollit në DRT.

Për sa më sipër me personat përgjegjës B. B., I. D., B. H. dhe C. K.

2.6.5 Auditimi i përputhshmërisë së procedurave të ndjekura nga Drejtoria e Hetimit Tatimor.

Objekti dhe detyrat e Drejtorisë së Hetimit Tatimor.

Drejtoria e Hetimit Tatimor ushtron detyrat e saj në kuadër të parandalimit, zbulimit dhe hetimit, në përputhje me ligjin e procedurave tatimore dhe legjislacionin penal apo procedural penal, të kundërvajtjeve administrative tatimore apo veprave penale në fushën e taksave dhe tatimeve.

- Strukturat e hetimit tatimor janë njësi të specializuara hetimi dhe zbatimi në administratën tatimore qendrore;

- Strukturat e hetimit tatimor kanë si funksion parësor:

a) Mbledhjen e informacionit tatimor;

b) Hetimin tatimor;

c) Zbatimin e masave shtrënguese;

d) Marrjen e masave administrative edhe për kundërvajtjet administrative tatimore.

Punonjësit e hetimit tatimor gëzojnë atributet e Policisë Gjyqësore, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale dhe ligjin për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore.

Organizimi dhe funksionimi i Drejtorisë së Hetimit Tatimor.

Drejtoria e Hetimit Tatimor është e organizuar në nivel qendror në përbërje të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Drejtoria e Hetimit Tatimor e ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar, neni 105, ndërkohë që detyrat dhe funksionet e Drejtorisë përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave. Kjo drejtori ka në përbërje:

I. Sektori i Hetimit Tatimor (Përgjegjësi+ Inspektorët) (1 + 42) Janar-Nëntor 2023.

Sektori i Hetimit Tatimor (Përgjegjësi+ Inspektorët) (1 + 21) Nëntor-Dhjetor 2023.

II. Sektori i Administrimit të Informacionit dhe Analizës (Përgjegjësi+ Inspektorët) (1+1+10), për periudhën Janar-Nëntor 2023.

Sektori i Administrimit të Informacionit dhe Analizës (Përgjegjësi+ Inspektorët) (1+26), për periudhën Nëntor-Dhjetor 2023.

III. Sektori i Parandalimit dhe Pastrimit të Parave (Përgjegjësi+ Inspektorët) (1+3).

Sektori i Hetimit Tatimor.

Sektori i Hetimit Tatimor ushtron funksionet e tij në përputhje me dispozitat e nenit 105 “Struktura dhe funksionet e njësive të hetimit tatimor, Kreu XII “Hetimi Tatimor”, Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij. Inspektorët e hetimi janë ngarkuar gjithashtu dhe me ndjekjen dhe ezaurimin e praktikave të ardhura nga Rajonet pas centralizimit të strukturës në DPT.

Struktura e Hetimit tatimor është njësi e specializuar hetimi që ka si funksion parësor mbledhjen e informacioneve dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme hetimore lidhur me veprat penale në fushën e tatimeve. Punonjësit e strukturave të hetimit tatimor gëzojnë atributet e Policisë Gjyqësore, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale dhe ligjin për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore.

Planet e punës dhe ngarkesa për çdo inspektor të Sektorit të Hetimit Tatimor në DPT.

Nga grupi i auditimit është kërkuar informacion nga Drejtoria e Hetimit Tatimor në DPT, nëpërmjet emailit në lidhje me “Planet e punës dhe ngarkesa për çdo inspektor të Sektorit të Hetimit Tatimor në DPT” për periudhën objekti auditimi 2023, ku është kthyer përgjigje: “Sektori Hetimit Tatimor harton planet e punës mujore, të cilat janë miratuara nga Drejtoria i

Hetimit Tatimore në DPT. Planet e punës të regjistruara në regjistrin e kartotekës janë konfidencial dhe dokumenta të klasifikuar”.

Qarkullimi i informacionit të klasifikuar dhe dokumentacionit që ka lidhje me hetimin e veprave penale në fushën tatimore, bëhet duke zbatuar dispozitat e legjislacionit të fushës në fuqi. Sektori Hetimit Tatimor në DPT ka arkivin e të dhënave të klasifikuara, me protokoll të veçantë me qëllim ruajtjen e sekretit hetimor, referuar nenit 105.5.4 të Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Për çështjet e referuara në Prokurori, punonjësit Drejtorisë së Hetimit Tatimor, të cilët gëzojnë atributet e Policisë Gjyqësore, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale dhe ligjin për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore, urdhërohen për të kryer veprime hetimore proceduriale për dhe në emër të prokurorit, në të gjitha ato raste që kryejnë referimin e veprave penale, përveç rasteve të parashikuara ndryshe në ligj apo të vlerësuara ndryshe nga prokurori. Nga këta inspektorë (O.P.G.J), me delegim ose urdhër të prokurorit mund të hetohen edhe çështje të tjera, që nuk janë referuar prej tyre, por që kërkojnë kualifikim të veçantë, në fushën e tatimeve. Kryejnë një sërë veprimesh proceduriale deleguar nga Prokuroria. Në përfundim të hetimeve mbështetur në rrethanat e faktit dhe të dhënat e mbledhura gjatë hetimeve, në bazë të nenit 327/1 “Veprimet e policisë gjyqësore dhe të prokurorit” të Kodit të Procedurës Penale, oficeri i policisë gjyqësore bën relacionin për përfundimin e hetimeve me sugjerimet e veta për mënyrën e përfundimit të hetimeve. Informacioni për veprimet dhe ngarkesën disponohet nga Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore.

Gjithashtu sipas rastit punonjësit e Sektorit të Hetimit Tatimor trajtojnë edhe kërkesa të ndryshme të adresuara në DHT, përcjellin propozimet për vlerësim të situatës financiare dhe kontroll tatimor, ndjekin apo kërkojnë informacion/materiale lidhur me çështjet në ndjekje etj, më konkretisht paraqitur në tabelën si më poshtë:

Regjistri i Shkresave Hyrëse/Dalëse/Referuar/Arshivuar	Nr
Kërkesa të ndryshme	302
Propozimet për vlerësim të situatës financiare dhe kontroll tatimor +Rikontroll	103
Referime	70 (99 subjekte)
Arkivime	23
Ezaurim, Kthim Përgjigje, Dërgim Materialesh, Relacione në Prokurori	155
Total	653

Burimi: Drejtoria e Hetimit Tatimor në DPT, përpunoi KLSH.

Regjistri elektronik i Referimeve ne Prokurori Janar- Dhjetor 2023.

Sektori i Hetimit Tatimor gjatë vitit 2023 ka referuar në Prokurori vepra penale në fushën e tatimeve dhe taksave në total 142 referime në shumën totale të prej 2,060,811,141 lekë, duke kërkuar fillimin e procedimit penal. Treguesit e rasteve të veprave penale e ndarë sipas vlerave në dëm ekonomik për këto raste, nga Sektori i Hetimit i Drejtorisë se Hetimit paraqitet si më poshtë:

Nr	Vepra Penale	Neni i Kodit Penal	Viti 2023	
			Nr. Ref	Vlera
1	Krijimi i skemave mashtruese me TVSH	144/a	1	300,000,000
2	Fshehje e të ardhurave	180	64	732,316,859
3	Mospagim taksash dhe tatimesh	181	47	516,460,191
4	Organizim i Llotarive të palejuara	197	0	-
5	Punësim i paligjshëm	170/a	0	-
6	Prishje e shenjave të bllokimit apo pezullimit të veprimtarisë tregtare	182/a	3	-
7	Të tjera		27	512,034,091
	Shuma		142	2,060,811,141

Burimi: Drejtoria e Hetimit Tatimor në DPT, përpunoi KLSH.

*Shënim: Numrat e referimeve në tabel janë sipas numrit të subjekteve të referuara si dhe shumë subjekte janë referuar për disa vepra penale.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Konstatimi nga grupi i auditimit ka arritur në këtë përfundim pasi janë marr informacionet lidhur me këto problematika nga DMR dhe DVKT ku nuk është vënë në dispozicion një informacioni i tillë. Observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

Pretendimet e subjektit: Lidhur me rekomandimi 15.1 ku konstatohet se objekti i verifikimit në terren nuk është sipas listave të paraqitura nga DMR ju sqarojmë se veprimtaria e DVKT për këtë periudhë është kryer në përmbushje të kuadrit ligjor dhe rregullator të kësaj drejtorie duke zbatuar planin e masave në terren me listat e ardhura nga DMR.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Pretendimi i ngritur nga ju nuk sjell të dhëna të reja ose ndryshe nga ato të cilat grupi i auditimit ka administruar gjatë fazës së auditimit në terren. Observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

Pretendimet e subjektit: Lidhur me gjetjen se DKT në DPT nuk rakordon gjendjen e kontrolleve në fund të vitit ju sqarojmë se gjendja e kontrolleve në fund të vitit nuk konsiderohet stok pasi kjo gjendje kontrollesh ka lidhje me të gjithë procesin e fazave të kryerjes së kontrolleve bazuar në ligjin 9920 për procedurat tatimore nenet 80-84.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Pretendimi i ngritur nga ju nuk sjell të dhëna të reja ose ndryshe nga ato të cilat grupi i auditimit ka administruar gjatë fazës së auditimit në terren. Observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

Pretendimet e subjektit: Lidhur me gjetjen se DKT nuk ka praktikë verifikimit dhe kontrollin nga zyra të veprimtarisë kontrolluese të DRT-ve nëpërmjet mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave nga sistemi C@ts ju sqarojmë se nga kjo drejtori është hartuar manuali i ri i kontrollit nga zyra i cili parashikon mënyrën se si do të kryhet një kontroll janë përcaktuar dhe detyrat specifike që ka një inspektor.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Pretendimi i ngritur nga ju nuk sjell të dhëna të reja ose ndryshe nga ato të cilat grupi i auditimit ka administruar gjatë fazës së auditimit në terren. Observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

Pretendimet e subjektit: Lidhur me konstatimin se janë shkelur afatet procedurale në lidhje me rastet e ndjekura që janë në proces deri në datën 31.12.2023 të cilat rezultojnë me tejkalim të afateve të hetimit dhe trajtimit ju sqarojmë se këto raste në përbërje të tyre kanë një datë relativisht të hershme të çeljes së analizës paraprake, por për këto raste është ndjekur një plan masash për përfundimin e tyre, për vitin 2023 rezultojnë se janë mbyllur 49% e tyre, 25% janë me shtyrje afati dhe 11% janë përcjell në DRT pa veprim.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Konstatimi nga grupi i auditimit i referohet Manualit të Hetimit Tatimor ku përcakton afatet procedurale të përcaktuara në pikën 4.6 “Verifikimi Paraprak”. Observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

Pretendimet e subjektit: Lidhur me rekomandimin 19.1 ju bëjmë me dije se kohëzgjatja e kontrollit tatimor të individit nuk është përcaktuar në programin e kontrollit për arsye se ndryshe nga kontrolli në subjekt ku shumica e të dhënave gjenden në sistem në këtë rast shumica e të dhënave duhet të sigurohen nga palët e treta si banka dhe institucione të tjera për të cilët mbledhja e informacion kërkon kohë, e njëjta problematik del edhe te pjesa e intervistimit të individit dhe për transaksionet financiare.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Pretendimi i ngritur nga ju nuk sjell të dhëna të reja ose ndryshe nga ato të cilat grupi i auditimit ka administruar gjatë fazës së auditimit në terren. Observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

2.7 Auditimi i planifikimit dhe zbatimit të buxhetit si dhe mbi hartimin e pasqyrave financiare PBA 2023- 2025, Buxheti 2023

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është instrument operacional për menaxhimin e shpenzimeve publike dhe një komponent i Sistemit të Planifikimit të Integruar. Ky dokument përdoret për të informuar Kuvendin e Shqipërisë dhe publikun e gjerë lidhur me planet e shpenzimeve për tre vitet e ardhshme. Të cilat do të çojnë në arritjen e objektivave politike të qeverisë. Planifikimi i zërave të shpenzimeve për “Fondin e pagave & sigurimeve shoqërore” (Ilog 600 & 601), është bazuar në nivelin aktual të punonjësve dhe strukturës së miratuar për secilin program buxhetor të pagave sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Llogaritja për shpenzime të tjera korrente (Ilog 602-606) është bazuar në kërkesat e institucioneve të vartësisë së këtij institucioni, limiteve të miratuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, limiteve të shpenzimeve të periudhave paraardhëse dhe realizimi i pritshëm të vitit. Llogaritja për shpenzime të tjera kapitale (Ilog 230-231) është bazuar në nevojat për investime të institucionit.

Mbi programimin buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe planifikimin fillestar për buxhetin e vitit 2023:

Me ligjin nr. 84/2022, datë 24.11.2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, është miratuar buxheti i shtetit për vitin 2023, pjesë e të cilit është edhe buxheti për grupin buxhetor “Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve” në vlerën 2,922,177 mijë lekë. Fondet buxhetore të këtij grupi buxhetor, për vitin 2023, janë miratuar në një program buxhetor:

➤ **01140– Menaxhimi i të Ardhurave Tatimore**

Referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 130, datë 02.03.2022 mbi “Miratimin e taveve përgatitore të shpenzimeve të PBA 2023- 2025” është parashikuar një buxhet në total prej 2,895,080 mijë lekë, nga i cili:

- Shpenzime Korrente 2,600,000 mijë lekë;
- Shpenzime Kapitale 295,080 mijë lekë;

Referuar Udhëzimit Plotësues nr. 9 datë 28.02.2022 dhe Udhëzimit Plotësues nr. 22 datë 07.07.2022 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”, detajimi i buxhetit në nivel llogarie për fazën e I-rë dhe të II-të të PBA-së 2023-2025, është përcjellë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë përkatësisht me shkresat nr. 6635, datë 22.04.2022 dhe nr. 14580, datë 26.08.2022 “Kërkesat buxhetore për periudhën 2023-2025”, paraqitet si më poshtë:

Tavanet për PBA 2023 – 2025 dhe kërkesat shtesë FI/FII

në 000/lekë

Llogaria	Emërtimi	PBA 2023-2025 Faza e I		PBA 2023-2025 Faza e II	
		Sipas taveve	Kërkesa shtesë	Sipas taveve	Kërkesa shtesë
600-601	Paga Sigurime	1,670,000	-	1,670,000	-
602-606	Shpenzime të tjera korrente	930,000	-	930,000	809,500
I	Shpenzime Korrente	2,600,000	-	2,600,000	809,500
230-231	Pajisje zyre	10,000	-	10,000	-5,000
	Hapësira HardWare kapacitetin e serverave	164,080	-	164,080	197,868
	Rikonstruksion (shtese kati) DRT Fier	35,000	-	35,000	-5,000
	Rikonstruksion DRT Elbasan	30,000	-	30,000	9,000
	Blerje pajisje kompj.				5,000
	Rikonstruksion DRT Diber	5,000	-	5,000	10,000
	Përmirësim i sistemit e- taxation	48,000		48,000	-48,000
	Pagese kontributi Fiscalis 2020	3,000	-	3,000	-3,000
II	Shpenzime Kapitale	295,080	-	295,080	150,868
I+II Totali i Shpenzimeve		2,895,080	-	2,895,080	960,368

Burimi: Të dhëna të DPT të përpunuar nga audituesit e KLSH.

Tab. PBA 2023- 2025, Faza e I dhe II, Shpenzime Korrente

në 000/lekë

Llog.	Faza e I PBA 2023-2025	Faza e II PBA 2023- 2025	Diferenca
600- Paga	1,420,000	1,420,000	0
601- Sigurime shoqërore	250,000	250,000	0
602- Mallra dhe shërbime te tjera	771,916	1,086,916	315,000
91004AB- Inspektive, Hetime tatimore	5,500		-5,500
91004AC- Vendime gjyqësore te ekzekutuara	150,000	650,000	500,000
Tot. llog. 602- Mallra dhe shërbime te tjera	927,416	1,736,916	809,500
604- Transferta Korente të Brendshme			0
605- Transferta Korente të Huaja	2,200	2,200	0
606- Trans. per Buxh. Fam. dhe Ind.	384	384	0
Shpenzime Korrente	2,600,000	3,409,500	809,500

Burimi: Të dhëna të DPT të përpunuar nga audituesit e KLSH.

Planifikimi nga DPT, në fazën e 1 është 2,895,080 mijë lekë dhe në fazën e 2 është 3,855,448 mijë lekë. Nga faza e 1 në fazën e 2, referuar Shpenzimeve Korrente llogaria 602- Mallra dhe shërbime te tjera ka pësuar ndryshim në vlerën 809,500 mijë lekë ku vlerën më të lartë të ndryshimit e kanë pësuar Vendimet gjyqësore shtim në vlerën 500,000 mijë lekë, ose 333 % rritje nga faza e I- rë e planifikimit në vlerën 150,000 mijë lekë në fazën e II- të 650,000 mijë lekë.

Totali i kërkesave sipas politikave ekzistuese për këtë fazë për DPT për projektet e investimit

në 000/lekë

Llog.	Kodi i projektit	Emertimi i projektit	Faza e I PBA 2023- 2025			Faza e II PBA 2023- 2025		
			2023	2024	2025	2023	2024	2025
231	18AV802	Pajisje zyre	10,000			5,000	12,224	46,000
231	18AV812	Hapesira Hardwarike kapacitetin e serverave	164,080	32,000	41,398	361,948	11,520	
231	18AV906	Rikonstruksion (shtese kati) DRT Fier	35,000			30,000		
232	18AV907	Brandimi I godinave DPT+ 14 DRT						
231	18AV905	Rikonstruksion DRT Elbasan	30,000			39,000		
231	18AV906	Rikonstruksion DRT Durres						
231	18AV908	Rikonstruksion DRT Vlore						
231	18AV909	Rikonstruksion DRT Berat						
231	18AV815	Blerje pajisje kompj.			38,602	5,000		30,000
231	18AV904	Rikonstruksion DRT Diber	5,000			5,000		
232	18AV816	Akses kontrolli						
231	22AD801	Permiresim i sistemit e-taxation	48,000	48,000				
231- Kapitale te trupezuara			292,080	80,000	80,000	445,948	23,744	76,000
230	M100255	Pagese kontributi Fiscalis 2020	3,000	3,000	3,000			
230- Kapitale te patrupezuara			3,000			0		
Totali 230- 231 Shpenzime Kapitale			295,080	80,000	80,000	445,948	23,744	76,000

Totali i shpenzimeve për fazën e 2-të të PBA-së është përcaktuar në vlerën 3,855,449 mijë lekë, nga të cilat shpenzimet korrente në vlerën 3,409,500 mijë lekë dhe shpenzime kapitale në vlerën 445,949 mijë lekë.

- Kërkesat shtesë në këtë fazë të PBA-së 2023-2025, janë përgatitur në zbatim të Udhëzimit Plotësues dhe përmbajnë formatet standarde të miratuara. Buxheti shtesë i kërkuar është në shumën 960,368 mijë lekë (paraqitur në tabelën e mësipërme), ku argumentimi i tyre sipas llogarive rezulton si më poshtë:
 - *Sa i përket shpenzimeve korrente;*
 - Shpenzimet për paga e sigurime, nuk kanë pësuar ndryshime.
 - Për realizimin e aktiviteteve/masave në funksion të mbarëvajtjes së institucionit gjatë vitit të ardhshëm është përllogaritur një kosto në zërat e shpenzimeve për mallra e shërbime prej 809,500 mijë lekë.
 - *Sa i përket shpenzimeve kapitale;*
 - Hapesira Hardwarike kapacitetin e serverave me vlerë 361,948 mijë lekë
 - Pajisje zyre me vlerë 5,000 mijë lekë
 - Rikonstruksion (shtese kati) DRT Fier me vlerë 30,000 mijë lekë
 - Rikonstruksion DRT Elbasan me vlerë 39,000 mijë lekë
 - Blerje pajisje kompj. me vlerë 5,000 mijë lekë
 - Rikonstruksion DRT Diber me vlerë 5,000 mijë lekë.

Me urdhrin e brendshëm nga NA, Urdhri nr. 11, datë 18.01.2023 është ngritur grupi i menaxhimit Strategjik (GMS). Nga auditimi i dokumenteve u konstatua se gjatë vitit 2023 Grupi i Menaxhimit Strategjik është mbledhur, si komponent kyç i organizimit institucional për të diskutuar mbi përgatitjen e kërkesave buxhetore në lidhje me programet përkatëse, referuar Ligjit nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i unifikuar si edhe në mosplotësim të përgjegjësisë të NA në rolin e koordinatorit të GMS të përcaktuara në Udhëzimin nr. 7 datë 28.2.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA”, Kreu II, pika 2.5 “Përgjegjësitë e Drejtuesit të Ekipit të Menaxhimit të Programit” dhe 2.6 “Përgjegjësitë e anëtarëve të ekipit të menaxhimit të programit”. Ekipi i Menaxhimit të Programeve Buxhetore është ngritur me urdhrin nr. 88/1, datë 20.04.2023 të ministrit të Ministrisë së Financave. Nga krahasimi i listës së investimeve të programuara përgjatë procesit të planifikimit dhe realizimit të buxhetit të vitit 2023, konstatohet se projekti i investimit me kod 18AV815 “Blerje pajisje kompj.”, nuk është pjesë e fazës së parë të PBA 2023-2025 por është shtuar në fazën e dytë në vlerën 5,000 lekë.

Projekti me kod 22AD801 “Përmirësimi i sistemit E- taxation” nuk është planifikuar në PBA 2023-2025, faza e II, edhe pse sipas shkresës së AKSH dhe DPT ky investim ka prioritet të lartë pasi rrezikon që të çojë deri në mosfunksionim të sistemit e-Tax dhe bllokim të punës së administratës tatimore. Në shkresën 2478/4 prot., datë 24.02.2023 të DPT- s drejtuar AKSHI-t, citohet se investimi i përcjell nga AKSHI nuk përputhet me investimin e miratuar në buxhet si në aspektin e fondit të tejkalkuar rreth 300 milion lekë si dhe elementeve dhe zërave të tjerë të shtuar për këtë investim në proceset e: rishikimit të termave të referencës, testimit të tregut, përllogaritjen e fondit limit si dhe hartimit të kriterëve të veçanta. Risk shumë i lartë mbetet edhe kontrata e mirëmbajtjes nr. 46, datë 06.01.2021 e cila ka përfunduar më 06.01.2023.

Nga auditimi ka rezultuar se:

Planifikimi nga DPT, në fazën e 1 është 2,895,080 mijë lekë dhe në fazën e 2 është 3,855,448 mijë lekë. Nga faza e 1 në fazën e 2, referuar Shpenzimeve Korrente llogaria 602- Mallra dhe shërbime të tjera ka pësuar ndryshim në vlerën 809,500 mijë lekë ku vlerën më të lartë të ndryshimit e kanë pësuar Vendimet gjyqësore shtim në vlerën 500,000 mijë lekë, ose 333 % rritje nga faza e I- rë e planifikimit në vlerën 150,000 mijë lekë në fazën e II- të 650,000 mijë

lekë. Nga krahasimi i listës së investimeve të programuara përgjatë procesit të planifikimit dhe realizimit të buxhetit të vitit 2023, konstatohet se projekti i investimit me kod 18AV815 “Blerje pajisje kompj.”, nuk është pjesë e fazës së parë të PBA 2023-2025 por është shtuar në fazën e dytë në vlerën 5,000 lekë.

Projekti me kod 22AD801 “Përmirësimi i sistemit E- taxation” nuk është planifikuar në PBA 2023-2025, faza e II, edhe pse sipas shkresës së AKSH dhe DPT ky investim ka prioritet të lartë pasi rrezikon që të çojë deri në mosfunksionim të sistemit e-Tax dhe bllokim të punës së administratës tatimore. Në shkresën 2478/4 prot., datë 24.02.2023 të DPT- s drejtuar AKSHI-t, citohet se investimi i përcjell nga AKSHI nuk përputhet me investimin e miratuar në buxhet si në aspektin e fondit të tejkualuar rreth 300 milion lekë si dhe elementeve dhe zërave të tjerë të shtuar për këtë investim në proceset e: rishikimit të termave të referencës, testimit të tregut, përllogaritjen e fondit limit si dhe hartimit të kriterëve të veçanta. Risk shumë i lartë mbetet edhe kontrata e mirëmbajtjes nr. 46, datë 06.01.2021 e cila ka përfunduar më 06.01.2023.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në:

Udhëzimin nr. 9 datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”, Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, pika 153-154

Ligjin nr. 84/2022, datë 24.11.2022 “Për buxhetin e vitit 2023”

Udhëzimin Plotësues nr. 9 datë 28.02.2022 dhe Udhëzimit Plotësues nr. 22 datë 07.07.2022 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”

Çelja e fondeve buxhetore të vitit 2023

Në zbatim të Ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023” dhe udhëzimit të Ministrit të Financave, nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, detajimi i planit të buxhetit për shpenzimet korrente për programin Menaxhimi i të Ardhurave Tatimore të menaxhuar nga Drejtoria Përgjithshme e Tatimeve është përcjellë me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 484 prot., datë 13.01.2023; për shpenzimet kapitale me shkresën nr. 2298 prot., datë 14.2.2022 të MFE.

Ky buxhet paraqitet për vitin 2023 në vlerën 3,078,296 mijë lekë, nga të cilat:

- Shpenzime Korrente në vlerën totale 2,683,216 mijë lekë;

Në nivel artikujsh, shpenzimet korrente janë përcaktuar si më poshtë:

Llogaria 600 “Paga dhe shtesa” në vlerën 1,491,600 mijë lekë;

Llogaria 601 “Sigurime shoqërore” në vlerën 262,000 mijë lekë;

Llogaria 602 “Blerje mallra e shërbime” në vlerën 927,416 mijë lekë;

Llogaria 605 “Transferata të jashtme” në vlerën 2,200 mijë lekë.

- Shpenzime Kapitale në vlerën totale 395,080 mijë lekë.

Ndryshimet e planit të buxhetit përgjatë vitit 2022:

Ne vijim paraqiten gjithë ndryshimet që ka pësuar buxhetit i DPT gjatë vitit 2023:

- **Llog. 600- Pagat:** Shtesa prej 83.000.000 lekë në plan është si rezultat i ndryshimit bazuar në shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me lëndë “dërgohet shkresa me nr.11837/2 prot., datë 13.07.2023 “Transferim fondi për vitin 2023” protokolluar me tonën me nr. 12338 prot., datë 20.07.2023, ku është aprovuar kërkesa për transferim fondi brenda programit 01140-“Menaxhimi i të Ardhurave Tatimore” me qëllim mbulimin e efekteve shtesë në shpenzime personeli në zbatim të VKM-së nr.325 datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”.

Me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 19989/6 prot., datë 24.11.2023, protokolluar me tonën me nr. 19159 prot., datë 01.12.2023, është dërguar miratimi i limitit për transferimin e fondeve në shpenzimet korrente.

Me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 415/2 prot., datë 29.01.2024, protokolluar me tonën me nr. 1995 prot., datë 31.01.2024, është dërguar miratimi i fondeve në vlerë 2,640,000 lekë sipas shkresës me nr. 415/1 prot., datë 15.01.2024 mbi zbatimin e VKM-së nr.795, datë 28.12.2023.

- **Llog. 601- Sigurimet shoqerore:** Shtesa prej 42.000.000 lekë në plan është si rezultat i ndryshimit bazuar në shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me lëndë “dërgohet shkresa me nr.11837/2 prot., datë 13.07.2023 “*Transferim fondi për vitin 2023*” protokolluar me tonën me nr. 12338 prot., datë 20.07.2023, ku është aprovuar kërkesa për transferim fondi brenda programit 01140-“*Menaxhimi i të Ardhurave Tatimore*” me qëllim mbulimin e efekteve shtesë në shpenzime personeli në zbatim të VKM-së nr.325 datë 31.05.2023 “*Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike*”.

- **Llog. 602- Mallra dhe sherbime te tjera:** Pakësimi prej 120.000.000 lekë në plan është si rezultat i ndryshimit bazuar në shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me lëndë “dërgohet shkresa me nr.11837/2 prot., datë 13.07.2023 “*Transferim fondi për vitin 2023*”, ku është aprovuar kërkesa për transferim fondi brenda programit 01140-“*Menaxhimi i të Ardhurave Tatimore*” me qëllim mbulimin e efekteve shtesë në shpenzime personeli në zbatim të VKM-së nr.325 datë 31.05.2023 “*Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike*”.

Me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 18618/3 prot., datë 20.10.2023 protokolluar me tonën me nr. 16798 prot., datë 23.10.2023, është dërguar shkresa me nr. 18618/2 prot., datë 20.10.2023 në të cilën është dërguar pakësimi i fondit në vlerën 15,976 lekë.

Me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 19989/6 prot., datë 24.11.2023, protokolluar me tonën me nr. 19159 prot., datë 01.12.2023, është dërguar miratimi i limitit për transferimin e fondeve në shpenzimet korrente.

Me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 22656/28 prot., datë 22.12.2023, protokolluar me tonën me nr. 20997 prot., datë 28.12.2023, është dërguar detajimi i ndryshimeve sipas Aktit Normativ Nr.6, datë 14.12.2023, në të cilën është dërguar miratimi i pakësimit të fondeve në vlerë 6,500,000 lekë.

- **Llog. 606- Trans. per Buxh. Fam. dhe Ind.:** Me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 462/6 prot., datë 03.02.2023, protokolluar me tonën me nr. 1787 prot., datë 01.02.2023, është dërguar shkresa me nr. 462/3 prot., datë 27.01.2023 në të cilën është dërguar miratimi i detajimit të shpenzimeve korrente, për vitin 2023. Në këtë shkresë për llog 606 “Fondi i veçantë” është miratuar fondi 381,000 lekë.

Me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 2196/2 prot., datë 16.02.2023 protokolluar me tonën me nr. 2645 prot., datë 21.02.2023, është dërguar shkresa me nr. 2196/1 prot., datë 14.02.2023 në të cilën është dërguar miratimi i detajimit të fondit të veçantë në vlerën 3,200,000 lekë.

Me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 20359/3 prot., datë 15.12.2023 protokolluar me tonën me nr. 19800 prot., datë 07.12.2023, është dërguar shkresa me nr. 20359/2 prot., datë 30.11.2023 në të cilën është dërguar miratimi i

detajimit të fondit të veçantë në vlerën 1,000,000 lekë, në total për vitin 2023 vlera e fondit të veçantë është 4,581,000 lekë.

- **Llog. 605- Transferta Korente të Huaja:** Me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 462/6 prot., datë 03.02.2023, është dërguar miratimi i detajimit të buxhetit për vitet 2023-2025, për shpenzimet korrente. Në këtë shkresë për llog.605 është miratuar fondi 2,200,000 lekë.

Me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 18618/3 prot., datë 20.10.2023, është dërguar shkresa me nr. 18618/2 prot., datë 20.10.2023 në të cilën është dërguar transferimi i fondit për vitin 2023 në vlerën 15,976 lekë, në total për vitin 2023 vlera e “transferime korrente me jashtë” është 2,215,976 lekë.

- **Llog. 230- 231 Shpenzimet Kapitale:** Me shkresën e MFE nr. 22656/118 prot., datë 09.01.2024, “Mbi zbatimin e Aktit Normativ Nr.6, datë 14.12.2023”, në të cilën është dërguar miratimi i pakësimit të fondeve kapitale në vlerë 150,000,000 lekë.

Fondet e shpenzimeve kapitale llog.230 – llog.231:

Me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 7635/5 prot., datë 08.06.2023 protokolluar me tonën me nr. 10249 prot., datë 09.06.2023, është dërguar shkresa me nr.7635/4 prot, datë 30.05.2023 për Transferim fondi për shpenzime kapitale, sipas tabelës bashkëlidhur:

KAP.	PROGRAMI	LLOG. EKON.	KODI I THESARIT	KODI I PROJEKTIT	EMERTIMI I PROJEKTIT	PAKESOHET	SHTOHET
01	01140	231	3535	18AV816	Akses kontrolli	614,577	
01	01140	231	3535	18AV911	Kolaudim dhe Mbikqyrje		614,577
01	01140	231	3535	18AV907	Brandimi I Godinave DPT + 14 DRT	2,800,000	
01	01140	231	3535	18AV817	Website I Ri per Administraten Tatimore		2,800,000

Me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 14914/3 prot., datë 13.09.2023 protokolluar me tonën me nr. 14990 prot., datë 15.09.2023, është dërguar shkresa me nr.14914/2 prot, datë 08.09.2023 për Transferim fondi për shpenzime kapitale, sipas tabelës bashkëlidhur:

KAP.	PROGRAMI	LLOG. EKON.	KODI I THESARIT	KODI I PROJEKTIT	EMERTIMI I PROJEKTIT	PAKESOHET	SHTOHET
01	01140	231	3535	18AV802	Blerje pajisje zyre	540,000	
01	01140	231	3535	18AV818	Blerje UPS		540,000

Me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 17858/3 prot., datë 05.10.2023 protokolluar me tonën me nr. 16034 prot., datë 09.10.2023, është dërguar shkresa me nr.17858/2 prot, datë 03.10.2023 për Transferim fondi për shpenzime kapitale, sipas tabelës bashkëlidhur:

KAP.	PROGRAMI	LLOG. EKON.	KODI I THESARIT	KODI I PROJEKTIT	EMERTIMI I PROJEKTIT	PAKESOHET	SHTOHET
01	01140	231	3535	22AD801	Përmirësimi i sistemit E-taxation	100,691,464	
01	01140	231	3535	22AD801	Përmirësimi i sistemit E-taxation (Software)		100,691,464

Me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 17858/3 prot., datë 05.10.2023 protokolluar me tonën me nr. 16034 prot., datë 09.10.2023, është dërguar shkresa me

nr.17858/2 prot, datë 03.10.2023 për Transferim fondi për shpenzime kapitale, sipas tabelës bashkëlidhur:

KAP.	PROGRAMI	LLOG. EKON.	KODI I THESARIT	KODI I PROJEKTIT	EMERTIMI I PROJEKTIT	PAKESOHET	SHTOHET
01	01140	231	3535	18AV815	Blerje pajisje elektronike dhe kompjuterike	16,765,000	
01	01140	231	3535	18AV816	Akses kontrolli	741,943	
01	01140	231	3535	18AV908	Rikonstrukcion DRT Durrës	7,000,000	
01	01140	231	3535	18AV907	Brandimi I Godinave DPT + 14 DRT		20,800,000
01	01140	231	3535	18AV904	Rikonstrukcion DRT Diber		1,709,856
01	01140	231	3535	18AV911	Kolaudim dhe Mbikëqyrje		1,997,087

Me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 22656/119 prot., datë 15.01.2024 protokolluar me tonën me nr. 1134 prot., datë 18.01.2024, është dërguar shkresa me nr.22656/118 prot, datë 09.01.2024 mbi “Zbatimin e Aktit Normativ Nr.6, datë 14.12.2023” për miratimin e detajimit të fondeve për shpenzime kapitale, sipas tabelës bashkëlidhur:

KAP.	PROGRAMI	LLOG. EKON.	KODI I THESARIT	KODI I PROJEKTIT	EMERTIMI I PROJEKTIT	PAKESOHET	SHTOHET
01	01140	231	3535	18AV817	website I Ri per Administratën Tatimore	2,800,000	
01	01140	230	3535	M100255	Pagesa biletës hyrëse FISCALIS 2020	160,755	
01	01140	231	3535	18AV907	Brandimi I Godinave DPT + 14 DRT	38,000,000	
01	01140	231	3535	18AV909	Rikonstrukcion DRT Vlore	1,297,670	
01	01140	231	3535	18AV910	Rikonstrukcion DRT Berat	10,000,000	
01	01140	231	3535	22AD801	Përmirësimi I sistemit E- taxation	97,741,575	

Realizimi i planit të buxhetit:

Të ardhurat jashtë limitit: Nga të dhënat e Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë dhe raportit të paraqitur nga ministria konstatohet se për vitin 2023 janë realizuar të ardhura jashtë limitit në masën 2,744,827 mijë lekë nga të cilat janë shpenzuar sipas tabelës më poshtë:

në 000/lekë

Llog.	Nga te ardhurat jashtë limitit
600- Paga	29,204
601- Sigurime shoqërore	1,874
602- Mallra dhe shërbime të tjera	91,609
604- Transferta Korente të Brendshme	2,616,499
231- Kapitale të trupëzuara	5,641
Tot.	2,744,827

Për sa i përket të ardhurave jashtë limitit, në vijim të kërkesës së grupit për vendosjen në dispozicion të një plani për këto shpenzime, nga ana e përfaqësuesve të institucionit u bëmë me dije se për këto të ardhura nuk ka një planifikim, pasi shpenzimet nga të ardhurat jashtë limitit janë shpenzime që i përkasin kapitull 6, rritje e autorizuar e cila ndjek këtë rrugë: DPT shpërndan produktet e saj (fatura tatimore etj.) Drejtorive Rajonale të cilat më pas kryejnë shitjen e tyre dhe i derdhen pagesat në buxhet nëpërmjet kapitullit 6. Pasi rakordohet çdo muaj mbi derdhjet që kryhen nga DRT në Degën e Thesarit, ato përcillen në rrugë zyrtare në DPT. DPT nëpërmjet shkresës zyrtare kërkon rritjen e autorizuar pranë MFE, e cila me pas realizon çeljen e fondit për ta përdorur më pas për likuidim faturash të shtypshkronjave të letrave me vlerë.

Për vitin 2023, janë kryer rakordimet me Drejtorinë e Thesarit dhe Drejtorinë e Buxhetit, brenda afateve dhe formateve të miratuara nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë. Raportet e monitorimit të buxhetit janë dërguar brenda afateve kohore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në zbatim të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes Qëndrore” dhe të Udhëzimit Plotësues nr.1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, konkretisht:

- Raporti i monitorimit 4–muajor për zbatimin e buxhetit është dërguar me shkresën nr. 88371 prot. datë 19.05.2023.

- Raporti i monitorimit 8–muajor për zbatimin e buxhetit është dërguar me shkresën nr. 14145 prot. datë 19.09.2023.

- Raporti i monitorimit 12-mujor për zbatimin e buxhetit të vitit 2023 është dërguar me shkresën nr. 3684 prot. datë 26.02.2024.

Për sa i përket realizimit në terma sasiore dhe në vlerë kundrejt treguesve të planifikuar dhe të pasqyruar në raportet e monitorimit të programit 03320 “Veprimtaria e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, në mënyrë të përmbledhur paraqitet si më poshtë:

Raporti i shpenzimeve të programit:

në 000/lekë

Llog.	Realizimi Viti 2022	Plani Fillestar Vjetor Viti 2023	Plan Vjetor i rishikuar Viti 2023	Realizimi Viti 2023	Ndryshim Plan-Fakt	% e realizimit
600- Paga	1,282,005	1,491,600	1,578,710	1,525,028	53,682	97%
601- Sigurime shoqërore	212,847	262,000	288,700	252,708	35,992	88%
602- Mallra dhe shërbime të tjera	1,214,495	927,416	809,730	725,656	84,074	90%
604- Transferta Korente të Brendshme	549,110					
605- Transferta Korente të Huaja	1,721	2,200	2,216	2,216	0	100%
606- Trans. per Buxh. Fam. dhe Ind.	19,318		4,581	3,873	708	85%
Nën totali Shpenzime Korrente	3,279,496	2,683,216	2,683,937	2,509,481	174,456	94%
230- Kapitale të Patrupëzuara	2,796	3,000	2,839	2,839	0	100%
231- Kapitale të Trupëzuara	528,604	392,080	242,241	163,103	79,138	67%
Nën totali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm	531,400	395,080	245,080	165,942	79,138	68%
230- Kapitale të Patrupëzuara	127				0	
231- Kapitale të Trupezuara					0	
Nentotali Shpenzime Kapitale me financim të huaj	127	0	0	0	0	
Totali Shpenzime Kapitale	531,528	395,080	245,080	165,942	79,138	68%
Totali i shpenzimeve buxhetore të programit	3,811,023	3,078,296	2,929,017	2,675,424	253,593	91%

Burimi: Të dhëna të DPT të përpunuar nga audituesit e KLSH.

- **Buxheti i rishikuar vjetor për programin 01140– Menaxhimi i të Ardhurave Tatimore, pas ndryshimeve është 2,929,017 mijë lekë, ndërsa realizimi vjetor është 2,675,424 mijë lekë ose në masën 91 %.**

Investimet

Projekte me financim të brendshëm dhe me financim të huaj

në 000/lekë

Llog.	Kodi i projektit	Emertimi i projektit	Faza e I PBA 2023-2025	Faza e II PBA 2023-2025	Plani Fillestar Vjetor Viti 2023	Plan Vjetor i rishikuar Viti 2023	Realizimi Viti 2023	% e realizimit
231	18AV802	Pajisje zyre	10,000	5,000	35,000	34,460	8,310	24%
231	18AV812	Hapesira Hardwarike kapacitetin e serverave	164,080	361,948	42,389	42,389	42,389	100%
231	18AV906	Rikonstruksion (shtese kati) DRT Fier	35,000	30,000	54,000	54,000	14,992	28%
232	18AV907	Brandimi I godinave DPT+ 14 DRT			20,000			
231	18AV905	Rikonstruksion DRT Elbasan	30,000	39,000	30,000	30,000	21,741	72%
231	18AV906	Rikonstruksion DRT Durrës			7,000			
231	18AV908	Rikonstruksion DRT Vlore			8,000	6,702	6,383	95%
231	18AV909	Rikonstruksion DRT Berat			10,000			
231	18AV815	Blerje pajisje kompj.		5,000	70,000	53,235	53,234	100%
231	18AV904	Rikonstruksion DRT Diber	5,000	5,000	11,000	12,710	12,105	95%
232	18AV816	Akses kontrolli			4,000	2,643	2,643	100%
231	22AD801	Përmirësim i sistemit e-taxation	48,000		100,691	2,950		0%
231	18AV818	Blerje UPS				540	294	54%
231	18AV911	Kolaudim dhe mbikëqyrje				2,612	1,012	39%
231- Kapitale te trupëzuara			292,080	445,948	392,080	242,241	163,103	67%
230	M100255	Pagese kontributi Fiscalis 2020	3,000		3,000	2,839	2,839	100%
230- Kapitale te patrupëzuara			3,000	0	3,000	2,839	2,839	100%
Totali 230- 231 Shpenzime Kapitale			295,080	445,948	395,080	245,080	165,942	68%

Burimi: Të dhëna të DPT të përpunuar nga audituesit e KLSH.

Investimet për vitin 2023 janë planifikuar në vlerën 395,080 mijë lekë, në planin e rishikuar vlera arrin 245,080 mijë lekë dhe investime të realizuara në vlerën 165,942 mijë lekë. Të realizuara kundrejt planit të rishikuar janë në masën 68 % ndërsa kundrejt planifikimit fillestar 42 %. Në tabelën e mësipërme qartazi të paraqitur investimet të cilat janë parashikuar në fazën e 1 dhe të 2 të PBA 2023- 2025, planin fillestar, të rishikuar dhe realizimin ku projekti me kod 22AD818 Përmirësim i sistemit e- taxation është parashikuar dhe nuk është realizuar. sipas shkresës së AKSH dhe DPT ky investim ka prioritet të lartë pasi rrezikon që të çojë deri në mosfunksionim të sistemit e-Tax dhe bllokim të punës së administratës tatimore. Pavarësisht se në përbërjen grupit të GMS është një anëtar edhe nga Drejtoria TIK nuk janë mirë planifikuar

projektet e investimit për sistemet e IT-së. Nga krahasimi i listës së investimeve të programuara përgjatë procesit të planifikimit dhe realizimit të buxhetit të vitit 2022, konstatohet se projekti i investimit: me kod 18AV908 “Rikonstruksion DRT Vlore”, me kod 18AV818 “Blerje UPS” dhe me kod 18AV911 “Kolaudim dhe mbikëqyrje” nuk janë pjesë e fazës së pare dhe së dytë të PBA 2022-2024 dhe vlera e likuidimit për këtë projekt është planifikuar 80,000 mijë lekë, nga 382,965 mijë lekë e planifikuar në kontratë, pra 302,965 mijë lekë më shumë nga planifikimi në PBA.

Likuidimi me vonesë i faturave

Tabela nr. Urdhër shpenzimet e paguara jashtë afatit

Në lekë

Përfituesi	Përshkrimi	Nr. fat.	Data e fat.	Vlera e fat.
Shtypshkronja e letrave me vlere	Bileta 40 leke	04/2023	17.01.2023	168,000
	Bileta 40 leke	05/2023	18.01.2023	336,000
	Bileta 40 leke	06/2023	19.01.2023	1,176,000
	Bileta 40 leke	102	26.05.2023	194,818
	Bileta 40 leke	21	29.05.2023	420,000
	Bileta 40 leke	113	07.06.2023	420,000
	Bileta 40 leke	117	12.06.2023	420,000
	Bileta 40 leke	119	12.06.2023	420,000
	Bileta 40 leke	124	19.06.2023	840,000
	Bileta 40 leke	22	22.06.2023	448,814
Total				4,843,632

Vlera totale e këtyre 10 urdhër- shpenzimeve është 4,843,632 lekë të cilat janë paguar jo të plota në datën 24.02.2023 dhe 01.08.2023.

Nga auditimi ka rezultuar se:

Nga auditimi me përzgjedhje i veprimeve me bankën u konstatuan 10 urdhër-shpenzime nga ana e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës janë kryer likuidimet në tejkallim të afatit 30 ditore nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik. Likuidimi me vonesë i këtyre detyrimeve paraqet risk në rritjen e shpenzimeve buxhetore si rezultat i lindjes së detyrimeve nga penalitetet bazuar në kontratë. Pavarësisht se në këtë rast nuk është kërkuar nga kontraktori pagesa e penaliteteve.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në:

Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 52 “Kryerja e shpenzimeve” .

Udhëzimin nr. 9 date 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” pika 184 “Nëpunësit zbatues të njërive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik”.

Raportet e monitorimit të buxhetit janë dërguar brenda afateve kohor në Ministrinë e Financave

dhe Ekonomisë, në zbatim të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, konkretisht:

- Raporti i monitorimit 4–mujor për zbatimin e buxhetit është dërguar me shkresën nr. 88371, prot datë 19.05.2023.
- Raporti i monitorimit 8–mujor për zbatimin e buxhetit është dërguar me shkresën nr. 15145, prot., datë 19.09.2023.
- Raporti i monitorimit 12-mujor për zbatimin e buxhetit të vitit 2023 është dërguar me shkresën nr. 3684, datë 26.02.2024.

Raportimi i detyrimeve të prapambetura.

Në zbatim të VKM- së nr. 50, datë 05.02.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe planit të veprimit” dhe Udhëzimit nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, më datë 07.02.2024, me shkresën nr. 2595 prot., Drejtorja e Financës dhe Buxhetit i ka nisur Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë Detyrimet e prapambetura deri në Dhjetor të vitit 2023.

Llog.	Emertimi	Vlera e detyrimit 31.12.2022	Vlera e detyrimit 31.12.2023
4864100	Detyr. e prapambetura Vendimet Gjyqësore	433,700.664	298,321,112
4864900	Detyr. e prapambetura Shtypshkronja e Letrave me Vlerë		12,873,444
Tot.		433,700,664	311,194,556

Vlera e detyrimeve të prapambetura deri më 31.12.2023 është 311,194,556 lekë, krahasuar me vitin paraardhës rezulton se në fund të vitit 2023 detyrimet e prapambetura janë pakësuar me 122,506 mijë lekë. Kjo vlerë është konfirmuar edhe nga vlera neto e llogarisë 486 “shpenzime te periudhave te ardhshme” në pasqyrat financiare të DPT. Totali i detyrimit përbëhet nga vendimet gjyqësore (gjyqëfitues ish punonjës dhe subjektet) dhe Shtypshkronja e Letrave me Vlerë. Në vitin paraardhës vlera e detyrimit nga vendimet gjyqësore për subjektet ishte 296,431,990 lekë dhe 137,268,674 lekë për ish punonjës. Për vitin 2023 vlera e detyrimit nga vendimet gjyqësore për subjektet është 239,153,387 lekë dhe 59,167,545 lekë për ish punonjës.

Në zbatim të Udhëzimit nr. 37, date 6.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”, kreu III pika 2 ku citohet se “*struktura përgjegjëse për thesarin. çdo muaj, deri në afatin e miratuar për publikimin e të dhënave përfundimtare të treguesve fiskal të konsoliduar, struktura përgjegjëse për Thesarin në degë kryen rakordimin mujor me njësitë shpenzuese, të konfirmuar zyrtarisht nga nëpunësi autorizues*”, dhe Udhëzimit nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, me shkresën nr. 3116, prot datë 18.2.2021 është përcjellë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë një kërkesë për bashkëpunim nga Drejtori i Përgjithshëm i DPT, ku është kërkuar bashkëpunim për mos raportimin mujor por 6 mujor të detyrimeve edhe gjatë vitit 2023 është vepruar në zbatim të kësaj shkrese.

Nga auditimi ka rezultuar se:

Nga auditimi konstatohet se DPT për vitin 2023 efekti në krijim e detyrimeve të prapambetura vlerësohet të jetë 311 milion leke nga të cilat janë për vendimet gjyqësore (subjekte) në vlerën 239,153 mijë lekë, në vlerën 137,268 mijë lekë për ish punonjës dhe Detyrime te prapambetura shtypshkrimesh në vlerën 12,873 mijë lekë dhe se në pasqyrat financiare të DPT nuk janë llogaritur provizione për shpenzimet. Krijimi i detyrimeve të prapambetura konstatohet se vjen edhe nga mos llogaritja e detyrimit të mundshëm në formën e provizioneve për planifikimin e fondeve në kohë. Konstatohet mos koordinim ndërmjet strukturave të ngarkuara me ndjekjen e vendimeve gjyqësore dhe atyre të ngarkuara me shlyerjen e vendimeve gjyqësore për

përlllogaritjen e efekteve në shpenzimet e vendimeve gjyqësore në kohë me pasojë krijimin e detyrimeve të prapambetura.

Pasqyra financiare viti 2023, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Bazuar në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022, për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8 date 09.03.2018 " Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme ".

Pasqyrat Financiare të raportimit për vitin 2023, përmbajnë:

- Pozicioni Financiar (Formati Nr.1).
- Performanca Financiare (Formati nr.2).
- Pasqyra e Cash Flow (Formati nr.3).
- Pasqyra e ndryshimeve në Aktivet Neto (Formati nr.4).
- Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore. (Formatet nr. 5).

Pasqyrat financiare vjetore shoqërohen nga disa pasqyra statistikore, të cilat janë:

- Pasqyra e investimeve dhe e burimeve të financimit të tyre (Formati nr.6).
- Pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto (Formati nr.7).
- Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave (Formati nr.8).

Veprimet për vitin 2023 janë azhornuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarët, ku llogaritë janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 neni 6, si dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006, UMF nr. 26, datë 27.12.2007.

Rregullshmëria e përgatitjes, dorëzimi dhe aprovimi i pasqyrave financiare vjetore.

Pasqyrat financiare vjetore të vitit 2023 i janë dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit dhe Degës së Thesarit me shkresën nr. 5167 prot., datë 20.03.2024, brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, në referim të paragrafit nr.117-119 dhe 121, të UMF nr.8, datë 9.3.2018. Bilanci ka të plotësuar aktiv-pasivin pasqyrat dhe anekset përkatëse dhe informacionin.

Zëri Aktive

Shuma e aktivitetit të pasqyrës financiare pasqyron aktivet e qëndrueshme, aktivet qarkulluese kërkesat për t'u arkëtuar dhe mjete monetare në llogarinë e thesarit që i shërbejnë institucionit për zhvillimin e aktivitetit të tij.

Nga të dhënat përmbledhëse të Aktivitetit të Pasqyrës Financiare të vitit ushtrimor të vitit 2023, rezulton se totali i aktivitetit me 31.12.2023 paraqitet me vlerën 1,174,401,254 lekë dhe se “Aktive Afatgjata”, zënë rreth 65 % të vlerës totale të aktivitetit ndërsa Aktivet Afatshkurtra zënë 35 % të vlerës totale. Aktivet Afatgjata në krahasim me vitin 2022, janë pakësuar në vlerën 28,492,247 lekë ndërsa, Aktivet Afatshkurtra janë pakësuar në vlerën 115,475,643 lekë.

Aktive Afatshkurtra. Totali i kësaj rubrike përfaqëson vlerën neto të aktiveve afatshkurtra dhe pasqyrohet në shumën lekë, e cila ka dalë si shumë e përgjithshme e llogarive “Mjeteve

monetare dhe ekujvalente të tyre” me “Gjendje inventarit qarkullues”, “Llogarive të arkëtueshme” dhe “Të tjera aktive afashkurtra”

Përbërës të këtij posti janë llogaritë:

- ❖ Mjete Monetare dhe ekujvalente të tyre në vlerën 14,386,625 lekë

Totali i llogarisë “Mjete Monetare dhe ekujvalente të tyre” ka pësuar një shtim me 4,820,753 lekë nga viti i shkuar.

- Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” ka pësuar një shtim me 4,820,753 lekë nga viti i shkuar, nga e cila në vlerën 2,761,078 lekë për ndalesën 5 % të garancisë në ruajtje. Për rikonstruksionin e ndërtesës dhe 2,059,675 lekë të ardhura të trashëguara.

- ❖ Gjendje Inventari Qarkullues me vlerën 27,082,678 lekë.

Totali i llogarisë “Gjendje inventari qarkullues ka pësuar një shtim me 501,608 lekë nga viti i shkuar. Nga krahasimi i të njëjtave poste për dy vitet, rezulton se diferenca e gjendjeve të inventarëve në fund të dy viteve, përputhet me efektin debitor të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” në Pasqyrën e performancës, e cila rezulton në vlerën 501,608 lekë.

Në përbërje të kësaj llogarie janë:

- Llogaria 31 “Materiale” me vlerë 26,118,727 lekë, shtuar nga viti i shkuar me 556,144 lekë, dhe pasqyron gjendjen e inventarit më datë 31.12.2023, materiale kancelarie si: letër, tonera, furnizime e materiale të tjera zyre e të përgjithshme, etj.
- Llogaria 32 “Inventar i imët” me vlerë 73,273 lekë, shtuar nga viti i shkuar me 10,800 lekë.
- Llogari të arkëtueshme me vlerë 53,047,378 lekë e cila përbëhet nga:
- Llogaria 4342 “Operacione me shtetin” me vlerë 52,277,893 lekë shtuar nga viti shkuar me 1,708,104 lekë, kjo llogari përfshin detyrime të konstatuara në vitin 2023, kryesisht në dhjetor 2023, detyrime për paga dhe kontribute të punonjësve të cilat, do të likujdohen nga fondet e buxhetore në vitin 2024.
- Llogaria 423, 429 Personeli, gjoba me vlerë 769,485 lekë, vlerë e pandryshuar nga viti i kaluar.

- ❖ Të tjera aktive afashkurtra me vlerë 311,194,556 lekë e cila përbëhet nga:

Llogaria 486 “Shpenzime te periudhave te ardhshme” me vlerë 311,194,556 lekë pakësuar 122,506,108 lekë nga viti shkuar përbëhet nga:

Gjendja e mbartur 31.12.2022	433,700,664
Vendimet Gjyqësore krijuar ne vitin 2023	141,422,917
Detyrime te prapambetura shtypshkrimesh krijuar ne vitin 2023	12,873,444
Vendimet Gjyqësore te paguara ne vitin 2023	276,802,469
Gjendja 31.12.2023	311,194,556

Më 20.12.2023, nr. 579 prot. Shtypshkronja e Letrave me Vlerë sh.a. i ka nisur Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve faturat e palikujduara ku saktëson se nga 28.12.2012- 25.10.2021 vlera totale e palikujduar është 12,999,705 lekë dhe përgjatë vitit ushtrimor 2023 është 12,898,704 lekë. Në total vlera e mbetur për likuidim është 25,989,409 lekë. Më datë 29.12.2023, nr. 3, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, ka kryer likuidimin e pjesshëm në vlerën 12,873,444 lekë.

Aktive Afatgjata. Totali i kësaj rubrike përfaqëson vlerën neto të aktiveve afatgjata dhe pasqyrohet në vlerën 768,690,017 lekë, e cila ka dalë si shumë e përgjithshme e llogarive “aktive afatgjata jomateriale”, “aktive afatgjata materiale” dhe “investime”

Përbërës të këtij posti janë llogaritë:

- Llogaria 20 “Aktive Afatgjata jo materiale” me vlerë totale prej 22,105,144 lekë pakësuar nga viti i shkuar me 2,186,316 lekë përbëhet nga:

- Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” me vlerë 22,105,144 lekë shtuar nga viti i shkuar me 2,186,316 lekë.
- Llogaria 21 “Aktive Afatgjata Materiale” me vlerë totale prej 746,584,873 lekë pakësuar nga viti i shkuar me 26,305,931 lekë përbëhet nga:
- Llogaria 212 Ndërtesa e Konstruksione me vlerë 116,229,038 lekë pakësuar nga viti i shkuar me 5,716,775 lekë.
- Llogaria 213 Rruge, rrjete, vepra ujore me vlerë 123,748,617 lekë pakësuar nga viti i shkuar me 30,937,151 lekë.
- Llogaria 214 Instalime teknike, makineri e paisje me vlerë 385,728,089 lekë pakësuar nga viti i shkuar me 54,043,486 lekë.
- Llogaria 215 Mjete Transporti me vlerë 25,155,958 lekë pakësuar nga viti i shkuar me 3,803,557 lekë.
- Llogaria 218 Inventar ekonomik me vlerë 52,209,241 lekë shtuar nga viti i shkuar me 24,681,108 lekë.
- Llogaria 28 Caktime te Aktiveve Afatgjata me vlerë 43,513,930 lekë shtuar nga viti i shkuar me 43,513,930 lekë. Investime akoma në proces në vlerën 43,513,930 lekë.

Amortizimi është llogaritur për çdo grup veç e veç sipas klasifikimit ekonomik për aktivet afatgjata jo materiale dhe materiale në përputhje me normat e amortizimit në pikën 36 të Udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” *“Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata, deri në daljen e dispozitave ligjore të veçanta për sektorin publik, amortizimi vjetor i këtyre aktiveve është llogaritur t sipas normave të përcaktuara në legjislacionin fiskal përkatës, si më poshtë vijon:*

- *Për aktivet afatgjata, materiale si: ndërtesat, konstruksionet, linjat teknologjike e të prodhimit dhe makineritë e pajisjet me afat të gjatë shërbimi, duhet të zbatohet norma 5%, duke i llogaritur veçmas me vlerën e mbetur;*
- *Kompjuterët, pajisjet e ruajtjes së të dhënave, softet e sisteme informacioni të amortizohen mbi bazë grupimi me normën 25%;*
- *Për të gjitha aktivet e tjera afatgjata materiale duhet të zbatohet norma vjetore e amortizimit 20% mbi bazë grupimi; dhe*
- *Për aktivet afatgjata jomateriale, amortizimi të llogaritet me metodën lineare me normë amortizimi 15%.”.*

Gjatë vitit 2023 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka patur shtesa në vlerën 61,874,044 lekë, pakësime në vlerën 42,094,404 lekë në llogarinë 218 Inventar Ekonomik.

Pasivi

Duke analizuar pasivin e bilancit të këtij viti dhe duke e krahasuar me një vit më parë, rezulton se llogaritë pasive janë pakësuar në krahasim me një vit më parë me 118,036,926 lekë. Totali i kësaj rubrike përfaqëson vlerën neto të pasiveve (detyrimeve) afatshkurtra dhe pasqyrohet në vlerën 376,568,885 lekë, e cila ka dalë si shumë e përgjithshme e llogarive “Llogari të Pagueshme”, “Detyrime ndaj personelit”, “Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore” dhe “Det. ndaj shtetit për tatim taksa”.

Përbërës të këtij posti janë llogaritë:

- “Llogari të Pagueshme” me vlerë totale prej 376,568,885 lekë pakësuar nga viti i shkuar me 118,036,926 lekë përbëhet nga:
- Llogaria 401-408 “Furnitore dhe llogari te lidhura me to” me vlerë 21,795,444 lekë shtuar nga viti i shkuar me 7,988,130 lekë

- Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit” me vlerë 23,387,078 lekë shtuar nga viti i shkuar me 4,719,987 lekë
- Llogaria 431 “Det. ndaj shtetit për tatim taksa” me vlerë 3,606,069 lekë shtuar nga viti i shkuar me 725,258 lekë
- Llogaria 435- 436 “Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore” 8,081,408 me vlerë lekë shtuar nga viti i shkuar me 1,585,038 lekë
- Llogaria 466 “Kreditore për mjete në ruajtje” 12,326,951 me vlerë lekë shtuar nga viti i shkuar me 2,761,078 lekë
- Llogaria 467 “Kreditore të ndryshme” 306,602,450 me vlerë lekë pakësuar nga viti i shkuar me 135,816,417 lekë
- Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” 769,485 me vlerë lekë i pandryshuar nga viti i shkuar
- Llogaritë 101 “*Teprica (Fond i akumuluar)/ Deficit i akumuluar*”, në vlerën 795,271,086 lekë. Këto fonde i përgjigjen pjesës së aktivitetit të bilancit.

Llogaria 423,429 “*Personeli, paradhënie, deficite, gjoha*” e aktivitetit e cila paraqitet në shumën 769,485 lekë dhe rakordon në pasiv me llogarinë 4341 “*Operacione me shtetin (detyrime)*” e cila përbëhet nga: llog 423: Debitorë të vjetër në vlera monetare/materiale O. S., M. S. në vlerën 227,490 lekë; llog 429: Debitorë të vjetër sipas urdhër zhdëmtimeve për mjetet në ngarkim “J. Sh.” në vlerën 541,995 etj.

Llogaria 4342 “*Operacione me shtetin (të drejta)*” në shumën 52,277,893 lekë, përbëhet nga detyrimet afatshkurtra të Dhjetorit 2022, e cila së bashku me llog 486 në shumën 311,194,556 lekë, kuadrojnë me llogaritë:

- Llogaria 401-408 “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*” në vlerën 21,795,444 lekë;
- Llogaria 42 “*Detyrime ndaj personelit*” në vlerën 23,387,078 lekë,
- Llogaria 431 “*Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa*” në vlerën 3,606,069 lekë,
- Llogaria 435 “*Detyrime për sigurime shoqërore*” në vlerën 7,081,824 lekë,
- Llogaria 436 “*Detyrime për sigurime shëndetësore*” në vlerën 999,584 lekë dhe llog 467 në vlerën 306,602,450 lekë.

Sipas Udhëzimit nr. 8 datë 09.03.2018 Llogaria 4342 “*Operacione me shtetin (të drejta)*” është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit). Raste specifike të tilla mund të jenë këto (por jo vetëm) si: pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore, apo ndonjë detyrim për tatimin mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit, por paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm. Veprimet kontabile në lidhje me këtë llogari janë si më poshtë: a) Gjatë konstatimit të shpenzimit është bërë veprimi:

- Debitohen llogaritë respektive të klasës 6 “*Shpenzime sipas natyrës*”;
- Kreditohen llogaritë e detyrimeve për konstatimin e detyrimit (42, 43, 40, e të tjera).

b) Në fund të periudhës duhet të bëhet veprimi:

- Debitohet llogaria 4342 “*Operacione me shtetin (të drejta)*”;
- Kreditohet llogaria 7206 “*Financim i pritshëm nga buxheti*”.

Në lekë

Llogaria	Vlera
Llog 486	311,194,556
Llog 4342	52,277,893
Total	363,472,449
Llog 401- 408	21,795,444
Llog 42	23,387,078
Llog 431	3,606,069
Llog 435	7,081,824
Llog 436	999,584
Llog 438	-

Llog 467	306,602,450
Total	363,472,449

Burimi: Të dhëna të DPT të përpunuar nga audituesit e KLSH.

Rezultati i veprimtarisë ushtrimore

Në lekë

Referenca e Logarive	E M E R T I M I	Ushtrimi I Mbyllur	Ushtrimi Paraardhës	Diferenca
C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	797,832,369	823,763,333	25,930,964
D	FONDII KONSOLIDUAR :	797,832,369	823,763,333	25,930,964
101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	795,271,086	848,583,289	53,312,203
85	Rezultati I Veprimtarisë Ushtrimore	501,608	-24,819,956	-25,321,564
	Te Tjera	2,059,675		-2,059,675
E	TOTALII PASIVEVE(B+C)	1,174,401,254	1,318,369,144	143,967,890

Rezultati i veprimtarisë ushtrimore paraqitet në vlerën 501,608 lekë e detajuar sipas tabelës.

b. Auditimi i llogarive të të ardhurave dhe shpenzimeve (Pasqyra e performancës)

Mbi të ardhurat:

Totali i ardhurave të funksionimit në “Pasqyrën e Performancës” është i barabartë me totalin e shpenzimeve vjetore plus rezultatin e ushtrimit (formati nr.2). Konkretisht për vitin 2023 paraqiten si më poshtë vijon:

i. Të ardhurat (grupi A, pasqyra F2) = 2,257,963,192 lekë

ii. Shpenzimet (grupi B, kolona 74 e F2) = 2,257,461,584 lekë

iii. Rezultati i ushtrimit (llog.85) = 501,608 lekë

Llogaria 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” nuk është element që ndikon në rezultat, por nëpërmjet operacioneve të transferimit ndikon sipas rastit në shtesë apo pakësim të fondeve bazë të institucioneve. Nga veprimet kontabël të bëra nga institucioni dhe të pasqyruar në pasqyrën e performancës financiare ndryshimi i gjendjes është pasqyruara drejtë në shumën prej 501,608 lekë, vlerë e cila rakordon me llogarinë 85 në vlerën 501,608.

Llogaria 7200 “Grante korrente nga Buxheti Qendror” është pasqyruar në vlerën 989,522,429 lekë, 1,075,357,069 lekë më pak se viti paraardhës.

Llogaria 7205 “Financim shtese për te ardhurat e krijuara brenda sistemit”, përbëhet nga shuma e përdorur nga te ardhurat për shpenzime, shuma 1,216,162,870 lekë, 254,917,955 lekë më shumë se viti paraardhës.

Llogaria 7206 “Financimi i pritshëm nga buxheti” është paraqitur si kundërpadi e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin” në vlerën 52,277,893 lekë si një detyrim që shteti ka kundrejt institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara.

Mbi shpenzimet

Në këtë format janë përfshirë shpenzimet faktike nga 1 Janari deri me 31 Dhjetor 2023.

-Llogaria (63) “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në vlerën 501,608 lekë, përfaqëson ndryshimin e gjendjes së inventarit në magazinën e materialeve dhe objekteve të inventarit të imët në përdorim të punonjësve, evidentuar në Formatin nr.2, për 501,608 lekë, rakordon me

ndryshimin e gjendjes të magazinës dhe është sa diferenca e klasës 2 “Gjendja e inventarit” në aktivin e bilancit ku (2,257,963,192 lekë -2,257,461,584 lekë= 501,608lekë)
Krahasuar me vitin paraardhës, në total llogaria e të ardhurave është ulur me 818,741,010 lekë më pak dhe llogaria e shpenzime në total është ulur me 844,062,574 lekë më pak.

c. Pasqyra e Flukseve Monetare (Cash Flow)

Në këtë pasqyrë janë pasqyruar fonde buxhetore të akorduara për shpenzime korrente të vitit 2023, shpenzimet e vitit ushtrimor, fondet buxhetore të akorduara për investime dhe shpenzimet e investimeve. Teprica e likuiditetit në fund të vitit ushtrimor është 14,386,625 lekë dhe rakordon me vlerën e fondeve disponibilitet në thesar.

Kontrolli periodik i aktiveve

Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë, i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me efience të tyre.

1-Procesi i inventarizimit të aktiveve në administratën e DPT

Në zbatim të neneve 8- 22 të Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 30, datë 27.10.2011, i ndryshuar kreu IV, për kryerjen e inventarizimit të vlerave materiale, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka ngritur Urdhërin nr. 19871, datë 11.12.2023 të Drejtorisë së Përgjithshme “Për ngritjen e komisionit për inventarizimin e aktiveve të institucionit”. Duke qene se dorëzimi i këtij raporti duhej të bëhej brenda 45 ditëve nga data e çeljes së urdhrorit, dhe nga ana e Komisionit është vlerësuar si kohë e pamjaftueshme, nga komisioni është kërkuar shtyrja nëpërmjet shkresës 1496 prot., datë 24.01.2024 drejtuar titullarit, kërkesë e cila është pranuar. Më datë 11.12.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka zhvilluar procesin e inventarizimit të aktiveve të saj. Komisioni i inventarizimit përbëhet nga pesë anëtarë: A K (Kryetar), E O (Anëtar), K H (Anëtar), A Q (Anëtar), I F (Anëtar). Fletët e inventarit të aktiveve në përdorim dhe të aktiveve gjendje në magazinën e institucionit, me informacionin sipas gjendjes kontabël në datën 15.12.2023. Komisioni ka arritur në përfundimin se për aktivet e inventarizuara:

- Nuk ka diferenca dhe dëmtime fizike të aktiveve dhe materialeve dhe se janë në gjendje cilësore dhe funksionale.
- Nuk ka diferenca midis të dhënave kontabël të aktiveve dhe të dhënave të librave të magazinës që mbahen nga punonjësi me përgjegjësi materiale.

Gjatë inventarizimit komisioni konstatoi se:

1. Disa prej punonjësve dhe ish- punonjësve të DPT- s rezultojnë me materiale në ngarkim në vlerën 331,523 lekë.
2. K P, në magazinën M03 me vlerë 227,317,264.01 lekë rezulton se ka ende në ngarkim materiale pasi asnjë punonjës nga Drejtoria TIK e atashuar pranë DPT- s nuk pranon ti marr në ngarkim materialet. Ky verifikim fizik u krye pranë drejtorisë TIK në DPT në prani të K.P. pavarësisht faktit që nuk ishte më punonjës i DPT. Inventari përmban orendi, mobilie, pajisje zyre dhe sisteme, pajisje dhe programe IT. Për këto materiale nuk ishte kryer procedura e dorëzimit kur është larguar nga puna punonjësi. Nga auditimi i dokumenteve bazuar në fletë hyrjen në magazine dhe sistemin e kartelës së përgjegjësit, u konstatua se orendi, mobilie, pajisje zyre etj., janë kaluar në kartelën e drejtorit të TIK në DPT. Ndërsa sistemet, pajisjet, programet do të kalohen nga “Komisioni i Kalimit Kapital” ndërmjet DPT-AKSHI-it, rezulton se nuk është finalizuar ky kalim inventari gjatë vitit 2023. Kjo problematikë e konstatuar edhe nga

komisioni i inventarizimit lidhet edhe me mos finalizimin e procedurës së inventarizimit midis AKSH-DPT në kundërshtim të urdhrit të përbashkët të kalimit kapital me nr. 8778, datë 02.05.2019, sipas të cilit afati i transferimit duhet të ishte përfunduar 09.05.2019.

3. Disa material rezultojnë “jashtë funksionit” të nënshkruara nga përgjegjësia e magazines së DPT- s H K si dhe punonjës të DPT-s.
4. Kartelat e inventarizimit të A A dhe E Q janë konfiskuar nga ana e Prokurorisë së Rrethit Tiranë, njësitë kompjuterike si dhe janë verifikuar sistemet të cilat janë në ngarkim të A A.

Nga auditimi i dosjeve të inventarit u konstatua se para fillimit të inventarit, nga komisioni i inventarizimit nuk është mbajtur procesverbal ku të ishte fiksuar numri rendor nëpërmjet një procesverbali të mbajtur midis përgjegjësit material (magazinerit) dhe komisionit të inventarizimit, veprim ky referuar me pikën 82 të UMFE nr. 30/2011, i ndryshuar, ku citohet ... “Para fillimit të inventarit fiksohet numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljeve nëpërmjet një proces verbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit dhe bëhet mbyllja dhe dyllosja e magazinës. Në dosje janë depozituar kartelat/ fletët e inventarit të çdo punonjësi, të nënshkruara rregullisht nga komisioni i inventarizimit dhe personat materialisht përgjegjës.

Nga komisioni i inventarizimit në fund të procesit ka përgatitur raportin mbi inventarizimin për gjendjen e aktiveve në përdorim, si dhe për vlerat materiale, (për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike), ku së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit është dorëzuar tek nëpunësi autorizues për veprime të mëtejshme, veprime në përputhje me paragrafin 85/c të UMF nr. 30/2011, i ndryshuar. Në këtë raport komisioni ka bashkangjitur në formë tabelore fletë- hyrjen dhe fletë daljen e fundit më datë 15.12.2023, për secilën magazine:

Magazina	FD e fundit datë 15.12.2023	FH e fundit datë 15.12.2023
M258- Mjete Kryesore Hysnia	425	323
M257- Materiale DPT Hysnia	433	31
M264- Materiale Silvana	142	11
M263- Mjete Kryesore Silvana	74	39
M265- Shtypshkrime Silvana	-	-
M235- Bileta Transporti	233 (mandate pagese)	117 (mandate arkëtimi)
M236- Pullë Takse	80 (mandate pagese)	40 (mandate arkëtimi)

2-Procesi i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi, në administratën e DPT

Me urdhër të brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT, Urdhri nr.1380/5 prot., datë 20.09.2022 është ngritur komisioni “Për ngritjen e komisionit të asgjësimit të materialeve në inventar të DPT”. Me shkresën nr.13801/9, datë 18.10.2022 është dërguar raporti përfundimtarë mbi procedurën e ndjekur nga komisioni. Komisioni ka bërë ndarjen e aktiveve që jashtë përdorimit por që janë të riciklueshme dhe do të ndiqet procedura e shitjes në ankand. Me anë të shkresës nr. 13801/7 prot., datë 14.10.2022 ka përcjellë pranë drejtorisë së mbështetjes listën e aktiveve që do të zbatohet procedura me ankand. Procedura e ndjekur nga dy komisionet është në përputhje me përcaktimet ligjore të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik “.

Me Urdhrin e Brendshëm nr.125, datë 29.09.2022, është ngritur grupi i punës ku AKSHI ka marr në ngarkim Aktivitet për infrastrukturën hardware dhe sistemeve IT, në zbatim të Urdhrit të Përbashkët nr.1, datë 19.10.2022, për AKSHI Nr. 6541 Prot., datë 19.10.2022 dhe DPT Nr. 13801/10 Prot., datë 19.10.2022 është finalizuar procesi i kalimit të pajisjeve dhe softuere të sistemeve:

1. E-TAX

2. M-TAX

3. Fiskalizimi - “Përmirësimi i modulit të menaxhimit të kontrollit të faturimit”

4. AEOI - “Sistemi i shkëmbimit të informacionit”

Kalimi i aseteve konfirmohet me shkresën e AKSHI-t Nr.7535/1, datë 07.12.2022 për marrjen në dorëzim të aktiveve. Konstatohet se procesi inventarit nuk është finalizuar i plotë pasi nuk është bërë kalimi tek AKSHI për sistemet NEXUS, Harta digjitale dhe BI për shkak të mungesës së kodit burim të softuere-ve si edhe dhomës së serverit tek AKSHI, me justifikim se AKSHI nuk ka kushtet e duhura për ta bërë këtë kalim. Në vitin 2023 Drejtorja e Shërbimeve Mbështetëse, në DPT, i është drejtuar Sektorit të Prokurimeve me shkresën nr. 13801/15 prot., më datë 5.4.2023 ku i ka vendosur kësaj të fundit në dispozicion shkresën e listës material ku evidentohen aktivet për procedure ankandi.

Nga auditimi ka rezultuar se:

Nga auditimi konstatohet se DPT përsa i përket procesit të vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi për vitin 2022, në administratën e DPT, për aktivet për procedurë ankandi nuk është ndjekur procedura e shitjes në ankand si dhe se edhe përgjatë vitit 2023 në zbatim të VKM nr. 673 date 22.11.2017 për “Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar, neni IV pika 18, nuk është realizuar procedura e kalimit të aseteve nga DPT tek AKSHI. Konstatohet se nuk është bërë kalimi tek AKSHI për sistemet NEXUS, Harta digjitale dhe BI për shkak të mungesës së kodit burim të software-ve si edhe dhomës së serverit tek AKSHI, me justifikim se AKSHI nuk ka kushtet e duhura për ta bërë këtë kalim.

Pasqyra financiare viti 2023, Të konsoliduara

Bazuar në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022, për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8 date 09.03.2018 " Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme ".

Pasqyrat Financiare të raportimit për vitin 2023, përmbajnë:

- Pozicioni Financiar (Formati Nr.1).
- Performanca Financiare (Formati nr.2).
- Pasqyra e Cash Floë (Formati nr.3).
- Pasqyra e ndryshimeve në Aktivet Neto (Formati nr.4).
- Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore. (Formatet nr. 5).

Pasqyrat financiare vjetore shoqërohen nga disa pasqyra statistikore, të cilat janë:

- Pasqyra e investimeve dhe e burimeve të financimit të tyre (Formati nr.6).
- Pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto (Formati nr.7).
- Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave (Formati nr.8).

Veprimet për vitin 2023 janë azhornuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarët, ku llogaritë janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 neni 6, si dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006, UMF nr. 26, datë 27.12.2007.

Regullshmëria e përgatitjes, dorëzimi dhe aprovimi i pasqyrave financiare vjetore.

Pasqyrat financiare vjetore të vitit 2023 i janë dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Juridike dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe Degës së Thesarit me shkresën nr. 7339 prot., datë 23.04.2024, brenda brenda muajit prill, afatit referuar udhëzimit. Këto pasqyra hartohen nga DPT duke përmbledhur informacionin respektiv të pasqyrave financiare të hartuara nga DPT: Aparati i Drejtorisë, Sektori i Pagesave, Vipa- t dhe 14 DRT: Berat, Durrës, Dibër, Elbasan, Fier, Gjirokastër, Korçë, Kukës, Lezhë, Sarandë, Shkodër, Tiranë, Vlorë dhe Sarandë.

Zëri Aktive

Shuma e aktivitetit të pasqyrës financiare pasqyrojnë aktivitetet e qëndrueshme, aktivitetet qarkulluese kërkesat për t'u arkëtuar dhe mjete monetare në llogarinë e thesarit që i shërbejnë institucionit për zhvillimin e aktivitetit të tij.

Nga të dhënat përmbledhëse të Aktivitetit të Pasqyrës Financiare të vitit ushtrimor të vitit 2023, rezultojnë se totali i aktivitetit me 31.12.2023 paraqitet me vlerën 487,362,339,659 lekë dhe se "Aktive Afatgjata", zënë rreth 0.3 % të vlerës totale të aktivitetit ndërsa Aktivitetet Afatshkurtra zënë 99.7 % të vlerës totale. Aktivitetet Afatgjata në krahasim me vitin 2022, janë pakësuar në vlerën 13,301,138 lekë ndërsa, Aktivitetet Afatshkurtra janë shtuar në vlerën 50,831,217,617 lekë.

Aktive Afatshkurtra. Totali i kësaj rubrike përfaqëson vlerën neto të aktiveve afatshkurtra dhe pasqyrohet në shumën lekë, e cila ka dalë si shumë e përgjithshme e llogarive "Mjeteve monetare dhe ekujvalente të tyre" me "Gjendje inventarit qarkullues", "Llogarive të arkëtueshme" dhe "Të tjera aktive afatshkurtra"

Përbërës të këtij posti janë llogaritë:

❖ Gjendje Inventari Qarkullues me vlerën 95,577,933 lekë.

Totali i llogarisë "Gjendje inventari qarkullues ka pësuar një pakësim me 4,789,347 lekë nga viti i shkuar. Nga krahasimi i të njëjtave poste për dy vitet, rezultojnë se diferenca e gjendjeve të inventarëve në fund të dy viteve, përputhet me efektin debitor të llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit" në Pasqyrën e performancës, e cila rezultojnë në vlerën 4,789,347 lekë.

Në përbërje të kësaj llogarie janë:

- Llogaria 31 "Materiale" me vlerë 59,577,083 lekë, shtuar nga viti i shkuar me 6,971,863 lekë, dhe pasqyrojnë gjendjen e inventarit më datë 31.12.2023, materiale kancelarie si: letër, tonera, furnizime e materiale të tjera zyre e të përgjithshme, etj.
- Llogaria 32 "Inventar i imët" me vlerë 4,132,719 lekë, pakësuar nga viti i shkuar me 718,156 lekë.
- Llogaria 35 "Mallra" me vlerë 31,868,131 lekë, pakësuar nga viti i shkuar me 1,464,360 lekë.
- Llogari të arkëtueshme me vlerë 268,009,249,378 lekë e cila përbëhet nga:
- Llogaria 4342 "Operacione me shtetin" me vlerë 110,629,182,893 lekë shtuar nga viti i shkuar me 2,562,950,499 lekë, kjo llogari përfshin detyrime të konstatuara në vitin 2023, kryesisht në dhjetor 2023, detyrime për paga dhe kontribute të punonjësve të cilat, do të likujdohen nga fondet e buxhetore në vitin 2024.
- Llogaria 423, 429 Personeli, gjoha me vlerë 805,141 lekë, vlerë e pandryshuar nga viti i kaluar
- Llogaria 468 Debitorë të ndryshëm me vlerë 157,379,261,344 lekë, nga viti i kaluar shtuar nga viti i shkuar me 7,858,450,502 lekë

❖ Të tjera aktive afashkurtra me me vlerë 311,194,556 lekë e cila përbëhet nga:
Llogaria 486 “Shpenzime te periudhave te ardhshme” me vlerë 311,194,556 lekë pakësuar
122,506,108 lekë nga viti shkuar përbëhet nga:

Gjendja e mbartur 31.12.2022	433,700,664
Vendimet Gjyqësore krijuar ne vitin 2023	141,422,917
Detyrime te prapambetura shtypshkrimesh krijuar ne vitin 2023	12,873,444
Vendimet Gjyqësore te paguara ne vitin 2023	276,802,469
Gjendja 31.12.2023	311,194,556

Detyrime që vijnë nga kontratat e lidhura mbi ofrimin e shërbimit ndaj institucionit (angazhime financiare).

Aktive Afatgjata. Totali i kësaj rubrike përfaqëson vlerën neto të aktiveve afatgjata dhe pasqyrohet në vlerën 1,298,376,744 lekë, e cila ka dalë si shumë e përgjithshme e llogarive “aktive afatgjata jomateriale”, “aktive afatgjata materiale” dhe “investime”

Përbërës të këtij posti janë llogaritë:

- Llogaria 20 “Aktive Afatgjata jo materiale” me vlerë totale prej 22,105,144 lekë pakësuar nga viti i shkuar me 2,186,316 lekë përbëhet nga:
- Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” me vlerë 22,105,144 lekë shtuar nga viti i shkuar me 2,186,316 lekë.
- Llogaria 21 “Aktive Afatgjata Materiale” me vlerë totale prej 1,276,271,600 lekë pakësuar nga viti i shkuar me 11,114,822 lekë përbëhet nga:
- Llogaria 210 Toka, Troje, Terrene me vlerë 16,194,396 lekë i pandryshuar nga viti i shkuar.
- Llogaria 212 Ndërtesa e Konstruksione me vlerë 484,764,756 lekë shtuar nga viti i shkuar me 5,986,791 lekë.
- Llogaria 213 Rruge, rrjete, vepra ujore me vlerë 123,748,617 lekë pakësuar nga viti i shkuar me 30,945,573 lekë.
- Llogaria 214 Instalime teknike, makineri e paisje me vlerë 405,289,421 lekë pakësuar nga viti i shkuar me 58,551,319 lekë.
- Llogaria 215 Mjete Transporti me vlerë 56,827,652 lekë pakësuar nga viti i shkuar me 1,884,193 lekë.
- Llogaria 218 Inventar ekonomik me vlerë 145,482,064 lekë pakësuar nga viti i shkuar me 30,810,008 lekë.
- Llogaria 24 Aktive Afatgjata të dëmtuara me vlerë 422,588 lekë pakësuar nga viti i shkuar me 44,466 lekë.
- Llogaria 28 Caktime te Aktiveve Afatgjata me vlerë 43,513,930 lekë shtuar nga viti i shkuar me 43,513,930 lekë.

Amortizimi është llogaritur për çdo grup veç e veç sipas klasifikimit ekonomik për aktivet afatgjata jo materiale dhe materiale në përputhje me normat e amortizimit në pikën 36 të Udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” “Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata, deri në daljen e dispozitave ligjore të veçanta për sektorin publik, amortizimi vjetor i këtyre aktiveve është llogaritur t sipas normave të përcaktuara në legjislacionin fiskal përkatës, si më poshtë vijon:

- Për aktivet afatgjata, materiale si: ndërtesat, konstruksionet, linjat teknologjike e të prodhimit dhe makineritë e pajisjet me afat të gjatë shërbimi, duhet të zbatohet norma 5%, duke i llogaritur veçmas me vlerën e mbetur;

- Kompjuterët, pajisjet e ruajtjes së të dhënave, softë e sisteme informacioni të amortizohen mbi bazë grupimi me normën 25%;

- Për të gjitha aktivet e tjera afatgjata materiale duhet të zbatohet norma vjetore e amortizimit 20% mbi bazë grupimi; dhe
- Për aktivet afatgjata jomateriale, amortizimi të llogaritet me metodën lineare me normë amortizimi 15%.”.

Pasivi

Gjendja e llogarive pasive në fund të vitit 2023, gjendja e tyre një vit më parë, por edhe diferenca midis dy periudhave (2023-2022), rezultuan si në tabelën e mëposhtme:

Pasivi (Detyrimet)

Duke analizuar pasivin e bilancit të këtij viti dhe duke e krahasuar me një vit më parë, rezulton se llogaritë pasive janë shtuar në krahasim me një vit më parë me 50,824,451,216 lekë. Totali i kësaj rubrike përfaqëson vlerën neto të pasiveve (detyrimeve) afatshkurtra dhe pasqyrohet në vlerën 485,966,348,126 lekë, e cila ka dalë si shumë e përgjithshme e llogarive “Llogari të Pagueshme”, “Detyrime ndaj personelit”, “Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore” dhe “Det. ndaj shtetit për tatim taksa”.

Përbërës të këtij posti janë llogaritë:

- “Llogari të Pagueshme” me vlerë totale prej 485,966,348,126 lekë shtuar nga viti i shkuar me 50,824,451,216 lekë përbëhet nga:
- Llogaria 401-408 “Furnitore dhe llogari te lidhura me to” me vlerë 24,124,180 lekë shtuar nga viti i shkuar me 4,725,639 lekë
- Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit” me vlerë 104,800,448 lekë shtuar nga viti i shkuar me 15,870,464 lekë
- Llogaria 431 “Det. ndaj shtetit për tatim taksa” me vlerë 12,319,408 lekë shtuar nga viti i shkuar me 3,079,643 lekë
- Llogaria 435- 436 “Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore” me vlerë 35,000,448 lekë shtuar nga viti i shkuar me 5,783,429 lekë
- Llogaria 44 “Institucione të tjera publike” me vlerë 8,019,269 lekë shtuar nga viti i shkuar me 877,226 lekë
- Llogaria 466 “Kreditore per mjete ne ruajtje” me vlerë 217,637,802,302 lekë shtuar nga viti i shkuar me 40,524,688,476 lekë
- Llogaria 467 “Kreditore te ndryshem” me vlerë 110,764,215,586 lekë shtuar nga viti i shkuar me 2,410,975,837 lekë
- Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” me vlerë 157,380,066,485 lekë shtuar nga viti i shkuar me 7,858,450,502 lekë
- Llogaritë 101 “**Teprica (Fond i akumuluar)/ Deficit i akumuluar**”, në vlerën 1,389,142,511 lekë. Këto fonde i përgjigjen pjesës së aktivitetit të bilancit.

Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” në shumën 110,629,182,893 lekë, përbëhet nga detyrimet afatshkurtra të Dhjetorit 2022, e cila së bashku me llog 486 në shumën 311,194,556 lekë, nuk kuadrojnë me diferencën në vlerën 82,621 lekë, me llogaritë:

- Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari te lidhura me to” në vlerën 24,124,180 lekë;
- Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit” në vlerën 104,800,448 lekë,
- Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” në vlerën 12,319,408 lekë,
- Llogaria 435 “Detyrime për sigurime shoqërore” në vlerën 30,681,634 lekë,
- Llogaria 436 “Detyrime për sigurime shëndetësore” në vlerën 4,318,814 lekë dhe llog 467 në vlerën 110,764,215,586 lekë.

Sipas Udhëzimit nr. 8 datë 09.03.2018 Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore,

por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit). Raste specifike të tilla mund të jenë këto (por jo vetëm) si: pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore, apo ndonjë detyrim për tatimin mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit, por paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm. Veprimet kontabile në lidhje me këtë llogari janë si më poshtë: a) Gjatë konstatimit të shpenzimit është bërë veprimi:

- Debitohen llogaritë respektive të klasës 6 “Shpenzime sipas natyrës”;
- Kreditohen llogaritë e detyrimeve për konstatimin e detyrimit (42, 43, 40, e të tjera).

b) Në fund të periudhës duhet të bëhet veprimi:

- Debitohet llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”;
- Kreditohet llogaria 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”.

Në lekë

Llogaria	Vlera
Llog 486	311,194,556
Llog 4342	110,629,182,893
Total	110,940,377,449
Llog 401- 408	24,124,180
Llog 42	104,800,448
Llog 431	12,319,408
Llog 435	30,681,634
Llog 436	4,318,814
Llog 438	
Llog 467	110,764,215,586
Total	110,940,460,070

Rezultati i veprimtarisë ushtrimore

Në lekë

Referenca e Llogarive	EMERTIMI	Ushtrimi i mbyllur	Ushtrimi Paraardhës	Diferenca
C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	1,395,991,533	1,402,526,270	6,534,737
D	FONDI I KONSOLIDUAR :	1,395,991,533	1,402,526,270	6,534,737
101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	1,389,142,511	1,436,555,975	47,413,464
85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	4,789,347	-34,029,705	-38,819,052
	Të Tjera	2,059,675	0	-2,059,675
E	TOTALI I PASIVEVE(B+C)	487,362,339,659	436,544,423,180	-50,817,916,479

Rezultati i veprimtarisë ushtrimore paraqitet në vlerën 4,789,347 lekë e detajuar sipas tabelës.

b. Auditimi i llogarive të të ardhurave dhe shpenzimeve (Pasqyra e performancës)

Mbi të ardhurat:

Totali i ardhurave të funksionimit në “Pasqyrën e Performancës” është i barabartë me totalin e shpenzimeve vjetore plus rezultatin e ushtrimit (formati nr.2). Konkretisht për vitin 2023 paraqiten si më poshtë vijon:

i. Të ardhurat (grupi A, pasqyra F2) = 345,225,747,126 lekë

ii. Shpenzimet (grupi B, kolona 74 e F2) = 345,220,957,779 lekë

iii. Rezultati i ushtrimit (llog.85) = 4,789,347 lekë

Llogaria 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” nuk është element që ndikon në rezultat, por nëpërmjet operacioneve të transferimit ndikon sipas rastit në shtesë apo pakësim të fondeve bazë të institucioneve. Nga veprimet kontabël të bëra nga institucioni dhe të pasqyruar në pasqyrën e performancës financiare ndryshimi i gjendjes është pasqyruara drejtë në shumën prej 4,789,347 lekë, vlerë e cila rakordon me llogarinë 85 në vlerën 4,789,347 lekë.

Llogaria 7200 “Grante korrente nga Buxheti Qendror” është pasqyruar në vlerën 5,027,866,845 lekë, 590,407,923 lekë më pak se viti paraardhës.

Llogaria 7205 “Financim shtese për te ardhurat e krijuara brenda sistemit”, përbëhet nga shuma e përdorur nga te ardhurat për shpenzime, shuma 1,216,162,870 lekë, 254,917,955 lekë më shumë se viti paraardhës.

Mbi shpenzimet

Në këtë format janë përfshirë shpenzimet faktike nga 1 Janari deri me 31 Dhjetor 2023.

-Llogaria (63) “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në vlerën 4,789,347 lekë, përfaqëson ndryshimin e gjendjes së inventarit në magazinën e materialeve dhe objekteve të inventarit të imët në përdorim të punonjësve, evidentuar në Formatin nr.2, për 4,789,347 lekë, rakordon me ndryshimin e gjendjes të magazinës dhe është sa diferenca e klasës 2 “Gjendja e inventarit” në aktivin e bilancit ku (345,225,747,126 lekë -345,220,957,779 lekë= 4,789,347 lekë)

Krahasuar me vitin paraardhës, në total llogaria e të ardhurave është shtuar me 48,942,275,185 lekë dhe llogaria e shpenzime në total është shtuar me 48,903,456,133 lekë.

c. Pasqyra e Flukseve Monetare (Cash Flow)

Në këtë pasqyrë janë pasqyruar fonde buxhetore të akorduara për shpenzime korrente të vitit 2023, shpenzimet e vitit ushtrimor, fondet buxhetore të akorduara për investime dhe shpenzimet e investimeve. Teprica e likuiditetit në fund të vitit ushtrimor është 217,647,941,048 lekë dhe rakordon me vlerën e fondeve disponibilitet në thesar.

Për veprime dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi D Ç, në pozicionin Drejtor, Drejtorja e Financës (NZ) dhe C K në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve (NA).

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 13085/27, datë 02.08.2024, protokolluar në KLSH me nr. 473/3 Prot., datë 05.08.2024, nga znj. D. Ç, Drejtor i Drejtorisë së Financës, ku është shprehur si më poshtë:

Prendimi i subjektit: Planifikimi për shpenzimet korrente – Në konstatimin e bërë nga KLSH mbi ndryshimet në fondin e zërit 602 ju sqarohet se: për DPT nuk ka pasur shtesë fondi dhe të gjitha ndryshimet janë bërë brenda për brenda klasës 6. Në konstatimin e bërë për vendimet gjyqësore nuk qëndron kjo vlerë pasi vendimet gjyqësore me kod produkti 91004AC kanë qënë të planifikuara në masën 350,000,000 lekë dhe pas rialokimit të bërë më anë të shkresës nr.11837/4, datë 19.07.2023 është pakësuar në masën 125,000,000 lekë dhe pas rialokimit më anë të shkresës nr.19989/6, datë 24.11.2023 është shtuar në masën 56,950,000 lekë. Planifikimet e vendimet gjyqësore të formës së prerë të reja nuk mund të parashikohen për gjatë vitit pasi nuk dihet se sa vendime dhe sa do të jetë vlera për vendimet e reja të ardhura në vitin korrent. Pra, klasa 6, konkretisht zëri 602 për kodin 91004AC nuk ka rritje 333% por ka rënie me mesatarisht 30%.

Planifikimi për shpenzimet kapitale – Sikurse është bërë më dije për disa vite rresht të gjitha ndryshimet kryesore në zërin e shpenzimeve kapitale kanë ndodhur nga investimet e përcjella nga AKSHI. Investime të cilat vijnë rishtazi, investime të cilat ju ndryshon vlera nga momenti për të cilin është kërkuar fondi me momentin kur është mbyllur procedura e studimit të tregut, të cilat vijnë më 3-fishim të buxhetit. DPT nuk e ka pranuar dhe ka bërë disa herë shkresa si drejtuar AKSHI-t ashtu dhe drejtuar Ministrisë së Financave për këtë situatë e cila na vë në si institucion në kushte të vështira buxhetore duke na krijuar pikërisht këto problematika të konstatuara. Ndaj, kjo çështje e ndryshimeve buxhetore për shpenzimet kapitale nuk vjen nga DPT por nga AKSHI dhe Ministria e Financës.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi auditues i qëndron konstatimit, duke sqaruar se konstatimi vjen nga analizimi i vlerave të Planifikimit Buxhetor Afatmesëm 2023- 2025 ku ju si institucion keni planifikuar për fazën e pare dhe të dytë shpenzimet buxhetore sipas llogarive. Nga faza e 1 në fazën e 2, referuar Shpenzimeve Korrente llogaria 602- Mallra dhe sherbime te tjera ka pësuar ndryshim në vlerën 809,500 mijë lekë ku vlerën më të lartë të ndryshimit e kanë pësuar Vendimet gjyqësore shtim në vlerën 500,000 mijë lekë, ose 333 % rritje nga faza e I- rë e planifikimit në vlerën 150,000 mijë lekë në fazën e II- të 650,000 mijë lekë. Mbi Projektin me kod 22AD801 “Përmirësimi i sistemit E- taxation” e kemi cituar edhe më lart se investimi i përcjell nga AKSHI nuk përputhet me investimin e miratuar në buxhet si në aspektin e fondit të tejkaluar rreth 300 milion lekë si dhe elementeve dhe zërave të tjerë të shtuar për këtë investim në proceset e: rishikimit të termave të referencës, testimi të tregut,

përlllogaritjen e fondit limit si dhe hartimit të kriterëve të veçanta, por grupi auditues i qëndron konstatimit mbi zhvillimin e takimeve dhe bashkëbisedimeve me përfaqësues të AKSH-it që të mos kemi cenim në zhvillimin dhe përmirësimin e punës në DPT si dhe të mos ketë mospërputhje me investimin e miratuar në buxhet në vazhdim.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 13085/27, datë 02.08.2024, protokolluar në KLSH me nr. 473/3 Prot., datë 05.08.2024, nga znj. D. Ç, Drejtor i Drejtorisë së Financës, ku është shprehur si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Kalimi i likuidimit mbi 30 ditë – DPT e ka tejkaluar këtë afat vetëm për faturat e Shtypshkronjës së Letrave me Vlerë. Faturimi i tyre bëhet në momentin e porosisë së kërkuar dhe likuidimi bëhet mbas shitjes së produkteve që janë për tu shpërndarë nga DPT në DRT, të cilat pas shitjes e arkëtojnë në buxhet nëpërmjet Kapitullit 6. Kjo kohë ndërmjet marrjes së mallit dhe likuidimit vonon pasi edhe rritja e autorizuar kalon nga një tjetër institucion që është Ministria e Financave. Gjithashtu në zbatim të Udhëzimit dhe bazës ligjore për SHLV konkretisht: Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.1497, datë 19.11.2008 ``Për Shtypjen e Letrave me Vlerë``, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.1149, datë 25.11.2009 ``Për Shtypjen dhe Shpërndarjen e Dokumentacionit Tatimor``, Vendimi nr.16, datë 02.04.2019 të Ministrave të Financave dhe Ekonomisë ``Për miratimin e çmimeve të Dokumentacionit Tatimor të prodhuar nga shoqëria e``Shtypshkronja e Letrave me Vlerë`` sh.a., në zbatim të VKM-së nr.435, datë 02.06.2010 ``Për administrimin e të ardhurave që krijohen nga shitja e dokumentacionit tatimor, pullave të akcizës dhe biletat e transportit rrugor``, si dhe Udhëzimit Nr.2, datë 06.02.2012 ``Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit`` shitjet që realizohen në muajin Dhjetor nuk mund të arkëtohen në emër të DPT-së por derdhen në Buxhetin e Shtetit, për këtë arsye është i pamundur evitimi i kësaj problematike për këtë pagesë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi auditues i qëndron konstatimit, duke sqaruar se likuidimet në tejkalim të afatit 30 ditorë nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik janë kryer për faturat e Shtypshkronjës së Letrave me Vlerë siç është paraqitur edhe më lart. Pavarësisht vonesës që sjell edhe rritja e autorizuar kalon nga një tjetër institucion që është Ministria e Financave, DPT duhet të marr masa për likuidimin e faturave në kohë për të shmangur rritjen e detyrimeve.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 13085/27, datë 02.08.2024, protokolluar në KLSH me nr. 473/3 Prot., datë 05.08.2024, nga znj. D. Ç, Drejtor i Drejtorisë së Financës, ku është shprehur si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me provigjonet – DPT vazhdon të ketë të njëjtin qëndrim kjo edhe duke u përforcuar edhe nga komunikimi zyrtar me Ministrinë e Financës ku është cituar edhe nga ju. Edhe në observacionin e vitit të kaluar 2022 kemi mbajtur të njëjtin qëndrim. I jemi drejtuar edhe Ministrisë së Financës e cila ka shprehur qartazi që është një zë i ri në pasqyrat financiare që pritet të vendoset në bazë të udhëzimit. Duke qenë se ka shumë ndryshime në aspektin e zërave, elementëve të cilat do të vendosen për provigjonet ende nuk kemi një udhëzim të posaçëm. Pra, të patrajtuar. Ndaj këtë vit, pas hapit të bërë nga DPT për ta saktësuar këtë rekomandim, nuk e pranojmë për sa kohë në pasqyrat financiare ky zë nuk është.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi auditues i qëndron konstatimit mbi mos llogaritjen e provizioneve dhe se duhet të ketë bashkëpunim me MFE-n që të mos ketë rritje të riskut potencial për mos likuidim në kohë të detyrimit të lindur.

2.8 Mbi strukturën organizative, administrimin e marrëdhënieve të punës dhe shpenzimet për pagat në institucion

Drejtorja e Burimeve Njerëzore në DPT është planifikuar të funksionojë si një strukturë me 11 punonjës, organizuar në dy sektorë, përkatësisht Sektori i Rekrutimit dhe Promovimit, si dhe Sektori i Trajnimit dhe Vlerësimit. Deri në fund të vitit 2023 kjo strukturë ka rezultuar me vakanca në pozicionin e përgjegjës të Sektorit të Rekrutimit dhe Promovimit; si dhe gjatë vitit 2024 me vakancë në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë.

Referuar Rregullores për Funksionimin e DPT, objekti kryesor i kësaj drejtorie është arritja e objektivave operaconale dhe objektivave të përcaktuar në planin strategjik të Administratës Tatimore dhe detyrave funksionale. Detyrat e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore janë:

1. Ndjekja dhe sigurimi i hedhjes në sistemin online të DAP të vendeve vakantë dhe të procedurave të rekrutimit sipas shpalljeve të DAP për punonjësit e shërbimit civil dhe rekrutimin e punonjësve, të cilëve marrëdhëniet e punës u rregullohen sipas Kodit të Punës;
2. Ndjekja dhe garantimi i një procesi real të vlerësimit të punës së nëpunësve/punonjësve të Administratës Tatimore Qendrore, sipas përcaktimeve në formularin e përshkrimit të punës dhe objektivave specifike dhe të përgjithshme, respektivisht të strukturës përkatëse dhe institucionit;
3. Sigurimi i ngritjes profesionale të stafit të DPT-së, nëpërmjet një procesi trajnimi dhe zhvillimi të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm që ka të bëjë me evidentimin e dobësive dhe zhvillimin e aftësive të punonjësve;
4. Mbikëqyrja për zbatimin e procedurave ligjore në dhënien e masave disiplinore për nëpunësit/punonjësit për të cilët konstatohet shkelje e dispozitave ligjore në fuqi, gjatë ushtrimit të detyrës funksionale.

Drejtoria e Burimeve Njerëzore raportimin mbi performancën e veprimtarisë së drejtorë e ka kufizuar vetëm në Raportin vjetor të DPT. Referuar këtij dokumenti aktivitetet e drejtorisë në vitin 2023 kanë konsistuar në hartimin e planeve vjetore të rekrutimeve, nevojave për personel të përkohshëm; vlerësimi i performancës; : Matja e efektivitetit dhe efikasitetit të strukturave të reja të krijuara apo riorganizuar, në bashkëpunim me Drejtoritë përkatëse, mbi bazë të KPI; 153-fillime ecurie disiplinore sipas procedurave të përcaktuara në Ligjin nr: 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij për nëpunës pjesë e shërbimit civil dhe sipas Rregullores Nr. 10, datë 30. 01.2020 “Për marrëdhëniet e punës të personelit jo nëpunës civil në administratën tatimore qendrore”.

Struktura e Administratës Tatimore Qendrore është miratuar me Urdhrin nr.33 datë 12.02.2020 të Kryeministrit, dhe përmban në total 1450 pozicione pune të ndara në:

- a. 1120 pozicione të rregulluara nga ligji për statusin e nëpunësit civil;
- b. 330 pozicione të rregulluara nga Kodi i Punës së RSH

Përgjatë vitit 2023 është miratuar edhe struktura e re e DPT sipas urdhrin nr. 69, datë 26.05.2023 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës organizative dhe numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore”, sipas së cilit struktura është miratuar me totalin prej 1450 punonjës, nga të cilët 327 punonjës në nivel qendror dhe 1123 punonjës në nivel rajonal (trajtuar me hollësisht në vijim të materialit), por nga ana e DPT deri në fund të vitit 2023, nuk janë reflektuar efektet e ndryshimit në strukturë dhe analizat mbi plotësimin e strukturës janë bazuar në urdhrin e vitit 2020, duke argumentuar se procesi i ristrukturimit të DPT deri në fund të vitit 2023 nuk ka përfunduar.

Në tabelën e mëposhtme është bërë një pasqyrim i përmbledhur i pozicioneve të punës në administratën tatimore qendrore, të ndara sipas drejtorive rajonale dhe ligjit që i trajton pozicionet në muajt Janar dhe Dhjetor të vitit 2023. Siç evidentohet qartësisht edhe në tabelë në muajin Janar, nga 1450 pozicione pune që ka struktura në total, rezultojnë të punësuar në total 1273 punonjës, nga ku 960 prej tyre me status të nëpunësit civil dhe 313 me kod pune, pra 177 pozicione pune janë vakante, ku prej tyre 160 pozicione me status të nëpunësit civil dhe 17 pozicione me kod pune. Në muajin Dhjetor situata paraqitet me një shtim të numrit të vakancave krahasuar me fillim vitin, ku konkretisht nga 1450 pozicione pune që ka struktura në total janë të punësuar në total 1212 ku 913 prej tyre janë me status të nëpunësit civil dhe 299 me kod pune, pra **238 pozicione pune janë vakante**, ku 207 prej tyre janë pozicione me status të nëpunësit civil dhe 31 pozicione me kod pune.

Konkretisht, struktura organizative e DPT dhe DRT në fillim të periudhës objekt auditimi dhe në përfundim të saj, klasifikuar në punonjës me kod pune dhe status nëpunësi, paraqitet si më poshtë:

Tabela- Struktura organizative e DPT dhe DRT 01.01.2023-31.12.2023

Degët	Numri punonjësve në strukturë	Numri i punonjësve Janar 2023	Numri i vakancave Janar 2023	Numri i punonjësve Dhjetor 2023	Numri i vakancave Dhjetor 2023	
DPT	Status nëpunësi	194	155	39	153	41
	Kod pune	114	104	10	100	14
	Total	308	259	49	253	55
DRT Tirana	Status nëpunësi	268	229	39	206	62
	Kod pune	86	83	3	77	9
	Total	354	312	42	283	71
DTM	Status nëpunësi	115	106	9	98	17
	Kod pune	13	12	1	13	0
	Total	128	118	10	111	17
DRT Fier	Status nëpunësi	91	79	12	77	14
	Kod pune	31	29	2	29	2
	Total	122	108	14	106	16
DRT Durrës	Status nëpunësi	79	69	10	68	11
	Kod pune	9	9	0	9	0
	Total	88	78	10	77	11
DRT Shkodër	Status nëpunësi	69	59	10	57	12
	Kod pune	30	29	1	25	5
	Total	99	88	11	82	17
DRT Elbasan	Status nëpunësi	52	46	6	45	7
	Kod pune	6	6	0	6	0
	Total	58	52	6	51	7
DRT Korçë	Status nëpunësi	52	44	8	47	5
	Kod pune	6	6	0	6	0
	Total	58	50	8	53	5
DRT Vlorë	Status nëpunësi	42	37	5	36	6
	Kod pune	5	5	0	5	0
	Total	47	42	5	41	6
DRT Lezhë	Status nëpunësi	32	31	1	27	5
	Kod pune	5	5	0	5	0
	Total	37	36	1	32	5
DRT Berat	Status nëpunësi	28	25	3	22	6
	Kod pune	5	5	0	5	0
	Total	33	30	3	27	6
DRT Gjirokastrë	Status nëpunësi	25	22	3	21	4
	Kod pune	5	5	0	5	0
	Total	30	27	3	26	
DRT Sarandë	Status nëpunësi	25	22	3	19	6
	Kod pune	5	5	0	5	0
	Total	30	27	3	24	6
DRT Dibër	Status nëpunësi	24	20	4	21	3
	Kod pune	5	5	0	5	0
	Total	29	25	4	26	3
DRT Kukës	Status nëpunësi	24	16	8	16	8
	Kod pune	5	5	0	4	1
	Total	29	21	8	20	9
Totali	1120+330=1450	960+313=1273	160+17=177	913+299=1212	207+31=238	

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Sikundër evidentohet në tabelën e mësipërme, struktura e ATQ karakterizohet në mënyrë të vazhdueshme nga një numër i konsiderueshëm pozicionesh vakante, dhe mos plotësimi i të cilave çënon jo vetëm performancën e këtyre institucioneve, por shoqërohet me kosto financiare të konsiderueshme për buxhetin e shtetit, duke qenë se në anën tjetër konstatohen ish punonjës që kërkojnë ekzekutimin e vendimit gjyqësor.

Gjithashtu, konstatohet se edhe numri i shpalljeve të vendeve vakante gjatë vitit 2023 nga Departamenti i Administratës Publike nuk përkon me vakancat e ngarkuara në sistem dhe është vetëm 15 shpallje në vend të 160-207 që do të duhej të ishte, sikundër është përcaktuar edhe me planin e rekrutimeve të hartuar në fillim të vitit 2023 nga DPT, përcjellë për DAP me shkresën nr. 21953, prot datë 30.12.2022, ku janë planifikuar nevojat për shërbimin civil për vitin 2023 prej 160 punonjësish. Konkretisht, shpalljet e DAP për DPT për vitin 2023 paraqiten

në aneksin si më poshtë, nga ku konstatohet se të gjitha shpalljet i përkasin periudhës fillim viti (Janar 2023).

Për DPT është kërkuar informacion i detajuar mbi plotësimin e strukturës organizative, pra sipas drejtorive dhe sektorëve përkatëse ku ekzistojnë vakancat, dhe në dispozicion të grupit të auditimit është vendosur informacioni **vetëm për Janarin 2023**, sipas aneksit më poshtë.

Për sa i përket situatës lidhur me vakancat në rang drejtorie në DPT në Dhjetor 2023, nga ana e DPT është argumentuar se **“Për vakancën e Dhjetorit nuk mund të shprehem, pasi nga periudha Korrik-Gusht 2023 e në vijim, ATQ është nënshtruar procesit të ristrukturimit.”**

Për sa më sipër konstatohet se nga ana e DPT, për periudhën objekt auditimi nuk janë analizuar vendet vakante në rang drejtorie, dhe nuk ishte e mundur të konkludohej mbi nivelin e këtyre vakancave në fund të vitit 2023. Gjithashtu, konstatohet se në kushtet kur nga ana e DPT nuk është kryer kjo analizë, reflekton se faktikisht veprimtaria e këtyre sektorëve është e mundur të kryhet edhe me strukturën aktuale, pra struktura e miratuar për DPT paraqitet mbi nevojat reale institucionale.

Në fund të vitit 2023, Drejtoria e Burimeve Njerëzore të DPT ka rezultuar me vakanca në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë dhe Përgjegjësit të Sektorit të Rekrutimit dhe Promovimit. Në pozicionin e Përgjegjësit të Sektorit të Rekrutimit dhe Promovimit është deleguar znj. Xh. H. në 13.04.2023, dhe deri në fund të periudhës së auditimit në terren.

-Informacioni lidhur me largimet nga puna, paraqitet si më poshtë:

Gjatë vitit 2023 nga Administrata Tatimore Qendrore janë larguar nga puna gjithsej 95 punonjës, prej të cilëve 64 nëpunës me status të nëpunësve civil dhe 31 punonjës me kontratë, pasqyruar në mënyrë të detajuar sipas DPT/DRT-ve në aneksin më poshtë. Institucionet me numër më të lartë të larguarish janë Drejtoria Rajonale Tiranë me 34 të larguar, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me 34 të larguar. Pjesa tjetër e Drejtorive Rajonale Tatimore konsistojnë me një numër nën 6 të larguarish. Konstatohet se përgjatë vitit 2023, në strukturën e DPT ka patur 18 largime, nga të cilat 7 punonjës me kod pune dhe 11 punonjës me status të nëpunësit civil. Konkretisht, referuar motivacioneve të largimeve konstatohet se nga 11 punonjësit me status, 1 prej tyre është larguar për shkak të pensionit, 7 punonjës janë larguar me dorëheqje dhe 3 punonjës janë larguar për shkak të masave disiplinore; si dhe 7 punonjësit me kod pune të larguar, kanë ardhur si shkak i dorëheqjeve.

Tabela- Largimet në total sipas motivacionit për punonjësit me kod pune dhe status

	Pension 2023	Dorëheqje 2023	Mase Disiplinore	Largim/Ristrukturim	Ndarje nga jeta
Kod pune	4	22	1	7	2
status	20	20	18	0	1
total	24	42	19	7	3

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Për sa më sipër është konstatuar se:

- 24 punonjës (20 me status dhe 4 me kod pune) janë larguar si rezultat i moshës së pensionit;
- 42 punonjës (22 kod pune dhe 20 me status) me dorëheqje;
- 19 punonjës (1 me kod pune dhe 18 me status) me masë disiplinore;
- 7 largime punonjësish me kod pune kanë ardhur si rezultat i ristrukturimit
- 3 punonjës (1 me status dhe 2 me kod pune) janë ndarë nga jeta

Për DPT është kërkuar informacion i detajuar mbi largimet sipas motivacionit, pra sipas drejtorive dhe sektorëve përkatëse, ku situata paraqitet sipas aneksit më poshtë.

-Referuar databazës së punonjësve të larguar nga puna administruar nga Drejtoria Ligjore dhe Teknike të cilët janë ende në proces gjyqësor sipas statusit, shkallës së gjyqimit dhe klasifikimit

në ish punonjës me status të nëpunësit civil dhe ish punonjës me kod pune, situata paraqitet si me poshtë:

Tabela- Informacion mbi statusin e proceseve gjyqësore të ish punonjësve

	Numri Çështjeve	Statusi i Procesit Ligjor	
Ish nëpunës më status	22	Çështje në proces Gj.Sh.I 10	
		Çështje në proces Apel 12	pranuar nga Gj.Sh.I 8 rrëzuar nga Gj.Sh.I 4
Ish punonjës me kod pune	49	Çështje në proces Gj.Sh.I 14 Çështje të pezulluara nga Gj.Sh.I 1	
		Çështje në proces Apel 34	pranuar nga Gj.Sh.I 4 pranuar pjesërisht Gj.Sh.I 21 rrëzuar nga Gj.Sh.I 9
Totali	71		

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Konstatohet se kjo databazë përbërë nga 71 procese gjyqësore, prej të cilëve 22 janë ish punonjës me status të nëpunësit civil dhe 49 janë ish punonjës me kod pune. Sikundër evidentohet në tabelën më sipër, nga 22 procese gjyqësore të ish nëpunësve civil 10 procese janë në shkallën e parë të gjykimit dhe 22 prej tyre janë çështje të apeluara në gjykatën e apelit. Nga këto 12 procese gjyqësore në gjykatën e apelit, rezulton që 8 prej tyre janë pranuar nga gjykata e shkallës së parë dhe vetëm 4 prej tyre janë rrëzuar. Në lidhje me ish punonjësit me kod pune rezulton se janë në proces aktualisht 49 çështje gjyqësore, ku 14 prej tyre janë në proces në gjykatën e shkallës së parë, 1 prej tyre është pezulluar dhe 34 prej tyre janë në proces në gjykatën e apelit. Nga këto 34 çështje në proces të apeluara, rezulton se 14 janë pranuar, 21 prej tyre janë pranuar pjesërisht nga gjykata dhe 9 prej tyre janë rrëzuar.

Grupi i auditimit kërkoi informacion lidhur me gjyqet e fituara vetëm përgjatë vitit 2023 nga ish punonjësit, sipas vlerave respektive të vendimit, si dhe në rastet kur vendimi ka qenë me objekt rikthimin në punë të ish punonjësve. Nga ana e Drejtorisë Ligjore dhe Teknike u vendos në dispozicion informacioni pas dorëzimit të akt konstatimeve, sipas së cilit rezulton se:

Vendime gjyqësore shkalla I				Vendime gjyqësore shkalla II			
13 raste	Pagim page	1 rast	Pranim pjesërisht	6 raste	Pagim page	5 raste	Rikthim në vendin e punës

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Nga krahasimi i databazës së Drejtorisë Ligjore dhe Teknike me Drejtorinë e Financës konstatohet se 1 prej vendimeve i përcjellë në DPT datë 07.12.2023, nuk është përfshirë në listën e vendimeve të pa ekzekutuara për vitin 2023, dhe është likuiduar në vitin 2024.

Nga auditimi konstatohet se planifikimi për vendimet gjyqësore sikurse evidentohet dhe në tabelën e mëposhtme nuk është bërë në përputhje me nevojat buxhetore. Konkretisht janë planifikuar për shpenzimet gjyqësore në fazën e parë të PBA-së një buxhet prej 150,000 mijë lekë, i cili më pas është 4 fishuar në fazën e dytë, në 650,000 mijë lekë (përfshirë këtu edhe detyrimet ndaj subjekteve, përveç ish punonjësve). Në buxhetin e akorduar sipas ligjit fillestar të buxhetit, konstatohet se janë miratuar fonde në vlerën 350,000 mijë lekë, të cilat janë të pamjaftueshme për të mbuluar detyrimet e prapambetura të gjyq fituesve (konkretisht për ish punonjës janë detyrime në fillim të vitit 2023 në vlerën 137,268 mijë lekë dhe për subjekte gjyq fituese në vlerën 296,432 mijë lekë, **pra në total rreth 433,700 mijë lekë**), duke mos marrë këtu në konsideratë vendimet shtesë të depozituara gjatë vitit 2023. Ky buxhet rezulton i pakësuar përgjatë vitit 2023 në vlerën 281,950 mijë lekë, dhe me një realizim prej vetëm 276,802 mijë lekë.

Tabela- Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për vendime gjyqësore të DPT

Emërtimi	PBA (Faza I)	PBA (Faza II)	Plani fillestar	Plani i rishikuar	Realizimi
Buxheti për vendime gjyqësore të ekzekutuara	150,000	650,000	350,000	281,950	276,802

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Nga auditimi konstatohet se në fillim të vitit 2023 rezultojnë detyrime të prapambetura për ish punonjës gjyqfitues në vlerën **137,268 mijë lekë**. Përgjatë vitit 2023, për ish punonjësit janë likuiduar detyrime në vlerën 216,523 mijë lekë, ku vlera e detyrimeve të lindura përgjatë vitit 2023 është 138,422 mijë lekë, dhe deri në fund të vitit 2023, rezultojnë detyrime të prapambetura për ish punonjës gjyqfitues në **vlerën 59,167 mijë lekë**. Nga totali i pagesave të kryera nga buxheti i shtetit për ish punonjësit gjyqfitues konstatohen se janë kryer likuidime të tarifave përmbartimore, duke e rënduar kështu buxhetin e shtetit për shkak të mos ekzekutimit në kohë të këtyre pagesave **me 5,964 mijë lekë**. Referuar databazës së administruar nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të dhënat e gjyqfituesve administroheshin në Excel, dhe për këtë arsye kishte disa pasaktësi në përlllogaritjen e detyrimeve të mbetura për likuidim, krahasimisht me detyrimet e konstatuara për periudhën 2022-2023 dhe likuidimet përkatëse, trajtuar sipas aneksit bashkëlidhur rillogaritjet e grupit të auditimit.

Sipas evidencës së DPT janë raportuar:

Statusi i punonjësit	Numri	Detyrimi i prapambetur 31.12.2022	Detyrime të lindura gjatë 2023	Paguar 2023	Detyrimi i prapambetur 31.12.2023
Ish nëpunës me status	77	127,901,069	110,491,956	180,128,179	58,721,566
Ish punonjës me kod pune	32	9,367,605	27,930,781	36,395,687	445,979
Totali	109	137,268,674	138,422,737	216,523,866	59,167,545

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Nga totali i 109 ish punonjësve gjyqfitues, rezultojnë se 77 prej tyre janë ish nëpunës me status të nëpunësit civil dhe 32 ish punonjës me kod pune. Nga totali ish nëpunësve civil, rezulton se 12 janë ish-punonjës të rikthyer, 1 ish-punonjës ka ndërruar jetë, 8 ish-punonjës në pension dhe **56 ish-punonjës janë të pa sistemuar**.

Urdhri nr. 5151, datë 28.10.2015 të Ministrisë së Shtetit për Inovacionit dhe Administratën Publike “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga Institucionet e Administratës Shtetërore” parashikon që “KP duhet të shqyrtojnë të gjitha rastet e gjyqfituesve, të pa sistemuar në një pozicion të rregullt të shërbimit civil, që kanë një vendim gjyqësor të formës së prerë, deri në datën e hyrjes në fuqi të urdhrit”. Urdhëri përcakton gjithashtu në Kreun IV, pika 2 se “**KP thirret nga Kryetari, brenda 2 ditëve punë nga depozitimi i kërkesës/lajmërimit me shkrim të kreditorit, për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, duke vënë në dijeni DAP-in**”. Kreu IV, pika 3 përcakton se “**Shqyrtimi administrative përfundon jo më vonë se 15 ditë nga momenti i depozitimit të kërkesës**”. Kreu VI, pika 4 përcakton se “**KP në përfundim të shqyrtimit administrativ, brenda 3 ditëve pune, i parashtron me shkrim gjyqfituesit alternativat, objektivist të mundshme, për t’u punësuar në një pozicion të rregullt të të njëjtës kategori dhe në pamundësi objektive, në një kategori më të ulët brenda institucionit nga ku është larguar apo në një institucion varësie**”. Komisioni i Posaçëm në DPT është ngritur sipas urdhrit nr. 85, datë 04.11.2021 “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga administrata tatimore”, i ndryshuar, i cili përgjatë vitit 2023 ka patur si përbërje:

Z. C. K, në cilësinë e Kryetarit,

Z. I. K, anëtar,

Znj. I. K, anëtarë,

Znj. D. C, anëtare.

Kryetari i KP përgjatë vitit 2023 nuk e ka thirrur komisionin asnjëherë, pavarësisht **56 gjyq fituesve të pa sistemuar që rezultojnë në databazën e DPT për të cilët vijojnë të kryhen pagesa për pagat e tyre të cilat shoqërohen m detyrime shtesë vit pas viti për buxhetin e shtetit**. Komisioni i Posaçëm për shqyrtimin e fakteve dhe rrethanave, pas marrjes së vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për rikthimin e nëpunësve civilë në detyrë nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për t'i rikthyer të gjithë, në kohë, dhe sipas radhës së daljes së vendimit të formës së prerë të Gjykatës. Sipas argumenteve të DPT, duke qenë se me Urdhrin nr. 69, date 26.05.2023 të Kryeministrit është miratuar struktura dhe organika e re e Administratës Tatimore Qendrore, për sa me lart nga periudha Maj 2023 e ne vijim (procesi i ristrukturimit është raportuar se ka vijuar deri ne periudhën Janar 2024), Komisioni i Ristrukturimit ka shqyrtuar transferimet për të gjithë Administratën Tatimore, ku për Komisionin e Posaçëm ka qene e pamundur mbledhja dhe sistemimi i gjyq fituesve në një pozicion të rregullt të shërbimit civil. Në vijim të kërkesës së grupit të auditimit për aktivitetin e këtij komisioni përgjatë vitit 2023, janë vendosur në dispozicion disa korrespondenca me KMSHC në lidhje me rekomandimet e lëna, ku nga DPT është kërkuar shtyrja e afatit mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KMSHC për shkak të miratimit të strukturës së re në Administratën Tatimore Qendrore, për të cilën KMSHC ka sjelle dakordesi me shkresën Nr 123/2 prot.,date 31.01.2024 protokolluar në DPT me Nr.3078 prot.,date 15.02.2024 të KMSHC.

Nga auditimi konstatohet se shtesa e vitit 2023 të detyrimeve për vendime gjyqësore të ish punonjësve prej 138,422 mijë lekë, përbëhet nga:

- **89,831,007 lekë për 56 ish punonjës për të cilët vazhdon detyrimi**, nga të cilët vetëm 3 prej tyre janë raportuar si gjyqfitues të depozituar përgjatë vitit 2023 dhe pjesa tjetër e shtesave të detyrimit janë pagat për punonjësit që vendimi i gjykatës ka përcaktuar kthim në punë, dhe rezultojnë ende të pa sistemuar nga DPT deri në përfundim të periudhës së auditimit. Nga këta punonjës konstatohet se për 1 rast është raportuar si detyrim vlere prej 5.3 milion lekë për vitin 2023, detyrim ky që është raportuar si 0 në vitin 2022, pavarësisht se data e depozitimit të vendimit është në vitin 2017. Sipas argumentit të Drejtorisë së Financës, shkak ka qenë ndërprerja e likuidimeve për shkak të propozimit të kryer për sistemim të gjyqfituesit, informacion ky që referuar kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi, nuk përbën argument justifikues pasi ndërprerja do të aplikohet në momentin e arritjes së një dakortësie nga të dyja palët për sistemim, dhe jo në mënyrë të një anshme.

Gjithashtu, konstatohen raste në të cilat janë raportuar vendime me vlere të konsiderueshme (pra që i tejkalojnë detyrimet e pagave të një viti) si detyrime të vitit 2023 dhe të pa njohura si të tilla në vitin 2022, pavarësisht se vendimet e depozituara në DPT për to i përkasin periudhave të hershme . Konkretisht, konstatohet se në 1 rast është njohur si detyrim vlere prej 8 milion lekë, ndërkohë që në vitin 2022 për këtë vendim janë raportuar detyrime 0.8 milion lekë, dhe vendimi i gjyqfituesit mban datën 2013, dhe i depozituar në DPT në vitin 2021. Ky detyrim është likuiduar në masën 83% përgjatë vitit 2023. Në 1 rast është njohur si detyrim vlere prej 3 milion lekë, ndërkohë që në vitin 2022 për këtë vendim janë raportuar detyrime prej 0.3 milion lekë, dhe vendimi mban datën 2014, dhe i depozituar në DPT në vitin 2022. Ky detyrim është likuiduar në masën 83% përgjatë vitit 2023.

Nga auditimi konstatohet se për këtë kategori gjyqfituesish, rezultojnë të jenë likuiduar vendimet për gjyqfituesit në nivelet që variojnë nga **93% si maksimum likuidimi për total detyrimin total 2023 dhe 2022, në 49% për disa ish punonjës të tjerë**, pavarësisht datave të depozitimit të vendimeve dhe datave të vendimeve gjyqësore. Pra konstatohet se pavarësisht se nuk ka patur asnjë gjyqfitues që nuk i është kryer likuidimi i njohur deri në vitin 2022 në drejtim të parimit “First In First Out”, konstatohet se vlere e shlyerjes së detyrimeve ndaj ish punonjësve në drejtim të detyrimeve të konstatuara nuk ka qenë e njëjtë për të gjithë gjyqfituesit. Nga ana e DPT nuk dokumentohet metodologjia e ndjekur për përcaktimin e

masës së likuidimit të detyrimit të gjyqfituesve. Për vlerën e detyrimeve deri në 31.12.2022 nga ana e DPT rezulton një nivel likuidimi mbi 95%, pasi niveli më i ulët i likuidimit rezulton për shtesat e detyrimeve të vitit 2023, pra përgjatë vitit, të cilat mbeten objekt planifikimi në referencë të buxhetit në dispozicion.

-27,930,781 lekë për 23 ish punonjës me kod pune, nga të cilët 18 janë vendime të raportuara si të depozituara në DPT përgjatë vitit 2023; 5 janë vendime të vitit 2022 të cilat pavarësisht se janë raportuara si të depozituara në DPT përgjatë vitit 2022, nuk janë të raportuara si detyrime të vitit 2022. Nga auditimi konstatohet se nga 18 vendimet e ish punonjësve të depozituar në DPT gjatë 2023, 2 janë vendime të vitit 2015, 8 janë vendime të 2022 dhe vetëm 8 janë vendime të vitit 2023.

- 20.186.056 lekë për 4 ish punonjës të dalë në pension. Nga këta punonjës rezulton se në 1 rast, pavarësisht se vendimi i depozitimit në drejtori mban vitin 2017, detyrimet për të në vitin 2022 janë raportuar 0, dhe rezultojnë të likuiduara detyrime për këtë vendim në vitin 2023 në vlerën respektive rreth 2 milion lekë; në 1 rast pavarësisht se vendimi i depozitimit në drejtori mban vitin 2022, detyrimet për të në vitin 2022 janë 2.4 milion lekë, dhe rezultojnë të likuiduara në vitin 2023 për këtë vendim në vlerën respektive rreth 11.3 milion lekë, nga ku shtesa e vitit 2023 rezulton 8.9 milion lekë, e pa përfshirë në detyrimin e vitit 2022. Një rast tjetër konstatohet se është likuiduar në vitin 2023 në vlerën 7.4 milion lekë, në masën 82% të total detyrimin, me datë vendimi të depozituar 27.10.2023.

- 474.894 lekë për 6 ish punonjës të rikthyer, për të cilët detyrimet në vitin 2022 paraqiten në 0, pavarësisht se vendimet për të cilat janë raportuar detyrime dhe janë likuiduar i përkasin vendimeve të depozituara në drejtori në periudhën 2013-2017 dhe vetëm 1 i përket vitit 2023.

Nga auditimi konstatohet se në kundërshtim me Udhëzimin nr.1 datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”, ku në pikën 4 përcakton se *“Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, gjate vitit buxhetor, mbajnë database për vendimet gjyqësore të formës së prerë që parashikojnë detyrime monetare, si dhe për shumat e detyrimeve. Shuma totale e detyrimeve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, bëhet pjesë e procesit të programimit buxhetor të vitit të ardhshëm, sipas përcaktimeve të akteve ligjorë e nënligjorë përkatës. Këto parashikime i bëhen të njohura edhe njësisë së qeverisjes së përgjithshme nga e cila varet”* dhe në pikën 5 përcakton se *“Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore që janë parashikuar të shlyhen nga buxheti përkatës, bëhet sipas rradhës së paraqitjes zyrtare të tyre në vitin paraardhës dhe grafiku i shlyerjes bëhet publik nëpërmjet publikimit në faqen on-line të njësisë shpenzuese, apo në forma të tjera të publikimit, që ju bëhen të ditura publikut. Përmbaruesi i përmbahet grafikut të shlyerjes së detyrimit të publikuar.”*, grafiku i shlyerjes, në bazë të radhës së paraqitjes së vendimeve gjyqësore nuk është publikuar në faqen online të DPT.

-Referuar informacionit të vendosur në dispozicion, *procedurat e rekrutimeve* të kryera gjatë vitit 2023, sipas DPT dhe DRT, të ndara në punonjës me status dhe kod pune paraqitet sipas aneksit më poshtë. Përgjatë vitit 2023 janë rekrutuar 60 punonjës të rinj në administratën tatimore, nga të cilët në DPT 25 punonjës, dhe në drejtoritë rajonale 35 punonjës. Referuar kategorisë së punonjësve, konstatohet se janë rekrutuar 41 punonjës me kod pune dhe 19 punonjës me status të nëpunësit civil.

-Numri i punonjësve të shërbimit dhe punonjësve me kontratë përgjatë vitit 2023, sipas planifikimit dhe numrit faktik të tyre rezulton si më poshtë:

Institucioni	Punonjës shërbimi	Punonjës me kontratë
DPT	35 Plan, 24 Fakt	8 Plan, 8 Fakt
DRT Tirana	84 Plan, 36 Fakt	6 Plan, 6 Fakt
DTM	20 Plan, 20 Fakt	5 Plan, 4 Fakt
DRT Fier	20 Plan, 17 Fakt	5 Plan, 3 Fakt
DRT Durrës	20 Plan, 20 Fakt	3 Plan, 3 Fakt

DRT Shkodër	30 Plan, 30 Fakt	2 Plan, 2 Fakt
DRT Elbasan	10 Plan, 10 Fakt	2 Plan, 2 Fakt
DRT Korçë	10 Plan, 10 Fakt	4 Plan, 4 Fakt
DRT Vlorë	23 Plan, 23 Fakt	2 Plan, 2 Fakt
DRT Lezhë	6 Plan, 6 Fakt	2 Plan, 1 Fakt
DRT Berat	8 Plan, 8 Fakt	0
DRT Gjirokastër	8 Plan, 7 Fakt	1 Plan, 1 Fakt
DRT Sarandë	10 Plan, 10 Fakt	1 Plan, 1 Fakt
DRT Dibër	10 Plan, 10 Fakt	3 Plan, 3 Fakt
DRT Kukës	6 Plan, 6 Fakt	0
Totali	300 Plan, 237 Fakt	43 Plan, 40 Fakt

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

-Informacioni lidhur me *delegimet e kompetencave* përgjatë vitit 2023 paraqitet si më poshtë:

Përgjatë vitit 2023 nga DPT janë kryer 6 delegime kompetencash në drejtoritë rajonale Gjirokastër, Vlorë (2), Shkodër, Korçë dhe Sarandë; si dhe 16 delegime kompetencat në strukturat e DPT. Grupi i auditimit kërkoi informacion lidhur me afatin e përfundimit të këtyre delegimeve, i cili deri në përfundim të auditimit nuk u vendos në dispozicion.

Nga grupi i auditimit u kërkua informacion lidhur me urdhërat aktiv për delegim kompetencash gjatë vitit 2023, duke specifikuar ato të mbartura nga vitet e mëparshme dhe urdhrat e nxjerra përgjatë vitit 2023 ku nga ana e DPT u raportua gjithsej për 12 të tilla, nga të cilat konstatohen urdhra delegimesh që kanë qenë aktiv për më shumë se 2 vite.

Numri i urdhërave për delegim kompetencash në fuqi në fund të vitit 2023

Referuar urdhrave për delegim kompetencash që kanë qenë në fuqi deri në fund të periudhës objekt auditimi, konstatohen 6 urdhra për drejtoritë rajonale dhe 14 urdhra për DPT.

Nga auditimi konstatohet se informacioni i vendosur në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore pranë DPT është i pasaktë, pasi në informacionin e përcjellë për delegimet në fuqi deri në fund të vitit 2023, nuk ishin reflektuar urdhra të tjerë delegimi me datë përfundimi përgjatë vitit 2024, si urdhra delegimi aktive deri në fund të vitit 2023. Grupi i auditimit kërkoi informacion të detajuar për delegimet e periudhave të mëparshme, me efekt përgjatë vitit 2023, për të cilat nuk u vendos në dispozicion informacion me argumentin se informacioni është dhënë vetëm për delegimet e vitit 2023, pasi delegimet e vitit 2022 janë audituar njëherë. Nga auditimi konstatohet se procedurat e delegimeve, nuk janë të parashikuar në asnjë dispozitë të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, apo dispozitave të tjera ligjore, dhe referuar intervaleve të kohëzgjatjeve të tyre në kohë tepër të konsiderueshme, konstatohet se kanë shërbyer si mjet për të shmangur procedurën e parashikuar nga neni 25 “Lëvizja Paralele”, të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”.

Në zbatim të nenit 48, pika 1, shkronja “a”, të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, ku përcaktohet që: “Nëpunësi civil mund të transferohet, përkohësisht, në një pozicion tjetër të shërbimit civil, të së njëjtës kategori, për këto arsye dhe kohëzgjatje: a) në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 viteve”, u kërkua informacion mbi numrin total të transferimeve të kryera nga DPT, ku konstatohet se përgjatë vitit 2023 në administratën tatimore janë kryer 4 procedura transferimi, të cilat i përkasin drejtorive rajonale tatimore.

a. Transferimet e Përkohshme në ATQ 2023

Përgjatë vitit 2023 janë kryer 3 procedura transferimi të përkohshme me afat 6 mujor, nga të cilat 1 rast punonjësi ka dalë në pension pas përfundimit të afatit; në 1 rast punonjësi është larguar; dhe në 1 rast është emëruar në një tjetër pozicion.

Referuar transferimeve aktive të administratës tatimore, pra edhe transferimet e miratuara në periudhat para vitit 2023, dhe që kanë patur efekt përgjatë vitit 2023 si dhe duke pasqyruar afatin e transferimit sipas urdhrat, dhe afatin faktik nëse ka ndryshime nga afati i përcaktuar në urdhër. Për sa më sipër konstatohet se intervalet e kohëzgjatjeve të transferimeve kanë variuar

në **6-8 muaj** në vijim të shkresave për transferim duke shmangur procedurën e parashikuar nga neni 25 “Lëvizja Paralele”, të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, ku cilësohet se: “*Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë ekzekutive, atë të ulët apo të mesme drejtuese bëhet së pari nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele*” .

Trajnimet e zhvilluara nga DPT paraqiten si më poshtë:

Trajnimi	Data	Numri I punonjësve
Ndryshimet në Ligjin Nr. 29/2023 datë 30.03.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat"	10.10.2023	120
	17.10.2023	100
	20.10.2023	23
	31.10.2023	101
	02.11.2023	100
	07.11.2023	64
	09.11.2023	64
	14.11.2023	86
	16.11.2023	72
	21.11.2023	79

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

Gjithashtu nga DPT janë kryer trajnime të vazhdueshme nga Qendra e Trajnimeve të Administratës Tatimore dhe Doganore ku në total konstatohet se janë kryer 39 tema trajnimesh, të organizuara në 456 orë, dhe janë ndjekur sipas punonjësve:

Muaji	Të trajnuarit	Tema	Orë trajnimi
Janar			
Shkurt			
Mars	31	1	24
Prill	118	5	54
Maj	193	9	60
Qershor	198	7	78
Korrik	52	2	24
Gusht			
Shtator	40	2	18
Tetor	578	7	120
Nëntor	559	3	48
Dhjetor	76	3	30
Total	1845	39	456

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

-Referuar të dhënave të DPT përgjatë vitit 2023 janë vendosur nga Komisioni i Disiplinës 72 masa disiplinore, nga të cilat “*Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për periudhat 2 mujore-1 vjeçare*” për 38 punonjës, “*Largim nga shërbimi civil*” për 19 punonjës dhe “*Vërejtje*” për 14 punonjës. Nëse i referohemi raportit të DPT për vitin 2023 raportohet për vendime gjithsej për 153 vendime gjithsej, nga të cilat në proces 55 vendime dhe 98 masa të dhëna. Nga 98 masat e dhëna janë raportuar për vitin 2023 si masa të dhëna për punonjës të shërbimit civil: “*largim nga shërbimi civil*” për 15 punonjës; “*pezullim ngritje në detyrë*” për 26 punonjës; “*nxjerrje jashtë juridiksioni*” për 20 punonjës; “*vërejtje*” për 7 punonjës dhe “*ndërprerje e ecurisë disiplinore*” për 17 punonjës; dhe masa të dhëna për punonjësit me kod pune: 3 masa “*zgjdhje të menjëhershme të kontratës së punës*”; 4 masa “*vërejtje me shkrim*”; 3 masa “*vërejtje me paralajmërim*” dhe 3 masa “*ndërprerje e ecurisë disiplinore*”.

Referuar raportit vjetor të DPT për vitin 2023 është raportuar se për 6 mujorin e parë të vitit 2023 dhe 6 mujorin e dytë të vitit 2023, procesi i vlerësimit është përmbyllur pjesërisht për nëpunësit e administratës tatimore, duke raportuar gjithsej 708 vlerësime për vitin 2023 dhe 512 vlerësime për 6 mujorin e dytë. Sipas raportit, për 6 mujorin e parë: “*Mungojnë (në proces): Vlerësimet për DPT, Drejtoret Rajonal, Drejtorët e Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Rajone, ZV. Drejtoret e Përgjithshëm, si dhe DRT Tiranë me mungesa*” si dhe për 6 mujorin e dytë “*Mungojnë vlerësimet për DPT, DRT Tiranë, Drejtoret*

Rajonal, Drejtorët e Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Paguara në Rajone, Zv. Drejtoret e Përgjithshëm, të cilat janë në proces përfundimi”.

Referuar DPT, bazuar në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve Nr. 10, datë 31.01.2020 “Për Miratimin e Rregullores për marrëdhëniet e punës të personelit jo nëpunës civil, në Administratën Tatimore Qendrore”, për strukturat të cilat trajtohen sipas dispozitave të Kodit të Punës, konkretisht vlerësimet të strukturës së Hetimit Tatimor dhe Verifikimit në Terren Administratën Tatimore (janë në proces përfundimi) dhe punonjësit e tjerë të shërbimeve mbështetëse janë vjetore. Vlerësimet vjetore të strukturave të Verifikimit dhe Koordinimit në Terren në Administratën Tatimore për vitin 2023 janë raportuar si të papërfunduar plotësisht, duke raportuar gjithsej 128 vlerësime, dhe duke raportuar se mungojnë formularët e vlerësimit për: Drejtorët e Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren në DPT dhe Rajone dhe Drejtorinë e Hetimit Tatimor në DPT. Vlerësimi vjetor i rezultateve në punë për punonjësit me Kod Pune në Administratën Tatimore për vitin 2023 është raportuar si i papërfunduar plotësisht me 80 vlerësime, nga ku mungojnë formularët e vlerësimit për DPT dhe DRT Tiranë.

Në vijim të kërkesës së grupit të auditimit nëse ka patur vlerësime rradhazi negative për punonjësit përgjatë vitit 2023, nga DPT u vendos në dispozicion informacioni se nuk ka patur asnjë rast.

-Nga auditimi konstatohet se DPT nuk disponon një strategji të burimeve njerëzore, duke ju referuar planit të rekrutimeve si dokumenti i strategjisë. Drejtoria e Burimeve Njerëzore nuk disponon një plan periodik apo vjetor të punës ku të paraqiten objektivat e saj; si dhe raport periodik apo vjetor të veprimtarisë së kësaj drejtorie.

Mbi procesin e ristrukturimit të institucionit

-Me shkresën nr. 1509, prot datë **31.01.2023** të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT, me lëndë “Dërgohet për mendim Draft Struktura Organizative, Draft Organigrama dhe Relacioni shoqëruar”, është dërguar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për mendim Draft Struktura Organizative, Draft Organigrama dhe Relacioni shoqëruar, me qëllim vijimin e procedurave të mëtejshme.

-Me urdhër nr. 69, datë **26.05.2023** të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të administratës tatimore qendrore”, prot në DPT nr. 9716, datë 29.05.2023, me propozim të Ministrit të Financave, është miratuar struktura organizative e administratës tatimore qendrore me numër total të personelit të administratës tatimore qendrore prej 1450 veta.

-Në zbatim të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të pikave 16 dhe 17 të Kreut II, të Vendimit nr.125, datë 17.02.20216 të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, pikës 2, gërma b, të Kreut II, të Udhëzimit nr.1, datë 01.03.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”, si dhe në bazë të Urdhrit nr.69, datë 26.05.2023, të Kryeministrit, me urdhër nr. 350, datë **08.06.2023** të Drejtorit të Departamentit të Administratës Publike është krijuar **Komisioni i Ristrukturimit**, me përbërje:

1. Znj. F. V, specialist në Sektorin e Sekretariatit Teknik për TND-në dhe Menaxhimin të Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Procedurave të Rekrutimit të Shërbimit Civil, në Departamentin e Administratës Publike, Kryetar.
2. Znj. R. Xh, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, anëtar.
3. Znj. D. C, Zv. Drejtor i Përgjithshëm i Mbështetjes së Programeve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, anëtar.

Ky urdhër ka përcaktuar vetëm ngritjen e komisionit, pa përcaktuar afatet sipas së cilave do të kryhet procesi.

-Me urdhër nr. 189, datë **08.08.2023** “Për miratimin e organigramës së administratës tatimore qendrore”, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, është miratuar organigrama për Administratën Tatimore Qendrore me 1450 punonjës, nga të cilët 327 punonjës në nivel qendror dhe 1123 punonjës në nivel rajonal. Pra, nga auditimi konstatohet se në vijim të urdhrin nr. 69, prot datë 26.05.2023 të Kryeministrit, nga ana e Ministrisë së Financave është miratuar organigrama mbi 2 muaj më vonë.

-Nga auditimi konstatohet se krahasimisht me propozimin e DPT, struktura e miratuar nga MFE ka përcaktuar se pozicionet e punës specialist, në Sektorët e Shërbimit Tatimpagues do të jenë të kategorisë IV-3, ndryshe nga sa propozuar nga DPT, si IV-2. Ky ndryshim, është konstatuar si një lapsus nga ana e MFE, duke qenë se me urdhrin nr. 189/1, datë **19.01.2024** të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për korrigjimin e gabimit material në urdhrin nr.189, datë 08.08.2023 “Për miratimin e organigramës së Administratës Tatimore Qendrore”, është korrigjuar klasa e pagës për pozicionet e punës specialist, në Drejtoritë/Sektorët e Shërbimit të Tatimpaguesve, nga IV-3, në IV-2.

Nga auditimi konstatohet se në dispozicion të grupit të auditimit u vendosën procesverbalet si më poshtë të Komisionit të Ristrukturimit:

1.Procesverbali me nr. 15452 prot datë 25.09.2023

Sipas këtij procesverbali konstatohet se komisioni ka shqyrtuar strukturën e miratuar me totalin prej 1450 punonjës, nga të cilët 327 punonjës në nivel qendror dhe 1123 punonjës në nivel rajonal. Nga ana e komisionit është deklaruar dhe përshkrimet e punës nuk ishin miratuar dhe përfunduar nga ana e burimeve njerëzore të DPT deri në këtë datë. Ky konstatim i Komisionit rezulton se dokumenton se DPT ka vepruar në kundërshtim me përcaktimet e udhëzimit nr.1, datë 01.03.2016, i ndryshuar “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”, ku citohet në pikën 6 të tij se “Nëpunësi më i lartë civil ka detyrë t’i paraqesë komisionit të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për çdo nëpunës që i nënshtrohet procesit të transferimit që përfshin përshkrimet e punës, dosjet personale, vërtetim vendbanimi të punonjësit..” dhe pika 7 ku përcaktohet se “Komisioni në punën e tij asistohet nga Sekretaria Teknike...njësia e personelit të institucionit”. Pra, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, përkatësisht Drejtoria e Burimeve Njerëzore, nuk është mundësuar vendosja në dispozicion e të gjitha dokumentacioneve të nevojshme. Mbledhja e ardhshme e komisionit është dakortësuar të kryhet pasi të mbarojë përshkrimi.

2.Procesverbali nr. 16646/1 prot datë 18.10.2023 dhe vendimi përkatës

Sipas këtij procesverbali janë shqyrtuar strukturat organizative të 12 Drejtorive Rajonale Tatimore, për të evidentuar ndryshimet që kanë ndodhur dhe të dhënat e nëpunësve (dosjet individuale) respektivisht me përshkrimet e punës për pozicionet e reja duke vendosur edhe për ndryshime konkrete të punonjësve në këto rajone. Nga auditimi konstatohet se referuar procesverbalit të mbledhjes së komisionit, nuk dokumentohet analiza e këtij komisioni për të argumentuar vendimmarrjet përkatëse, sikundër përcakton udhëzimit nr.1, datë 01.03.2016, i ndryshuar, aneksi 1.

3.Procesverbali nr. 16646/3 prot datë 18.10.2023 dhe vendimi përkatës

Sipas këtij procesverbali janë shqyrtuar strukturat e Drejtorive të Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në rajone sipas strukturës së re krahasuar me atë ekzistuese duke

vendosur edhe për ndryshime konkrete të punonjësve në këto rajone. Nga auditimi konstatohet se referuar procesverbalit të mbledhjes së komisionit, nuk dokumentohet analiza e këtij komisioni për të argumentuar vendimmarrjet përkatëse, sikundër përcakton udhëzimit nr.1, datë 01.03.2016, i ndryshuar, aneksi 1.

4.Procesverbali nr. 20615 prot datë 20.12.2023 dhe vendimi përkatës

Sipas këtij procesverbali janë shqyrtuar mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi civil të prekur nga ristrukturimi i ATQ, duke kryer një analizë të strukturës së re krahasuar me atë ekzistuese duke vendosur edhe për ndryshime konkrete të punonjësve në këto rajone. Nga auditimi konstatohet se referuar procesverbalit të mbledhjes së komisionit, nuk dokumentohet analiza e këtij komisioni për të argumentuar vendimmarrjet përkatëse sikundër përcakton udhëzimit nr.1, datë 01.03.2016, i ndryshuar, aneksi 1.

Për sa më sipër konstatohet se ristrukturimi i DPT deri në fund të vitit 2023 konstatohet si i pa përfunduar.

-Nga auditimi konstatohet se në kundërshtim me Udhëzimin nr.1, datë 01.03.2016, i ndryshuar, pika 5 i cili përcakton se “*Komisioni detyrohet të fillojë shqyrtimin administrativ për mundësinë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese, Brenda 2 ditëve nga data e nxjerrjes së aktit të krijimit të Komisionit nga njësia përgjegjëse (DAP)*”, mbledhja e parë e komisionit për shqyrtimin e mundësisë së sistemimit ka iniciuar datë 25.09.2023, ndërkohë që struktura është riorganizuar me urdhrin e Kryeministrit datë 26.05.2023; si dhe organigrama është miratuar me urdhrin nr. 08.08.2023 të Ministrit të Financave.

Nga auditimi konstatohet se në kundërshtim me përcaktimet e pikës 16, të kreut II, të udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016, të Departamentit të Administratës Publike, ku citohet se “*Pas këtij procesi Komisioni brenda 15 ditësh nga momenti i krijimit të tij i propozon DAP transferimin e punonjësit... i dërgon njësisë së burimeve njerëzore të institucionit vendimin për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të mbylljes apo ristrukturimit*”, Komisioni i Ristrukturimit nuk ka zbatuar afatin 15 ditor nga momenti i krijimit të tij, për të propozuar vendimet mbi transferimet e nëpunësve civil. Nga verifikimi i afateve të të gjithë procesit të ristrukturimit, rezulton se nga momenti i miratimit të strukturës së re (26.05.2023), e deri në daljen e vendimit për transferimin e përhershëm të nëpunësve civil brenda administratës tatimore (18.10.2023; 20.12.2023), procesi i ka tejkaluar afatet dhe nuk ka përfunduar deri në fund të vitit 2023.

-Nga auditimi konstatohet se vendimet e Komisionit të Ristrukturimit në asnjë rast nuk janë të shoqëruara me dokumentacionit e pikëzimit , sikundër përcakton aneksi 1 i udhëzimit nr. 1, datë 01.03.2026, i ndryshuar “*Metodologjia e vlerësimit dhe sistemi i pikëzimit*”
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e Komisionit të Ristrukturimit.

-Nga auditimi konstatohet se pas miratimit të strukturës së re të DPT sipas urdhrin të Kryeministrit nr.69, datë 26.05.2023, nga ana e DPT nuk janë hartuar Rregulloret e DPT dhe DRT, në zbatim të këtij urdhri, deri në fund të periudhës objekt auditimi. Grupi i auditimit kërkoi vendosjen në urdhrin të Drejtorit të Përgjithshëm për grupin e punës që do të hartojë ndryshimet në rregullore, por ky dokument nuk u vendos në dispozicion. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me shkresën nr. 10970 Prot., date 14.06.2024, ka përcjellë per miratim pranë Ministrisë së Financave Draft Rregulloret e reja, të cilat deri në fund të periudhës së auditimit në terren, nuk janë miratuar. Si rezultat, struktura aktuale e DPT rezulton e pa harmonizuar me rregulloren e funksionimit të administratës tatimore, aktualisht në fuqi .

Për sa konstatohet në situatën e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi përfaqësuesit e DPT, konkretisht:

Z. C. K , në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të DPT

Znj. D. C, në cilësinë e Zv. Drejtorit të Përgjithshëm të Mbështetjes së Programeve

Znj. I. K, në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë Teknike e Ligjore

Znj. D. C, në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit

Znj. V. T, në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore

Z. I. K, në cilësinë e Përgjegjësit të Sektorit të Trajnimit dhe Vlerësimit

Znj. Xh. H, në cilësinë e Përgjegjësit të Sektorit të Rekrutimit dhe Promovimit (me urdhër delegimi)

Për sa trajtuar në Projektraportin e auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr.13085/44, prot datë 11.09.2024 , prot në KLSH me nr.473/7, prot datë 16.09.2024, nga z. C. K., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: - Për vitin 2023 Komisioni i Posaçëm e ka patur të pamundur shqyrtimin e gjyqituesve pasi nga 1 Janar 2023 është përcjellë për miratim draft struktura e re dhe deri në Janar 2024 ka vijuar procesi i ristrukturimit dhe ka qenë e pamundur. Gjithashtu edhe në korrespondencat me KMSHC është kërkuar shtyrja e afatit për zbatimin e rekomandimeve të lëna mbi ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, dhe kërkesa është marë për bazë dhe në shkresën nr. 3078 prot në DPT datë 15.02.2024 është cituar se ndjekja e këtij procesi duhet të vijojë pasi institucioni të ketë përmbyllur procesin e ristrukturimit. .

Qëndrimi i grupit të auditimit: Problematikat lidhur me vonesat në procesin e ristrukturimit dhe komisionit të ngritur për këtë qëllim janë trajtuar gjerësisht në materialin e hartuar nga grupi i auditimit, dhe për sa më sipër observacioni nuk meret në konsideratë. Korrespondenca shkresore me KMSHC e cituar në observacion është përtej periudhës objekt auditimi (viti 2023).

Për sa trajtuar në Projektraport, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr.13085/45, prot datë 11.09.2024 , prot në KLSH me nr.473/6, prot datë 16.09.2024, nga Drejtori i Përgjithshëm i DPT, znj. E. Ç. ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Lidhur me shpalljet sqarojmë se DAP dhe DPT nuk mund të vepronte lidhur me shpalljet e vendeve vakante për shkak të procedurës së ristrukturimit. Lidhur me Komisionin e Posaçëm, ka qenë i pamundur shqyrtimi i gjyqituesve pasi DPT ka qenë në proces ristrukturimi dhe për këtë kemi njoftuar edhe KMSHC se do të duhet shtesë kohe për vendimet, dhe është miratuar.

Lidhur me pretendimin se nuk ishte mundur të konkludohej mbi nivelin e vakancave në fund të vitit 2023, ju informojmë se informacionin e kemi dërguar, megjithëse vakancat për shkak të ristrukturimit në 6 mujorin e dytë kanë pësuar ndryshime për shkak sistemimi punonjësve.

Në lidhje me Komisionin e Posaçëm (gjyqituesit), sic ju kemi bërë me dije, ka qenë i pamundur shqyrtimi pasi institucioni ka qenë në proces ristrukturimi, konfirmuar edhe nga shkresa e KMSHC.

Lidhur me konstatimin se grupi i auditimit kërkoi informacion lidhur me afatin e përfundimit të delegimeve, ju sqarojmë se ai është përcjellë me email të datës 11.07.2024, dhe lidhur me urdhrat për delegim kompetencash të mbartura nga vitet e tjera, ju sqarojmë se informacioni është dhënë vetëm për delegimet e vitit 2023, pasi delegimet e vitit 2022 janë audituar njëherë. Disa nga delegimet e vitit 2022 kanë vazhduar pjesërisht gjatë 2023 për shkak të vakancës dhe pamundësisë së shpalljeve vakante nga DAP për shkak të ristrukturimit. Për rastet e delegimeve që kanë zgjatur më shumë se një vit, sidomos në pozicione të nivelit drejtues, siç janë Drejtorët e Drejtorive Rajonale. Drejtor Kontrolli, etj, është e domosdoshme ndjekja e procedurave me delegim/caktim ushtrim funksioni për shkak të domosdoshmërisë në menaxhimin e punës, duke qenë se procedurat e shpalljes deri në emërim kërkojnë një periudhë jo më pak se 2-3 muaj, kur procedura përfundon me fitues, në të kundërt vendi mbetet vakant përsëri. Këto pozicione thelbësore, nëse nuk realizohen me delegim/caktim ushtrim funksioni, bëhen pengesë për kryerjen e detyrave dhe kjo procedurë ndër të tjera gjen mbështetje në ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, neni 3,12 dhe 13 ku thuhet “drejtori i drejtorisë/shef sektori, në rast mungese apo paafësie afatshkurtër, zëvendësohet për shkak të ligjit nga nëpunësi i nivelit më të lartë të të njëjtit drejtori/sector. Në rast se ka më shumë se një nëpunës civil të të njëjtit nivel, ai zëvendësohet na nëpunësi civil i nivelit më të lartë që ka vjetërsi më të madhe në shërbimin civil”. Delegimet/caktim ushtrim funksionin janë mbështetur në ligjin nr. 9920,

datë 19.04.2008, Kushtetutën, ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003, ligji 90/2012, Kodit të Procedurave Administrative të cilat në thelb nuk kanë cënuar marrëdhëniet financiare të nëpunësit. Nisur nga pozicionet vakante, ka plane kontrolli të miratuara për çdo muaj/vit, të cilët duhen realizuar në respektim të afateve të caktuar në funksion të zbatimit të legjislacionit tatimor, objektivave që ka administrata tatimore, etj. Procedurat e delegimeve janë të përkohshme deri në shpalljen e pozicionit vakant nga DAP, deri në nxjerrjen e aktit të emërimit të cilat në 2023 kanë zgjatur më tepër duke qenë se institucioni ka qenë në proces ristrukturimi. Lidhur me procedurat e transferimit, transferimi është bërë me DAP dhe sipas korrespondencave mund të jetë devijime të vogla. Lidhur me mungesën e strategjisë së burimeve njerëzore, Drejtoria e Burimeve Njerëzore përgatit planin e rekrutimit; është pjesë e planit operacional, etj. Lidhur me vonesat për procesin e ristrukturimit, sqarojmë se pas miratimit të strukturës organizative sipas Urdhrit të Kryeministrit nr. 69, datë 26.05.2023, është përcjellë për miratim nga DPT në MFE shkresa nr. 6889/4, datë 31.05.2023 dhe është miratuar me urdhrin nr. 189, datë 08.08.2023 të Ministrit të Financave, gjë e cila ka sjellë pengesë për komisionin e ristrukturimit në respektimin e afateve. Komisioni nuk mund të vepronte se nuk ishin të miratuar përshkrimet e punës, nga MFE. Komisioni i ristrukturimit nuk është bazuar në sistem pikësimi për ristrukturimin, pasi në asnjë rast nuk ka patur 2 nëpunës që pretendojnë të njëjtin pozicion. Sektori i Rekrutimit dhe promovimit ka kryer rolin e sekretarisë teknike bazuar në detyrat funksionale, duke vënë në dispozicion çdo dokument. Lidhur me njoftim e znj. V. T., sqarojmë se nga viti 2022 deri në momentin e largimit në 22.11.2023, znj. V. T. si Drejtor i DBNJ nuk ka ushtruar funksionin për shkaqe shëndetësore si raport lindje, ashtu edhe raport paafhtësie të përkohshme në punë (me përjashtim të një periudhe 1 javore).

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa i përket mos kryerjes së shpalljeve; numrit të vakancave; delegimeve, duke paraqitur si shkak për situatën procesit të ristrukturimit që nuk ka përfunduar, sqarojmë se problematikat e konstatuara lidhur me vonesat e këtij procesi janë trajtuar gjerësisht në material. Lidhur me bazën ligjore të cituar, sqarojmë sërish se delegimi i një pozicioni për periudha disa vjeçare, pa kryer shpalljen apo shqyrtimin e plotësisht të tij nëpërmjet lëvizjes paralele nuk është i parashikuar në asnjë akt ligjor apo nënligjor. Për sa i përket mos vënies në dispozicion të delegimeve të mëparshme që kanë vijuar edhe gjatë vitit 2023, sqarojmë se për sa kohë ato kanë vijuar edhe përgjatë periudhës së auditimit, janë objekt auditimi nga ana jonë. Mos vënia në dispozicion e dokumentacioneve/informacioneve të kërkuara nga KLSH është në kundërshtim me Nenin 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së" të Ligjit Nr. 154/2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit". Lidhur me përbërjen e komisionit, përbërja e vitit 2023 është reflektuar në material. Lidhur me mos vendosjen në dispozicion të akt konstatimeve për ish drejtorin, sqarojmë se për sa kohë punonjësi ka qenë i emëruar për atë pozicion, duhet të informohet për problematikat e konstatuara në drejtorinë që ka patur nën varësi, sikundër është e përcaktuar në fund të akt konstatimit të KLSH se të gjithë personat e cituar duhet të njihen me gjetjet e KLSH. Për sa i përket informacionit të vendosur në dispozicion lidhur me vakancat, sqarojmë se informacioni i përcjellë nga ana juaj i referohet strukturës së mëparshme, duke qenë se ka qenë ende në proces ristrukturimi institucioni, sikundër konfirmuar në pjesën e dytë të observacionit tuaj.

2.9 Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave në punë, mallrave dhe shërbimeve

Për auditimin e këtij drejtimi u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Regjistri i parashikimit dhe realizimeve të prokurimeve publike për vitin 2023.
2. Planifikimi buxhetor i prokurimeve.
3. Dosjet e procedurave të prokurimeve.
4. Procedurat e prokurimit në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE) në faqen e APP (<http://www.app.gov.al/>).

Për vitin 2023, Personat Përgjegjës për Prokurimet (PPP), janë përcaktuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor (AK) z. C. K, me anë të Urdhrit nr. 229, datë 09.01.2023, si më poshtë:

1. znj. B. H, me detyrë ish-Përgjegjës i Sektorit të Prokurimeve;
2. z. A. K, me detyrë Specialist i Sektorit të Prokurimeve;

3. znj. A. S, me detyrë Specialiste e Sektorit të Prokurimeve;
 Me urdhër të titullarit nr.229/4 prot, datë 14.02.2023, është bërë zëvendësimi i personave përgjegjës të prokurimeve znj. A. S me z. D. H.
 Me urdhër të titullarit nr.16695 prot, datë 19.10.2023, është bërë zëvendësimi i personave përgjegjës të prokurimeve z. D. H me znj. A. S.

-Regjistri i parashikimeve të prokurimeve për vitin 2023, është miratuar me shkresën nr.1674 prot, datë 03.02.2023, është ndryshuar me shkresën nr.10249/1 prot, datë 13.06.2023, ndryshuar me shkresën nr.14991/1 prot, datë 19.09.2023, ndryshuar me shkresën nr.1212/56 prot, datë 04.10.2023, jashtë afateve kohore, kjo jo në përputhje me kërkesat e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu II, neni 3, pika 3.

Nga verifikimi i SPE, konstatohet se regjistri i parashikimeve dhe realizimeve për vitin 2023, është si vijon:

Tabela nr.1- “Planifikimi dhe realizimi i procedurave të prokurimit për vitin 2023, sipas llojit” lekë

Nr.	Lloji i procedurës	Parashikimi (pa TVSh)		Realizimi (me TVSh)	
		Numri	Vlera (lekë)	Numri	Vlera (lekë)
1	Blerje nën vlerën 100,000 lekë	2	855,232	3	135,680
2	Blerje me Vlerë të Vogël	17	10,022,762	16	4.469.665
3	Sistem Dinamik i Blerjeve	12	2,000,000	12	1,300,590
4	Procedurë e hapur	4	74,166,667	1	21,741,417
5	Procedurë e hapur e thjeshtuar	2	12,500,000	1	6,383,234
SHUMA		37	99,544,661	33	33,979,586

Burimi: Regjistri i Parashikimit dhe Realizimit për DPT.

Sa sipër rezulton së për vitin 2023, janë parashikuar gjithsej 37 procedura prokurimi me vlerë 99,544,661 lekë, nga të cilat janë realizuar 33 procedura me vlerë gjithsej 33,979,586 lekë. DPT nuk ka realizuar 4 procedura me vlerë të planifikuar 65,565,075 lekë, çka tregon mangësi në procesin e parashikimit, në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu II, neni 3, pika 2, ku përcaktohet se: “Regjistri i parashikimeve duhet të synojë planifikimin e mirë të përdorimit të fondeve publike dhe planifikimin e realizimin në kohë të procedurave të prokurimit publik.”

Nga ana e audituesve të KLSH-së, u analizuan regjistrat e realizimit të prokurimeve në periudhën e auditimit ku rezulton se, janë realizuar gjithsej 33 procedura me fond limit në vlerën **33,979,586** lekë pa TVSH nga ku: 2 procedura prokurimi për (shërbime, mallra dhe punë) në shumën 28,124,651 lekë pa TVSH + 31 procedura “Blerje me vlerë të vogël“, “Blerje Dinamike“ dhe “Blerje nën 100,000 lekë“ në shumën 5,854,935 lekë pa TVSH. Më hollësisht të dhënat për procedurat e prokurimit të zhvilluara gjatë periudhës së auditimit 2023, janë paraqitur sipas tabelës më lartë.

Për periudhën e auditimit janë audituar 11 procedura për punë publike, mallra dhe shërbime, në vlerën e kontratës 27,095,674 lekë pa TVSH ose në masën 80 % të mbulimit të prokurimeve, respektivisht:

2 Procedura Prokurimi me vlerë 24,358,916 lekë pa TVSH, si më poshtë:

Nr.	Objekti i Prokurimit	Tipi i Kontratës	Lloji i Procedurës së Prokurimit	Fondi Limit	Vlera e kontratës	OE i shpallur fitues
1	Rikonstruksion DRT Vlorë	Punë	Proc e Hapur e thjeshtuar	6,666,667	5,610,691	B.O.E “AO” dhe “U”.
2	Rikonstruksion DRT Elbasan	Punë	Proc e Hapur e thjeshtuar	24,997,800	18,748,225	I Sh.p.k

5 Procedura “Blerje me vlerë të vogël“, në shumën 2,736,758 lekë pa TVSH, si më poshtë:

Nr.	Objekti i Prokurimit	Tipi i Kontratës (mall/punë/shërbim)	Lloji i Procedurës se Prokurimit	Fondi Limit	Vlera e kontratës	Emri i OE shpallur fitues
1	Materiale për pastrim I	Mall	Prokurim BV	310,120	277,000	N V
2	Shërbim për mirëmbajtje të printerave I	Mall+Shërbim	Prokurim BV	370,000	323,000	R
3	Shërbim për mirëmbajtje të printerave II	Mall+Shërbim	Prokurim BV	378,000	365,000	C
4	Blerje certifikat SSL	Mall	Prokurim BV	216,466	149,000	X S
5	Materiale për pastrim II	Mall	Prokurim BV	499,800	257,000	H
6	Mirëmbajtje objekti	Shërbim	Prokurim BV	574,116	540,000	A
7	Sigurimi i automjeteve të DPT-së	Mall	Prokurim BV	324,678	319,220	A
8	Blerje UPS.	Mall	Prokurim BV	523,935	245,000	E A 2008
9	Mbikëqyrje rikonstruksioni DRT Elbasan	Shërbim	Prokurim BV	843,670	261,538	M G P

Në mënyrë të përmbledhur paraqiten sipas tabelës më poshtë:

Tabela nr. 2: “Procedura prokurimi të audituara”

lekë

Viti	Procedura të Prokuruar			Procedura të Audituar			
	Numër	Fond limit	Vlerë kontrate	Numër	Fond limit	Vlerë Kontrate	% e fondeve të audituara
2023	33	99,544,661	33,979,586	11	35,705,251	27,095,674	80%

Burimi: DPT, përpunoi KLSH

Nga procedurat e përzgjedhura për auditim, është konstatuar si më poshtë vijon:

I-Procedura Prokurimi të zhvilluara gjatë vitit 2023

➤ 1- Procedura prokurimit “Rikonstruksion i godinës të DRT Elbasan”, viti 2023

Të dhëna të përgjithshme të procedurës

Urdhër prokurimi nr.11173/13 Prot., datë 30.08.2023	NJHDT B H A K D H	KVO me urdhrin nr.11173/12 Prot, datë 30.08.2023 G P - Kryetar B B - Anëtar D K - Anëtar A D - Anëtar G G - Anëtar
Fondi limit 24,997,800 Lekë		
Procedura e prokurimit - Procedurë e hapur		
Burimi i Financimit: Fondet e DPT.	Fitues: I Sh.p.k, me NIPT J...Ë	Vlera fituese 18,748,225 Lekë
Datë e hapjes së tenderit 21.09.2023.	Diferenca nga fondi limit: 6,249,757 lekë.	

Marrin pjesë 7 OE S' kualifikuar 2 OE	Miratimi i procedurës: Memo nr.11173/26 Prot., datë 24.10.2023.	Vlera e kontratës 18,748,225 lekë pa TVSH dhe 22,497,870. lekë me TVSH.
Ankimime për vleresim në AK - Jo Ankimime në KPP për vlerësim - JO	Afati kontratës 3 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.	Titullar i AK – C K Administrator i Shoqerise:F C

Përcaktimi i kritereve teknike dhe fondit limit

- Me shkresën nr.2659 prot, datë 24.05.2023, Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan, ka paraqitur kërkesë për marrjen e një specialisti inxhinier ndërtimi për nënshkrimin e kontratës me një shoqëri e cila ka dhuruar projektin dhe preventivin e punimeve për rikonstruksionin e DRT Elbasan, i cili do të jetë pjesë e Grupit të Punës për marrjen në dorëzim të projektit dhe preventivit të punimeve.

- Me Urdhër me nr.11173, datë 27.06.2023, titullari i AK, ka miratuar ngritjen e grupit të punës për marrjen në dorëzim të projektit me objekt “Dorëzim i projektit të preventivit përfundimtar të rikonstruksionit të ambienteve të DRT Elbasan dhe hartimin e kritereve teknike” me përbërjen e të cilit janë: 1- A I, Inxhinier ndërtimi në DRT Tiranë, 2- E A Inxhinier ndërtimi në DTM, 3-K H, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse në DPT.

- Me shkresën nr.3688 prot, datë 03.07.2023, Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan, ka dërguar në DPT dokumentacionin teknik lidhur me rikonstruksionin e DRT Elbasan.

- Me procesverbalin më nr.11173/3 prot, datë 05.07.2023 njësia e prokurimit i ka dorëzuar komisionit për marrjen në dorëzim të “Projektit të zbatimit dhe preventivat përfundimtar të rikonstruksionit të ambienteve të DRT Elbasan”

- Me shkresën nr.11173/10 prot, datë 02.08.2023, Sektori i prokurimeve në DPT i është drejtuar Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit për miratimin e fondeve për rikonstruksionin e DRT Elbasan, nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit i është kthyer përgjigje me shkresën me nr.11173/11 prot, datë 04.08.2023 ku konfirmohet kërkesa për miratimin e fondeve.

- Me shkresën me nr.14018 prot, datë 25.08.2023 Komisioni i marrjes në dorëzim të projektit dhe preventivit për rikonstruksionin e DRT Elbasan me përbërjen e të cilit janë: 1- A I, Inxhinier ndërtimi në DRT Tiranë, 2- E A Inxhinier ndërtimi në DTM, 3-K H, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse në DPT ka hartuar specifikimet/termat teknike.

- Me shkresën me nr.11173/12 prot, datë 30.08.2023, ka dal urdhëri për krijimin e komisionit të vlerësimit të ofertave me përbërje: 1-G P, 2-B B, 3-D K, 4-A D, 5-G G.

-Me shkresën me nr.11173/13 prot, datë 30.08.2023 ka dal urdhër prokurimi për rikonstruksionin e DRT Elbasan me fond limit 24,997,800 lekë pa TVSH, ku ngarkohen për zbatimin e këtij urdhëri NJP me përbërje: 1-B H, Përgjegjës Sektori, 2-A K, Specialist, 3-D H, Specialist/Jurist.

- Hartimi i fondit limit është bazuar në VKM nr.629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre.

Hartimi i DST-të

- Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Njësia e Prokurimit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim.

- Me procesverbal datë 04.09.2023, Njësia e Prokurimit ka përcaktuar shtojcat që do të jenë pjesë e DST-ve.

- Kriteret e veçanta janë evidentuar në procesverbalin me nr.14018 prot., datë 04.09.2023 të grupit të punës “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim”, të cilat janë si më poshtë:

2.3 Kapaciteti teknik:

Kriteri 2.3.3-Stafi kryesor e mbështetës, punonjësit, certifikimet, kualifikimet per ekzekutimin e kontratës.

Kriteri 2.3.2- Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Arkitekt 1 (një)
- Inxhinier Elektronik/ Informatik/ Telekomunikacion 1 (një)

-Vendosja e kriterit për të pasur pjesë të stafit teknik 1 Arkitekt dhe 1 Inxhinier Elektronik/ Informatik/ Telekomunikacion 1 (një), referuar zërave të punimeve në preventiv, është i fryrë pasi këto zëra punimesh mund të mbulohen nga Inxhinieri Ndërtimit si dhe Inxhinieri Elektrik, pra janë të paargumentuar dhe jo në përputhje me objektin e kontratës.

- **Kriteri 2.3.3**-Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- Teknik ndërtimi min. 2 (dy)
- Teknik gjeodet min 1(nje)
- Specialist elektrikist min. 3(tre)
- Specialist hidraulik min 2(dy)
- Specialist bojaxhi min 3(tre)
- Specialist pllaka-shtrues min 2(dy)
- Specialist për punime duralumini min 2(dy)
- Specialist per sistemet e kondicionimit min 2(dy)

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratën individuale të punës;
- certifikata/diploma profesionale per secilin. Certifikatat/diplomat duhet te jene te lëshuara nga institucione publike/private te licensuara sipas ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional ne R.Sh.”, i ndryshuar.
- dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik,(të vlefshme) lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve.

-Vendosja e kriterit për të pasur pjesë të stafit teknik 2 Specialist për punime duralumini min nuk është i argumentuar, pasi në preventivin ne zërin 2.373./1, është parashikuar furnizim vendosje duralumin plastik me dopio xham, punime të cilat përgjithësisht kryen nga nënkontraktorët të specializuar në këtë fushë.

- **Kriteri 2.3.6** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr.	Mjete/pajisje teknike	Sasia	Komenti
1.	Kamioncinë vetëshkarkuese (2 - 3.5) ton- (sipas lejes së qarkullimit /pika 23 në lejen e qarkullimit	2 copë	Për të kryer transportin e materialeve dhe të veglave të punës që do të përdoren për punime.
2.	Kamion vetëshkarkuese min 5 ton	1 copë	Për të kryer transportin e materialeve dhe të veglave të punës që do të përdoren për punime.

-Vendosja e kriterit për të pasur 2 kamioncina vetëshkarkuese (2-3.5) ton dhe 1 kamioncine vetëshkarkuese 5 ton janë kriteret të fryra pasi këto zëra punimesh mund të mbulohen nga vetëm 1 mjet, pra janë të paargumentuar dhe jo në përputhje me objektin e kontratës.

- **Kriteri-2.3.7.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata
 - Certifikatë **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” e vlefshme, ose ekuivalente/barasvlefshme, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim;
 - Certifikatë ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të ambientit” e vlefshme, ose ekuivalente/barasvlefshme;
 - Certifikatë **ISO 45001:2021** mbi “Shëndetin dhe sigurimin në punë”, e vlefshme, ose ekuivalente/barasvlefshme.
 - Certifikatë **ISO 3834-2:2021** mbi “Menaxhimin e cilësisë për saldimin dhe bashkimin e materialeve metalike”, e vlefshme, ose ekuivalente/barasvlefshme.

Vendosja e kërkesës për disponimin e Certifikatës **ISO 14001:2015**, është e tepërt dhe e paargumentuar ligjërisht se për çfarë shërben në këtë rast, jo në përputhje me objektin e kontratës.

Si përfundim vendosja e kriterëve më sipër është e paargumentuar dhe e tepërt jo në përputhje me përcaktimet e nenit 46, Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, dhe nenit 26, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, që sanksionon që: “...çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje dhe i lidhur ngushtë me natyrën e kontratës”.

Mos argumentimi i kriterëve të vendosura bie në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 36, pika 2, Neni 77, pika 1 dhe 4, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 41, pika 2, në të cilën citohet: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”, Neni 55, pika 4, Neni 78, pika 2.

Veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi Njësinë e Prokurimit: 1-B H, Përgjegjës Sektori, 2-A K, Specialist, 3-D H, Specialist/Jurist.

Zhvillimi i procedurës

Nga auditimi në sistemin elektronik dhe dokumenteve faktike të procedurës së prokurimit me objekt “Rikonstruksioni godinës të DRT Elbasan”, rezultoi se në tender kanë marrë pjesë 7 operator, për të cilin KVO ka kryer vlerësimin si më poshtë:

Nr.	Operatori ekonomik pjesëmarrës	Oferta ekonomike (pa TVSh)	Vlerësimi KVO-së
1	“I”	18,748,225	Kualifikuar dhe shpallur fitues
2	“A CO”	18,767,280	Kualifikuar, renditur i dyti
3	“2 ”	20,000,000	Kualifikuar, renditur i treti
4	“B	20,374,650	Kualifikuar, renditur i katërti
5	“EI”	23,599,891	Kualifikuar, renditur i pesti
6	“L K”	23,707,304	S’KUALIFIKUAR

7	“A”	24,256,379	S’KUALIFIKUAR
---	-----	------------	---------------

Nga auditimi i ofertës fituese të paraqitur nga “I”, me vlerë 18,748,225 lekë pa TVSH dhe 22,497,870 lekë me TVSH, rezultoi se:

- Në lidhje me plotësimin e kriterit **2.3.8**. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata:
 - Certifikatë **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” e vlefshme, ose ekuivalente/barasvlefshme, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim.
 - Certifikatë **ISO 14001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të ambientit” e vlefshme, ose ekuivalente/barasvlefshme.
 - Certifikatë **ISO 45001:2021** mbi “Shëndetin dhe sigurimin në punë”, e vlefshme, ose ekuivalente/barasvlefshme.
 - Certifikatë **ISO 3834-2:2021** mbi “Menaxhimin e cilësisë për saldimin dhe bashkimin e materialeve metalike”, e vlefshme, ose ekuivalente/barasvlefshme.

Konstatohet se OE i shpallur fitues nuk ka paraqitur certifikatat : 1.Certifikatë **ISO 45001:2021** mbi “Shëndetin dhe sigurimin në punë”, e vlefshme, ose ekuivalente/barasvlefshme. 2. Certifikatë **ISO 3834-2:2021** mbi “Menaxhimin e cilësisë për saldimin dhe bashkimin e materialeve metalike”, e vlefshme, ose ekuivalente/barasvlefshme. Veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 92-Shqyrtimi i ofertave dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 82, pika 2 dhe 3.

Sa më sipër, KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues “I”, me vlerë 18,748,225 lekë, edhe pse nuk ka plotësuar plotësisht kriteret e kërkuara në DST, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 87 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, neni 92 “Shqyrtimi i ofertave” dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, ç’ka ngarkon me përgjegjësi KVO-në, me përbërje: 1-GP, 2-B B, 3 D K, 4-A D, 5-G G.

Marrja në dorëzim

Është nënshkruar kontrata me nr.11173/28 prot, datë 30.10.2023 me vlerë 18,748,225 lekë pa TVSH dhe 22,497,870 lekë me TVSH.

- Me urdhër nr.11173/32 prot, datë 30.10.2023, të titullarit të autoritetit kontraktor, është ngritur Komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës, i përbërë nga z. N. P, z. K. K dhe z. A. Gj.

- Nga Komisioni për ndjekjen dhe marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve është hartuar plani për zbatimin e kontratës me nr.11173/33 prot, datë 30.10.2023.

Me raportin periodik me nr.5818/16 prot, datë 29.12.2023 mbajtur nga komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës është vënë në dijeni AK për përfundimin e punimeve lidhur me rikonstruksionin e DRT Elbasan.

Likuidim kontrate është bërë vetëm për situacionin me nr. 1, i cili është përcjell me memo sqaruese me nr.5818/8, datë 18.12.2023, hollësisht paraqitet sipas tabelës më poshtë:

Tabela nr. “Likujdime kontrata “Rikonstruksion DRT Elbasan” viti 2023

Nr	Përshkrimi I mallrave	Nr/ dt - fature	Vlera në lekë pa TVSH	Vlera në lekë me TVSH	Likujduar
1	Rikonstruksion DRT Ebasan	32/2023	4,396,836	5,276,203	19.12.2023

Burimi: DPT, përpunoi KLSH

Procedura e marrjes në dorëzim të punimeve dhe likuidimi i plotë i kontratës janë veprime të cilat janë zhvilluar gjatë vitit 2024.

➤ **2- Procedura prokurimit “Rikonstruksion i DRT Vlorë” viti 2023**

Të dhëna të përgjithshme të procedurës

Urdhër prokurimi nr.13331/1 Prot., datë 04.09.2023	NJHDT B H A K D H	KVO me urdhrin nr.13331/6 Prot, datë 04.09.2023 S K-Kryetar L K-Anëtar A K-Anëtar I K-Anëtar J F-Anëtar
Fondi limit 6,666,666 Lekë		
Procedura e prokurimit – Procedurë e hapur e thjeshtuar		
Burimi i Financimit: Fodet DPT.	Fitues: B.O.E “A O” dhe “U”.	Vlera fituese 5,610,691 Lekë
Datë e hapjes së tenderit 29.09.2023.	Diferenca nga fondi limit 1,055,975 lekë.	
Marrin pjesë 3 OE S kualifikuar – Ska	Miratimi i procedurës:Memo nr.14375/1 Prot., datë 06.09.2023	Vlera e kontratës 5,610,691 lekë pa TVSH dhe 6,732,829 lekë me TVSH.
Ankimime per vleresim në AK - Jo Ankimime në KPP per vleresim - Jo	Afati kontratës 2 muaj nga data e nëshkrimit të kontratës.	Titullar i AK – C K Administrator i Shoqerise:A Gj

Përcaktimi i kriterëve teknike dhe fondit limit

- Me shkresën nr.5215/1 prot, datë 09.08.2023, Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, ka paraqitur kërkesë për marrjen e një specialisti inxhinier ndërtimi për nënshkrimin e kontratës me një shoqëri e cila ka dhuruar projektin dhe preventivin e punimeve për rikonstruksionin e DRT Vlorë, i cili do të jetë pjesë e Grupit të Punës për marrjen në dorëzim të projektit dhe preventivit të punimeve.

- Me Urdhër me nr.13331 prot, datë 09.08.2023, titullari i AK, ka miratuar ngritjen e grupit të punës për marrjen në dorëzim të projektit me objekt “Dorëzim i projektit të preventivit përfundimtar të rikonstruksionit të ambienteve të DRT Vlorë dhe hartimin e kriterëve teknike” me përbërjen e të cilit janë: 1- A I, Inxhinier ndërtimi në DRT Tiranë, 2- EA Inxhinier ndërtimi në DTM, 3-K H, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse në DPT.

- Me shkresën nr.5215/1 prot, datë 28.08.2023, Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, ka dërguar në DPT dokumentacionin teknik lidhur me rikonstruksionin e DRT Vlorë.

- Me procesverbalin më nr.13331/4 prot, datë 30.08.2023 njësia e prokurimit i ka dorëzuar komisionit për marrjen në dorëzim të “Projektit të zbatimit dhe preventivat përfundimtar të rikonstruksionit të ambienteve të DRT Vlorë”

- Me shkresën nr.14375 prot, datë 01.09.2023, Sektor i prokurimeve në DPT i është drejtuar Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit për miratimin e fondeve për rikonstruksionin e DRT Vlorë, nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit i është kthyer përgjigje me shkresën me nr.14375/1 prot, datë 06.09.2023 ku konfirmohet kërkesa për miratimin e fondeve të cilat janë parashikuar në shumën 8,000,000 lekë.

- Me shkresën me nr.14356 prot, datë 01.09.2023 Komisioni i marrjes në dorëzim të projektit dhe preventivit për rikonstruksionin e DRT Vlorë me përbërjen e të cilit janë: 1- A I, Inxhinier ndërtimi në DRT Tiranë, 2- E A Inxhinier ndërtimi në DTM, 3-K H, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse në DPT ka hartuar specifikimet/termat teknike.

- Me shkresën me nr.13331/6 prot, datë 04.09.2023, ka dal urdhëri për krijimin e komisionit të vlerësimit të ofertave me përbërje: 1-S K, 2-L K, 3-A K, 4-I K, 5-J F.

- Me shkrësn me nr. 13331/6 prot, datë 04.09.2023 ka dal urdhër prokurimi për rikonstruksionin e DRT Vlorë me fond limit 6,666,666 lekë pa TVSH, ku ngarkohen për zbatimin e këtij urdhëri NJP me përbërje: 1-BH, Përgjegjës Sektori, 2-AK, Specialist, 3-DH, Specialist/Jurist.
- Hartimi i fondit limit është bazuar në VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre.

Hartimi i DST-të

- Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Njësia e Prokurimit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim.
- Kriteret e veçanta janë evidentuar në procesverbalin me datë 13.09.2023 të grupit të punës “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim”, ku janë përcaktuar dhe shtojcat që do të jenë pjesë e DST-ve, të cilat janë si më poshtë:

2.3 Kapaciteti teknik:

Kriteri 2.3.3-Stafi kryesor e mbështetës, punonjësit, certifikimet, kualifikimet për ekzekutimin e kontratës.

Kriteri 2.3.2- Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Arkitekt 1 (një)
- Inxhinier Elektronik/ Informatik/ Telekomunikacion 1 (një)

-Vendosja e kriterit për të pasur pjesë të stafit teknik 1 Arkitekt dhe 1 Inxhinier Elektronik/ Informatik/ Telekomunikacion 1 (një), referuar zërave të punimeve në preventiv, është i fryrë pasi këto zëra punimesh mund të mbulohen nga Inxhinieri Ndërtimit si dhe Inxhinieri Elektrik, pra janë të paargumentuar dhe jo në përputhje me objektin e kontratës.

- **Kriteri 2.3.4-**Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:
 - Teknik ndërtimi min. 2 (dy)
 - Teknik gjeodet min 1(një)
 - Specialist elektrikist min. 3(tre)
 - Specialist hidraulik min 2(dy)
 - Specialist bojaxhi min 3(tre)
 - Specialist pllaka-shtrues min 2(dy)
 - Specialist per punime duralumini min 2(dy)
 - Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë:
 - kontratën individuale të punës;
 - certifikata/diploma profesionale per secilin. Certifikatat/diplomat duhet te jene te lëshuara nga institucione publike/private te licensuara sipas ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional ne R.Sh.”, i ndryshuar.

- dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik,(të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve.
- Vendosja e kriterit për të pasur pjesë të stafit teknik 2 Specialist per punime duralumini min 2 nuk është i argumentuar, pasi në preventivin ne zërin 2.373./1, është parashikuar furnizim vendosje d/alumin plastik me dopio xham, punime të cilat përgjithësisht kryen nga nënkontraktorët të specializuar në këtë fushë.
- **Kriteri 2.3.6** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr.	Mjete/pajisje teknike	Sasia	Komenti
3.	Kamioncinë vetëshkarkuese (2 - 3.5) ton- (sipas lejes së qarkullimit /pika 23 në lejen e qarkullimit	2 copë	Për të kryer transportin e materialeve dhe të veglave të punës që do të përdoren për punime.
4.	Kamion vetëshkarkuese min 5 ton	1 copë	Për të kryer transportin e materialeve dhe të veglave të punës që do të përdoren për punime.

-Vendosja e kriterit për të pasur 2 kamioncina vetëshkarkuese (2-3.5) ton dhe 1 kamioncine vetëshkarkuese 5 ton janë kriteret të fryra pasi këto zëra punimesh mund të mbulohen nga vetëm 1 mjet, pra janë të paargumentuar dhe jo në përputhje me objektin e kontratës.

- **Kriteri-2.3.7.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata
 - Certifikatë **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” e vlefshme, ose ekuivalente/barasvlefshme, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim;
 - Certifikatë ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të ambientit” e vlefshme, ose ekuivalente/barasvlefshme;
 - Certifikatë **ISO 45001:2021** mbi “Shëndetin dhe sigurimin në punë”, e vlefshme, ose ekuivalente/barasvlefshme.

-Vendosja e kërkesës për disponimin e Certifikatës **ISO 14001:2015**, është e tepërt dhe e paargumentuar ligjërisht se për çfarë shërben në këtë rast, jo në përputhje me objektin e kontratës.

Si përfundim vendosja e kriterëve më sipër është e paargumentuar dhe e tepërt jo në përputhje me përcaktimet e nenit 46, Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, dhe nenit 26, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, që sanksionon që: “...çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje dhe i lidhur ngushtë me natyrën e kontratës”.

Mos argumentimi i kriterëve të vendosura bie në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 36, pika 2, Neni 77, pika 1 dhe 4, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 41, pika 2, në të cilën citohet: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”, Neni 55, pika 4, Neni 78, pika 2.

Veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi Njësinë e Prokurimit: 1-B H, Përgjegjës Sektori, 2-A K, Specialist, 3-D H, Specialist/Jurist.

Zhvillimi i procedurës

Nga auditimi në sistemin elektronik dhe dokumenteve faktike të procedurës së prokurimit me objekt “Rikonstruksioni godinës të DRT Vlorë”, rezultoi se në tender kanë marrë pjesë 3 operator, për të cilin KVO ka kryer vlerësimin si më poshtë:

Nr.	Operatori ekonomik pjesëmarrës	Oferta ekonomike (pa TVSh)	Vlerësimi KVO-së
1	“I”	4,934,398	Kualifikuar
2	B.O.E “AO” dhe “U”	5,610,691	Kualifikuar dhe shpallur fitues
3	“M K”	5,772,984	Kualifikuar, renditur i treti

Me procesverbalin e mbajtur në datën 29.10.2023 nga ana e KVO pasi janë shqyrtuar dhe vlerësuar ofertat për tenderin e sipërcituar AK ka mbyllur procedurën në SPE dhe është njoftuar OE “I” ShPK nëpërmjet sistemin elektronik të prokurimit për të paraqitur dokumentacionin original ose fotokopje të njësuar me origjinalin. OE “I” Sh.P.K renditur i pari nuk ka paraqitur dokumentacionin brenda afatit 5 ditor përcaktuar në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 26, pika 6.

Komisioni ka vendosur të skualifikojë OE “I” dhe të kalojë te OE i renditur i dyti, B.O.E “A-O” dhe “U” me ofertën ekonomike 5,610,691 lekë.

Nga auditimi i ofertës fituese të paraqitur nga B.O.E “A O” dhe “UA”, me vlerë 5,610,691 lekë pa TVSH dhe 6,732,829 lekë me TVSH, rezultoi se:

KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues B.O.E “AO” dhe “UA” me ofertën ekonomike 5,610,691 lekë, pasi ka plotësuar plotësisht kriteret e kërkuara në DST, sipas kërkesave të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 87 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, neni 92 “Shqyrtimi i ofertave” dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Marrja në dorëzim

Është nënshkruar kontrata me nr.13331/16 prot, datë 30.10.2023 me vlerë 5,610,691 lekë pa TVSH dhe 6,732,829 lekë me TVSH.

- Me urdhër nr.13331/19 prot, datë 30.10.2023, të titullarit të autoritetit kontraktor, është ngritur Komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës, i përbërë nga z. B. P, z. I. R dhe znj. E. M.

- Nga Komisioni për ndjekjen dhe marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve është hartuar plani për zbatimin e kontratës me nr.13331/21 prot, datë 31.10.2023.

Me raportin periodik me nr.7964/2 prot, datë 21.12.2023 mbajtur nga komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës është vënë në dijeni AK për përfundimin e 80% të punimeve lidhur me rikonstruksionin e DRT Vlorë.

Procedura e marrjes në dorëzim të punimeve dhe likuidimi i kontratës janë veprime të cilat janë zhvilluar gjatë vitit 2024.

II- Procedura Prokurimi “Blerje me vlerë të vogël”

- Me urdhër të titullarit të DPT nr.230, datë 09.01.2023, është ngritur Komisionit i Prokurimit me Vlerë të Vogël për vitin 2023, i përbërë nga znj. B. H, me detyrë ish-Përgjegjës i Sektorit të Prokurimeve, A. K, me detyrë Specialist i Sektorit të Prokurimeve, znj. A. S, me detyrë Specialiste e Sektorit të Prokurimeve.

Me urdhër të titullarit të DPT nr.230/1, datë 14.02.2023, është zëvendësuar njëri prej anëtarëve të Komisionit Prokurimit me Vlerë të Vogël znj. A.S me z. D.H.

Me urdhër të titullarit nr. 16694 prot, datë 19.10.2023, është bërë zëvendësimi i personave përgjegjës të prokurimeve z. D.H me znj. A.S.

1- Materiale për pastrim.

- Me shkresën nr.9909 prot, datë 01.06.2023, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm, nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, është bërë kërkesa për miratimin e fillimit të procedurës së prokurimit.

- Me procesverbal datë 03.07.2023, Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, ka hartuar fondin limit bazuar në testimin e tregut, sipas mesatares së 3 ofertave të paraqitura, në vlerën 310,120 lekë pa TVSH.

Me shkresën nr.9909/1 prot, datë 05.07.2023 ka dal urdhër prokurimi për blerje me vlerë të vogël “Blerje materiale pastrimi”.

Me shkresën nr.9909/2 prot, datë 05.07.2023 është publikuar ftesa për ofertë.

- Në përfundim të procesit të vlerësimit është shpallur fitues OE NV, Nipt-K.....Q, me ofertë me vlerë 277,000 lekë pa TVSH dhe 332,400 lekë me TVSH.

- Me urdhër nr.9909/3 prot, datë 12.07.2023, të titullarit, është ngritur Komisioni për marrjen në dorëzim të mallrave, i përbërë nga znj. H.K, z. A.K dhe znj. L.B.

Marrja në dorëzim e mallrave është bërë me proces-verbalin me datë 21.07.2023, brenda afateve të parashikuara në kontratë.

Likuidimet paraqiten sipas tabelës më poshtë:

Nr	Përshkrimi I mallrave	Operatori	Urdhër Prokurimi/ Shërbimi	Nr/ dt - fature	Vlera në lekë	Likuiduar
1	Blerje Materiale Pastrimi	NV	nr.9909/1, datë 05.07.2023	nr.23/2023, datë 21.07.2023	332,400	01.08.2023

Burimi: DPT, përpunoi KLSH

-Nga verifikimi i zbatimit të kontratës dhe urdhër shpenzimeve, rezulton se likuidimet janë kryer bazuar në dokumentacionin justifikues, si procesverbale për marrjen në dorëzim të mallit, fletë hyrje, fatura tatimore e lëshuar nga subjekti si dhe Memo mbi likuidimin e faturës dhe zbatimin e kontratës.

2- Shërbim për mirëmbajtje të printerave I.

- Me shkresën nr.1944/1 prot, datë 16.02.2023, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm, nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, është bërë kërkesa për miratimin e fillimit të procedurës së prokurimit., bashkëngjitur procesverbal për hartimin e specifikimeve teknike.

- Me procesverbal datë 06.03.2023, Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, ka hartuar fondin limit bazuar në testimin e tregut, sipas mesatares së 3 ofertave të paraqitura, në vlerën 370,000 lekë pa TVSH.

Me shkresën nr.3790 prot, datë 07.03.2023 ka dal urdhër prokurimi për blerje me vlerë të vogël “Shërbim për mirëmbajtje të printerave”.

Me shkresën nr.3790/1 prot, datë 07.03.2023 është publikuar ftesa për ofertë.

- Në përfundim të procesit të vlerësimit është shpallur fitues OE “R.” Sh.p.k, me nipt-L.....K me ofertë me vlerë 323,000 leke pa TVSH dhe 387,600 lekë me TVSH.

- Me urdhër nr.3790/2 prot, datë 15.03.2023, të titullarit, është ngritur Komisioni për ndjekjen dhe marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve, i përbërë nga z. G.SH, z. R.D anëtar dhe z. E.C anëtar.

Marrja në dorëzim e mallrave/shërbimeve është bërë me proces-verbalin me datë 16.03.2023, brenda afateve të parashikuara në kontratë.

Janë realizuar likuidimet sipas tabelës më poshtë:

Nr	Përshkrimi I mallrave	Operatori	Urdhër Prokurimi/ Shërbimi	Nr/ dt - fature	Vlera në lekë	Likuiduar
I	Shërbim për mirëmbajtje të printerave	R 2	nr.3790, datë 07.03.2023	2/2023 datë 12.04.2023	323,000	01.08.2023

Burimi: DPT, përpunoi KLSH

- Nga verifikimi i zbatimit të kontratës dhe urdhër shpenzimeve, rezulton se likuidimet janë kryer bazuar në dokumentacionin justifikues, si procesverbale për marrjen në dorëzim të mallit, raport për zbatimin e kontratës, fletë hyrje, fatura tatimore e lëshuar nga subjekti si dhe Memo mbi likuidimin e faturës dhe zbatimin e kontratës.

3- Shërbim për mirëmbajtje të printerave II.

- Me shkresën nr.16964 prot, datë 25.10.2023, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm, nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, është bërë kërkesa për miratimin e fillimit të procedurës së prokurimit., bashkëngjitur procesverbal për hartimin e specifikimeve teknike.

- Me procesverbal datë 27.10.2023, Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, ka hartuar fondin limit bazuar në testimin e tregut, sipas mesatares së 3 ofertave të paraqitura, në vlerën 378,000 lekë pa TVSH.

Me shkresën nr.17177 prot, datë 30.10.2023 ka dal urdhër prokurimi për blerje me vlerë të vogël “**Shërbim për mirëmbajtje të printerave**”.

Me shkresën nr.17177/1 prot, datë 30.10.2023 është publikuar ftesa për ofertë.

- Në përfundim të procesit të vlerësimit është shpallur fitues OE “C” Sh.p.k, me nipt-K.....V me ofertë me vlerë 365,000 leke pa TVSH dhe 438,000 lekë me TVSH.

- Me urdhër nr.17177/4 prot, datë 01.12.2023, të titullarit, është ngritur Komisioni për ndjekjen dhe marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve, i përbërë nga z. D.J, z. R.D dhe z. A.D.

Marrja në dorëzim e mallrave/shërbimeve është bërë me proces-verbalin me datë 15.12.2023, brenda afateve të parashikuara në kontratë.

Janë realizuar likuidimet sipas tabelës më poshtë:

Nr	Përshkrimi I mallrave	Operatori	Urdhër Prokurimi/ Shërbimi	Nr/ dt - fature	Vlera në lekë	Likuiduar
I	Shërbim për mirëmbajtje të printerave	C	nr.17177, datë 30.10.2023	380/2023 datë 15.12.2023	438,000	20.12.2023

Burimi: DPT, përpunoi KLSH

- Nga verifikimi i zbatimit të kontratës dhe urdhër shpenzimeve, rezulton se likuidimet janë kryer bazuar në dokumentacionin justifikues, si procesverbale për marrjen në dorëzim të mallit, raport për zbatimin e kontratës, fletë hyrje, fatura tatimore e lëshuar nga subjekti si dhe Memo mbi likuidimin e faturës dhe zbatimin e kontratës.

4- Blerje certifikat SSL për nevojat e aksesimit të Sistemit të Përbashkët të Transmetimit.(CTS)”.

- Me memon nr.15543 prot, datë 27.09.2023 Drejtoria TIK e Tatimeve i është drejtuar Drejtorisë së Administratës dhe Prokurimeve ku i vë në dijeni se afati i vlefshmërisë së certifikatës EV SSL është deri në 27.12.2023 dhe i kërkohet të merren masa për zhvillimin e procedurës së prokurimit për blerjen e certifikatës së re.

- Me shkresën nr.15543/1 prot, datë 29.09.2023, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm, nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, është bërë kërkesa për miratimin e fillimit të procedurës së prokurimit., bashkëngjitur procesverbal për hartimin e specifikimeve teknike.

- Me procesverbal datë 18.10.2023, Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, ka hartuar fondin limit bazuar në testimin e tregut, sipas mesatares së 3 ofertave të paraqitura, në vlerën 216,466 lekë pa TVSH.

Me shkresën nr.16696 prot, datë 19.10.2023 ka dal urdhër prokurimi për blerje me vlerë të vogël “Blerje certifikat SSL për nevojat e aksesimit të Sistemit të Përbashkët të Transmetimit.(CTS)”.

Me shkresën nr. 16696/1 prot, datë 19.10.2023 është publikuar ftesa për ofertë.

- Në përfundim të procesit të vlerësimit është shpallur fitues OE “XS” Sh.p.k,me nipt-L.....L me ofertë me vlerë 149,000 leke pa TVSH dhe 178,800 lekë me TVSH.

- Me urdhër nr.17178/2 prot, datë 14.11.2023, të titullarit, është ngritur Komisioni për ndjekjen dhe marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve, i përbërë nga znj.I.S, znj. A.G dhe znj. H.K.

Marrja në dorëzim e mallrave/shërbimeve është bërë me proces-verbalin me datë 28.12.2023, afati i parashikuar i dorëzimit të mallit është brenda 3 ditëve nga data e shpalljes së fituesit e cila është realizuar në datën 26.10.2023.

Bazuar në Ftesën për ofertë nr. 16696/1 prot, datë 19.06.2023, në të cilën citohet se “Afati i lëvrimit të mallit/punës do të jetë Brenda 3 ditëve duke filluar nga shpallja e njoftimit të fituesit. Marrja në dorëzim e mallrave është bërë sipas procesverbalit të dorëzimit mbajtur midis Autoritetit Kontraktor dhe përfaqësuesit të Operatorit ekonomik të shpallur fitues, mbajtur me datë 28.12.2023. kjo në kundërshtim të nenit 41, pika1, gërma ë) dhe nenit 2, të Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik, nenit 56, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, dokumenteve Standarte të Tenderit për procedurat e thjeshtuara, nenit 17, “Dëmet e likujduara”, në nenin 17.1, pika a).

Në këto kushte Autoriteti Kontraktor nuk ka përmbushur detyrimet VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, e nenit 108 “Raportimi në rastet e mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale”, në të cilën citohet se:

1. *Mos përmbushja e detyrimeve të kontratës nga ana e kontraktorit përbën shkak për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike, sipas përcaktimeve të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 78, të LPP-së.*

Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor ka detyrimin të dërgojë në APP kërkesën për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike brenda 3 (tre) muajve nga zgjidhja e kontratës apo përfundimi i afatit të zbatimit të saj, përfshirë këtu edhe periudhën e garancisë.

2. *Paraqitja e kërkesës në APP, jashtë afatit të përcaktuar në këtë pikë, ngarkon me përgjegjësi autoritetin/entin kontraktor. Në çdo rast, APP-ja nuk pengohet në veprimet e mëtejshme për shqyrtimin e kërkesës për përjashtimin e operatorit ekonomik.*

Janë realizuar likujdimet sipas tabelës më poshtë:

Nr	Përshkrimi i mallrave	Operatori	Urdhër Prokurimi/ Shërbimi	Nr/ dt - fature	Vlera në lekë	Vlera e likuiduar	Datë Likuidimit
1	Blerje certifikat SSL	XS	nr.16696, datë 19.10.2023	204/2023 datë 28.12.2023	178,800	178,800	28.12.2023

Burimi: DPT, përpunoi KLSH

-Nga verifikimi i zbatimit të kontratës dhe urdhër shpenzimeve, rezulton se likujdimet janë kryer bazuar në dokumentacionin justifikues, procesverbal për marrjen në dorëzim të punimeve/shërbimeve si dhe fatura tatimore e lëshuar nga subjekti.

5- Materiale për pastrim II.

- Me shkresën nr.18936 prot, datë 30.11.2023, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm, nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, është bërë kërkesa për miratimin e fillimit të procedurës së prokurimit.

- Me procesverbal datë 04.12.2023, Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, ka hartuar fondin limit bazuar në testimin e tregut, sipas mesatares së 3 ofertave të paraqitura, në vlerën 499,800 lekë pa TVSH.

Me shkresën nr.19618 prot, datë 06.12.2023 ka dal urdhër prokurimi për blerje me vlerë të vogël “Blerje materiale pastrimi”.

Me shkresën nr. 19618/1 prot, datë 06.12.2023 është publikuar ftesa për ofertë.

- Në përfundim të procesit të vlerësimit është shpallur fitues OE “H 2”, Nipt-M...F, me ofertë me vlerë 257,000 lekë pa TVSH dhe 308,400 lekë me TVSH.

- Me urdhër nr.19618/2 prot, datë 11.12.2023, të titullarit, është ngritur Komisioni për marrjen në dorëzim të mallrave, i përbërë nga znj. H.K, znj. K.H dhe znj. V.J.

Marrja në dorëzim e mallrave është bërë me proces-verbalin me datë 15.12.2023, brenda afateve të parashikuara në kontratë.

Likujdimet paraqiten sipas tabelës më poshtë:

Nr	Përshkrimi I mallrave	Operatori	Urdhër Prokurimi/ Shërbimi	Nr/ dt - fature	Vlera në lekë	Likujduar
1	Blerje Materiale Pastrimi	H 2	nr.19618, datë 06.12.2023	nr.110/2023, datë 15.12.2023	308,400	20.12.2023

Burimi: DPT, përpunoi KLSH

-Nga verifikimi i zbatimit të kontratës dhe urdhër shpenzimeve, rezulton se likujdimet janë kryer bazuar në dokumentacionin justifikues, si procesverbale për marrjen në dorëzim të mallit, fletë hyrje, fatura tatimore e lëshuar nga subjekti si dhe Memo mbi likuidimin e faturës dhe zbatimin e kontratës.

6- Mirëmbajtje objekti.

- Me shkresën nr.2368 prot, datë 16.02.2023, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm, nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, është bërë kërkesa për miratimin e fillimit të procedurës së prokurimit.

- Me procesverbal datë 25.12.2023, Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, ka hartuar fondin limit bazuar në testimin e tregut, sipas mesatares së 3 ofertave të paraqitura, në vlerën 574,116 lekë pa TVSH.

Me shkresën nr.7864 prot, datë 09.05.2023 ka dal urdhër prokurimi për blerje me vlerë të vogël “Mirëmbajtje objekti”.

Me shkresën nr. 7864/1 prot, datë 09.05.2023 është publikuar ftesa për ofertë.

- Në përfundim të procesit të vlerësimit është shpallur fitues OE “A”, Nipt-K.....E, me ofertë me vlerë 540,000 lekë pa TVSH dhe 648,000 lekë me TVSH.

- Me urdhër nr.7864/4 prot, datë 14.07.2023, të titullarit, janë caktuar personat për ndjekjen e kontratës, z. E.C, z. D.J dhe z. R.D.

Marrja në dorëzim e mallrave/shërbimeve është bërë me Relacionin Përmbledhës me datë 05.01.2024,sipas afateve të parashikuara në kontratë.

Likujdimet paraqiten sipas tabelës më poshtë:

Nr	Përshkrimi I mallrave	Operatori	Urdhër Prokurimi/ Shërbimi	Nr/ dt - fature	Vlera në lekë	Likujduar
1	Mirëmbajtje objekti	A	nr.7864, datë 09.05.2023	nr.62/2023, datë 12.09.2023	648,000	28.09.2023

Burimi: DPT, përpunoi KLSH

-Nga verifikimi i zbatimit të kontratës dhe urdhër shpenzimeve, rezulton se likujdimet janë kryer bazuar në dokumentacionin justifikues, si procesverbale për marrjen në dorëzim të mallit,

fletë hyrje, fatura tatimore e lëshuar nga subjekti si dhe Memo mbi likuidimin e faturës dhe zbatimin e kontratës.

7- Sigurimi i automjeteve të DPT-së.

- Me shkresën nr.2739 prot, datë 22.02.2023, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm, nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, është bërë kërkesa për miratimin e fillimit të procedurës së prokurimit.

- Me procesverbal datë 23.02.2023, Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, ka hartuar fondin limit bazuar në testimin e tregut, sipas mesatares së 3 ofertave të paraqitura, në vlerën 324,678 lekë pa TVSH.

Me shkresën nr.2739/1 prot, datë 28.02.2023 ka dal urdhër prokurimi për blerje me vlerë të vogël “Sigurimi i automjeteve të DPT-së”.

Me shkresën nr. 2739/2 prot, datë 28.02.2023 është publikuar ftesa për ofertë.

- Në përfundim të procesit të vlerësimit është shpallur fitues OE “A”, Nipt-K.....C, me ofertë me vlerë 319,220 lekë pa TVSH dhe 383,064 lekë me TVSH.

- Me urdhër nr.3789 prot, datë 07.03.2023, të titullarit, është ngritur Komisioni për marrjen në dorëzim të mallrave, i përbërë nga znj. S.H, z. R.D dhe z. E.B.

Marrja në dorëzim e mallrave është bërë me proces-verbalin me datë 08.03.2023, brenda afateve të parashikuara në kontratë.

Likujdimet paraqiten sipas tabelës më poshtë:

<i>Nr</i>	<i>Përshkrimi i mallrave</i>	<i>Operatori</i>	<i>Urdhër Prokurimi/ Shërbimi</i>	<i>Nr/ dt - fature</i>	<i>Vlera në lekë</i>	<i>Likujuar</i>
<i>1</i>	Sigurimi i automjeteve të DPT-së	A	nr.2739/1, datë 28.02.2023	nr.29677/2023, datë 08.03.2023	319,220	12.04.2023

Burimi: DPT, përpunoi KLSH

-Nga verifikimi i zbatimit të kontratës dhe urdhër shpenzimeve, rezulton se likujdimet janë kryer bazuar në dokumentacionin justifikues, si procesverbale për marrjen në dorëzim të mallit, fletë hyrje, fatura tatimore e lëshuar nga subjekti si dhe Memo mbi likuidimin e faturës dhe zbatimin e kontratës.

8- Blerje UPS.

- Me shkresën nr.12674 prot, datë 26.07.2023, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm, nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, është bërë kërkesa për miratimin e fillimit të procedurës së prokurimit.

- Me procesverbal datë 08.08.2023, Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, ka hartuar fondin limit bazuar në testimin e tregut, sipas mesatares së 3 ofertave të paraqitura, në vlerën 523,935 lekë pa TVSH.

Me shkresën nr.16244 prot, datë 12.10.2023 ka dal urdhër prokurimi për blerje me vlerë të vogël “Blerje UPS”.

Me shkresën nr.16244/1 prot, datë 12.10.2023 është publikuar ftesa për ofertë.

- Në përfundim të procesit të vlerësimit është shpallur fitues OE “E A 2”, Nipt-K.....O, me ofertë me vlerë 245,000 lekë pa TVSH, dhe 294,000 lekë me TVSH.

- Me urdhër nr.16244/2 prot, datë 23.10.2023, të titullarit, është ngritur Komisioni për marrjen në dorëzim të mallrave, i përbërë nga z. D.J, z. R.D dhe znj. H.K.

Marrja në dorëzim e mallrave është bërë me proces-verbalin me datë 24.10.2023, brenda afateve të parashikuara në kontratë.

Likujdimet paraqiten sipas tabelës më poshtë:

Nr	Përshkrimi I mallrave	Operatori	Urdhër Prokurimi/ Shërbimi	Nr/ dt - fature	Vlera në lekë	Likujduar
1	Blerje UPS	EA 2	nr.16244, datë 12.10.2023	nr.868/2023, datë 24.10.2023	294,000	02.11.2023

Burimi: DPT, përpunoi KLSH

-Nga verifikimi i zbatimit të kontratës dhe urdhër shpenzimeve, rezulton se likujdimet janë kryer bazuar në dokumentacionin justifikues, si procesverbale për marrjen në dorëzim të mallit, fletë hyrje, fatura tatimore e lëshuar nga subjekti si dhe Memo mbi likujdimin e faturës dhe zbatimin e kontratës.

9- Mbikëqyrje rikonstruksioni DRT Elbasan.

- Me shkresën nr.15978 prot, datë 06.10.2023, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm, nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, ka dalë urdhëri për emërimin e inxhinierit z. L.S, për llogaritjen e vlerës së mbikëqyrjes dhe kolaudit të rikonstruksionit të ambienteve të DRT Elbasan dhe DRT Vlorë.

- Me procesverbal nr.1, datë 10.10.2023, inxhinieri ka përlllogaritur fondin limit bazuar në VKM nr.354, datë 11.05.2016 “Për Miratimin e Manualit të Tarifave për Shërbime në Planifikimin e Territorit”, në vlerën 843,670 lekë pa TVSH.

Me shkresën nr.16449 prot, datë 16.10.2023 ka dal urdhër prokurimi për blerje me vlerë të vogël “Mbikëqyrje rikonstruksioni DRT Elbasan”.

Me shkresën nr. 16449/1 prot, datë 16.10.2023 është publikuar ftesa për ofertë.

- Në përfundim të procesit të vlerësimit është shpallur fitues OE “M. P”, Nipt-M.....A, me ofertë me vlerë 261,538 lekë pa TVSH, dhe 313,845 lekë me TVSH.

- Nga titullari i AK me shoqërinë “M. P” është lidhur kontrata me nr.16244/2 prot, datë 31.10.2023, për mbikëqyrjen e punimeve për rikonstruksionin e DRT Elbasan.

Likujdimet paraqiten sipas tabelës më poshtë:

Nr	Përshkrimi I mallrave	Operatori	Urdhër Prokurimi/ Shërbimi	Nr/ dt - fature	Vlera në lekë	Likujduar
1	Mbikëqyrje rikonstruksioni DRT Elbasan	M. P	nr.19449, datë 16.10.2023	nr.24/2023, datë 29.12.2023	313,845	14.01.2024

Burimi: DPT, përpunoi KLSH

-Nga verifikimi i zbatimit të kontratës dhe urdhër shpenzimeve, rezulton se likujdimet janë kryer bazuar në dokumentacionin justifikues, si procesverbale për marrjen në dorëzim të mallit, fletë hyrje, fatura tatimore e lëshuar nga subjekti si dhe Memo mbi likujdimin e faturës dhe zbatimin e kontratës.

Veprimet e mësipërme bien jo në përputhje me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

1. Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin Publik”,
2. VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar,
3. Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”,
4. Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Për mangësitë dhe veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi rast pas rasti:

- 1- Z. C.K, në cilësinë e ish titullarit të AK;
- 2- Znj. B.H, me detyrë ish-Përgjegjës i Sektorit të Prokurimeve dhe në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël;

- 3- Z. A.K, me detyrë Specialist i Sektorit të Prokurimeve dhe në cilësinë e anetërit të Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël;
- 4- Z. D.H, me detyrë Specialist i Sektorit të Prokurimeve dhe në cilësinë e anetërit të Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël;
- 5- Z. G.P, në cilësinë e anetërit të KVO-së;
- 6- Znj. D.K, në cilësinë e anetërit të KVO-së;
- 7- Z. B.B, në cilësinë e anetërit të KVO-së;
- 8- Znj. A.D, në cilësinë e anetërit të KVO-së;
- 9- Z G.G, në cilësinë e anetërit të KVO-së;
- 10- Znj. I.S, në cilësinë e anetërit të Komisionit për ndjekjen dhe marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve;
- 11- Znj. A.G, në cilësinë e anetërit të Komisionit për ndjekjen dhe marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve;
- 12- Znj. H.K, në cilësinë e anetërit të Komisionit për ndjekjen dhe marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve.

Për sa është trajtuar në Projekt-Raportin Nr473./5 datë 09.08.2024 nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me Nr.13085/45 Prot dhe datë 11.09.2024, protokolluar në KLSH me Nr.473/6 Prot., datë 16.09.2024 nga znj. E.C, në cilësinë e Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: Lidhur me konstatimet e problematikave për zhvillimin e procedurave të prokurimit për vendosjen e specifikimeve teknike të paargumentuara dhe të fryra si dhe konstatimi se OE fitues për rikonstruksionin e DRT Elbasan nuk ka paraqitur certifikatat iso ju bëjmë me dije se për specifikimet teknike është marr edhe konfirmimi nga APP e cila nuk ka paraqitur vërejtje për këto specifikime, gjithashtu për certifikatat iso të cilat janë paraqitur nga OE por jo të vitit që kërkohen ato konsiderohen të barasvlershme .

Qëndrimi i grupit të auditimit: Pretendimi i ngritur nga ju nuk sjell të dhëna të reja ose ndryshe nga ato të cilat grupi i auditimit ka administruar gjatë fazës së auditimit në terren. Observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

Pretendimet e subjektit: Lidhur me konstatimin për marrjen në dorëzim të certifikatës SSL sqarojmë se marrja në dorëzim në datën 26.12.2023 është kryer sepse në këtë datë skadon afati i certifikatës ekzistuese.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Konstatimi nga grupi i auditimit se jemi në kushtet e marrjës në dorëzim me vonesë i certifikatës SSL është bërë duke ju referuar afateve të përcaktuara në procedurën e blerjes më vlerë të vogël nga njësia e prokurimit, pretendimi juaj lidhet me anën teknike por jo për zbatimin e një procedure blerje dhe afateve të përcaktuara për zbatimin e saj . Observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

2.10 Mbi auditim e menaxhimit financiar dhe kontrollin, si dhe vlerësimi i veprimtarisë së auditimit të brendshëm

Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm.

Në zbatim të pikës nr. 10, të Programit të Auditimit nr. 473/1, datë 15.04.2024, ndryshuar me shkresën nr. 473/2 prot., datë 18.07.2024, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Pyetësori i vetëvlerësimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit;

Deklarata e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm;

Raportet vjetore mbi cilësinë dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm,

Urdhri i krijimit të Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS);

Regjistri i riskut;

Dokumentimi i gjurmës së auditimit;

Manuali i proceseve të punës etj.

Referuar ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, u krye vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku u konstatua se, strukturat përgjegjëse (NA dhe NZ) të DPT, kanë dijeni mbi kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit.

* Për periudhën objekt auditimi, institucioni në bazë të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka hartuar projektbuxhetin e vitit 2023 - 2025. Me shkresën nr. 14580 prot, datë 26.08.2022, është dërguar në MFE, një kopje e projektbuxhetit.

* Me shkresën nr. 19961/6 prot., datë 16.02.2024, të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT i është dërguar Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Financave, brenda afatit të caktuar, “Deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe raportin për funksionimin e kontrollit të brendshëm” në DPT, i cili është përmbledhje e raportit vjetor të aktivitetit dhe performancës së Drejtorisë së Auditit të Brendshëm.

* Në zbatim të nenit 18, të ligjit të MFK, me shkresën nr. 3410 prot., datë 20.02.2024, është dërguar në Ministrinë e Financave “Pyetësori i vetëvlerësimit për komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin 2023”;

* Me shkresën nr. 3412, datë 21.02.2024, është dërguar Regjistri i riskut për vitin 2023, si dhe Plani operacional për vitin 2024;

* Me urdhrin nr. 11, nr. prot., 730, datë 18.01.2023, titullari i DPT ka urdhëruar krijimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS), i kryesuar nga Drejtori i Përgjithshëm dhe në cilësinë e anëtarëve, janë caktuar zv. Drejtorët e Përgjithshëm dhe Drejtorët e Drejtorive në DPT.

Referuar nenit 19, të ligjit nr. 10 296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, titullarët e njërive publike zbatojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet 5 komponentëve të ndërlidhur me njëri-tjetrin.

1. Mjedisi i Kontrollit.

Menaxhimi ka rolin kryesor në miratimin dhe mbështetjen e mjedisit të kontrollit. Faktorët e mjedisit të kontrollit përfshijnë:

a) Integritetin dhe vlerat etike profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të institucionit.

Nga auditimi u konstatua se, institucioni disponon Kodin Etik të Brendshëm për Administratën Tatimore, e miratuar me Vendimin nr. 22, datë 17.12.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT, në cilësinë e Kryetarit të Komitetit të Reformave, sipas përcaktimeve të nenit 20, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, si dhe të Manualit të MFK. Me urdhrin nr. 4, datë 21.01.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm është miratuar rregullorja “Për parandalimin e konfliktit të interesave në DPT”.

b) Stili i të vepruarit dhe politikat menaxheriale.

Punësimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve kryhet në zbatim të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar. Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe me akte të tjera ligjore e nënligjore për nëpunësit e shërbimit civil dhe ata jashtë shërbimit civil në ATQ. Nga auditimi u konstatua se, kjo procedurë rregullohet nga:

* Sektori i Rekrutimit dhe i Promovimit në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore (DBNJ) në DPT, i cili është përgjegjës për zbatimin e procedurave të menaxhimit sipas nenit 10, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe kreu II, i VKM nr. 243, datë 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar;

* Komiteti i Pranimit në DAP, sipas përcaktimeve të VKM nr. 243, datë 18.03.2015, i ndryshuar;

* Titullari i institucionit, në zbatim të nenit 20, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

* Me shkresën nr. 21953 prot., datë 30.12.2022, Drejtoria e Burimeve Njerëzore në DPT, ka dërguar në Departamentin e Administratës Publike, “Planifikimin e nevojave për pranimin në shërbimin civil për vitin 2023”, të miratuar nga titullari i institucionit.

c) Struktura organizative duhet përfshijë rregullat e qarta në ndarjen e të drejtave, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

DPT funksionon me strukturën që bazohet në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Për periudhën 01 janar – 25 maj 2023, DPT ka funksionuar me strukturën e miratuar me urdhrin nr. 33, datë 12.02.2020, të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qëndrore”, i ndryshuar; ndërsa në periudhën 26 maj 2023 – 31 dhjetor 2023, struktura organizative ka funksionuar në zbatim të urdhrin nr. 69, datë 26.05.2023, të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qëndrore”, si dhe me urdhrin nr. 189, datë 08.08.2023 “Për miratimin e organigramës së Administratës Tatimore Qëndrore” të Ministrit të Financave. Nga auditimi u konstatua se struktura e re organizative në kuadër të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoritetit publik, nuk është publikuar në faqen zyrtare të institucionit nga personat përgjegjës, duke mos i garantuar e njohur publikut informacionin, veprim në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Sektori i Rekrutimit dhe Promovimit në DBNJ ka dhënë informacion për pozicionet vakante në muajin janar dhe dhjetor 2023 në DPT, të paraqitur në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 1 Vakancat në janar dhe dhjetor 2023 në DPT

DPT	Struktura me urdhrin nr. 33, dt. 12.02.2020	Nr. fakt janar 2023	Nr. i vakancave janar 2023	Nr. fakt dhjetor 2023	Nr. i vakancave dhjetor 2023
Nëpunës civil	194	155	39	153	41
Kod pune	114	104	10	100	14
Totali	308	259	49	253	55

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore në DPT, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

Nga auditimi u konstatua se numri i vakancave në dhjetor 2023 nuk paraqitet i saktë, me 55 punonjës, pasi gjatë vitit si dhe pas miratimit të strukturës me urdhrin nr. 69, datë 26.05.2023, të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qëndrore” me 327 punonjës në total, institucioni ka pasur më shumë emërimë në punonjës sesa largime, veprim ky në kundërshtim me urdhrin nr. 69, datë 26.05.2023 të Kryeministrit. Si dhe me pikën nr. 8, neni 73 “Përgjegjësitë dhe detyrat e përgjegjësit të Sektorit të Rekrutimit dhe Promovimit”, pikës nr. 14, neni 74 “Përgjegjësitë dhe detyrat e specialistit të Sektorit të Rekrutimit dhe Promovimit”, të Rregullores së funksionimit të ATQ, miratuar me urdhrin nr. 193, datë 12.08.2020 të Ministrit të Financave.

Nga auditimi u konstatua se edhe pas miratimit të strukturës së re, DPT ka vazhduar për 1 vit të funksionojë me Rregulloren së funksionimit të ATQ, të miratuar me urdhrin nr. 193, datë 12.08.2020 të Ministrit të Financave. Me shkresën nr. 10970 prot., datë 14.06.2024, të Drejtorit të Përgjithshëm, janë përcjellë në Ministrinë e Financave për miratim, Draft Rregulloret e Administratës Tatimore Qëndrore.

* Me urdhrin nr. 10, datë 31.01.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm është miratuar Rregullorja “Për marrëdhënien e punës të personelit jo nëpunës civilë, në ATQ”.

* Sipas përcaktimeve të pikës nr. 23, neni 4, i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Drejtori i Përgjithshëm është Nëpunësi Autorizues (NA) i institucionit, si dhe në bazë të pikës nr. 1, neni 10, i po këtij ligji, është edhe Koordinator i riskut. Detyrën e Nëpunësit Zbatues (NZ), e ka kryer Drejtori i Financës dhe Buxhetit, emëruar në këtë pozicion me vendimin nr. 208, datë 06.02.2017. Nga auditimi u konstatua se, përcaktimi i NA dhe NZ është bërë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

ç) Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Politikat e menaxhimit të burimeve njerëzore në këtë institucion, janë të rregulluara me ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe aktet në zbatim të tij. Si dhe me Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë. Në Kodin e Etikës së institucionit janë të përcaktuara orari dhe koha e punës, etika në komunikim, shkeljet disiplinore, etj.

Për sa i përket vlerësimeve mbi performancën e punonjësve të institucionit, nga auditimi u konstatua se për vitin 2023, ishin kryer vlerësimet 6 mujore për nëpunësit civil dhe punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kodin e Punës, sipas përcaktimeve të Vendimit nr. 252, datë 30.3.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 109, datë 26.02.2014 “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”.

d) Aftësitë profesionale të punonjësve.

Nga auditimi u konstatua se në Programin vjetor të trajnimit të Administratës Tatimore Qëndrore për vitin 2023, miratuar me shkresën nr. 112 prot., datë 05.01.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm nuk ishin planifikuar trajnime të punonjësve për njohje të ligjit “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, veprim në kundërshtim me pikën nr. 3.1, të kapitullit III, “Komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit”, të Manualit të MFK, i ndryshuar, miratuar me urdhrin nr. 108, datë 17.11.2016, të Ministrisë të Financave. Mungesa e bazës rregullatore ka ardhur si pasojë e mosnjohjes së punonjësve në përgjithësi dhe e menaxherëve në veçanti, me këtë ligj.

Me urdhrin nr. 11, datë 27.02.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm të Qendrës së Trajnimit të Administratës Tatimore e Doganore (QTATD), është miratuar programi i trajnimeve për administratën tatimore, për vitin 2023.

dh) Delegimi i detyrave

Nga auditimi u konstatua se gjatë vitit 2023, NZ nuk ka deleguar asnjë nga funksionet e tij. Ndërsa NA me urdhrin nr. 56, nr. 5246 prot., datë 21.03.2023, ka urdhëruar delegimin e të drejtës së firmës, znj. D.C me detyrë zv. Drejtori i Përgjithshëm të Mbështetjes së Programeve. Me urdhrin nr. 119, nr.11562 prot., datë 05.07.2023, janë urdhëruar shtesa të delegimit të drejtës së firmës për znj. D.C.

Me shkresën nr.184, nr. 16852 prot., datë 24.10.2023, NA ka urdhëruar delegimin e të drejtës së firmës, z. I.D me detyrë Inspektor në Drejtorinë e Hetimit Tatimor, për shkresat që përmbajnë informacion të klasifikuar “sekret shtetëror”, siç përcaktohet në nenin 15 “Rregulla të përgjithshme për delegimin e detyrave”, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, si dhe në Manualin për MFK.

2. Menaxhimi i Riskut

Nga auditimi u konstatua se, titullari i institucionit i cili është njëkohësisht koordinator i riskut, nuk ka urdhëruar ngritjen e Grupit të Menaxhimit të Riskut (GMR), si dhe nuk janë kryer takime me stafin menaxherial me qëllim diskutimin e problematikave dhe çështjeve të menaxhimit të riskut në institucion, si dhe marrjen e masave të mëtejshme, veprim në kundërshtim me gjurmën b, pika nr. 8, neni 8 “Përgjegjëshmëria menaxheriale e titullarit”, e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar.

Nëpunësi zbatues i institucionit, ka krijuar Regjistrin e riskut, pas mbledhjes së Regjistrave nga drejtoritë e DPT dhe të Drejtorive Rajonale Tatimore, si dhe me shkresën nr. 3412 prot, datë 21.02.2024, të Drejtorit të Përgjithshëm, është miratuar dhe dërguar në Drejtorinë e Buxhetit

dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Financave, në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, si dhe pikës nr. 3.2, “Menaxhimi i Riskut” në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.

* Me urdhrin nr. 11, nr. prot., 730, datë 18.01.2023, titullari i DPT ka urdhëruar krijimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS). Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, u konstatua se GMS është mbledhur në 4 takime gjatë vitit 2023, ku objekt të takimeve kanë qenë kërkesat buxhetore të drejtorive të DPT dhe të Drejtorive Rajonale Tatimore.

3. Aktiviteti i Kontrollit.

Aktivitetet e kontrollit janë rregulla, procedura dhe veprime që kanë si qëllim reduktimin e risqeve me synim arritjen e objektivave.

a) Ndarja e detyrave

Në DPT, përgjegjësitë kryesore të punës janë të shkruara në Rregulloren e funksionimit të institucionit, ku në bazë të strukturës së miratuar ekziston dhe ndarja e detyrave. Nga auditimi u konstatua se në përshkrimet për çdo pozicion pune, ishin përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë kryesore, vartësia funksionale dhe administrative, si dhe linja e raportimit. Në formularët e përshkrimit të punës të cilët ju vunë në dispozicion grupit të auditimit, u konstatua se ato nuk kishin nënshkrimin e nëpunësit civil, veprim i cili sjell mosnjohjen e tij me punën që duhet të kryejë, si dhe në kundërshtim me nenin 19 e 20, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Me kapitullin IV “Procedura dhe formati i përshkrimit të punës” i VKM nr. 142, datë 12.3.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar.

b) Sistemi i dy firmave.

Nga auditimi u konstatua se, praktikat që hartohen nga specialistët në institucion, pranohen nga përgjegjësit e sektorëve, konfirmohen nga drejtorët e drejtorive, si dhe më pas paraqiten te NA për miratim, duke respektuar hierarkinë dhe sistemin me të paktën dy firma. Në lidhje me kryerjen e transaksioneve financiare, kryerja e pagesave është autorizuar pas firmosjes së NZ dhe NA.

c) Procedura e sinjalizimit

Me shkresën nr. 25669/1 prot., datë 23.11.2017, të titullarit të institucionit është miratuar Rregullorja e brendshme e DPT, “Për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidentalitetit”, në zbatim të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

ç) Sistemet e TI-së

Në zbatim të Manualit të MFK, sistemet e TI- së kërkojnë lloje specifike të kontrollit, që duhet të miratohen nga titullarët e njëjësive. Nga auditimi u konstatua se DPT dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) kanë nënshkruar “Marrëveshjen e nivelit të shërbimit (SLA)” me shkresën nr. 7160 prot., datë 05.04.2019 dhe shkresën 1745/1 prot., datë 08.04.2019.

d) Harta e proceseve të punës

Përgatitja e një harte me proceset e punës garanton uniformitetin në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave duhet të kryhen ato. Nga auditimi u konstatua se institucioni nuk disponon Hartën e proceseve të punës, krijimi i të cilës do të paraqiste një tablo të përgjithshme të mënyrës se si institucioni i arrin objektivat e veta të punës, veprim në kundërshtim me Kapitullin III, i Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, i ndryshuar, miratuar me Urdhrin nr. 108, datë 17.11.2016, të Ministrisë të Financave.

dh) Manuali i proceseve të punës

Nga auditimi u konstatua se titullari i institucionit nuk ka miratuar “Manualin e proceseve të punës”, qëllimi i të cilit është të përcaktojë në detaje, rolin dhe detyrat brenda institucionit,

dokumenti nxjerr në pah atë që duhet bërë dhe nga kush duhet realizuar, ndihmon institucionin të jetë i sigurt se nuk ka asnjë aktivitet pa person përgjegjës dhe që të gjithë punonjësit kanë përgjegjësitë përkatëse dhe të drejtën për të nënshkruar dokumente. Veprim ky në kundërshtim me Kapitullin III, i Manualit të MFK, i ndryshuar.

e) Gjurma e auditimit

Gjurma e auditimit është një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e ecurisë së një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen e ecurisë së këtij procesi përgjatë strukturave të njësisë, apo ndërmjet vetë njësisë dhe institucioneve të jashtme. Nga auditimi u konstatua se, titullari i institucionit nuk ka miratuar Gjurmën e Auditimit të detajuar për procedurat kryesore, si dhe nuk rezultoi arkivimi i saj, veprim në kundërshtim me pikën nr. 2, të nenit 16 “Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit” të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.

f) Arkivimi i dokumentacioneve

Nga auditimi u konstatua se, në DPT protokollimi, arkivimi dhe ruajtja e informacionit, kryhet nga zyra e protokollit në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse, në zbatim të kërkesave të parashikuara në “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

4. Informimi dhe Komunikimi.

Mjetet e komunikimit për DPT dhe njësitë në varësi të saj, janë forma shkresore dhe email-i zyrtar. Në aspektin organizativ dhe funksional, çdo drejtori raporton te Drejtori i Përgjithshëm nëpërmjet mbledhjeve, relacioneve dhe raporteve të ndryshme. Komunikimi dhe shkëmbimi elektronik i dokumenteve zyrtare, brenda institucionit realizohet duke përdorur postën elektronike (e-mail) dhe dërgesa në institucionet e tjera bëhet në formë shkresore zyrtare, me shërbim postar. NZ, informon me anë të informacioneve periodike, me anë të situacioneve buxhetore mujore dhe vjetore të krahasuara me planin, si dhe me anë të raporteve të monitorimit çdo 3-mujaj. DPT veprimtarinë e saj e publikon në faqen zyrtare të internetit, si dhe për denoncime ka vënë në dispozicion numrin e gjelbër të telefonit 08001414.

5. Monitorimi.

Monitorimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit realizohet kryesisht përmes monitorimit në vijueshmëri, vetëvlerësimit dhe auditimit të brendshëm, nëpërmjet organizimit të grupeve të punës ose komisioneve përkatëse. Nga auditimi u konstatua se DPT ka përcjellë në Ministrinë e Financave, Raportet periodike të monitorimit të buxhetit 4, 8 dhe 12 mujore, por nuk janë zbatuar kërkesat e paragrafit 271, Kreu VI, “Raportet e monitorimit”, të udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, për publikimin e tyre në faqen zyrtare të saj.

Funksionimi i kontrollit të brendshëm në DPT për vitin 2023, nuk ka qenë i mirë organizuar dhe plotësisht funksional, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi i cili ka sjellë mos përmbushje të objektivave në mënyrë jo të plotë për komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:

z. C.K me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Tatimeve dhe Nëpunësi Autorizues i institucionit; znj. D.C me detyrë zv. Drejtor i Përgjithshëm i Mbështetjes së Programeve.

Për sa është trajtuar në ProjektRaportin nr. 473/5 prot., datë 09.08.2024, nga subjekti i audituar Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve, janë paraqitur observacionet si më poshtë:

- Titullari i institucionit i cili është njëkohësisht koordinator i riskut, nuk ka urdhëruar ngritjen e Grupit të Menaxhimit të Riskut (GMR), si dhe nuk janë kryer takime me stafin menaxherial mbi diskutimin e problematikave dhe çështjeve të menaxhimit të riskut në institucion. Lidhur me këtë konstatim sqaroj se: Me urdhrin nr. 11, datë 18.01.2023, “Për krijimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik” (GMS) të Drejtorit të Përgjithshëm është ngritur grupi i punës për Menaxhimin Strategjik, i cili ka si detyrë

sigurimin e një kontrolli të brendshëm efektiv si dhe evidentimin e risqeve në zbatim të ligjit 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar.

Grupi i punës (GMS) zhvillon takime të vazhdueshme me Drejtorinë në DPT si dhe DRT me qëllim diskutimin e problematikave, evidentimin e risqeve si dhe marrjen e masave për minimizimin e tyre.

Nëpërmjet shkresës nr. 3786, datë 07.03.2023, pas njohjes së Regjistrit të Riskut të plotësuar nga Drejtorinë e DPT dhe DRT, është kryer raportimi mbi ecurinë e regjistrit të riskut pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

- Titullari i institucionit nuk ka miratuar: Gjurmën e Auditimit të detajuar për procedurat kryesore të punës, Hartën e proceseve të punës, si dhe manualin e proceseve të punës. Lidhur me këtë konstatim sqarohet se: Në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, janë miratuar manualët e punës për çdo drejtori operacionale, të cilat janë të publikuara dhe lirisht të aksesueshme për të gjithë stafin e administratës tatimore.

Për të gjitha strukturat e administratës, për çdo pozicion pune, janë miratuar përshkrimet e punës. Gjithashtu detyrat funksionale për nëpunësit janë të përcaktuara edhe në rregulloren e brendshme të funksionimit të administratës tatimore qëndrore.

Me strukturën e re organizative në vitin 2023, pranë Drejtorisë për Proceset e Biznesit, është krijuar edhe Sektori i Koordinimit të/manualeve të punës, i cili është duke koordinuar procesin e hartimit të manualeve të reja të punës si dhe rishikimit të manualeve ekzistuese sipas nevojave.

- Nga grupi i auditimit të KLSH, pretendohen veprime apo mosveprime për të cilat është vlerësuar përgjegjës Drejtori i Drejtorisë Teknike e Ligjore, të lidhura me faktin se struktura organizative e administratës tatimore nuk është publikuar në faqen zyrtare të institucionit në kundërshtim me ligjin “Për të drejtat e informimit”. Në Rregulloren e funksionimit të ATQ, neni 34 i saj, parashikohet shprehimisht se struktura përgjegjëse për përditësimin e website të DPT është Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve e cila përditëson përmbajtjen e Website të DPT duke mbledhur ato nga të gjitha njësitë e tjera të DPT.

Struktura që ka ndjekur procesin e implementimit të strukturës së re organizative dhe që ka disponuar tërësinë e dokumentacionit që lidhet me strukturën organizative, përfshirë edhe dokumentacionin e detyrueshëm për tu publikuar, është Drejtoria e Burimeve Njerëzore.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me objeksionet e bëra nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve mbi auditimin “Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, sqarohet se janë të njëjta me ato të paraqitura pas lënies së Aktkonstatimeve nga Grupi i Auditimit, (të trajtuara hollësisht në pjesën takuese në ProjektRaport). Nga subjekti nuk janë paraqitur argumente apo dokumente shtesë.

- Është përgjegjësi e titullarit të institucionit, krijimi i Grupit të Menaxhimit të Riskut (GMR), si dhe zhvillimi i takime me stafin menaxherial, sipas përcaktimeve në gërmën “b”, pika nr. 8, neni 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar. Për sa më sipër, objeksioni juaj nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

- Gjurma e auditimit është një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e ecurisë së një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen e ecurisë së këtij procesi përgjatë strukturave të njësisë, apo ndërmjet vetë njësisë dhe institucioneve të jashtme. Harta e proceseve të punës, do të paraqiste një tablo të përgjithshme të mënyrës se si institucioni i arrin objektivat e veta të punës, si dhe hartimi dhe miratimi i Manualit të proceseve të punës, ka qëllim të përcaktojë në detaje, rolin dhe detyrat brenda institucionit, dokumenti nxjerr në pah atë që duhet bërë dhe nga kush duhet realizuar. Për sa më sipër, objeksioni juaj nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Mbi vlerësimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm.

Në zbatim të pikës nr. 10, të Programit të Auditimit nr. 473/1, datë 15.04.2024 ndryshuar me shkresën nr. 473/2 prot., datë 18.07.2024, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Struktura e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm (DAB) dhe veprimtaria e saj;
- Plani Vjetor i Auditimit 2023 dhe Plani Strategjik 2023-2025;

- Raporti Vjetor i DAB për vitin 2023;
- Zbatimi i rekomandimeve nga DAB;
- Inventarizimi i dosjeve auditimi.

Misioni i auditit të brendshëm, referuar nenit 5, të kreut II, të ligjit nr. 114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, është të japë siguri të arsyeshme për titullarin e njësisë së sektorit publik, në mënyrë të pavarur dhe objektive, si dhe këshilla për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë e sektorit publik. Në zbatim të nenit 8, të këtij ligji, veprimtaria e Auditimit të Brendshëm duhet të kryhet në përputhje me:

- Standardet Ndërkombëtare të auditimit të brendshëm të njohura dhe të zbatuara në Republikën e Shqipërisë dhe të miratuara nga Ministri i Financave;
- Këtë ligj dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij;
- Kartën e Auditimit, Kodin e Etikës, Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar nga Ministri i Financave, si dhe akte të tjera për kryerjen e shërbimit të auditimit, pra zbatimi i standardeve është detyrim ligjor.

Mbi strukturën dhe kapacitetet audituese të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm (DAB).

Nga auditimi rezultoi se, njësia e Auditimit të Brendshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, është ngritur dhe funksionon në nivel Drejtorie, në zbatim të ligjit nr. 114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, si dhe përcaktimeve të standardit 1100 “Pavarësia dhe objektiviteti”, në Manualin e Auditimit të Brendshëm. DAB në aspektin organizativ dhe funksional përgjigjet përpara titullarit të institucionit. Për vitin 2023, kjo Drejtori e ka realizuar veprimtarinë e auditimit të brendshëm në:

- 15 Drejtori në DPT;
- 14 Drejtori Rajonale Tatimore;
- 6 Drejtori sipas Rajoneve.

Për periudhën 01 janar – 25 maj 2023, Drejtorja e Auditimit të Brendshëm është miratuar dhe ka funksionuar në zbatim të urdhrin nr. 33, datë 12.02.2020, të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qëndrore”, i ndryshuar; ku struktura organizative ishte e përcaktuar në 1 drejtori me 2 sektorë:

1. Sektori i Auditimit të Këshillimit, Sigurimit të Cilësisë, Planifikimit dhe Raportimit (përgjegjës sektori 1 + inspektorë/auditues 2);

2. Sektori i Auditimit Financiar dhe të Ardhurave (përgjegjës sektori 1 + inspektorë/auditues 4).

Për periudhën 26 maj 2023 – 31 dhjetor 2023, struktura organizative e DAB ka funksionuar në zbatim të urdhrin nr. 69, datë 26.05.2023, të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qëndrore”, si dhe me urdhrin nr. 189, datë 08.08.2023 “Për miratimin e organigramës së Administratës Tatimore Qëndrore” të Ministrit të Financave dhe të Ekonomisë, ku u evidentua se nuk ka pasur ndryshime në strukturë, por vetëm në emërtimin e një sektori, Sektori i Auditimit Financiar dhe të Ardhurave është ndryshuar në, Sektori i Auditimit dhe Përputhshmërisë Ligjore.

1. Sektori i Auditimit të Këshillimit, Sigurimit të Cilësisë, Planifikimit dhe Raportimit (përgjegjës sektori 1 + inspektorë/auditues 2);

2. Sektori i Auditimit dhe Përputhshmërisë Ligjore (përgjegjës sektori 1 + inspektorë/auditues 4).

Sipas organigramës së vënë në dispozicion nga Drejtorja e Burimeve Njerëzore, struktura e DAB në muajin Janar dhe Dhjetor 2023, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 1 Struktura e DAB në Janar dhe Dhjetor 2023

Emërtimi	Pozicione sipas strukturës Urdhri KM nr. 33, dt. 12.02.2020	Janar 2023	Pozicione sipas strukturës Urdhri KM nr. 69, dt. 26.05.2023	Dhjetor 2023
DAB	9	6	9	7
Drejtor Drejtorie	1	1	1	Vakant
<i>Spektori i Auditimit Financiar dhe të Ardhurave më pas/Spektori i Auditimit dhe Përputhshmërisë Ligjore</i>	5	5	5	5
Përgjegjës Spektori	1	1	1	1
Inspektor	1	1	1	1
Inspektor	1	1	1	1
Inspektor	1	1	1	1
Inspektor	1	1	1	1
<i>Spektori i Auditimit të Këshillimit, Sigurimit të Cilësisë, Planifikimit dhe Raportimit</i>	3	0	3	2
Përgjegjës Spektori	1	Vakant	1	1
Inspektor	1	Vakant	1	1
Inspektor	1	Vakant	1	Vakant

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore në DPT, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

Nga auditimi u konstatua se në fillim të vitit 2023, DAB ka funksionuar me 66.7% të kapacitetit të strukturës së saj dhe në fund të vitit me 78% të kapacitetit, me vakancë në pozicionin e drejtorit të Drejtorisë dhe një pozicion inspektori. Veprim jo në përputhje me strukturën organike të miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 69, datë 26.05.2023, “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qëndrore”, duke sjellë mungesë performance të kësaj drejtorie.

Nga auditimi i dosjeve personale u konstatua se punonjësit i përshtateshin kërkesave të arsimimit për pozicionin e punës, ku 6 prej tyre rezultojnë me arsim bazë, ekonomik dhe 1 jurist. Si dhe kishin kryer trajnimet e vijueshme profesionale për vitin 2023, duke marrë pjesë në trajnimet e organizuara nga Njësia Qendrore e Auditimit të Brendshëm (NJQAB) në Ministrinë e Financave.

Përsa i përket eksperiencës dhe vjetërsisë në strukturat e auditimit ndarja rezultoi si më poshtë:

- Vjetërsi pune deri në 3 vite: 1 punonjës
- Vjetërsi pune mbi 3 vite: 5 punonjës

Si dhe pa vjetërsi pune si auditues i brendshëm, rezultoi 1 punonjës z. V.R, i cili me shkresën nr. 6506/1 prot., datë 19.04.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT, pas vendimit të emërimit nr. 2302 prot., datë 12.04.2023 të DAP-it, është emëruar përgjegjës në Spektorin e Auditimit të Këshillimit, Sigurimit të Cilësisë, Planifikimit dhe Raportimit të DAB.

Me urdhrin nr. 76, datë 19.04.2023, nr. 6795 prot., “Për caktimin e një nëpunësi për ushtrimin e funksioneve”, Drejtori i Përgjithshëm ka urdhëruar z. V.R, i emëruar përgjegjës në Spektorin e Auditimit të Këshillimit, Sigurimit të Cilësisë, Planifikimit dhe Raportimit, (detyrë e marrë në të njëjtën datë), të ushtrojë edhe detyrat funksionale të drejtorit të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm.

Nga auditimi u konstatua se, nëpunësi V.R ka ushtruar funksionin e drejtorit të DAB, si i ngarkuar në këtë detyrë për një periudhë 6 mujore. Me urdhrin e titullarit nr. 53, nr. 1699 prot., datë 26.01.2024 “Për përfundimin e periudhës së zëvendësimit për shkak të ligjit”, i është komunikuar përfundimi i detyrës.

Në përputhshmëri me përcaktimet e gërmës ç, pika nr. 2, neni 11 “Punësimi i audituesit të brendshëm”, të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar i cili citon se: “punonjësi, që nuk zotëron certifikatën si “Auditues i brendshëm”, por ka përvojë pune 3 vjet në profesion, punësohet në njësinë e auditimit të brendshëm dhe gjatë 2 viteve të para punon nën mbikëqyrjen e eprorit të drejtpërdrejtë. Brenda kësaj periudhe

ky punonjës duhet t'i nënshtrohet detyrimisht procedurës së certifikimit si “Auditues i brendshëm”. Në rast se brenda këtij afati punonjësi nuk certifikohet si “Auditues i brendshëm”, punonjësit i ndërpriten marrëdhëniet e punës në njësinë e auditimit të brendshëm, të cilat konsiderohen se janë ndërprerë për shkak të këtij ligji”, grupi i auditimit shqyrtoi dokumentacionin në dosjet personale, ku konstatoi se 6 punonjës të kësaj Drejtorie ishin të certifikuar si “Auditues të Brendshëm në Sektorin Publik”, ndërsa z. V.R i emëruar në pozicionin përgjegjës në Sektorin e Auditimit të Këshillimit, Sigurimit të Cilësisë, Planifikimit dhe Raportimit dhe i ngarkuar të kryejë edhe detyrën e Drejtorit të Drejtorisë, nuk rezultoi të ishte i certifikuar si “Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik”. Me shkresën nr. 6506/2 prot., datë 25.04.2023, Drejtoria e Burimeve Njerëzore në DPT ka dërguar “Kërkesën për regjistrimin e tij si kandidat për certifikim si auditues i brendshëm”, në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE. Nga auditimi u konstatua se z. R nuk ka ndjekur trajnimin për certifikim si auditues i brendshëm.

Për sa më sipër konstatohet se ngarkimi në detyrë dhe kryerja e funksionit të Drejtorit të Drejtorisë së Auditit të Brendshëm për 6 muaj, me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT nga z. V.R, i cili nuk ka pasur kualifikimin dhe kompetencat e duhura, është bërë në kundërshtim me gërmën b, pika nr. 2, neni 11 “Punësimi i audituesit të brendshëm”, të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar.

Në formularët e përshkrimit të punës të cilët ju vunë në dispozicion grupit të auditimit, u konstatua se ato nuk kishin nënshkrimin e nëpunësit civil, veprim i cili sjell mosnjohjen e nëpunësit me punën që duhet të kryejë, si dhe në kundërshtim me nenin 19 e 20, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Me kapitullin IV “Procedura dhe formati i përshkrimit të punës” i VKM nr. 142, datë 12.3.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar.

Karta e Auditimit.

Karta e Auditit është një akt administrativ që miratohet me urdhër të titullarit të institucionit, ku përcaktohen statusi organizativ, qëllimi e misioni, objektivat e përgjegjësitë e DAB. Nga auditimi u konstatua se pas ndryshimit të emërimit të një sektori të kësaj Drejtorie, nuk është përditësuar ky akt, si dhe nuk është përcjellë nga drejtori i DAB për miratim tek titullari i institucionit. Veprime këto në kundërshtim me gërmën c, neni 12 “Përgjegjësitë e titullarëve të njësisve publike”, si dhe gërma b, neni 14 “Përgjegjësitë e drejtuesit të njësisë së auditimit të brendshëm”, të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar.

Planifikimi dhe miratimi i Planit Vjetor 2023, si dhe Planit Strategjik 2023-2025.

Me shkresën nr. 17887 prot., datë 19.10.2022, Drejtori i Përgjithshëm i DPT ka marrë Vendimin “Për miratimin e planit strategjik të auditimit për vitet 2023-2025 dhe vjetor të vitit 2023”. Zgjedhja për auditimet e vitit 2023, është kryer në bazë të përcaktimit të sistemeve prioritare dhe në bazë të vlerësimit të riskut. Në planin vjetor janë planifikuar 9 auditime:

- 7 auditime të kombinuara;
- 1 auditim përputhshmërie;
- 1 auditim mbi zbatimin e rekomandimeve.

Tabela nr. 2 Planit Vjetor i Auditimeve për vitin 2023

Planifikuar			Statusi në fund të vitit 2023
Nr.	Subjekti	Lloji i auditimit	
1	Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë	Auditim i kombinuar	Në proces
2	Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë	Auditim i kombinuar	Përfunduar
3	Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër	Auditim i kombinuar	Pa audituar
4	Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë	Auditim i kombinuar	Përfunduar
5	Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë	Auditim i kombinuar	Përfunduar

6	Drejtoria Rajonale Tatimore Kukës	Auditim i kombinuar	Përfunduar
7	Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër	Auditim i kombinuar	Përfunduar
8	Drejtoria Verifikimit Koordinimit në Terren RV	Auditim përputhshmërie	Në proces
9	Zbatimi i rekomandimeve	Auditim përputhshmërie	Përfunduar
Total		9	

Burimi: Drejtoria e Auditit të Brendshëm në DPT, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

Me shkresën nr. 17887/1 prot., datë 19.10.2022, DPT ka përcjellë në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE, “Planin strategjik të auditimit për vitet 2023-2025 dhe vjetor të vitit 2023”. Nga auditimi u konstatua se, Komiteti i Auditimit të Brendshëm nuk ka dërguar në DPT, Vendimin me mendimin dhe rekomandimin pozitiv ose jo, për Planin vjetor 2023 dhe Planin strategjik 2023-2025, për shkak të mosfunksionimit të tij, pas përfundimit të mandatit të anëtarëve në muajin Qershor 2021. Veprimi i cili ka sjellë moskryerjen e kompetencave të Komitetit, të përcaktuara në nenin 13 “Komiteti i Auditimit të Brendshëm”, të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar. Me shkresën nr. 2606/1 prot., datë 15.02.2024, është dërguar brenda afatit, në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Financave,”Raporti i veprimtarisë së Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2023”, së bashku me Pyetësin e vetëvlerësimit, në të cilin nga 40 pyetje në total, 8 kanë vlerësim “përputhshmëri e pjesshme” dhe 32 të tjerat “përputhshmëri e plotë”, pra përputhshmëria e pjesshme rezulton 20% dhe ajo e plotë 80%.

Identifikimi i sistemeve dhe fushat me risk për auditim.

Në fazën e planifikimit vjetor 2023, DAB është mbështetur në auditimin e sistemeve dhe drejtorive që kanë një risk më të lartë, si dhe ka vlerësuar sipas fushave për auditim:

- 29 drejtori me risk të lartë;
- 6 drejtori me risk të mesëm.

Vlerësimi i fushave me risk paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 3 Vlerësimi i fushave me risk, viti 2023

Identifikimi i risqeve	Risk
Sistemi i kontrollit tatimor, sistemi i verifikimeve në terren, sistemi i mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara, sistemi i funksionimit të hetimit tatimor, sistemi i rimbursimit të TVSH, sistemi i implementimit të proceseve të biznesit.	I lartë
Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore, sistemi i menaxhimit të projekteve, sistemi i shërbimit të tatimpaguesve.	I mesëm

Burimi: Drejtoria e Auditit të Brendshëm në DPT, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

Realizimi i planit vjetor të auditimit nga ana sasiore dhe analiza sipas llojeve dhe zbulimeve.

Në planin vjetor të auditimeve për vitin 2023, nga 35 subjekte ku ushtron veprimtarinë e saj audituese, DAB ka planifikuar gjithsej 9 misione auditimi të kombinuara (2 në auditime përputhshmërie dhe 7 të kombinuara).

Me urdhrin nr. 155, nr. prot., 18896 datë 07.11.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT, është urdhëruar të kryhet auditim përputhshmërie “Vlerësimi i pavarur i funksionimit të Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara”, në Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në DPT, në Rajonin Qendror dhe në Rajonin Jugor.

Me urdhrin nr. 141, nr. prot., 12881 datë 01.08.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm është urdhëruar të kryhet auditim përputhshmërie “Vlerësimi i pavarur mbi funksionimin e Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara” në Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Rajonin Verior, të paraqitura në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 4 Auditime me urdhër të titullarit

Auditime me urdhër të titullarit			Statusi në fund të vitit 2023
Nr	Subjekti	Lloji i auditimit	
1	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguar në DPT.	Përputhshmëri	<i>Përfunduar</i>
2	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguar Rajoni Qendror.	Përputhshmëri	<i>Përfunduar</i>
3	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguar Rajoni Jugor.	Përputhshmëri	<i>Përfunduar</i>
4	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguar Rajoni Verior.	Përputhshmëri	<i>Në proces</i>
Total		4	

Burimi: Drejtoria e Auditit të Brendshëm në DPT, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

Përmbledhja e misioneve të DAB përgjatë vitit 2023, paraqitet si më poshtë:

Auditime të përfunduara, të mbartura nga viti 2022:

- ✓ Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguar në DPT;
- ✓ Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguar në Rajonin Qendror;
- ✓ Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguar në Rajonin Jugor.

Auditime të përfunduara për vitin 2023:

- ✓ Auditim mbi zbatimin e Rekomandimeve,
- ✓ Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë;
- ✓ Drejtoria Rajonale Tatimore Kukës;
- ✓ Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër;
- ✓ Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë;
- ✓ Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë.

Auditime në proces nga data 31.12.2023 e në vazhdim.

- ✓ Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit, Rajoni Verior;
- ✓ Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë.

Nga parashikimi vjetor, DAB nuk ka kryer auditimin e miratuar sipas planit, në:

- ✓ Drejtorinë Rajonale Tatimore Dibër.

Në Raportin Vjetor 2023 të DAB, është raportuar si arsye për mosrealizimin e planit të auditimeve të planifikuara, mosplotësimi me burime njerëzore në këtë drejtori. Nga auditimi u konstatua se gjatë vitit 2023, kanë përfunduar 9 auditime, 3 auditime në proces, si dhe 1 auditim nuk është realizuar. DAB nuk ka kryer misionin e tij auditues sipas identifikimit të risqeve për çdo drejtori, pasi nuk është audituar me prioritet DRT Dibër, e cila në vlerësimin e nivelit të riskut, ka rezultuar drejtori me nivel të lartë, por kanë përfunduar auditimet në DRT Lezhë e Korçë, drejtori të cilat vlerësimin e nivelit të riskut e kanë pasur të mesëm. Pra, DAB nuk e ka arritur objektivin e përmbushjes së Planit Vjetor 2023, veprim ky në kundërshtim me gërmën c, neni 14 “Përgjegjësitë e drejtuesit të njësisë së auditimit të brendshëm”, të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, si dhe Vendimit “Për miratimin e planit vjetor të vitit 2023”, të miratuar nga drejtori i Drejtorit të Përgjithshëm i DPT.

Nga auditimi i dokumentacionit mbi efektivitetin e ditëve të punës për çdo punonjës dhe shpërndarjen e ngarkesës së punës për secilin, rezultoi se ngarkesa e punës së audituesve gjatë vitit ka qenë pothuajse e njëjtë për të gjithë si dhe nuk ka pasur ditë jo efektive pune.

Gjetjet dhe Rekomandimet e auditimeve të DAB, viti 2023.

Gjetjet që kanë ardhur si rezultat i auditimeve nga DAB për vitin 2023, kryesisht janë në sistemin e kontrollit tatimor, në sistemin e mbledhjes së detyrimeve të papaguara e në sistemin e kontrollit të brendshëm. Gjetjet në vlerë kanë rezultuar në sistemin e kontrollit tatimor, taksa

e dogana. Gjetjet e auditimit në vlerë janë gjetje me efekte tatimore në shumën **61,043,000 lekë**, e cila i përket DRT Korçë, Kukës, Shkodër, Gjirokastrë e Lezhë.

Gjetjet në numër, sipas fushës ose sistemeve rezultojnë 2301 në total, të gjitha në sistemet e tatimeve, taksave, e doganave. Në krahasim me numrin e gjetjeve të vitit paraardhës, gjetjet janë më të mëdha në numër, të paraqitura në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 6 Gjetjet në auditime në vitet 2022-2023

Gjetjet	Viti 2023	Viti 2022
Gjetje në vlerë	61,043,000	7,600,000
Gjetje në numër	2301	26

Burimi: Drejtoria e Auditit të Brendshëm në DPT, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

Për sa më sipër, konstatohet vlerë më e lartë e gjetjeve krahasuar me vitin 2022, ku rezulton se për vitin 2023, vlera e gjetjeve është 12.5% më e lartë se e vitit paraardhës.

✓ **Disa nga gjetjet kryesore janë:**

* Mospërputhje e të ardhurave sipas deklaratës së tatimit mbi fitimin me të ardhurat nga shitja sipas deklaratës së TVSH, kur rezultojnë të pa arsyetuara sipas legjislacionit tatimor prodhojnë efekte financiare;

* Mospenalizim në disa raste, sipas pikës 5, neni 30 të Ligjit Nr.8438 datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” kur “detyrimi tatimor vjetor për tatimin mbi fitimin tejkalon shumën e paguar të kësteve mujore të paradhënëve të tatimit mbi fitimin me më shumë se 10 %”;

* Raste të mospërputhjes import/experte lidhur me TVSH e paguar në doganë me atë të deklaruar në tatime;

* Në disa raste, tatimpaguesit nuk i janë përmbajtur akt-marrëveshjes për pagesa me këste duke mos paguar në kohë dhe pa paguar detyrimet e tjera tatimore;

* Mosplanifikimi i fondeve buxhetore për vitin 2023, në artikullin “shpenzime për procesim me Autoritetin Shtetëror të Kadastrës” (ASHK), duke shkaktuar aplikime të dështuara të masave shtrënguese të ndërmarra për kategorinë vendosje të barrës hipotekore.

Nga auditimet e kryera në vitin 2023, rezulton që asnjë çështje nuk është dërguar për investigim, pra sipas DAB asnjë gjetje nuk ka rezultuar të përbëjë vepër penale.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u konstatua se DAB për vitin 2023, ka dhënë 154 rekomandime në total, të cilat janë pranuar nga subjektet e audituara në masën 100%, të ndara si më poshtë në:

- Rekomandime për përmirësime të sistemeve të kontrollit të brendshëm – 16, nga të cilët 3 janë zbatuar dhe 13 janë në proces zbatimi;
- Rekomandime për përmirësim të kuadrit ligjor – 9, të cilat janë në proces zbatimi;
- Rekomandime të karakterit organizativ - 50, nga të cilat 1 është zbatuar dhe 49 janë në proces zbatimi;
- Rekomandime të tjera – 71, të cilat janë në proces zbatimi;
- Rekomandime për arkëtime – 8, të cilat janë në proces zbatimi.

Në lidhje me rekomandimet për arkëtime në vlerë ato kanë qenë të natyrës:

- Marrje mase në saktësimin dhe aplikim penalteti për pagesën me vonesë të këstit të tatim fitimit;
- Marrje mase për monitorim dhe vlerësim të rubrikave Tatimpagues me të ardhura tatimore 0 dhe shpenzime tatimore pozitive Tatim fitimi me përqindje të tjera dhe Tatim fitimi i shtyrë;
- Marrje mase për qartësimin e situatës për 49 tatimpaguesit, tatimi mbi qeranë duke bërë vlerësim tatimor për situatat që prodhojnë detyrime me efekt financiar (dhënë në DRT Korçë).

- Propozim për rikontroll për subjektet;
D me NIPT L.....B, në DRT Korçë;
EC SHPK me NIPT L.....R, në DRT Kukës.

Nga auditimi nëse janë kryer propozimet për rikontrolle për subjektin D me NIPT LB në DRT Korçë, u konstatua se me shkresën nr. 18932 prot., datë 30.11.2023, të zv. Drejtorit të Përgjithshëm të Mbështetjes së Programeve në DPT, është planifikuar rikontrolli ndaj këtij tatimpaguesi. Ndërsa për subjektin E. C. SHPK me NIPT L....R në DRT Kukës, DAB ka dërguar Raportin përfundimtar të këtij angazhimi në DRT Kukës më datë 28.12.2023, më datë 09.07.2024, i është përcjellë titullarit të institucionit kërkesa për miratimin e ri kontrollit për këtë subjekt, i cili është miratuar me shkresën nr. 13217 prot., datë 22.07.2024.

Ndjekja e zbatimit të masave të rekomanduara.

Me shkresën nr. 6317 prot., datë 07.04.2023, DAB ka dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE, “Raportin vjetor të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të auditit të brendshëm”.

Nga auditimi u konstatua se ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të vitit 2022, është kryer në zbatim të Planit vjetor 2023, miratuar me shkresën nr. 17887 prot., datë 19.10.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT. Subjektet e audituara kanë pranuar 47 rekomandime nga 49 që janë dhënë gjithsej, ose 96 % e tyre. Nuk janë pranuar 2 rekomandime nga DRT Dibër. Shkalla e zbatimit të tyre, paraqitet në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 7 Shkalla e zbatimit të rekomandimeve për vitin 2022.

Periudha	Në total	Rekomandime të pranuar	Rekomandime të zbatuara	Rekomandime në proces zbatimi	Rekomandime të pazbatuara	Zbatimi në %
Viti 2022	49	45	27	10	8	60 %

Burimi: Drejtoria e Auditit të Brendshëm në DPT, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Zbatimi i procedurave në dokumentimin e punës, evadimi, ruajtja dhe arkivimi i tyre.

Për zbatimin e procedurave të inventarizimit u përzgjedhën në mënyrë të rastësishme 5 dosje auditimi nga 12 në total, për subjektet Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguar Rajoni Jugor, Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguar në DPT, DRT Kukës, DRT Lezhë e DRT Gjirokastrë të angazhimeve të kryera në vitin 2023.

Nga auditimi u konstatua se DAB pas përfundimit të çdo auditimi, ka kryer procesin e inventarizimit të dosjeve, ku për çdo subjekt të audituar kanë krijuar një dosje të veçantë. Inventarizimi është bazuar në Manualin e auditimit të brendshëm, si dhe në kërkesat e parashikuara në “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën Shqipërisë”, Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, dosjet e auditimeve, DAB i ka dorëzuar në Arkivën e DPT.

Në dosjet e auditimit u gjenden të administruara e të firmosura dokumentet sipas modelit të Formatit Standard nr. 1, të Manualit të Auditimit të Brendshëm, i ndryshuar. Në përfundim të çdo angazhimi auditues, është përcjellë tek titullari i institucionit, Memo e cila është paraqitur përmbledhje e shkurtër e Raportit Përfundimtar. Gjithashtu, nga ana e DAB, ishin respektuar afatet për dërgimin e Projektraporteve dhe Raportet përfundimtare të auditimit në subjektet e audituara, të shoqëruara me plan veprimin e sugjeruar për realizimin e rekomandimeve.

Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:

- z. C.K me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Tatimeve;
- z. SH.P me detyrë Drejtor i Auditit të Brendshëm për periudhën 01.01.2023 – 24.03.2023;
- z. V.R me detyrë Përgjegjës në Sektorin e Auditimit të Këshillimit, Sigurimit të Cilësisë, Planifikimit dhe Raportimit, i ngarkuar të ushtrijë funksionin e Drejtorit të Auditit të Brendshëm, për periudhën 19.04.2023 – 31.12.2023.

Për sa është trajtuar në ProjektRaportin nr. 473/5 prot., datë 09.08.2024, nga subjekti i audituar Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, janë paraqitur observacionet si më poshtë:

- Ngarkimi në detyrë dhe kryerja e funksionit të drejtorit të DAB për 6 muaj, nga z. V.R i cili nuk kishte vjetërsi pune si auditues i brendshëm dhe nuk ishte i certifikuar "Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik", ju sqarojmë se nga rëndësia e kësaj strukture duke qenë se pozicioni i Drejtorit ishte vakant, në cilësinë e titullarit kam nxjerr urdhrin e caktimit për ushtrim funksioni përkohësisht për z. R, me qëllim mirëfunksionimin e kësaj strukture për pjesën e menaxhimit të saj. Bazuar në kompetencat e Drrejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve të përcaktuara në Rregulloren e brendshme të ATQ, ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e KM", ligjit nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore", neni 3, 12 dhe 13 ku ndër të tjera thuhet... " .. drejtori drejtorisë/ shef sektori, në rast mungese apo paaftësie afatshkurtër, zëvendësohet, për shkak të ligjit, nga nëpunësi civil i nivelit më të lartë të të njëjtit drejtori, sektor. Në rast se ka më shumë se një nëpunës civil të të njëjtit nivel, ai zëvendësohet nga nëpunësi civil i nivelit më të lartë që ka vjetërsi më të madhe në shërbimin civil..", konkretisht z. R. para se të emërohej në këtë pozicion ka patur një përvojë rreth 10 vjeçare në strukturat e administratës tatimore në nivelin e mesëm drejtues si Drejtor Drejtorie në ATQ.

Me shkresën nr. 6506/2 prot., datë 25.04.2023, DPT ka përcjellë "Kërkesë" pranë MFE, për regjistrimin si kandidat në procesin e certifikimit të Audituesit të Brendshëm për sezonin 2023-2024, për nëpunësin z.V.R, aktualisht Përgjegjës sektori në DAB. Në vijim, Drejtoria e Burimeve Njerëzore me emailin e datës 12.07.2024 kërkoi informacion në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MF, ku mori përgjigje se është regjistruar kërkesa për regjistrimin e z. R. për sezonin 2023-2024.

-Në lidhje me formularët e përshkrimit të punës të cilët ju keni konstatuar se ato nuk kishin nënshkrimin e nëpunësit civil, veprim i cili sjell mosnjohjen e nëpunësit me punën që duhet të kryejë, sqarojmë se formularët janë hartuar dhe miratuar në nivel inspektor, që nënkupton jo individual për çdo auditues, në zbatim të ligjit nr. 114/2015.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me objeksionet e bëra nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, sqarojmë se janë të njëjta me ato të paraqitura pas lënies së Aktkonstatimeve nga Grupi i Auditimit, (të trajtuara hollësisht në pjesën takuese në ProjektRaport). Nga subjekti nuk janë paraqitur argumente apo dokumente shtesë.

- Punësimi si "auditues i brendshëm në njësitë publike" kryhet në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për nëpunësin civil, si dhe në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës në njësinë publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil. Përveç kushteve të përgjithshme, për punonjësit që punësohen si auditues të brendshëm, kërkohet plotësimi i kushteve të posaçme të përcaktuara në ligjin nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", neni 11, si dhe specifikisht për drejtorin e drejtorisë pika 2, gërma "b" pra, drejtuesi i DAB të ketë përvojë jo më pak se 3 vjet në fushën e auditimit. Drejtoria e Burimeve Njerëzore kishte dërguar shkresë në DHAB në Ministrinë e Financave, për regjistrimin e z. R. për certifikim si auditues i brendshëm, por interesimi i kësaj Drejtorie për kryerjen e trajnimit është bërë në kohën kur në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, ka qenë grupi i auditimit të KLSH, "Për auditimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së DPT në periudhën 01.01.2023-31.12.2023". Për sa më sipër, z. R. nuk duhej të ishte ngarkuar nga titullari i institucionit në pozicionin e Drejtorit të DAB dhe ta ushtronte këtë detyrë për 6 muaj, për sa nuk plotësonte kriteret e përcaktuara në ligjin nr.114/2015. Objeksionin juaj nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

- Formatit i hartimit të përshkrimit të punës dhe nënshkrimi i saj nga punonjësit, kryhet sipas përcaktimeve të VKM nr. 142, datë 12.3.2014 "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", i ndryshuar, për pasojë objeksioni juaj nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në Projekt raportin e auditimit.

IV. REKOMANDIME

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas shkresës Nr.284/12 Prot datë 09.10.2023, të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit me lëndë “Dërgim i Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe Rekomandimet”, konstatohet se nga 32 rekomandime të lëna, subjekti ka pranuar 27 rekomandime, ose 84% e tyre dhe nuk ka pranuar 5 rekomandime. Janë zbatuar plotësisht 7 rekomandime, janë zbatuar pjesërisht 6 rekomandime dhe nuk janë zbatuar 14 rekomandime ose 51.9 % e tyre, si më poshtë:

- Nga 29 “Masa Organizative”, janë pranuar 24 masa, nga të cilat 7 janë zbatuar plotësisht, 6 masa janë zbatuar pjesërisht, 11 masa janë pa zbatuar dhe 5 masa janë pa pranuar.

- Është rekomanduar 1 “Masë për eliminimin e paligjshmërive në administrimin e fondeve publike dhe menaxhimin me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike”, ku nga verifikimi rezulton se është pranuar masa por nuk është zbatuar.

- Janë rekomanduar 2 “Masa Disiplinore” në kompetencë të Titullarit, të cilat janë pranuar nga ana e subjektit por nuk janë zbatuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 18-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1.Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për strukturat e ngarkuara në planin e masave, të cilët nuk kanë realizuar zbatimin e rekomandimeve, si dhe rikërkojmë të merren masa nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e rekomandimeve që janë në proces zbatimi, pjesërisht të zbatuara si dhe të pa zbatuara të dërguara me shkresën Nr.284/12 Prot., të Kryetarit të KLSH datë 09.10.2023, konkretisht për masat organizative, rekomandimet nr.1, 2, 3, 7, 8, 9, 11, 14, 15, 16, 17, 21, 22, 23, 25, 26, 29, për masën për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike, rekomandimin nr.1 si dhe për dy rekomandimet për masat disiplinore, rekomandimi nr.1 dhe 2.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se plani i të ardhurave për DPT është përgatitur nga MFE, dhe është përcjellë për njohje dhe zbatim pranë DPT, duke mos dokumentuar kontributin e DPT përgjatë përgatitjes së planit të të ardhurave, nëpërmjet analizave lidhur me parashikimin e arkëtiveve, projekt plane, apo raporteve të tilla të ngjashme, duke konsistuar kështu në kryerjen e një roli vetëm zbatues të planit të të ardhurave.

-Nga auditimi konstatohet se pavarësisht se sipas projekt ligjit është argumentuar se krahasuar me të pritshmin e vitit 2023, të ardhurat gjithsej të buxhetit të shtetit janë parashikuar të rriten me 7.7 %, dhe të ardhurat tatimore nga tatimet dhe doganat janë programuar të rriten me **8%**, faktikisht, **të ardhurat nga TVSH (bruto)** rezulton të jenë planifikuar vetëm 7.2% më tepër se realizimi i vitit 2022. Ky nivel rritjeje në plan, vjen si rezultat i një planifikimi për rimbursimet e kryera rreth 20% më pak se rimbursimet e vitit 2022, dhe një rritjeje të të ardhurave neto nga TVSH në rreth 25% më shumë re realizimi i vitit paraardhës për këtë zë. Gjithashtu, të ardhurat nga tatimi mbi fitimin, pavarësisht projeksionit të rritjes së të ardhurave, konstatohet se në planin sipas Ligjit të Buxhetit ka reflektuar vetëm normat e inflacionit të pritshëm (rreth 3%), duke miratuar një plan për tatim fitimin me vetëm 3.6% më shumë se realizimi i vitit 2022. Në ndryshim nga të ardhurat e tjera, të ardhurat personale rezultojnë të jenë planifikuar 3.3% më pak se viti paraardhës.

- Nga auditimi konstatohet se përgjatë 3-mujorit të parë të vitit 2023 realizimi i të ardhurave të administratës tatimore nuk ka qenë i bazuar në një planifikim mujor për nivelet e pritshme të realizimit të të ardhurave, për shkak të vonësive në detajimin e planit në nivel MFE-DPT dhe më pas shpërndarjes së DPT në drejtori rajonale. Planifikimi konstatohet se është përcjellë mujor pra jo progresivisht, dhe i përcjellë për zbatim në mes/fund muaji.

-Nga auditimi konstatohet se ndryshimet në planin e të ardhurave të DPT në Aktin Normativ, pavarësisht se janë miratuar në datën 18.10.2023, dhe janë përcjellë pranë DPT për dijeni në datën 02.11.2023, këto ndryshime konstatohet se kanë patur efekt edhe mbi muajt paraardhës, dhe jo vetëm në muajin Nëntor dhe Dhjetor. Kryerja e ndryshimeve në periudha për të cilat realizimi është kryer në ndjekje të një plani të përcaktuar më parë me ligjin vjetor të buxhetit, sjell si pasojë kryerjen e ndryshimeve pas faktit, të cilat ndjekin trendin e realizimit dhe nuk janë më kriter vlerësimi, për sa kohë ndryshimet në planifikim nuk janë relevant me realizimin.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 36-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1.Rekomandimi: DPT në bashkëpunim me MFE të marrin masat për ngritjen e një grupi pune me përfaqësues nga të dy institucionet për të analizuar procedurat aktuale të ndjekura lidhur me procesin e planifikimit të të ardhurave, dhe garantimin e përfshirjes edhe të strukturave përgjegjëse për zbatimin e tyre me qëllim përmirësimin e këtij procesi si në nivel të kufijve të miratuar të planit sipas llojit të të ardhurave, ashtu edhe në drejtim të afateve kohore të ndjekura.

-Drejtori i Përgjithshëm i DPT të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me qëllim përcaktimin e procedurave dhe afateve që duhet të ndiqen nga ana e institucionit lidhur me procesin e planifikimit dhe monitorimit të realizimit të të ardhurave, si nga ATQ ashtu edhe nga DRT, duke i përmbledhur në një dokument të posaçëm, objekt zbatimi nga strukturat përgjegjëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Referuar të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të ardhurat tatimore janë realizuar 227.6 miliard lekë, pra 9.5 miliard lekë më shumë se plani (ose 4.35% më shumë) i cili paraqitet në vlerën 218.1 miliard lekë. Ky nivel realizimi paraqitet rreth 38 miliard lekë më tepër se viti paraardhës, në të cilin të ardhurat janë realizuar në vlerën 189.6 miliard lekë.

Në terma neto, të ardhurat janë realizuar në shumën 205 miliard lekë, përkundërt planit prej 200.1 miliard lekë, me një mbi realizim në shumën 4.9 miliard lekë. Të analizuar sipas llojit të tatimeve, problematika paraqiten në drejtim të mos realizimit me ndikim më të madh nga taksat nacionale dhe taksa e qarkullimit rrugor. Nga analiza e tejkallimit të realizimit të të ardhurave nga TVSH (bruto), tejkallimit të realizimit të rimbursimeve të kryera, konstatohet se efekti final i këtij raporti është mos realizimi në vlerën 1.29 miliard lekë, dhe në vitin 2022 ky raport rezultonte 2.9 miliard lekë.

Konkretisht, zërat që paraqiten me mos realizim janë Taksat dhe Tarifa Nacionale, të cilat janë realizuar sipas të dhënave të DPT në vlerën rreth 14.3 miliard lekë, kundërt planit prej 14.8 miliard lekë (97%), pra rreth 0.5 miliard lekë më pak. Pra, mos realizimi ka ardhur kryesisht për shkak të nivelit të realizimit të taksës së rentës minerare, automjetet e përdorura, taksës nacionale për ambalazhet plastike të lëngjeve të ambalazuara, dhe Taksës mbi Primet e shkruara. Gjithashtu, Taksat nga Qarkullimi Rrugor janë realizuar në vlerën rreth 19.5 miliard lekë, kundërt planit prej 21 miliard lekë (93%), pra rreth 1.5 miliard lekë më pak. Krahasimisht me vitin 2022, konstatohen se janë realizuar të ardhura nga taksat e qarkullimit rrugor në vlerën rreth 1.3 miliard lekë më shumë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 36-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1.Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të marrë masat për përmirësimin e procedurave aktuale të ndjekura për monitorimin e sektorëve që janë përgjegjës për arkëtimin

e taksave dhe tarifave nacionale, si dhe taksave nga qarkullimi rrugor, referuar nivelit aktual të realizimit të këtyre të ardhurave kundrejt planit.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Të ardhurat nga Tatimi mbi Fitimin janë realizuar në vlerën 55 miliard lekë, kundrejt planit në vlerën 50.7 miliard lekë (realizimi në masën 108%), pra me një realizim 4.3 miliard lekë më shumë. Krahasimisht me vitin 2022, konstatohet se të ardhurat nga TF janë realizuar 7.2 miliard lekë më shumë. Të ardhurat nga tatim fitimi realizohen më së shumti nga depozitimet e përkohshme të tatimit mbi fitimit (parapagimet e kësteve), të cilat paraqiten në vlerën rreth 40 miliard lekë, krahasuar me 34 miliard që ishin vitin paraardhës. Nga ana e DPT raportohen si të ardhura edhe parapagimet e tatim fitimit, duke vepruar jo në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, pasi nuk plotësohen kushtet për klasifikimin si të ardhur duke qenë se nuk lidhen me një pagesë pa kthim. Nga auditimi konstatohet se nga DPT, në momentin e dorëzimit të deklarimeve në fund të vitit ku kryhet edhe përlllogaritja e detyrimeve faktike të tatimit mbi fitimit, nuk kryhet netimi i llogarisë së parapagimeve, si veprim rregullues për njohjen e të ardhurës, problematikë kjo e konstatuar edhe në auditimin paraardhës të KLSH, e cila sjell edhe raportim jo të saktë të të ardhurës së periudhës në lidhje me tatimin mbi fitimin. Nga auditimi paralel i kryer nga KLSH pranë Ministrisë së Financave, u kërkua informacion pranë Drejtorisë së Programimit të Statistikës dhe Analizës së të ardhurave tatimore në planifikimin e të ardhurave a planifikohen për zërin e të ardhurave të tatim fitimit edhe paradhëniet e kësteve të paguara, apo nëse merret për bazë vetëm vlera që ka rezultuar sipas formularit të deklarimit të tatim fitimit, nga ku u raportua se në hartimin e projekt buxhetit, administrata tatimore nuk proceson parapagimet, pasi ato përcaktohen e vlerësohen në fillim të vitit. Paradhëniet e kësteve sipas MFE shërbejnë për analiza periodike gjatë vitit. Si rezultat, raportimi i parapagimeve të vitit në realizimin e të ardhurave të tatimit mbi fitimin, pa kryer rregullimin vetëm për pjesën që i përket detyrimeve të subjekteve për vitin 2023, në kushtet kur nga ana e MFE konfirmohet se paradhëniet e kësteve nuk përfshihen në planifikim, rezulton me mbi vlerësim të raportimit për këtë zë të të ardhurave.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 36-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1. Rekomandimi: DPT në bashkëpunim me MFE të marrin masat për ngritjen e një grupi pune me përfaqësues nga këto dy institucione për analizimin e procedurave aktuale të ndjekura për përcaktimin e planit vjetor të të ardhurave nga tatim fitimi, konkretisht lidhur me parapagesat e kësteve të tatim fitimit, me qëllim raportimin e realizimit të të ardhurave për këtë zë në koherencë me planin, në kushtet ku në procedurat aktuale nga MFE të ardhurat nga parapagesat e kësteve të tatim fitimit nuk përfshihen në planifikim, dhe nga DPT raportohen në totalin e të ardhurave të tatim fitimit.

-Nga ana e DPT të kryhen veprimet rregulluese në lidhje me depozitimet e përkohshme për deklaratën e tatim fitimin në momentin e dorëzimit të deklaratës së tatim fitimit nga ana e tatimpaguesve.

Brenda vitit 2024

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se në realizimin e të ardhurave tatimore, raportohen edhe të ardhurat që arkëtohen si gjoba të sistemit tatimor, të cilat për vitin 2023 përlllogariten në vlerën rreth 876 milion lekë, problematikë kjo e konstatuar edhe në auditimin e mëparshëm të KLSH.

-Nga auditimi mbi saktësinë e mbledhjes dhe raportimit të të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të cilat mblidhen në DPT, u konstatua se për efekt raportimi, DPT përfshin si të ardhur nga kontributet edhe të ardhurat nga gjobat për deklarim të vonuar të kontributeve dhe TAP, gjoba për mosdeklarim punonjësish dhe depozitime të

përkohshme për listëpagesën e kontributeve dhe TAP, në vlerën totale për 391,853 mijë lekë, vlerë e cila nuk është e përfshirë si e ardhur në raportimet që bëhen në ISSH dhe FSDKSH, referuar shkresave mbi treguesit e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për vitin 2023, veprim ky i cili ka sjellë mos raportim të saktë të të ardhurave nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në Raportin vjetor të DPT, si dhe në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022.

-Gjithashtu, sipas të dhënave të DPT, rezulton se Drejtoria e Kontrollit gjatë rivlerësimeve tatimore të kryera, ka konstatuar detyrime dhe penalitete për subjektet objekt kontrolli për periudhën 2023/2022, ku konkretisht janë konstatuar penalitete në vlerën 2,371 milion lekë për vitin 2023, dhe 2,194 milion lekë për vitin 2022. Nga auditimi konstatohet se referuar procedurave aktuale të ndjekura nga DPT lidhur me realizimin e të ardhurave, këto penalitete të konstatuara gjatë rivlerësimeve të kryera sipas kontrolleve të DPT, në momentin a likuidimit të tyre nga ana e subjekteve, nga ana e DPT raportohen si të ardhura tatimore, në zërat respektiv ku janë konstatuar mungesa e të ardhurave (të tilla si TVSH, TF), në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018. –Nga auditimi konstatohet se referuar Drejtorisë së Programimit të Statistikës dhe Analizës së të ardhurave tatimore pranë MFE, të ardhurat nga gjobat/penalitetet nuk janë pjesë e planit, pasi nuk mund të projektohen, duke konfirmuar se raportimi i tyre nga DPT si të ardhura, në kushtet kur nga MFE konfirmohet se nuk janë të përfshira në planifikim, rezulton në një raport realizimi të të ardhurave që nuk është në koherencë, apo i krahasueshëm me planin.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 36-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1. Rekomandimi: DPT në bashkëpunim me MFE të marrin masat për ngritjen e një grupi pune me përfaqësues nga këto dy institucione për analizimin e procedurave aktuale të ndjekura për përcaktimin e planit vjetor të të ardhurave tatimore, konkretisht lidhur me gjobat dhe penalitetet, me qëllim raportimin e realizimit të të ardhurave për këtë zë në koherencë me planin, në kushtet ku në procedurat aktuale të ndjekura nga MFE, në përcaktimin e planit të të ardhurave përjashtohen gjobat dhe penalitetet e ndryshme dhe nga DPT analizohet realizimi kundrejt planit, së bashku me këto elementë.

-Strukturat drejtuese të DPT, të marrin masat e nevojshme me qëllim unifikimin e vlerës së të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të shprehur në raportimet e DPT, me vlerën e raportuar si e ardhur nga kontributet për institucionet e ISSH dhe FSDKSH.

-DPT të marrë masat për raportimin e të ardhurave nga penalitetet të ndara nga detyrimet e konstatuara përgjatë rivlerësimeve tatimore në kontrollet e kryera, për të shmangur mbivlerësimin e të ardhurave të arkëtuara sipas llojit të tyre, në kushtet kur në planifikim nuk përfshihen të ardhurat nga penalitetet.

Brenda vitit 2024

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se struktura faktike e Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në DPT nuk është në përputhje me strukturën Organizative të miratuar me Urdhrin nr. 69, datë 26.05.2023 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore” dhe Urdhrin Nr. 189 datë 08.08.2023 “Për miratimin e Organigramës së Administratës Tatimore Qendrore” të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, ku struktura e Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara është përcaktuar me 12 punonjës. Kjo drejtori ka 3 vende të lira/vakante konkretisht: 1 përgjegjës sektori e 1 inspektor në Sektorin e Përcaktimit të Standardeve për Procedurat Ligjore të Mbledhjes me Forcë dhe 1 inspektor në Sektorin e Monitorimit dhe Analizës. Personeli i pamjaftueshëm ka ndikuar negativisht në objektivat e mbledhjes së detyrimeve tatimore, si edhe në menaxhimin e tyre. Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara (DMDTP) gjatë vitit 2023 nuk ka kryer asnjë inspektim në asnjë drejtori rajonale tatimore në kundërshtim me Ligjin nr. 9920,

datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, KREU XI, “Mbledhja me force e detyrimit tatimor i papaguar”, neni 88” Autoriteti dhe kompetencat për të mbledhur detyrimit tatimorë të papaguar”, nenin 135, paragrafet “3” dhe “4” dhe Manualin e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, Kreu 2.1.1 “Inspektimi”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 54- 76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1. Rekomandimi: Titullari i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të marrë masa për plotësimin e vendeve vakantë të drejtorisë DMDTP sipas strukturës së miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 69, datë 26.05.2023 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”, si dhe të miratohen e të ndiqen programet e inspektimit në të gjithë rajonet në kuadër të procedurave për monitorimin e mbledhjes së detyrimeve të papaguara.

Në vazhdimësi

7.Gjetje nga auditimi: Gjendja e detyrimeve tatimore të papaguara në fillim të vitit 2023 paraqitet në vlerën rreth 146,767 milion lekë, që i përket një numri prej 182,490 subjektsh debitore, dhe në fund të vitit 2023 këto detyrime rezultojnë në vlerën rreth 155,165 milion lekë që i përket një numri prej rreth 181,023 subjektsh debitore. Detyrimet e shtuara gjatë vitit 2023 janë 40 miliard lekë ose afërsisht 3 miliard lekë më shumë krahasuar me vitin 2022, ku detyrimet e shtuara ishin 37 miliard lekë. Arkëtimet paraqiten në vlerën 31 miliard lekë, krahasuar më vitin paraardhës ku arkëtimin ishin 24 miliard lekë, këtë vit janë mbledhur afërsisht 7 miliard lekë më shumë.

Subjekte në proces gjyqësor rezultojnë 1,401 subjekte me detyrim total 13 miliard lekë. Krahasuar me vitin 2022 janë rreth 10 subjekte më shumë me një vlerë të detyrimeve të papaguara të ankimuara në gjykatë prej rreth 901 milion lekë më shumë.

Peshën më të madhe të stokut të detyrimit sipas moshës e zënë detyrimet me moshë borxhi detyrimet mbi 5 vite të cilat zënë rreth 55 % të total detyrimit. Krahasuar me vitin e kaluar uljen më të lartë të detyrimit tatimor e ka pësuar detyrimet 1- 2 vite në vlerën 3 miliard lekë dhe rritjen më të madhe detyrimet mbi 5 vite në vlerën 13 miliard lekë.

Subjekte me status aktiv janë në numër 64,476 ose 36 % e total numrit të subjekteve debitore, me vlerë detyrimi 40.8 miliard lekë ose 26 % e total detyrimit të papaguar. Subjektet me status pasive janë numër 115,547 subjekte ose 63.8 % mbi numrin gjithsej të subjekteve, me vlerë 114 miliard lekë ose 74 % mbi total detyrimin e papaguar.

Për sa i përket gjendjes së stokut të detyrimeve të papaguara në afat sipas llojit të tatimit, rezulton se zëri TVSH me peshën më të madhe në stokun e detyrimeve të papaguara në afat, 36% me një vlerë prej rreth 55.2 milion lekë. Rajoni Qendror ka detyrimet më të larta krahasuar me rajonet e tjera për të gjitha llojet e tatimeve ku është llogaritur detyrimi+ gjoba+ interesi. Në total për të gjithë rajonet, principali i detyrimeve tatimore të akumuluar përbën rreth 61 % të vlerës totale të detyrimeve tatimore, nga penalitetet (gjobat) me 33 % dhe 6 % kamatëvonesat (interesat).

Detyrimet e papaguara të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për vitin 2023 janë në vlerën 22,509 milion lekë nga të cilat 21,316 milion lekë, ose 95 % e vlerës i përkasin subjekteve private dhe 1,192 milion lekë, ose 5 % enteve publike. Masat shtrënguese në të gjitha rajonet janë marrë për 117,991 raste, të cilat janë edhe të përsëritura për një subjekt disa here gjatë vitit. “Urdhëri i bllokimit të llogarive bankare”, i cili pas “Njoftim dhe kërkesë për të paguar” është masa më e përdorur si masë shtrënguese është nisur për 31,422 raste për të gjitha rajonet. Duke mos marrë masat e duhura shtrënguese rritet vështirësia e mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar, KREU XI, “Mbledhja me force e detyrimit tatimorë i papaguar”, neni 88” Autoriteti dhe kompetencat për të mbledhur detyrimit tatimorë të papaguar”, Ligjin nr. 9928, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”

Udhëzimin nr.24 datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar dhe Manualin, në seksionin 3.3.2 “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 54-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1. Rekomandimi:Drejtori i Drejtorisë së Mbledhjes të Detyrimit Tatimor të Papaguara, në DPT, të ndërmarrë masat shtrënguese duke përdorur instrumentet e duhura për mbledhjen e detyrimit tatimor.

Në vazhdimësi

8.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka një vlerë detyrimi tatimor të papaguar jashtë sistemit C@TS në vlerën 2,351,817,199 lekë. Bazuar në Urdhrin Nr. 209, datë 06.12.2023 “Për trajtimin e problemeve të identifikuar nga grupi i punës në DPT lidhur me detyrimeve tatimore të papaguara jashtë sistemit C@ts” është ngritur grupi i punës, i cili ka identifikuar mundësinë dhe pamundësinë e hedhjes në sistem. Grupi i punës ka përshkruar arsyet për të cilat nuk ekziston mundësia e hedhjes në sistem ndër të cilat subjekte të paidentifikuar me Nipt/ Nid apo adresë, me status ç’regjistruar, nuk ka modul në sistem. Nuk ekziston mundësia e hedhjes në sistem për këto detyrime për 924 subjekte në masën 36 % ose 89,249,785 lekë, të vlerës totale të DRT- ve 2,353,412,061 lekë, duke përjashtuar nga vlera totale detyrimin tatimor për 1 subjekt në vitin 2010 në përgjegjësinë Akcizë në vlerën 2,106,993,328 lekë të DRT Tiranë për të cilën nuk ka modul për hedhjen e saj dhe e cila është në juridiksion të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe vlerën 165,000 lekë për 1 subjekt i cili paraqitet me detyrime të taksës së solidaritetit për të cilin po ashtu nuk ka modul në sistem. Ekziston mundësia teknike që Drejtoritë Rajonale përkatëse të kryejë procesin e hedhjes së detyrimeve në sistem në total për 775 subjekte në vlerën 150,192,552 lekë dhe 6 individë në vlerën 5,176,509 lekë. Në kontabilitet ka ngelur që nga viti 1999 ku u vendos një taksë për ndërtimin e rrugës, grande 1 %, gjoba sekuestrimi në vlerën 11,348,575. Në totalin e detyrimit tatimor jashtë sistemit c@ts grupi i punës ka konstatuar se nga vlera totale 93 % e subjekteve nuk mund të hidhen në sistem dhe vetëm 7 % e subjekteve kanë mundësi hedhje duke bashkëpunuar me sektorin e tyre juridik Drejtoria Rajonale përkatëse. Nga auditimi konstatohen mangësi në drejtim të hedhjes në sistem të këtyre detyrimeve si edhe mungesa e moduleve në sistem për hedhjen e detyrimeve. Ekzistenca e detyrimeve tatimore jashtë sistemit aktual sjell mangësi në raportimin e të dhënave lidhur me debitorët për sa kohë mbahen jashtë sistemit; gjendja e lartë e detyrimeve tatimore jashtë sistemit sjell vështirësi në arkëtimin dhe monitorimin e procesit të ndjekjes me forcë të borxhit tatimor nga DRT dhe DPT. Gjendja e lartë e detyrimeve tatimore jashtë sistemit sjell vështirësi në arkëtimin dhe monitorimin e procesit të ndjekjes së mbledhjes me forcë të borxhit tatimor nga DRT dhe DPT, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, KREU XI, “Mbledhja me force e detyrimit tatimorë i papaguar”, neni 88” Autoriteti dhe kompetencat për të mbledhur detyrimin tatimorë të papaguar”, Ligjin nr. 9928, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe Urdhrin e brendshëm nga titullari i DPT, Nr. 209, datë 06.12.2023 “Për trajtimin e problemeve të identifikuar nga grupi i punës në DPT lidhur me detyrimeve tatimore të papaguara jashtë sistemit c@ts”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 54-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1. Rekomandimi:Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve në bashkëpunim me DRT-të përkatëse, të marrin masat e duhura për të kryer procesin e hedhjes së detyrimeve në sistem në total për 775 subjekte në vlerën 150,192,552 lekë dhe 6 individë në vlerën 5,176,509 lekë, për të cilët ekziston mundësia e hedhjes në sistemin C@TS.

Menjëherë

9.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se DRT Fier dhe DRT Vlorë, nuk kanë përfshirë në Planin akumulativ të kontributeve, ndryshimet e dërguara nga Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës sipas Aktit Normativ nr. 5, datë 18.10.2023, veprim që ka sjellë raportim të pasaktë nga këto Drejtori Rajonale, të planifikimit dhe realizimin e të ardhurave për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për vitin 2023.

- Nga auditimi mbi realizimin e të ardhurave të kontributeve u konstatua se, DRT nuk kanë raportuar në DPT, me një analizë performance mbi mosrealizimin e të ardhurave të kontributeve për vitin 2023.

DRT Dibër, DRT Gjirokastrë e DRT Kukës kanë raportuar mosrealizim të planit të të ardhurave shëndetësore, ndërsa në realizimin e të ardhurave shoqërore, janë po këto Drejtori që kanë raportuar tejkallim të planit vjetor, situatë e cila ka sjellë raportim të pasaktë mbi realizimin faktik për vitin 2023. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën nr. 6, neni 4 “Përgjegjësitë dhe detyrat e Drejtorit të Drejtorisë Rajonale” dhe neni 23 “Përgjegjësitë dhe detyrat e drejtorit/përgjegjësit të Drejtorisë/Sektorit të Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave në DRT”, të Rregullores “Për funksionimin e Drejtorive Rajonale Tatimore”, miratuar me Urdhrin nr. 192, datë 120.8.2020 të Ministrisë të Financave.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 76-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1. Rekomandimi: Titullari i institucionit të marrë masat e nevojshme që Drejtoritë Rajonale Tatimore të përfshijnë në Planin akumulativ të gjitha ndryshimet sipas AN, që dërgohen nga Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës në DPT, të kryejnë analiza të performancës mbi mosrealizimin e planit të të ardhurave të kontributeve, si dhe raportim të saktë të planifikimit dhe realizimit vjetor.

Menjëherë e në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2023 rimbursimi për TVSH-në bazuar në ligjin vjetor të buxhetit është programuar në shumën për 18,000,000 mijë lekë, i cili nuk ka ndryshuar gjatë vitit dhe është realizuar në shumën 22,614,132 mijë lekë duke rezultuar me tejkallim në shumën 4,614,132 mijë lekë, ose 25.63% më shumë kundrejt planit të rimbursimit.

Fillimisht, me shkresën e MFE nr. 2701 prot., date 08.02.2023 dhe protokolluar në DPT, nr 2111 prot datë 13.02.2023, sipas së cilës është përcjellë planifikimi vjetor i të ardhurave tatimore për periudhën Janar-Dhjetor 2023 progresiv, dhe i ndarë për çdo muaj, është përcaktuar edhe totali i rimbursimit në vlerën 18,500 milion lekë, së bashku me planifikimin e këtij zëri për çdo muaj. Sipas aneksit bashkëlidhur shkresës ku detajohet plani mujor, konstatohet se totali i planit për këtë zë rezulton 18,000 milion lekë, dhe jo 18,500 milion lekë, konfirmuar më pas edhe me shkresën nr/ 2615, prot datë 21.02.2023 të MFE, prot në DPT nr. 2831, prot datë 23.02.2023 ku është përcjellë detajimi i të ardhurave të taksave nacionale dhe të tjera, sipas zërave përkatës. Plani i rimbursimit mujor është tejkalluar ndjeshëm në 7 muaj të vitit 2023, konkretisht në muajt: Janar +5%, Shkurt +14%, Maj +33%, Korrik +3%, Shtator +46%, Nëntor +92% dhe Dhjetor +146%, ndërsa kemi mosrealizim të planit të rimbursimit në muajt Mars -7%, Prill -1%, Qershor -3%, Gusht -6% dhe Tetor -21%.

Në 13 Drejtori Rajonale Tatimore është tejkalluar ndjeshëm plani i rimbursimit, konkretisht në DTM, Durrës, Shkodër, Korçë, Kukës, Lezhë, Dibër, Berat, Elbasan, Fier, Vlorë, Gjirokastrë dhe Sarandë të cilët së bashku kanë paguar më tepër se fondet e planifikuara për rimbursimin shumën totale për 5,349,388 mijë lekë, ose ka tejkalluar fondet e parashikuara për rimbursim e TVSH-së, ndërsa në DRT Tiranë nuk kanë realizuar planin e rimbursimit për 735,255.98 mijë lekë. Referuar të dhënave si më lart, peshën më të madhe të rimbursimit të TVSH-së e zë Drejtoria e Tatim Paguesve të Mëdhenj në vlerën për 14,457,833.99 mijë lekë, ose 63.93 %, të totalit të realizimit faktik të Rimbursimit të TVSH-së në DPT, ndërkohë që kjo drejtori në mbyllje të periudhës ushtrimore rezulton me një realizim të planit në masën +27.33% e ndjekur

më pas më DRT Durrës, e cila ka paguar shumën 2,007,151.30 mijë lekë, duke e realizuar planin e rimbursimit në masën 74.53%, duke tejkaluar në shumën 781,837 mijë lekë.

-Nga auditimi u konstatua se në mbyllje të periudhës ushtrimore 2023, rezultojnë 9 kërkesa për rimbursimin e TVSH-së të pranuar por të pa miratuara në vlerën totale për 100,569,976 lekë, të cilat megjithëse kanë kaluar afati maksimal prej 60 ditëve nga data e paraqitjes së tyre nuk janë rimbursuar, veprime këto në kundërshtim me Ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 75/1, dhe VKM Nr.953 datë 29.12.2014 “Për dispozitat zbatuese të Ligjit Nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar pika 3 dhe 4 të nenit 10.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 85-91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1. Rekomandimi: DPT të marrë masat për të dokumentuar rolin e saj përgjatë planifikimit, duke bashkëpunuar me MFE për përcaktimin e planit të rimbursimit vjetor të TVSH-së, për të kryer një planifikim sa më real të vlerës së rimbursimeve, me qëllim parandalimin e kryerjes së pagesave përtej planit të miratuar.

DPT të marrë masat për të intensifikuar procedurat monitoruese të subjekteve objekt rimbursimi i TVSH-së përgjatë aktivitetit të tyre, me qëllim garantimin e një projektimi sa më efektiv të kufijve të rimbursimit nga ana e tyre, dhe respektimin e afateve ligjore në kryerjen e procesit të rimbursimit të TVSH-së, në kuadër të miradministrimit të fondeve buxhetore.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se për vitin 2023 nga vetëdeklarimet e Drejtorive Rajonale Tatimore nuk janë filluar 109 kontrole nga 2,982 kontrole të planifikuara ose rreth 4% e totalit, duke krijuar një stok të subjekteve të planifikuara për kontroll dhe të pa kontrolluara, si pasojë edhe e mos koordinimit midis Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut dhe Drejtorive Rajonale. Drejtoria e Menaxhimit të Riskut (DMR) nuk është plotësuar me numrin e nevojshëm të punonjësve sipas strukturës. Megjithëse përzgjedhja e subjekteve për kontroll është automatike, detajimi i subjekteve për secilën drejtori kryhet manualisht, pasi sistemi nuk merr në konsideratë subjektet e planifikuara për kontroll në planet e mëparshme të kontrollit të cilat nuk janë realizuar brenda afateve të përcaktuara, janë në proces kontrolli apo janë hequr nga lista e subjekteve të planifikuara, të cilat eliminohen manualisht nga punonjësit e Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut, në bazë të informacionit të marrë nga Drejtoritë Rajonale.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 91-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të marrë masa që në aktivitetet e planifikimit për kontroll të reflektohet stoku i kontroleve të mbartura nga viti i kaluar dhe në bashkëpunim me DRT të shkëmbejë në kohë informacion për problematikat e kontroleve tatimore.

- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të marrë masa për plotësimin e organikës në kuadër të ndryshimeve të strukturës së miratuar me VKM me qëllim arritjen e objektivave të institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

12.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Menaxhimit të Riskut pranë DPT në 5 vitet e fundit nuk ka kryer për asnjë rast propozim kontrolli për subjektet e regjistruara si “OJF”, pavarësisht qarkullimit të lartë që këto subjekte realizojnë, ku nga databaza e aktivitetit për 5 vitet e fundit, ekzistojnë OJF me qarkullim deri në 728,808,724 lekë, por gjithashtu edhe për risqet e tjera që këto biznese mbartin të tilla si diferenca mes të ardhurave/shpenzimeve të deklaruara në pasqyrat financiare të dorëzuara në C@ts, krahasuar me situatën që është raportuar në FDP, pagave të ulëta të deklaruara në listëpagesa, tatimit në burim, pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 91-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut, të kryejë një analizë të detajuar të treguesve financiarë të deklaruar të OJF-ve për 5 vitet e fundit, sipas kritereve të riskut, me qëllim përfshirjen për kontroll të thelluar në vend të subjekteve që paraqesin risk të lartë sipas kritereve të thyera.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nuk ka një rakordim midis Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut dhe Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, lidhur me problematikat, kontrollet e ushtruara dhe rezultatet e Planeve Operacionale sipas listave të gjeneruara për verifikim në bazë të kritereve të riskut të thyera, veprime këto në kundërshtim me pikat 2 dhe 2.3 të Urdhërit Nr.42 Prot, datë 23.02.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm për ngritjen e “Komitetit të Riskut dhe përcaktimin e rregullave të funksionimit të tij”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 91-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

13.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut, të kryejë një analizë të detajuar për çdo plan operacional të nxjerrë nga DMR për të patur një nivel matës të rezultateve të dala nga listat e gjeneruara nga kjo drejtori.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 14 vendimeve të nxjerra nga Komiteti i Riskut në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për vitin 2023, është konstatuar konkretisht se në Vendimin e Komitetit të Riskut Nr.6, datë 26.06.2023, është kryer miratimi i propozimit të DRT Tiranë për ndryshimin e pikës 2 të Kapitullit II të Manualit të Kontrollit Tatimor, për ndryshimin e përzgjedhjes së tatimpaguesve që do të kontrollohen: 50% nga propozimet e DRT Tiranë dhe 50% nga DMR. Veprime të cilat janë në kundërshtim me përcaktimet e Urdhërit Nr.42, datë 23.02.2023 “Ngritjen e Komitetit të Riskut dhe përcaktimin e rregullave të funksionimit të tij”, konkretisht pikën 2 “Komiteti i Riskut ka për detyrë zbatimin e një sistemi modern të menaxhimit të rrezikut të papajtueshmërisë dhe promovimin e zhvillimit të strategjive të integruara të përmirësimit të pajtueshmërisë dhe në veçanti, komiteti do të identifikojë dhe do t’ju japë prioritet rreziqeve të mëdha të pajtueshmërisë sipas një procesi të strukturuar të vlerësimit të rreziqeve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 91-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

14.1. Rekomandimi: Drejtor i Përgjithshëm i Tatimeve në cilësinë e Kryetarit të Komitetit të Riskut në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të marrë masat e nevojshme ligjore për shfuqizimin e këtij ndryshimi në Manualin e Kontrollit Tatimor.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i akt konstatimeve të mbajtur nga inspektorët e DVKT, në sistemin informatik tatimor C@ts në lidhje me verifikimet në terren, ka rezultuar se ato janë jashtë tematikës së përcaktuar për verifikim nga analiza e riskut të DMR, sipas kritereve të riskut të thyera, veprime të cilat janë në kundërshtim me Ligjin Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, Vendimin Nr.36, datë 25.05.2023 “Miratimin e Planit të Punës së DVKT, për periudhën 01 Qershor - 30 Shtator 2023” dhe Manualin e DVKT. Gjithashtu nga kryqëzimi i të dhënave sipas listës me subjekte me kritere risku të thyera sipas analizës së riskut nga DMR, me të dhënat e verifikimeve në terren nga DVKT përgjatë sezonit turistik 2023, ka rezultuar se janë kryer verifikime në terren vetëm për 430 subjekte nga totali prej 2,002 subjekte ose vetëm 21.5% e kampionit, konkretisht:

- Lista e subjekteve për verifikim sipas kriterit të riskut nr.3 të thyer “Tatimpagues me çmim të ulët të çadrave”, janë verifikuar vetëm 18 subjekte nga 122 ose 14.75%;

- Lista e subjekteve për verifikim sipas kriterit të riskut nr.4 të thyer “Tatimpagues për t’u monitoruar në terren pasi mund të ketë risk nëndeklarimi (Fundjavë 14, 15, 16 Korrik organizohet “T F”)", janë verifikuar vetëm 17 subjekte nga 47 ose 36.17%;
- Lista e subjekteve për verifikim sipas kriterit të riskut nr.5 të thyer “Tatimpagues me aktivitet akomodim me çmim dhomash shumë të ulëta”, janë verifikuar vetëm 109 subjekte nga 522 ose 20.88%;
- Lista e subjekteve për verifikim sipas kriterit të riskut nr.7 të thyer “Tatimpagues të cilët nuk kanë lëshuar kupon për çadrat e dhëna me qera (edhe pse kanë kontratë me Agjencinë Kombëtare të Bregdetit për stacionet e plazhit, nga të dhënat e sipërfaqes është llogaritur nr hipotetik i çadrave dhe janë mbajtur TP mbi 50 çadra)", janë verifikuar vetëm 19 subjekte nga 122 ose 15.57%;
- Lista e subjekteve për verifikim sipas kriterit të riskut nr.8 të thyer “Tatimpagues me përgjegjësinë e TVSH-së por që kanë pak fatura ose kanë pak qarkullim në pikun orar 12.00-16.00 në datat 23,24,25 Qershor”, janë verifikuar vetëm 76 subjekte nga 357 ose 21.29%;
- Lista e subjekteve për verifikim sipas kombinimit të kriterëve të riskut nr.1, 2 dhe 6 të thyer “Tatimpagues me rënie xhiro krahasuar Qershor 2023-Qershor 2022”, janë verifikuar vetëm 191 subjekte nga 832 ose 22.96%.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 91-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

15.1. Rekomandimi: Komiteti i Riskut në Drejtorin e Përgjithshme të Tatimeve, brenda tagrit dhe kompetencave ligjore të analizojë shkaqet e problematikave në performancën e DVKT përgjatë sezonit turistik për të verifikuar listën e tatimpaguesve me kritere të thyera riskut të gjeneruara nga DMR, dhe të merren masat me qëllim përmirësimin e situatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

16.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar se gjatë vitit 2023 grupet e verifikimit në terren nuk kanë qenë të pajisur me sistemin elektronik të monitorimit “E-Inspektor”, i cili shërben për regjistrimin e veprimeve të punës, monitorimin e inspektorëve gjatë kryerjes së kontrollit në terren, identifikimin dhe regjistrimin e subjekteve të tatueshme, rritjen e transparencës dhe përmirësimin e monitorimit në procesin e kryerjes së inspektimeve nga administrata tatimore, automatizimin e proceseve të punës si dhe arritjen e objektivave në luftën kundër informalitetit, fakt ky që në gjykimin e grupit të auditimit përbën një risk të shtuar shtesë në monitorimin e inspektorëve të terrenit si dhe krijon mundësi për abuzim dhe janë në kundërshtim me përcaktimet e Manualin e Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, Kreu VII “Programi E-Inspektor”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 91-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

16.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të merren masa për vendosjen në funksionim të Programit “E-Inspektor” i cili shërben për regjistrimin e veprimeve të punës së Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren me qëllim rritjen e transparencës dhe monitorimit në kryerjen e kontrolleve tatimore.

Menjëherë dhe në vijimësi

17.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i planit dhe realizimit të kontrolleve për vitin 2023, konstatohet se ka një mosrealizim të kontrolleve në 2 DRT më të rëndësishme konkretisht DRT Tiranë me 12.34% të kontrolleve dhe DTM me 0.85% të kontrolleve. Nga analiza e të dhënave mbi evidencat e fazave në të cilat ndodhen kontrollet në proces, rezulton se stoku i kontrolleve të papërfunduara nga Drejtoritë Rajonale Tatimore, vijon të jetë i konsiderueshëm në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, konkretisht nenet 81, 83 dhe 84, ku gjendja e stokut të kontrolleve për vitin 2023 rezulton të jetë 805 kontrolle të pezulluara, të pafilluara ose në proces nga 1,140 kontrolle që kanë qenë për vitin 2022, duke pasur një ulje të vogël të tyre.

Konstatohet se Drejtoria e Kontrollit në DPT nuk rakordon gjendjen e kontrolleve në fund të vitit për ta përdorur si referim lidhur me planifikimet të cilat realizon për vitin pasardhës duke sjell vazhdimisht një numër të lartë të kontrolleve në proces ose të pafilluar në fund të vitit. Drejtoria e Kontrollit nuk ka praktikë verifikimin dhe kontrollin nga zyra të veprimtarisë kontrolluese të DRT-ve nëpërmjet mbledhjes dhe përpunimit të dhënave nga sistemi C@ts ku të verifikohet kontrollohet dhe analizohen fenomene të cilat janë si bazë për arritjen e konkluzioneve në mirëfunksionimin e Drejtorive të Kontrollit në DRT.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 91-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

17.1. Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të implementohen procedura rakordimi me DRT me qëllim planifikimin e saktë të burimeve kohore dhe njerëzore në dispozicion për kryerjen e kontrolleve sipas aktivitetit vjetor.

Menjëherë dhe në vijimësi

18.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi për zbatimin e përputhshmërisë ligjore të afateve procedurale, i të dhënave të vendosura në dispozicion nga Sektori i Hetimit Tatimor, në lidhje me rastet e ndjekur të cilat janë në proces deri në datë 31.12.2023, rezultojnë tejkalime të afateve administrative të hetimit dhe trajtimit mbi 6 muaj, veprime të cilat janë në shkelje të afateve procedurale të përcaktuara në pikën 4.6 “Verifikimi Paraprak” të Manualit të Hetimit Tatimor, paraqitur si më poshtë:

- 75 raste në hetim nga të cilat 57 raste janë në tejkalim të afatit procedurale prej 6 muajsh;
- 81 raste të cilët janë në proces kontrolli tatimore, me kohëzgjatje që varion nga 81-3,147 ditë;
- 67 raste të cilat janë në proces vlerësimi tatimore, me kohëzgjatje që varion nga 165-3,415 ditë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 91-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

18.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshme e Tatimeve të ngrihet grup pune për të analizuar shkaqet e tejkalimit të afateve ligjore procedurale në hetimin e subjekteve nga Sektori i Hetimit Tatimor dhe të merren masa me qëllim përmirësimin e situatës së rasteve hetimore në proces.

Menjëherë dhe në vijimësi

19.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve të raport kontrolleve të Drejtorisë së Kontrollit të Specializuar, konkretisht i programeve të kontrollit është konstatuar se mungojnë përcaktimi i orëve në dispozicion për kryerjen e kontrollit, veprime të cilat janë në kundërshtim me përcaktimet e shkronjës f) të pikës 2) të nenit 81) “Njoftimi i kontrollit tatimore” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 91-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

19.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të marrë masat e nevojshme për standartizimin e dokumentit të “Njoftim i kontrollit tatimor” të Drejtorisë së Kontrollit të Specializuar, konform përcaktimeve të legjisllacionit tatimor në fuqi, duke përcaktuar orët në dispozicion për kryerjen e kontrollit.

Menjëherë dhe në vijimësi

20.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se planifikimi i buxhetit nga DPT, në fazën e I të PBA-së është 2,895,080 mijë lekë dhe në fazën e 2 është 3,855,448 mijë lekë. Nga faza e I në fazën e II, referuar shpenzimeve korrente të llogarisë 602- Mallra dhe shërbime të tjera, planifikimi buxhetor ka pësuar ndryshim në vlerën 809,500 mijë lekë, ku vlerën më të lartë të ndryshimit e kanë pësuar fondet buxhetore të planifikuara për vendimet gjyqësore, të cilat paraqiten me rritje në vlerën 500,000 mijë lekë, ose 333 % rritje nga faza e I- rë e planifikimit në vlerën 150,000 mijë lekë në fazën e II- të 650,000 mijë lekë. Nga auditimi konstatohet se nga krahasimi i listës së investimeve të programuara përgjatë procesit të planifikimit dhe

realizimit të buxhetit të vitit 2023, konstatohet se projekti i investimit me kod 18AV815 “Blerje pajisje kompj.”, nuk është pjesë e fazës së parë të PBA 2023-2025, por është shtuar në fazën e dytë në vlerën 5,000 mijë lekë.

Projekti me kod 22AD801 “Përmirësimi i sistemit E- taxation” nuk është planifikuar në PBA 2023-2025, faza e II, edhe pse sipas shkresës së AKSH dhe DPT ky investim ka prioritet të lartë pasi rrezikon që të çojë deri në mosfunksionim të sistemit e-Tax dhe bllokim të punës së administratës tatimore. Në shkresën 2478/4 prot., datë 24.02.2023 të DPT- s drejtuar AKSHI-t, citohet se investimi i përcjellë nga AKSHI **nuk përputhet me investimin e miratuar në buxhet, si në aspektin e fondit të tejkaluar rreth 300 milion lekë si dhe elementeve dhe zërave të tjerë të shtuar për këtë investim në proceset e: rishikimit të termave të referencës, testimit të tregut, përlllogaritjen e fondit limit si dhe hartimit të kriterëve të veçanta.** Risk shumë i lartë mbetet edhe kontrata e mirëmbajtjes nr. 46, datë 06.01.2021 e cila ka përfunduar më 06.01.2023, dhe nuk është përsëritur përgjatë vitit 2023 dhe sistemi ka operuar pa mirëmbajtje, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 9 datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”, Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, pika 153-154, Ligjin nr. 84/2022, datë 24.11.2022 “Për buxhetin e vitit 2023” dhe Udhëzimin Plotësues nr. 9 datë 28.02.2022 dhe Udhëzimit Plotësues nr. 22 datë 07.07.2022 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 145-169 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

20.1. Rekomandimi: Planifikimi buxhetor afatmesëm nga DPT, të kryhet sa më afër nevojave të institucionit si dhe të zhvillohen takime dhe bashkëbisedime me përfaqësues të AKSH-it për të rritur bashkëpunimin midis tyre mbi projekte të cilat në zhvillimin dhe përmirësimin e punës së kryer në DPT, po ashtu që të mos ketë mospërputhje me investimin e miratuar në buxhet.

Në vazhdimësi

21.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me përzgjedhje i veprimeve me bankën u konstatuan 10 urdhër-shpenzime nga ana e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës, për të cilat janë kryer likuidimet në tejkalim të afatit 30 ditor nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik. Likuidimi me vonesë i këtyre detyrimeve paraqet risk në rritjen e shpenzimeve buxhetore, si rezultat i lindjes së detyrimeve nga penalitetet bazuar në kontratë, pavarësisht se në këtë rast nuk është kërkuar nga kontraktori pagesa e penaliteteve, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 52 “Kryerja e shpenzimeve” dhe Udhëzimin nr. 9 date 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” pika 184.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 145-169 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

21.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa për likuidimin e faturave në kohë dhe sipas datave të faturimit për të shmangur rritjen e detyrimit si dhe të penaliteteve që mund të vijnë si pasojë e vonesave të likuidimit.

Në vazhdimësi

22.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se DPT për vitin 2023 efekti në krijim e detyrimeve të prapambetura vlerësohet të jetë 311 milion leke nga të cilat janë për vendimet gjyqësore (subjekte) në vlerën 239,153 mijë lekë, në vlerën 137,268 mijë lekë për ish punonjës dhe Detyrime të prapambetura shtypshkrimesh në vlerën 12,873 mijë lekë dhe se në pasqyrat financiare të DPT nuk janë llogaritur provizione për shpenzimet. Krijimi i detyrimeve të prapambetura konstatohet se vjen edhe nga mos llogaritja e detyrimit të mundshëm në formën e provizioneve për planifikimin e fondeve në kohë. Nga auditimi konstatohet mos koordinim ndërmjet strukturave të ngarkuara me ndjekjen e vendimeve gjyqësore dhe atyre të ngarkuara me shlyerjen e vendimeve gjyqësore për përlllogaritjen e efekteve në shpenzimet e vendimeve gjyqësore në kohë me pasojë krijimin e detyrimeve të prapambetura. Në kundërshtim me

Standardin Kombëtar të kontabilitetit nr.6, “Provizionet, pasivet dhe aktivet e kushtëzuara”, pika nr. 47, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 34.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 145-169 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

22.1. Rekomandimi: Nga ana e titullarit të DPT-së të përcaktohen procedura konfirmuese mbi vendimet gjyqësore dhe efektin e pritshëm të tyre në ciklin e menaxhimit të shpenzimeve buxhetore, të llogariten provizionet në pasqyrat financiare të DPT që të mos ketë rritje të riskut potencial për mos likuidim në kohë të detyrimit të lindur.

Në vazhdimësi

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se DPT përsa i përket procesit të vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi për vitin 2022, në administratën e DPT, për aktivet për procedurë ankandi nuk është ndjekur procedura e shitjes në ankand, si dhe se edhe përgjatë vitit 2023 në zbatim të VKM nr. 673 date 22.11.2017 për “Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar, neni IV pika 18, nuk është realizuar procedura e kalimit të aseteve nga DPT tek AKSHI. Konstatohet se nuk është bërë kalimi tek AKSHI për sistemet NEXUS, Harta digjitale dhe BI, për shkak të mungesës së kodit burim të software-ve si edhe dhomës së serverit tek AKSHI, me justifikim se AKSHI nuk ka kushtet e duhura për ta bërë këtë kalim. Në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe Urdhrin nr.1380/5 prot., datë 20.09.2022 është ngritur komisioni “Për ngritjen e komisionit të asgjësimit të materialeve në inventar të DPT”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 145-169 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

23.1. Rekomandimi: Nga e DPT-së për aktivet për procedurë ankandi të ndiqet procedura e shitjes në ankand si dhe të realizohet procedura e kalimit të aseteve nga DPT tek AKSHI.

Menjëherë

24. Gjetje nga auditimi: Sipas urdhrin nr. 69, datë 26.05.2023 të Kryeministrit është miratuar struktura e re e DPT, me totalin prej 1450 punonjës, nga të cilët 327 punonjës në nivel qendror dhe 1123 punonjës në nivel rajonal. Nga auditimi konstatohet se pas urdhrin të Kryeministrit, nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë është miratuar organigrama në zbatim të strukturës organizative, 2 muaj më vonë, konkretisht me urdhrin nr. 189 datë 08.08.2023. Deri në fund të vitit 2023 nga ana e DPT nuk janë reflektuar efektet e ndryshimeve në strukturë dhe sipas raporteve vjetore të hartuara nga institucioni, analizat mbi plotësimin e strukturës janë bazuar në urdhrin e vitit 2020, duke argumentuar se procesi i ristrukturimit të DPT deri në fund të vitit 2023 nuk ka përfunduar.

Në muajin Dhjetor 2023 DPT paraqitet me një shtim të numrit të vakancave krahasuar me fillim vitin, ku konkretisht nga 1450 pozicione pune që ka struktura në total janë të punësuar në total 1212 ku 913 prej tyre janë me status të nëpunësit civil dhe 299 me kod pune, pra **238 pozicione pune janë vakante**, ku 207 prej tyre janë pozicione me status të nëpunësit civil dhe 31 pozicione me kod pune. Referuar numrit të konsiderueshëm të pozicioneve vakante nga të cilat karakterizohet ATQ, konstatohet se mos plotësimi i të cilave cënon jo vetëm performancën e këtyre institucioneve, por shoqërohet me kosto financiare të konsiderueshme për buxhetin e shtetit, duke qenë se në anën tjetër konstatohen ish punonjës që kërkojnë ekzekutimin e vendimit gjyqësor. Kjo situatë reflekton problematikat në përcaktimin e numrit të punonjësve të planifikuar sipas strukturës së DPT, për sa kohë veprimtaria institucionale ka vijuar me personelin faktik, pavarësisht nivelit të konsiderueshëm vakancave. Gjithashtu, konstatohet se edhe numri i shpalljeve të vendeve vakante gjatë vitit 2023 nga Departamenti i Administratës Publike nuk përkon me vakancat e ngarkuara në sistem dhe është vetëm 15 shpallje në vend të

160-207 që do të duhej të ishte, sikundër është përcaktuar edhe me planin e rekrutimeve të hartuar në fillim të vitit 2023 nga DPT, përcjellë për DAP me shkresën nr. 21953, prot datë 30.12.2022, ku janë planifikuar nevojat për shërbimin civil për vitin 2023 prej 160 punonjësish, argumentuar me faktin se procesi i ristrukturimit ka qenë ende në proces.

- Nga totali i 109 ish punonjësve gjyqfitues, rezultojnë se 77 prej tyre janë ish nëpunës me status të nëpunësit civil dhe 32 ish punonjës me kod pune. Nga totali ish nëpunësve civil, rezulton se 12 janë ish-punonjës të rikthyer, 1 ish-punonjës ka ndërruar jetë, 8 ish-punonjës në pension dhe **56 ish-punonjës janë të pa sistemuar**. Kryetari i Komisionit të Posaçëm në DPT përgjatë vitit 2023 nuk e ka thirrur asnjëherë komisionin, në kundërshtim me Urdhrin nr. 5151, datë 28.10.2015 të Ministrisë së Shtetit për Inovacionit dhe Administratën Publike, Kreu IV, pika 2, pavarësisht 56 gjyqfituesve të pa sistemuar që rezultojnë në databazën e DPT për të cilët vijojnë të kryhen pagesa për pagat e tyre të cilat shoqërohen m detyrime shtesë vit pas viti për buxhetin e shtetit, duke argumentuar sërish se shkak për këtë ka qenë procesi i ristrukturimit i pa finalizuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 169-184 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

24.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve në bashkëpunim me DAP, të marrë masa për plotësimin e vendeve vakante në zbatim të urdhrin nr. 69, datë 26.05.2023, të Kryeministrit, nëpërmjet procedurave të rekrutimit apo sistemimit të gjyqfituesve, me qëllim shmangien e vakancave që çenojnë kryerjen e detyrave funksionale sipas strukturave përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

25. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohen mangësi në administrimin e databazës së gjyqfituesve nga ana e DPT, lidhur me ekzekutimin e vendimeve dhe njohjen e detyrimeve në zbatim të vendimit të gjykatës. Konkretisht, të dhënat e gjyqfituesve administroheshin në Excel, dhe ku u konstatuan pasaktësi në përlllogaritjen e detyrimeve të mbetura për likuidim, krahasimisht me detyrimet e konstatuara për periudhën 2022-2023 dhe likuidimet përkatëse. Konstatohen raste në të cilat janë raportuar vendime me vlera të konsiderueshme (pra që i tejkalojnë detyrimet e pagave të një viti) si detyrime të vitit 2023 dhe të pa njohura si të tilla në vitin 2022, pavarësisht se vendimet e depozituara në DPT për to i përkasin periudhave të hershme. Gjithashtu konstatohen raste për të cilët është bërë ndërprerja e likuidimeve për shkak të propozimit të kryer për sistemim të gjyqfituesit, informacion ky që referuar kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, nuk përbën argument justifikues pasi ndërprerja do të aplikohet në momentin e arritjes së një dakortësie nga të dyja palët për sistemim, dhe jo në mënyrë të një anshme. Nga auditimi konstatohet se janë likuiduar vendimet për gjyqfituesit në nivelet që variojnë nga **93% si** maksimum likuidimi për total detyrimin total 2023 dhe 2022, në 49% për disa ish punonjës të tjerë, pavarësisht datave të depozitimit të vendimeve dhe datave të vendimeve gjyqësore. Nga ana e DPT nuk dokumentohet metodologjia e ndjekur për përcaktimin e masës së likuidimit të detyrimit të gjyqfituesve, në rastet kur fondet e alokuara përgjatë vitit, tejkalojnë normat e përcaktuara fillimisht sipas kostimit të vitit.

Gjithashtu, nga auditimi konstatohet se në kundërshtim me Udhëzimin nr.1 datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”, grafiku i shlyerjes, në bazë të radhës së paraqitjes së vendimeve gjyqësore nuk është publikuar në faqen online të DPT.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 169-184 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

25.1. Rekomandimi: Drejtorja e Financës pranë DPT të marrë masat për rishikimin e databazës sipas së cilës administrohet likuidimi i gjyqfituesve, duke paraqitur qartazi për çdo gjyqfitues vlerën e përcaktuar në vendimin e gjykatës, vlerën që i përket vendimit të vitit, vlerën e mbetur për likuidim, si dhe duke përcaktuar nivelin e likuidimeve që do të aplikohet për periudhat e tjera në rast rialokimesh fondesh gjatë vitit, në mënyrë që ky likuidim të jetë i unifikuar për të gjithë gjyqfituesit.

-DPT të marrë masat për të publikuar në faqen zyrtare të institucionit grafikun e shlyerjes, në bazë të radhës së paraqitjes së vendimeve gjyqësore, duke përcaktuar vlerat respektive që do të likuidohen për çdo vit.

Menjëherë dhe në vijimësi

26. Gjetje nga auditimi: Përgjatë vitit 2023 nga DPT janë kryer 6 delegime kompetencash në Drejtoritë Rajonale Tatimore Gjrocastër, Vlorë (2), Shkodër, Korçë dhe Sarandë; si dhe 16 delegime kompetencat në strukturat e DPT. Grupi i auditimit kërkoi informacion lidhur me afatin e përfundimit të këtyre delegimeve, i cili deri në përfundim të auditimit nuk u vendos në dispozicion. Deri në fund të vitit 2023 është raportuar se kanë qenë në fuqi 6 urdhra për drejtoritë rajonale dhe 14 urdhra për DPT. Nga grupi i auditimit u kërkua informacion lidhur me urdhërat aktiv për delegim kompetencash gjatë vitit 2023, duke specifikuar ato të mbartura nga vitet e mëparshme dhe urdhrat e nxjerra përgjatë vitit 2023 ku u raportuan gjithsej 12 të tilla, por konstatohet se informacioni i vendosur në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore pranë DPT është i pasaktë, dhe në vijim të kërkesës së grupit të auditimit për saktësimin e tyre, nga ana e DPT në observacionin e përfaqësuesve të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore është parashtruar se nuk u vendos në dispozicion informacioni, sepse këto urdhra delegimi i përkasin periudhave të mëparshme. Faktikisht nga ana e grupit të auditimit është kërkuar informacion lidhur me urdhrat që pavarësisht se i përkasin periudhave të mëparshme (audituar nga KLSH) kanë vijuar edhe përgjatë vitit 2023 dhe më vonë. Nga auditimi konstatohet se referuar intervaleve të kohëzgjatjeve të tyre në kohë të konsiderueshme (disa urdhra delegimesh kanë qenë aktiv për më shumë se 2 vite), konstatohet se kanë shërbyer si mjet për të shmangur procedurën e parashikuar nga neni 25 “Lëvizja Paralele”, të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”. Përgjatë vitit 2023 janë kryer 3 procedura transferimi të përkohshme me afat 6 mujor, nga të cilat 1 rast punonjësi ka dalë në pension pas përfundimit të afatit; në 1 rast punonjësi është larguar; dhe në 1 rast është emëruar në një tjetër pozicion. Referuar transferimeve aktive të administratës tatimore, pra edhe transferimet e miratuara në periudhat para vitit 2023, dhe që kanë patur efekt përgjatë vitit 2023, kanë rezultuar 8 procedura të tilla, për të cilat konstatohet se intervalet e kohëzgjatjeve të transferimeve kanë variuar në 6-8 muaj në vijim të shkresave për transferim duke shmangur procedurën e parashikuar nga neni 25 “Lëvizja Paralele”, të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 169-184 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

26.1. Rekomandimi: Titullari i DPT të marrë masat për të finalizuar plotësimin e pozicioneve vakante nëpërmjet shpalljeve për të vijuar me procedurat e emërimit apo lëvizjes paralele, duke shmangur kryerjen e delegimeve apo transferimeve të përkohshme të cilat vijnë për periudha mbi 1 vjeçare, të cilat çenojnë mbarëvajtjen institucionale.

Menjëherë dhe në vijimësi

27. Gjetje nga auditimi: Referuar të dhënave të DPT përgjatë vitit 2023 janë vendosur nga Komisioni i Disiplinës 72 masa disiplinore, duke rezultuar me diferenca krahasuar raportin e DPT, në të cilin paraqiten 153 vendime gjithsej, nga të cilat në proces 55 vendime dhe 98 masa të dhëna. Referuar raportit vjetor të DPT për vitin 2023 është raportuar se për 6 mujorin e parë të vitit 2023 dhe 6 mujorin e dytë të vitit 2023, procesi i vlerësimit është përmbyllur pjesërisht për nëpunësit e administratës tatimore, duke raportuar gjithsej 708 vlerësime për vitin 2023 dhe 512 vlerësime për 6 mujorin e dytë. Vlerësimi vjetor i rezultateve në punë për punonjësit me Kod Pune në Administratën Tatimore për vitin 2023 është raportuar si i papërfunduar plotësisht me 80 vlerësime, nga ku mungojnë formularët e vlerësimit për DPT dhe DRT Tiranë. -Nga auditimi konstatohet se DPT nuk disponon një strategji të burimeve njerëzore, duke ju referuar planit të rekrutimeve si dokumenti i strategjisë. Drejtoria e Burimeve Njerëzore nuk

disponon një plan periodik apo vjetor të punës ku të paraqiten objektivat e saj; si dhe raport periodik apo vjetor të veprimtarisë së kësaj drejtorie.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 169-184 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

27.1. Rekomandimi: DPT të marrë masat për hartimin e një strategjie të burimeve njerëzore, në zbatim të së cilës të hartohet plani periodik dhe vjetor i punës për t'i shërbyer raportimit të veprimtarisë së kësaj drejtorie.

Titullari i DPT të marrë masat për të finalizuar procesin e vlerësimit të punonjësve në fund të çdo viti për të gjitha strukturat përbërëse të DPT, dhe paraqitjen e rezultateve në rang institucional në raportet vjetore të hartuara, duke evituar diferencat në raportime.

Menjëherë dhe në vijimësi

28. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se me shkresën nr. 1509, prot datë 31.01.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT, është dërguar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për mendim Draft Struktura Organizative, Draft Organigrama dhe Relacioni shoqëruar, me qëllim vijimin e procedurave të mëtejshme. Me urdhër nr. 69, datë 26.05.2023 të Kryeministrit, prot në DPT nr. 9716, datë 29.05.2023, është miratuar struktura organizative e administratës tatimore qendrore me numër total të personelit të administratës tatimore qendrore prej 1450 veta. Me urdhër nr. 350, datë 08.06.2023 të Drejtorit të Departamentit të Administratës Publike është krijuar Komisioni i Ristrukturimit. Ky urdhër ka përcaktuar vetëm ngritjen e komisionit, pa përcaktuar afatet sipas së cilave do të kryhet procesi. Me urdhër nr. 189, datë 08.08.2023 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, është miratuar organigrama për Administratën Tatimore Qendrore me 1450 punonjës, nga të cilët 327 punonjës në nivel qendror dhe 1123 punonjës në nivel rajonal. Pra, nga auditimi konstatohet se në vijim të urdhrin nr. 69, prot datë 26.05.2023 të Kryeministrit, nga ana e Ministrisë së Financave është miratuar organigrama mbi 2 muaj më vonë.

Komisioni i Ristrukturimit ka kryer 4 mbledhje përgjatë vitit 2023, në të cilat janë shqyrtuar strukturat organizative të 12 Drejtorive Rajonale Tatimore dhe është dalë me vendimmarrje për strukturat e Drejtorive të Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në rajone dhe ATQ, duke dalë me vendimmarrjet përkatëse. Nga verifikimi i dokumentacioneve të vendosura në dispozicion lidhur me veprimtarinë e Komisionit të Ristrukturimit konstatohet se në kundërshtim me Udhëzimin nr.1, datë 01.03.2016, i ndryshuar, pika 5, mbledhja e parë e komisionit për shqyrtimin e mundësisë së sistemimit ka iniciuar datë 25.09.2023, ndërkohë që struktura është riorganizuar me urdhrin e Kryeministrit datë 26.05.2023; si dhe organigrama është miratuar me urdhrin nr. 08.08.2023 të Ministrit të Financave. Në kundërshtim me përcaktimet e pikës 16, të kreut II, të udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016, të Departamentit të Administratës Publike, Komisioni i Ristrukturimit nuk ka zbatuar afatin 15 ditor nga momenti i krijimit të tij, për të propozuar vendimet mbi transferimet e nëpunësve civil. Nga verifikimi i afateve të të gjithë procesit të ristrukturimit, rezulton se nga momenti i miratimit të strukturës së re, deri në daljen e vendimit për transferimin e përhershëm të nëpunësve civil brenda administratës tatimore, procesi i ka tejkaluar afatet.

Procesi i ristrukturimit ka qenë në proces deri në fund të periudhës objekt auditimi, dhe ka vijuar përgjatë vitit 2024. Vendimet e Komisionit të Ristrukturimit në asnjë rast nuk janë të shoqëruara me dokumentacionin e pikëzimit, sikundër përcakton aneksi 1 i udhëzimit nr. 1, datë 01.03.2026, i ndryshuar “Metodologjia e vlerësimit dhe sistemi i pikëzimit”.

-Nga auditimi konstatohet se pas miratimit të strukturës së re të DPT sipas urdhrin të Kryeministrit nr.69, datë 26.05.2023, nga ana e DPT nuk janë hartuar Rregulloret e DPT dhe DRT, në zbatim të këtij urdhri, deri në fund të periudhës objekt auditimi, pra struktura aktuale e DPT rezulton e pa harmonizuar me rregulloren e funksionimit të administratës tatimore, aktualisht në fuqi.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 169-184 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

28.1. Rekomandimi: Ministri i Financave dhe Ekonomisë të marrë masat për miratimin e rregullores së funksionimit të DPT, në zbatim të strukturës së re të institucionit.

Komisioni i Ristrukturimit për sistemimin e punonjësve të DPT, të marrë masat për finalizimin e procesit të restrukturimit të administratës tatimore, dhe plotësimin e vendimmarrjes me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

29.Gjetje nga auditimi: Në dy raste nga auditimi i dokumentacionit të procedurës së prokurimit “Rikonstruksion i godinës të DRT Elbasan” dhe “Rikonstruksion i godinës të DRT Vlorë”, për vitin 2023, janë konstatuar mangësi në zhvillimin e procedurës për hartimin e DST-ve në lidhje me kriteret e vendosura, janë konstatuar kritere jo në përputhje me natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë paargumetuar, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme. Mos argumentimi i kriterëve të vendosura bie në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 36, pika 2, Neni 77, pika 1 dhe 4, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 41, pika 2, në të cilën citohet: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”, Neni 55, pika 4, Neni 78, pika 2.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9, faqe 184-201 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

29.1. Rekomandimi: AK në hartimin e DST, të marrë masa në vijimësi të shmang aplikimin e kriterëve që nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargumetuara dhe jo në përputhje me procedurën e zhvilluar.

Menjëherë dhe në vijimësi

30.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të zhvillimit të procedurës së prokurimit “Rikonstruksion i godinës të DRT Elbasan” konstatohet se OE i shpallur fitues nuk ka paraqitur certifikatat: 1.Certifikatë ISO 45001:2021 mbi “*Shëndetin dhe sigurimin në punë*”, e vlefshme, ose ekuivalente/barasvlefshme, 2. Certifikatë ISO 3834-2:2021 mbi “Menaxhimin e cilësisë për saldimitin dhe bashkimin e materialeve metalike”, e vlefshme, ose ekuivalente/barasvlefshme. Veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 92-Shqyrtimi i ofertave dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 82, pika 2 dhe 3.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9, faqe 184-204 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

30.1. Rekomandimi: AK të marrë masa në vijimësi në zhvillimin e procedurave të prokurimit të respektojë kriteret e vendosura në DST për vlerësimin dhe shpalljen fitues të OE me qëllim përdorimin me efektivitet të fondeve publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

31.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të procedurës blerje me vlerë të vogël “*Blerje certifikat SSL për nevojat e aksesimit të Sistemit të Përbashkët të Transmetimit(CTS)*” konstatohet se: marrja në dorëzim e mallrave sipas procesverbalit të dorëzimit mbajtur midis Autoritetit Kontraktor dhe përfaqësuesit të OE të shpallur fitues, është bërë në datën 28.12.2023, ndërkohë në DST është parashikuar se dorëzimi i mallit duhet të bëhet brenda 3 ditëve nga data e shpalljes së fituesit, i cili është shpallur në datën 26.10.2023, pra 62 ditë me vonesë, kjo në kundërshtim të nenit 41, pika 1, gërma e) dhe nenit 2, të Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik, nenit 56, të VKM nr. 285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, dokumenteve Standarte të Tenderit për procedurat e thjeshtuara, nenit 17, “Dëmet e likujduara”, në nenin 17.1, pika a). Në këto kushte Autoriteti Kontraktor nuk ka përmbushur detyrimet VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, e nenit 108 “Raportimi në rastet e mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9, faqe 184-201 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

31.1. Rekomandimi: AK të marrë masa në vijimësi në zhvillimin e procedurave të prokurimit të respektojë përcaktimet ligjore në procesin e marrjes në dorëzim të punëve, mallrave dhe shërbimeve me qëllim përdorimin me efektivitet të fondeve publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

32. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, u konstatua se:

- Struktura e re organizative e DPT e miratuar me urdhrin nr. 69, datë 26.05.2023, të Kryeministrit, si dhe Raportet periodike të monitorimit të buxhetit 4, 8 dhe 12 mujore, nuk janë publikuar në faqen zyrtare të saj, veprim në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe përcaktimet e paragrafit 271, Kreu VI, “Raportet e monitorimit”, të udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

- Numri i vakancave në dhjetor 2023 nuk paraqitet i saktë, veprim ky në kundërshtim me urdhrin nr. 69, datë 26.05.2023. Si dhe me pikën nr. 8, neni 73 “Përgjegjësitë dhe detyrat e përgjegjësit të Sektorit të Rekrutimit dhe Promovimit”, pikës nr. 14, neni 74 “Përgjegjësitë dhe detyrat e specialistit të Sektorit të Rekrutimit dhe Promovimit”, të Rregullores së funksionimit të ATQ, miratuar me urdhrin nr. 193, datë 12.08.2020 të Ministrit të Financave.

- Në Programin vjetor të trajnimit të ATQ për vitin 2023, nuk ishin planifikuar trajnime të punonjësve për njohje të ligjit “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Veprim në kundërshtim me pikën nr. 3.1, të kapitullit III, “Komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit”, të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, i ndryshuar.

- Në formularët e përshkrimit të punës u konstatua se nuk ishin nënshkrimet e nëpunësit civil, veprim në kundërshtim me nenin 19 e 20, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Me kapitullin IV “Procedura dhe formati i përshkrimit të punës” i VKM nr. 142, datë 12.3.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar.

- Titullari i institucionit i cili është edhe koordinator i riskut, nuk ka urdhëruar ngritjen e “Grupit të Menaxhimit të Riskut” (GMR), si dhe nuk janë kryer takime me stafin menaxherial, nuk ka miratuar “Gjurmën e Auditimit” të detajuar për procedurat kryesore, “Hartën e proceseve të punës” dhe “Manualin e proceseve të punës”. Veprime këto në kundërshtim me gjurmën “b”, pika nr. 8, neni 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, me pikën nr. 2, të nenit 16 “Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit” të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, si dhe me Kapitullin III, i Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.10, faqe 201-215 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

32.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK, të marrë masat që:

- Struktura e re organizative e DPT dhe Raportet e monitorimit të buxhetit 4, 8 dhe 12 mujore, të publikohen në faqen zyrtare të internetit të institucionit, në kuadër të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoritetit publik.

- Drejtoria e Burimeve Njerëzore në DPT të kryejë një analizë mbi numrin e saktë të vakancave në institucion, me qëllim plotësimin e tyre. Të planifikojë programe trajnime për punonjësit, në

njohje të ligjit “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe të bëjë të mundur njohjen e nëpunësit me përshkrimin e punës së tij, si dhe duke e nënshkruar atë.

- Titullari i institucionit të urdhërojë krijimin e grupin e menaxhimit të riskut (GMR). Të miratojë “Hartën e proceseve të punës”, “Manualin e proceseve të punës”, si dhe “Gjurmën e Auditimit” për procedurat e proceset që lidhen me veprimtarinë kryesore të DPT.

Deri në datë 31.12.2024

33.Gjetje nga auditimi: -Nga auditimi mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm gjatë vitit 2023, u konstatuan vakanca në strukturën e saj, e cila ka sjellë mungesë performance të Drejtorisë. DAB nuk ka kryer misionin e tij auditues sipas identifikimit të risqeve për çdo Drejtori, pasi nuk ka audituar DRT Dibër, e cila në vlerësimin e nivelit të riskut, ka rezultuar Drejtori me nivel të lartë, duke mos arritur objektivin e përmbushjes së Planit Vjetor 2023.

-Nga auditimi u konstatua se pas ndryshimit të emërimit të një sektori të DAB, nuk është përditësuar Karta e Auditit, si dhe nuk është përcjellë për miratim tek titullari i institucionit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me gërmën “c”, neni 12 “Përgjegjësitë e titullarëve të njësive publike”, si dhe gërma “b”, neni 14 “Përgjegjësitë e drejtuesit të njësisë së auditimit të brendshëm”, të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar.

-Komiteti i Auditimit të Brendshëm nuk ka dërguar në DPT, Vendimin me mendimin dhe rekomandimin pozitiv ose jo, për Planin vjetor 2023 dhe Planin strategjik 2023-2025, për shkak të përfundimit të mandatit të anëtarëve të tij. Veprim i cili ka sjellë moskryerjen e kompetencave të Komitetit, të përcaktuara në nenin 13 “Komiteti i Auditimit të Brendshëm”, të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.10, faqe 201-215 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

33.1. Rekomandimi: Titullari i institucionit të marrë masa për plotësimin e pozicioneve vakante në këtë Drejtori, sipas strukturës së miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 69 datë 26.05.2023 “Për miratimin e strukturës organizative të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”.

- Drejtoria e Auditit të Brendshëm të përcjellë për miratim te Drejtori i Përgjithshëm, Kartën e Auditit, të përditësuar.

- Ministria e Financave si organi epror i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të urdhërojë emërimin e anëtarëve të Komitetit të Auditimit të Brendshëm, roli i të cilit përmes mendimeve për Planin strategjik e vjetor, monitorimin e raporteve të DAB, këshillimit e rekomandimeve objektive, i jep titullarit të DPT mbështetje në përmbushjen e përgjegjësiave të saj.

Menjëherë e në vijimësi

34.Gjetje nga auditimi: Mbi ngarkimin në detyrë të drejtorit të Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, nga auditimi u konstatua se me urdhrin nr. 76, datë 19.04.2023, nr. 6795 prot., “Për caktimin e një nëpunësi për ushtrimin e funksioneve”, Drejtori i Përgjithshëm i DPT ka urdhëruar Përgjegjësin e Sektorit të Auditimit të Këshillimit, Sigurimit të Cilësisë, Planifikimit dhe Raportimit në DAB, të ushtrojë edhe detyrat funksionale të drejtorit të kësaj drejtorie. Më pas, me urdhrin nr. 53, nr. 1699 prot., datë 26.01.2024 të titullarit “Për përfundimin e periudhës së zëvendësimit për shkak të ligjit”, i është komunikuar përfundimi i detyrës.

Nga auditimi rezultoi se ngarkimi në detyrë dhe kryerja e funksionit të drejtorit të DAB, për periudhën 6 mujore nga Përgjegjësi i Sektorit të Auditimit të Këshillimit, Sigurimit të Cilësisë, Planifikimit dhe Raportimit në DAB, i cili nuk kishte vjetërsi pune 3 vite, si auditues i brendshëm dhe nuk ishte i certifikuar “Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik”, është bërë në kundërshtim me gërmën “b”, pika nr. 2, neni 11 “Punësimi i audituesit të brendshëm”, të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.10, faqe 201-215 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

34.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të marrë masa në plotësimin e pozicionit vakant të drejtorit të Auditit të Brendshëm, me një nëpunës i cili i plotëson të gjitha kriteret e nevojshme dhe i jep titullarit të institucionit, siguri të arsyeshme, këshilla për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në DPT.

Menjëherë

B. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1.1 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se planifikimi për vendimet gjyqësore nuk është bërë në përputhje me nevojat buxhetore të institucionit, pasi në buxhetin e akorduar sipas ligjit fillestar të buxhetit, anë miratuar fonde në vlerën 350,000 mijë lekë, të cilat konstatohet si të pamjaftueshme për të mbuluar detyrimet e prapambetura të gjyqfituesve (në total detyrime për ish punonjës dhe për subjekte gjyqfituese 433,700 mijë lekë), duke mos marrë këtu në konsideratë vendimet shtesë të depozituara gjatë vitit 2023. Përgjatë vitit 2023 fondet në dispozicion janë pakësuar në vlerën 281,950 mijë lekë, dhe me një realizim prej vetëm 276,802 mijë lekë.

-Nga auditimi konstatohet se në fillim të vitit 2023 rezultojnë detyrime të prapambetura për ish punonjës gjyqfitues në vlerën 137,268 mijë lekë, dhe këto detyrime në fund të vitit paraqiten në vlerën 59,167 mijë lekë, nga ku shtesat e vitit 2023 janë në vlerën 138,422 mijë lekë. Në këtë vlerë konstatohet se nuk është përfshirë vendimi i një gjyq fituesi, vendimi i të cilit është dorëzuar në DPT në 07.12.2023, dhe është likuiduar përgjatë vitit pasardhës.

Përgjatë vitit 2023, për ish punonjësit janë likuiduar detyrime në vlerën **216,523 mijë lekë**, e cila konsiderohet efekt financiar negativ në buxhetin e shtetit, nga të cilat tarifatat përmbartimore për mos ekzekutimin në kohë të këtyre pagesave në vlerën 5,964 mijë lekë.

1.2 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet databaza e punonjësve të larguar nga puna përbëhet nga **71 procese gjyqësore**, prej të cilëve 22 janë ish punonjës me status të nëpunësit civil dhe 49 janë ish punonjës me Kod Pune. Nga 22 procese gjyqësore të ish nëpunësve civil, 10 procese janë në shkallën e parë të gjykimit dhe 22 prej tyre janë çështje të apeluara në gjykatën e apelit. Nga këto 12 procese gjyqësore në gjykatën e apelit, rezulton që 8 prej tyre janë pranuar nga gjykata e shkallës së parë dhe vetëm 4 prej tyre janë rrëzuar.

Në lidhje me ish punonjësit me Kod Pune rezulton se janë në proces aktualisht 49 çështje gjyqësore, ku 14 prej tyre janë në proces në gjykatën e shkallës së parë, 1 prej tyre është pezulluar dhe 34 prej tyre janë në proces në gjykatën e apelit. Nga këto 34 çështje në proces të apeluara, rezulton se 14 janë pranuar, 21 prej tyre janë pranuar pjesërisht nga gjykata dhe 9 prej tyre janë rrëzuar.

Lidhur me gjyqet e fituara vetëm përgjatë vitit 2023 nga ish punonjësit, sipas vlerave respektive të vendimit, si dhe në rastet kur vendimi ka qenë me objekt rikthimin në punë të ish punonjësve, konstatohen se përgjatë vitit 2023 janë depozituar në DPT 13 vendime gjyqësore në Shkallë të Parë “Pagim page” dhe 1 vendim “Pranuar Pjesërisht”. Në Shkallë të Dytë rezultojnë 6 vendime gjyqfituesish me objekt “Pagim page” dhe 5 vendime “Rikthim në vendin e punës”, të cilat në momentin e zbardhjes së tyre, do të shoqërohen me kosto financiare shtesë për buxhetin e shtetit, për periudhat në vijim.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9, faqe 184-201 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i DPT të marrë masat për analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësisë për të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore të depozituara në DPT, duke intensifikuar procedurat aktuale të ndjekura në drejtim të përfaqësimit të institucionit për çështjet gjyqësore në proces, shoqëruar me efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit.

1.2. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i DPT të garantojë një rol më aktiv në drejtim të veprimtarisë së komisionit për sistemimin e gjyqfituesve, me qëllim arritjen e vendimmarrjeve efektive për sistemimin e gjyqfituesve, për të mos vijuar me likuidimin e tyre për periudha disa vjeçare, duke sjellë kështu duplikim të pagesave për çdo pozicion pune, pasi për të njëjtin pozicion pune, paguhen edhe ish-punonjësi që ka fituar gjyqin për largim të padrejtë nga puna dhe punonjësi i emëruar rishtaz në administratën tatimore.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA DISIPLINORE

C.1 Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, germat “b”, “c” dhe “ç”; bazuar në nenin 57, 58 dhe 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar, si dhe në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandohet Titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve vlerësimi i problematikave dhe shkeljeve të përshkruara në mënyrë të detajuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe të nisin procedurat për dhënien e masave disiplinore nga “Vërejtje” deri “Largim nga shërbimi civil”, për të gjithë punonjësit e konstatuar me përgjegjësi sipas çështjeve të trajtuara.

C.2. Për punonjësit marrëdhëniet e punës së të cilëve rregullohen me Kodin e Punës

Bazuar në Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe kontratën individuale të punës, pasi të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar shkeljet e evidentuara dhe të jenë identifikuar përgjegjësit në lidhje me këto shkelje, kërkojmë fillimin e dhënies së masave disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna” për të gjithë punonjësit e konstatuar me përgjegjësi sipas çështjeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

D. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

E. TË TJERA, PËR MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe përcaktimeve të pikave 1 dhe 2, të nenit 17, të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për problematikat e konstatuara në drejtimin dhe organizimin e veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve i rekomandohet Titullarit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë disiplinore për Drejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve në përputhje me kuadrin ligjor të rregullimit të marrëdhënieve përkatëse të punës.